



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



GJUHA DHE IDENTITETI I SHQIPTARËVE  
NË INTEGRIMIN EVROPIAN

PUNIM PËR GRADËN SHKENCORE  
“DOKTOR” NË GJUHËSI

Specialiteti: GJUHËSI/KOMUNIKIM

Disertante:

Msc. Bukuroshe ISUFAJ

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. Klodeta DIBRA

Tiranë, 2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE

PUNIM PËR GRADËN SHKENCORE  
“DOKTOR” NË GJUHËSI

Specialiteti: GJUHËSI/KOMUNIKIM

Përgatitur nga:  
znj. BUKUROSHE ISUFAJ

TEMA:

GJUHA DHE IDENTITETI I SHQIPTARËVE  
NË INTEGRIMIN EVROPIAN

Komisioni për mbrojtjen e doktoratës:

1. Prof. Dr. Artur SULA	Kryetar	_____
2. Prof. Dr. Gjovalin SHKURTAJ	Oponent	_____
3. Prof. Dr. Bardhosh GAÇE	Oponent	_____
4. Prof. Dr. Saverina PASHO	Anëtar	_____
5. Prof. As. Dr. Esmeralda KROMIDHA	Anëtar	_____

Tiranë, 2015

## Falënderime dhe mirënjohje

*Dëshiroj të shpreh falënderimet e mia të përzemërta dhe mirënjohje të thellë për të gjithë personat që ndihmuan dhe kontribuan në realizimin e këtij punimi.*

*Falënderimi më i sinqertë dhe mirënjohja ime më e madhe shkon për udhëheqësen shkencore, Prof. Dr. **Klodeta Dibra**, për përkrahjen dhe mbështetjen, këshillat e vyera dhe përkushtimin e saj ndaj meje për realizimin e këtij studimi kompleks mbi gjuhën dhe identitetin e shqiptarëve në integrimin evropian.*

*Falënderoj shefin e Departamentit, Prof. Dr. **Artur Sula**, për inkurajimin që më ka dhënë që ta vazhdoja këtë objektiv të rëndësishëm.*

*Falënderoj gjithashtu familjen time, për mbështetjen e saj të vazhdueshme që unë ta kryeja këtë studim, duke më liruar nga shumë angazhime familjare, me qëllim që ta kisha krejt kohën në dispozicion të këtij studimi.*

Msc. Bukuroshe Isufaj

## PASQYRA E LËNDËS:

<b>FALËNDERIME</b> .....	<b>iii</b>
<b>PASQYRA E LËNDES</b> .....	<b>iv</b>
<b>HYRJE</b> .....	<b>vii</b>

### **KAPITULLI I**

#### **GJUHA DHE IDENTITETI I SHQIPTARËVE PËRBALLË INTEGRIMIT EVROPIAN**

I.1.Hyrje e përgjithshme rreth integrimit evropian.....	1
I.2.Dukuria e Globalizmit-histori e shkurtër.....	3
I.3.Bashkimi Evropian dhe strukturat e tij.....	8
I.4.Struktura e BE-së dhe shtyllat e saj.....	10
I.5.Institucionet e BE-së-Këshilli Evropian.....	12
I.6. Gjuhët e Bashkimit Evropian dhe statusii anglishtes.....	20
I.7.Statusi i shqipes në Republikën e Shqipërisë dhe në hapësirat shqiptare në Ballkan e më gjerë.....	21
I.8.Shqiptarët dhe plurilinguzmi në Evropën e Bashkuar.....	25
I.9.Gjuhët kombëtare dhe gjuhët zyrtare në Bashkimin Evropian.....	26
I.10.Anglishtja në kuadrin e BE-së, aspekte politiko-shoqërore dhe gjuhësore.....	30
I.11.Koncepti i sociolinguistikës së sotme ndaj gjuhëve kombëtare të BE-së.....	34

### **KAPITULLI II**

II.1.Shqipëria dhe Bashkimi Evropian.....	41
II.2.Shqipja përballë gjuhëve të Evropës:Kufijtë shtetërorë dhe shtrirja truallësore e shqipes.....	54
II.3.Rreth dygjuhësisë në bashkësinë gjuhësore shqiptarenë hapësirat truallësore shqiptare në Ballkan dhe në diasporë.....	61
II.4.“Flukset e dukshme” dhe “të padukshme” në kohën e sotme dhe pasojat e tyre kulturore e gjuhësore.....	69
II.5.“Flukset e padukshme” si përçuese të së resë në ligjërim.....	73

II.6.Roli i shkollës dhe i librit në kultivimin e gjuhës shqipe letrare.....	79
II.7.Ndikimi i internetit dhe i rrjeteve sociale në gjuhën shqipe.....	83
II.8Radio-televizioni dhe organet e shtypit si shtypsa integruese.....	86
II.9.Cilat janë anët pozitive dhe negative të televizionit?.....	88
II.10.Pasojat gjuhësore dhe shoqërore të reklamave mbi fëmijët.....	92
II.11.Shprehitë e të folurit dhe televizori.....	93

### **KAPITULLI III**

III.1.Huazimet në shqipen si tregues të integritit të hershëm e të sotëm....	96
III.2.Huazimet nga greqishtja në shqipen.....	101
III.3. Huazimet nga latinishtja në shqipen.....	103
III.4.Huazimet nga italishtja në shqipen.....	105
III.5.Huazimet nga gjuhët orientale në shqipen.....	107
III.6.Huazimet nga turqishtja në shqipen.....	109
III.7.Degëzimi tematik dhe kulturor i orientalizmeve në shqipen.....	118
III.8.Ndërkombëtarizmat në shqipen e sotme.....	122
III.9.Fjalët e huaja të panevojshme.....	125
III.10. Huazimet nga anglishtja.....	126
III.11.Ndikime nga anglishtja dhe gjuhët e tjera në drejtshkrim.....	130
III.12. Ndikimet evropianizuese në drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj në shqipen.....	137

### **KAPITULLI IV**

#### **SHTRIRJA E SHQIPES NE HAPESIRAT SHQIPTARE BALLKANIKE**

IV.1. Statusi i shqipes në diasporë.....	140
IV.2.Statusi zyrtar i shqipes në Greqi.....	142
IV.3.Gjendja socio-dhe etnolinguistike e arbëreshëve të Italisë.....	144
IV.4. Gjuha shqipe në shkollat arbëreshe të Kalabrisë e të Sicilisë.....	146
IV.5.Arbneshët e Zarës dhe gjuha e tyre.....	146
IV.6.Gjuha shqipe në Mal të Zi.....	148
IV.7. Shqiptarët e Bullgarisë dhe gjuha e tyre.....	149
IV.8.Shqiptarët e Ukrainës dhe gjuha e tyre.....	151

## **KAPITULLI V**

V.1.Zhvillimet e shqipes në vitet e fundit, probleme aktuale dhe perspektiva.....	154
V.2Hapësira të shqipes në botë. Pjesë plotësuese e thelluese për integrimet e shqipes në mjediset evropiane.....	159
V.3. Kurset e gjuhës shqipe për të huaj dhe katedrat e shqipes në Itali, Greqi, Rusi etj.....	162
V.4. Shkolla shqipe në Zvicër - Mësimi plotësues ose ruajtja e shqipes përmes shkrimit.....	164
V.5. Hapësira të reja të shqipes në mjediset greke.....	166
<b>PËRFUNDIME.....</b>	<b>168</b>
<b>BIBLIOGRAFIA.....</b>	<b>182</b>

## **HYRJE**

### **0.1. Përlligjja e punimit**

*Në bashkëpunim me udhëheqësen time shkencore, Prof.Dr. Klodeta Dibra, zgjodhëm si temë për studimin e doktoratës “Gjuha dhe identiteti i shqiptarëve në integrimin evropian”. Zgjedhëm këtë temë, për arsye, se larmia e gjuhës dhe zhvillimi i saj në rrjedhë të kohës, po edhe në varësi nga kushtet historiko-shoqërore dhe faktorët e tjerë jashtëgjuhësorë, paraqesin interes dhe vlera njohëse. Gjithashtu, aktualiteti që paraqet trajtimi i temave të tilla bashkëkohore e të lidhura aq ngushtë me kahët e zhvillimit e sotme të shqiptarëve dhe të kulturës së tyre, rrjedhimisht edhe të gjuhës e ligjërimit të shkruar e të folur në hapësirat shqiptare, është një tjetër arsye e përzgjedhjes sonë.*

*Zgjedhja e temës së mësipërme mbështetet në disa argumente:*

*1) Evropianizimi dhe botërorizimi i kulturës shfaqet dukshëm edhe në gjuhë, në stilin e të shkruarit dhe të të folurit, në etnografinë e sjelljes dhe në etnografinë e komunikimit, pra, edhe në gjuhën e shkruar e të folur. Në kushtet kur shoqëritë po bëhen gjithmonë e më të hapura, pikëtakimet e shpeshta mes njerëzve që u përkasin etnive, besimeve fetare, klasave shoqërore të ndryshme kanë lindur nevojën për të studiuar elementet çelës të komunikimit për të arritur: mënyrë më efektive të të folurit dhe të dëgjuarit, kuptim më të qartë të partnerit, zgjidhje më të shpejtë të konflikteve, përmirësim të komunikimit prindër-fëmijë. Me shumë rëndësi janë sot situatat e ligjërimit në rastet e fëmijëve të emigranteve shqiptare të martuar me të huaj, d.m.th. me joshqiptarë (dhe anasjelltas: të meshkujve shqiptarë të martuar me joshqiptare).*

*Njohja dhe studimi i thelluar i gjuhës shqipe, në takim me gjuhët e huaja fqinje dhe me gjuhët e Evropës, sidomos me anglishten, por edhe në hapësirat e diasporave të hershme e të sotme arvanite (në Greqi), arbëreshe (në Itali), arnauete (në Turqi, Bullgari, Ukrainë) dhe në qytetet e mëdha të Evropës e deri në Amerikë, qoftë për vlerat e ditura si shqipe e shkëputur herët nga trangu amtar, qoftë për ndikimin që kanë pësuar prej pesë shekujve nga gjuhët e huaja të vendeve përkatëse ku janë shpërngulur (nga greqishtja, italishtja, turqishtja, bullgarishtja, ukrainishtja; në shekujt e fundit edhe nga anglishtja në diasporën shqiptare të Amerikës etj.), pastaj edhe nga rrjedhat e zhvillimeve të sotme, kanë rëndësi shkencore të veçantë.*

*Emigrantët shqiptarë në Evropë e në mbarë Botën përbëjnë sot një network të konsiderueshëm dhe një aspekt interesant të njohjes së simbiozës së dy qytetërimeve, kurdoherë nëpërmjet depërtimit në proceset e kalimit prej sociolketëve monolinge shqiptare në sociolekte dygjuhëshe, së pari, vetëm me bilingualitet ose nxënie gjuhe “nga jashtë”, pastaj në diglosi e dygjuhësi të realizuar e të mbështetur në*

*dykulturorësi e në ndërthurjen e qytetërimeve në simbiozë. Bashkësitë monolinge po pakësohen dhe, kudo në Evropë, po edhe më gjerë në botë, përzierjet etnike janë shtuar dukshëm dhe problemet e tyre nuk mund të zgjidhen vetëm me domosdoshmërinë që ndjenë ata për të nxënë gjuhën e mjedisit.*

*Në kuadrin e simbiozës me vendasit dhe me ardhës prej etnish të ndryshme, monolingvizmi do të plekset gjithmonë e më shumë me bilingvizmin e diglosinë, gjithmonë nëpërmjet bikulturalizmit e multilingvizmit si pamjet më të forta të qasjes së qytetërimeve në takim. Jo vetëm në fillesat e emigracionit, por edhe për shumë vjet më vonë, ndoshta edhe për dekada, emigrantët do të jenë nën dy trysni a kahe emocionale dhe gjuhësore: midis “gjuhës së bukës” dhe “gjuhës së zemrës”.*

*2) Çdo shkencë ka një fushë të caktuar studimi së cilës i referohet. Ajo përmbahet edhe në termin a emërtimin përkatës, si psh: arkeologjia, historia, gjeografia, kimia. Tema jonë përfshihet në një fushë të caktuar e pikërisht të Sociolinguistikës, e cila ka emërtim të përbërë nga dy rrënjë të ndryshme (socio “shoqëri, shoqëror+linguistikë “gjuhësi”), që mbahet disi në mes të dy kaheve studimore: të gjuhësisë, që ka për objekt studimin e gjuhës e të sistemeve a nënsistemeve të saj, dhe të aspektit shoqëror a, më saktë, të faktorëve jashtgjuhësorë ndikues, të cilët janë shtytës themelorë në jetën e gjuhës së folur e të shkruar të çdo shoqërie të caktuar.*

*Fusha e studimit të sociolinguistikës nuk është struktura e shoqërisë, por gjuha e shoqërisë, sikundër po shihet gjithandej, shoqëria dhe faktorët shoqërorë vendorë, kombëtarë dhe, madje, ndërkombëtarë, ndikojnë fuqishëm në kahet dhe rrjedhat e zhvillimit të gjuhës. Ata herë ndihmojnë fuqishëm, herë, përkundrazi, edhe mund të pengojnë. Po u zhvilluan shkollat dhe institucionet publike e private të një vendi, po pati hapje ndaj botës dhe kultuarve të tjera, sigurisht ka edhe prurje e hapësira të reja ligjërimore e kulturore. Përndryshe do të mbeteshim në izolimin e njohur të periudhave tashmë të tejkaluara.*

*3) Globalizmi është një dukuri që prek në thellësi edhe proceset gjuhësore. Shpesh, duke përmendur këtë koncept, mendja na shkon tek “hegjemonia” e anglishtes e cila, në kuadrin e një “lingua franca” po shtrihet shumë shpejt në botë, duke ndikuar ndjeshëm mbi gjuhët vendase në Evropë e më gjerë, në mbarë Botën. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për shqipen, ku huazimet nga anglishtja duket se po perceptohen si një normalitet për shkak të fluksit të dendur e të papërbalueshëm të tyre. Megjithatë, globalizmi nuk mund të reduktohet thjesht në fjalë e struktura të huazuara nga anglishtja; ai depërton më thellë në psikikën e popujve, prek marrëdhëniet e tyre, të cilat, sigurisht, reflektohen edhe në gjuhë.*

*Konteksti global dhe proceset integruese po mishërohen në sistemin e shqipes, po orientojnë modelet e komunikimit të shqiptarëve, prandaj edhe pasojat e tyre në gjuhën shqipe janë të dukshme.*

*Së pari, ndryshime vihen re në ligjërimin publik (si në formë, edhe në përmbajtje), në gjinitë dhe stilet e përdorura, ku ndihet bindshëm ndikimi i gjuhëve të huaja, kryesisht i anglishtes. Ky ndikim reflektohet në fjalor, në struktura gjuhësore të*

huazuara, nëmodelet e ndjekura për hartimin e raporteve, kërkesave, projekteve të shkruara, kjo për arsye të bashkëpunimit me organizata, institucione dhe partnerë të huaj. Madje, jo të rralla janë rastet kur edhe vetë komunikimi/dialogimi kryhet tërësisht në anglisht. Mjaft të përdorshme në këtë lloj konteksti janë huazime leksikore e strukturore si: implementim projekti, ndërtim i kapaciteteve, resurse humane/natyrore; partnership; investime publike, workshop-e etj.

Mendojmë se, këtij ndikimi, është e pamundur t'i shpëtohet plotësisht, pasi prirja është e qartë, ajo lidhet me aspiratat e shqiptareve për integrim në Evropë, por çështja është që huazimet të përdoren me kriter, siç është rasti kur shqipja mund të paraqitet me mungesë fjalësh për një koncept të ri (p.sh. kompjuter, biznes) ose kur fjala e huaj mbart ndonjë ngjyrim kuptimor e stilistikor, që nuk e ka në shqip, p.sh. themi “fansat e Maikell Xhekson-it” dhe jo “tifozat e Maikell Xhekson-it”; “do të shoh një film me serial killer” dhe jo “me vrasës në seri”, sepse ka tjetër ngarkesë emocionale në anglisht.

## **0.2. Objekti, karakteri dhe synimet e punimit**

Studimi ynë synon të jetë hulumtues, rreth gjuhës së shkruar dhe ligjërimeve të folura të shqipes në hapësirat shqiptare ballkanike dhe në diasporë, duke vështruar si është përdorur ajo në kontekste të ndryshme, sa më të larmishme dhe me mundësi për të parë në rrafsh të ndryshme, se si shkallëzohet pragmatikisht gjuha e shkruar dhe e folur nën gjykimin e bindjes, duke u pykëzuar në fusha të komunikimit, duke pasur si objekt dhe synim kryesor të studimit: ekuilibrin ndërmejt dy kaheve të mirënjohura në sociolinguistikë, midis “gjuhës së zemrës” dhe “gjuhës së bukës”, që do të thotë edhe shqyrtim i asaj që vjetërohet e zhduket, po edhe i asaj që vjen e re dhe që ka si shtysa jo vetëm faktorët mirëfilli gjuhësorë, por kryesisht shoqërorë, pra jashtëgjuhësorë.

Ndër këta faktorë, këto njëzet vite e fundit, pa dyshim, edhe në gjuhën shqipe ka dalë në dukje me mjaft peshë procesi integrimi evropian. Ky integrim është pa dyshim edhe gjuhësor. Në sociolinguistikë përshkruhen karakteristikat gjuhësore, që lindin dhe pasqyrojnë trysninë shoqërore ose, e thënë ndryshe: larminë dhe variacionet ligjërimore që shfaqen në gjuhë si pasqyrim i ndikimit të faktorëve shoqërorë jashtëgjuhësorë.<sup>1</sup>

Njerëzit flasin gjuhë dhe dialekte të ndryshme. Këtë e ka pasur dhe vijon ta ketë për objekt studimi gjuhësia, e cila tradicionalisht është quajtur edhe me termin ndërkombëtar linguistikë. Qysh nga krijimi i gjuhës si mjet komunikimi e shprehjeje, në vende të ndryshme, gjuhët kanë pasur e kanë gjithandej edhe larmi variantesh të ndryshme, sipas një numri të madh faktorësh shoqërorë, jashtëgjuhësorë, si: personi që flet, cilësitë dhe karakteristikat e tij, mjedisi shoqëror ose vendi dhe koha kur kryhet procesi i ligjërimit konkret, si dhe faktorë të tjerë, gjithmonë në shtim e me

---

<sup>1</sup>Shih: R.Hudson, *Sociolinguistika*, Përkthyer nga M.Ymeri, Dituria, 2002 ; G.Berruto, *Fondamenti di sociolinguistica*, Editore Laterza, 2006; Gj.Shkurta, *Sociolinguistika*, Shblu, Tiranë, 2009.

*peshë, për hir të të cilëve asnjë gjuhë nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë njëvariantëshe.*

*Domosdoshmëria për ta parë, përshkruar dhe studiuar gjuhën e çdo bashkësie të caktuar në larminë dhe ndryshueshmërinë e pafundme të saj, me kohë, krahas gjuhësisë tradicionale dhe degëve të saj, si diaktellogjia, fonetika, gramatika, leksikologjia, leksikografia, solli në skenë edhe atë disiplinë “hibride”, që sot quhet Sociolinguistikë. Pra, është e nevojshme të pranojmë se sociolinguistika përbën një disiplinë më vete, të pavarur dhe të veçuar aq sa kërkohet që një shkencë humane të mund të konsiderohet e pavarur nga të tjerat.*

*Kjo shkencë e re “hibride” është përvijuar e ka ecur përpara jo vetëm nga sociologë e gjuhëtarë, siç parakupton termi me të cilin emërtohet, por edhe nga përfaqësues të disiplinave të tjera. Pra, sociolinguistika ka qenë qysh në fillim fryt i një kërkimi ndërdisiplinor.*

*Vështrimi i sotëm sociolinguistik ka lënë pas pikënisje e teza të gjuhësisë tradicionale. Hapësira e re ka vërtetuar se variabilitetet dhe sjellja gjuhësore janë të lidhura me tregues etnikë, fetarë, moshorë, krahinorë, arsimorë etj. Nga pikënisja për kundrimin sociogjuhësor të të folmeve të fshehta apo për lidhjen midis dialekteve dhe gjuhës standarde në vitet ‘50–‘60, zëdhënësit e një modeli të ri shestuan, anketuan, përgatitën pyetësorë e tekste universitare, duke treguar se arealet shqiptare janë pasuri që presin punë dhe kërkime të reja<sup>2</sup>.*

*Studimi në vijën si thellim e mbështetje e fushës “Qytetërime në simbiozë e gjuhë në kontakt” dhe, në vijim të shtjellimeve që janë bërë në boshtin “përplasja e qytetërimeve” të formuluar prej Hantingtonit, si dhe të sociologëve të tjerë në fundshekullin XX, në mijëvjeçarin e ri kërkohet edhe hetime konkrete në aspektin sociolinguistik të proceseve të lidhura me emigrimin dhe imigrimin e shqiptarëve.*

*Mbi bazën e mundësive të sotme për hulumtime, do të ndiqen dy drejtime vëzhgimesh e analizash gjuhësore: të shqiptarëve që ua do puna t’i mësojnë gjuhët e huaja, duke emigruar në Evropë (Itali, Greqi, Zvicër, Gjermani, Angli etj.), por edhe të evropianëve që, qoftë edhe në sasi më të vogla, jetojnë në Shqipëri e janë në kushte simbioze.*

*Një shqyrtim i tillë në aspektin sociolinguistik dhe etnolinguistik mendojmë se mund të japë rezultate të rëndësishme për njohjen e ecurisë dhe shkallëzimit që ndjek sot procesi i dygjuhësisë dhe i shumëkulturalizmit shqiptaro-evropian.*

*Emigrantët shqiptarë në diasporat e hershme arvanite, arbëreshe dhe shqiptare tëfundshekullit XX dhe të dekadave të para të mijëvjeçarit të ri, përbëjnë një network të konsiderueshëm dhe një aspekt interesant të njohjes së simbiozës së qytetërimeve të*

---

<sup>2</sup>Shih për këtë ndihmesën Q. Haxhihasanit për të folmen e dogançes, artikujt e A. Kostallarit, J. Gjinarit për dialektet dhe gjuhën standarde; ndihmesën tërësore socio- e etnolinguistike të Gj. Shkurtajt, prurjet e R. Memushajt për planifikimin gjuhësor e bilinguizmin.

pranëvëna dhe gjuhëve në kontakt, kurdoherë nëpërmjet depërtimit në proceset e kalimit, prej sociolekteve një gjuhëshe arbëreshe e shqiptare, në sociolekte dygjuhëshe, së pari, vetëm me dygjuhësi ose nxënie gjuhe “nga jashtë”, pastaj në diglosi e dygjuhësi të realizuar e të mbështetur në dykulturorësi e në ndërthurjen e qytetërimeve në simbiozë.

Bashkësitë njëgjuhëshe po pakësohen dhe, kudo në Evropë, po edhe më gjerë në botë, përzierjet etnike janë shtuar dukshëm dhe problemet e tyre nuk mund të zgjidhen vetëm me domosdoshmërinë që ndjenë ata për të nxënë gjuhën e mjedisit.

Në kuadrin e simbiozës me vendasit dhe me ardhës prej etnish të ndryshme, njëgjuhësia (monolinguizmi) do të plekset gjithmonë e më shumë me dygjuhësinë e diglosinë, nëpërmjet dykulturorësisë e qasjes së qytetërimeve në takim. Jo vetëm në fillimet e emigracionit, por edhe për shumë vjet më vonë, ndoshta edhe për dekada të tëra, emigrantët do të jenë nën dy trysni a kahe emocionale dhe gjuhësore: midis “gjuhës së bukës” dhe “gjuhës së zemrës”.

### **0.3. Metodologjia dhe struktura e punimit**

Në kushtet kur shoqëritë po bëhen gjithmonë e më të hapura, pikëtakimet e shpeshta mes njerëzve, që u përkasin etnive, besimeve fetare, klasave shoqërore të ndryshme kanë lindur nevojën për të studiuar elementet-çelës të komunikimit, për të arritur mënyrë më efektive të të folurit dhe të dëgjuarit, kuptim më të qartë të partnerit, zgjidhje më të shpejtë të konflikteve, përmirësim të komunikimit prindër-fëmijë.

Me shumë rëndësi janë sot situata e ligjërit në rastet e fëmijëve të emigranteve shqiptare, të martuara me qytetarë evropianë: italianë, gjermanë, zviceranë, belgë, francezë, anglezë etj. (dhe anasjelltas: të meshkujve shqiptarë të martuar me joshqiptare).

Rasti i emigracionit shqiptar në Itali, ashtu si edhe në Greqi, Zvicër, SHBA etj. meriton të studiohet jo vetëm nga ana sociolinguistike dhe etnolinguistike, por edhe si faktor i pranëvënies dhe qasjes së qytetërimeve.

Sigurisht, në studimin tonë do të trajtohen edhe shfaqje të kulturës globale në gjuhën shqipe, duke theksuar se globalizmi është dukuri që prek në thellësi edhe proceset gjuhësore.

Shpesh, duke përmendur këtë koncept, mendja na shkon tek “hegjemonia” e anglishtes, e cila, në kuadrin e një “lingua franca” po shtrihet shumë shpejt nëpër botë, duke ndikuar ndjeshëm mbi gjuhët vendase.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për shqipen, ku huazimet nga anglishtja duket se po perceptohen si një normalitet për shkak të fluksit të dendur e të papërbalueshëm të tyre.

Lidhur me këtë dukuri, akad. Kolec Topalli shkruan :“Jetojmë në epokën e globalizmit, kur marrëdhëniet e dendura ndërmjet shteteve, krahinave e gjuhëve janë shtuar së tepërmi; kur këmbimet kulturore, letrare e artistike janë shumëfishuar, kur zhvillimi i vrullshëm i shkencës e i teknikës ecën me ritme të paparashikueshme”. Në kushte të tilla, **të gjitha gjuhët ndodhen para një dukurie të re, që është globalizmi gjuhësor**. Gjuhët e mëdha e të zhvilluara, që kanë përparësinë e zhvillimit ekonomik, shkencor, teknik e artistik, gëzojnë edhe përparësinë gjuhësore, duke u bërë rrezatuese të fjalëve, shprehjeve dhe formave të reja në të gjitha gjuhët me të cilat janë në kontakt popujt e vendeve të ndryshme të globit.

Një dukuri e tillë është e pashmangshme edhe për shqipen, madje, në një shkallë edhe më të lartë se gjuhët e tjera, që kanë pasur stabilitet më të hershëm kombëtar e gjuhësor, krahas stabilitetit politik, ekonomik e shoqëror.

Për gjuhën shqipe, globalizmi është një dukuri e pashmangshme. Shumë fjalë, shprehje dhe ndërtime gramatikore të gjuhëve të huaja depërtojnë çdo ditë, orë e minutë në gjuhën shqipe. Ky depërtim është i fuqishëm nga dy burime: nga gjuhët romane, për arsye të traditës së krijuar prej disa shekujsh, sipas së cilës elementet e reja të gjuhës kanë depërtuar kryesisht nga këto gjuhë, sidomos prej italishtes e frëngjishtes. Burimi i dytë është anglishtja, fuqia e së cilës, si gjuha me prestigjin më të lartë botëror, është bërë e ndieshme në të gjitha gjuhët evropiane, sidomos në shekullin e fundit, duke përfshirë edhe shqipen.”<sup>3</sup>

Në punimin tonë të disertacionit për mbrojtjen e gradës Doktor i Shkencave jemi përpjekur që arkitekturën e studimit ta ndërtojmë në përshtatje me gjithë problemet që ka krijuar përballja e integritetit evropian në gjuhën dhe integritetin e shqiptarëve, ku ndihet edhe presioni i gjuhëve të mëdha si anglishtja, frëngjishtja, italishtja e gjermanishtja, të cilat diktohen edhe nga marrëdhëniet e reja të komunikimit dhe emigrimit bibliotekësor të shqiptarëve në Evropë.

**Në kapitullin e parë**, duke analizuar disa aspekte të gjuhës dhe identitetit të shqiptarëve përballë integritetit evropian kemi nxjerrë në dritë mjaft çështje që lidhen me dukuritë e globalizmit dhe dëshirave të shqiptarëve për tu përfshirë në rrjedhat e tij. Është pikërisht procesi i globalizimit ai që është i ndërlidhur të shqiptarët edhe me hapsirat e reja të komunikimit midis njerëzve, i cili, ka krijuar vizione të reja jo vetëm për ndarjet gjeopolitike, etnike dhe kulturore.

Në këtë drejtim, në këtë kapitull dhe hulumtimet që kemi bërë më pas jemi ndalur në analiza e përgjithësime të fjalëve e termave të përdorshme në Bashkimin Evropian me anën e të cilave realizohet një komunikim global, por duke u këndvështruar edhe në aspektin se gjuha dhe feja e njerëzimit janë elemente të rëndësishme Shndërrimet e mëdha shoqërore dhe ekonomike, si dhe marrëdhëniet e afërta me kulturat dhe gjuhët e popujve të tjerë kanë sjellë ndryshime të dukshme edhe në sjelljen gjuhësore të shqiptarëve në mbarë hapësirat e Republikës, po dhe më gjerë, sidomos në hapësirat kombëtare shqiptare, në trojet kompakte ballkanike, madje, deri në diasporat e hershme historike ende shqipfolëse.

---

<sup>3</sup>Shih: Kolec Topalli, *Dialektet e shqipes dhe standardi në kushte e globalizmit*, kumtesë, maj.2014.

*Në kapitullin e dytë të këtij punimi, duke parë përfshirjen e vendit tonë në proceset integruese në Bashkimin Evropian, kemi analizuar ndikimin e fuqishëm që ka anglishtja si gjuhë e globalizimit në tërë jetën shqiptare si dhe marrëdhëniet e saj me gjuhën shqipe. Tashmë gjuha angleze mësohet qysh në kopështet e fëmijëve, ajo zë vend të vaçantë në jetën politike dhe shtetërore, mjaft ligje e "drafte" hartohen duke u bazuar në modele të huaja. Në mjaft shkolla të mesme dhe universitete programet mësimore po njësohen me ato të Amerikës dhe vendeve të tjera evropiane.*

*Po kështu në vendin tonë dhe në Kosovë veprojnë një varg organizatash të huaja si OSBE, NATO, PNUT, KFOR, e gjithashtu mjaft kompani biznesi, shoqëri prodhuese, hotele, bare, gazeta, revista dhe institucione emrat e tyre i shkruajnë në anglisht, ashtu si veprohet edhe me gjuhën e kompjutrave dhe të elektronikës.*

*Në këtë proces kemi analizuar dhe depërtimin në gjuhën shqipe të fjalëve të reja nga gjuhë të ndryshme si latinishtja, greqishtja e sidomos nga anglishtja e nga ndonjë gjuhë tjetër.*

*Në dekadat e fundit gjuha shqipe është mjaft e përhapur përballë gjuhëve të huaja, sidomos përballë anglishtes, por edhe përballë italishtes e greqishtes, për shkak të emigrimit të madh të shqiptarëve, por edhe të mjaft emërtimeve në fushën e informatikës, të financës, të ekonomisë së tregut, të biznesit dhe të arteve modern të cilat kanë marrë një zhvillim bashkëkohor duke mbushur dhe zbrazëtinë e leksikut që krijohet prej tyre.*

*Çështjen e pastërtisë së leksikut e kemi parë të ndërlidhur me ruajtjen e gjuhës amtare, por edhe me kristalizimin e normave të gjuhës standarte në leksik. Në këtë drejtim një veprimtari e gjerë po zhvillohet sot në të gjitha sferat e jetës shqiptare edhe për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës standarte, pra zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë shqipe.*

*Në kapitullin e tretë të këtij punimi një vend të vaçantë zënë huazimet në shqipen si tregues të integritetit të hershëm dhe atij bashkëkohor. Edhe ndër shqiptarët gjuha është e lidhur ngushtë me veprimtarinë prodhuese të tyre, por nga ana tjetër ajo bëhet pasqyrë e kulturës së tij përgjatë zhvillimit historik. Në këtë drejtim kemi argumentuar rëndësinë e vaçantë të dëshmimeve gjuhësore, jo vetëm në fushën gjuhësore por edhe në shkencat e tjera albanologjike; në etnografi, folklor, kulturën popullore, në historinë dhe arkeologjinë.*

*Fjalët e huaja kanë hyrë në gjuhën shqipe në rrjedhë të kohërave dhe vazhdojnë të hyjnë ende me veçoritë e tyre specifike në të dy pjesët kryesore të leksikut; në leksikun e përgjithshëm dhe atë terminologjik. Gjendja e bilinguizmit ka çuar në ndikime të mëdha deri edhe në strukturën gramatikore të shqipes. Në këtë drejtim mjaft studime bëjnë fjalë për detyrat dhe përgjegjësitë e gjuhësisë shqiptare duke trajtuar një varg problemesh që sqarojnë në mënyrë më të plotë pozicionin e saj.*

*Duke këndvështruar këto dukuri kemi vënë në dukje se ndikimi i globalizmit në gjuhën shqipe nuk mund të shihet vetëm si ndikimi i anglishtes dhe që shprehet nëpërmjet huazimeve e barbarizmave. Globalizmi dhe proceset integruese janë të lidhura ngushtë edhe në aspektin e zhvillimeve të përgjithshme politike, ekonomike, kulturore, letrare dhe padyshim gjuhësore, që kanë dhënë ndikimin e vet edhe në llojshmërinë e ligjërimeve diskurse të shqipes së sotme.*

*Në kapitullin e katërt kemi analizuar shtrirjen e shqipes në hapësirat shqiptare ballkanike, për të argumentuar ndryshimet që ka pësuar ajo në treva e vise të ndryshme. Duke u mbështetur në një material të pasur gjurmues kemi përfutur edhe statusin e shqipes në diasporë duke dhënë kështu një pamje të përgjithshme për të folmen e arvanitasve në Greqi, e arbëreshëve në Itali si dhe të mbarë të folmeve të diasporës shqiptare në kontakt me gjuhët e tjera evropiane.*

*Hapësirat e shqipes në botë na kanë dhënë mundësinë që të këndvështrojmë edhe më mirë integrimet e shqipes në mjediset evropiane si në Mal të Zi, Zvicër, SHBA, Itali, Greqi, Rusi, Angli e vende të tjera.*

*Larmia e gjuhës dhe zhvillimi i saj në rrjedhë të kohës, po edhe në varësi nga kushtet historiko-shoqërore dhe faktorët e tjerë jashtëgjuhësorë, paraqesin interes dhe vlera njohëse. Gjithashtu, aktualiteti që paraqet trajtimi i temave të tilla bashkëkohore e të lidhura aq ngushtë me kahët e zhvillimet e sotme të shqiptarëve dhe të kulturës së tyre, rrjedhimisht edhe të gjuhës e ligjërimit të shkruar e të folur në hapësirat shqiptare, është një tjetër arsye e përzgjedhjes sonë.*

*Studimi ynë synon të jetë hulumtues, rreth gjuhës së shkruar dhe ligjërimeve të folura të shqipes në hapësirat shqiptare ballkanike dhe në diasporë, duke vështuar si është përdorur ajo në kontekste të ndryshme, sa më të larmishme dhe me mundësi për të parë në rrafsh të ndryshme, se si shkallëzohet pragmatikisht gjuha e shkruar dhe e folur nën gjykimin e bindjes, duke u pykëzuar në fusha të komunikimit, duke pasur si objekt dhe synim kryesor të studimit: ekuilibrin ndërmejt dy kaheve të mirënjohura në sociolinguistikë, midis “gjuhës së zemrës” dhe “gjuhës së bukës”, që do të thotë edhe shqyrtim i asaj që vjetërohet e zhduket, po edhe i asaj që vjen e re dhe që ka si shtysa jo vetëm faktorët mirëfilli gjuhësorë, por kryesisht shoqërorë, pra jashtëgjuhësorë. Një shqyrtim i tillë në aspektin sociolinguistik dhe etnolinguistik mendojmë se mund të japë rezultate të rëndësishme për njohjen e ecurisë dhe shkallëzimit që ndjek sot procesi i dygjuhësisë dhe i shumëkulturalizmit shqiptaro-evropian.*

*Ky studim do t’u vijë në ndihmë, jo vetëm studiuesve dhe studentëve, por edhe sociologëve e politologëve, duke qenë se në kohën tonë kudo në Evropë po bëhen përpjekje të vazhdueshme për të vënë në jetë politika integruese të atilla që, nëpërmjet dygjuhësisë dhe dykulturorësisë, të realizohet sa më mirë simbioza e popullsive etnikisht të ndryshme të parëvëna në mjedise të përbashkëta.*

*Rasti i emigracionit shqiptar në Itali, ashtu si edhe në Greqi, Zvicër, SHBA etj. meriton të studiohet jo vetëm nga ana sociolinguistike dhe etnolinguistike, por edhe si faktor i pranëvënies dhe qasjes së qytetërimeve*

## KAPITULLI I

### GJUHA DHE IDENTITETI I SHQIPTARËVE PËRBALLË INTEGRIMIT EVROPIAN

#### I.1 Hyrje e përgjithshme rreth integrimit evropian

Në vitin 1990 në Shqipëri iu dha goditja e parë e rëndësishme diktaturës komuniste. Lëvizjet masive dhe ato studentore e detyruan udhëheqjen e partisë së vetme asokohe të ligjëronte ekzistencën e partive të tjera. Kështu, Shqipëria përfitoi një sistem politik pluralist. Njerëzit mundën të përfaqësoheshin nga forca të tjera përveç Partisë së Punës (pasardhëse e vazhduese e Partisë Komuniste), e cila, që prej vitit 1945, e kishte sunduar vendin me grusht të hekurt. Simbolikisht, ky ishte fundi i diktaturës.<sup>4</sup>

“E duam Shqipërinë si gjithë Evropa” ishte vizioni i atëhershëm i mijëra njerëzve, sidomos nga masa e të rinjve që dolën në rrugë. Gra e burra, të rinj e të moshuar, njerëz që, në jetën e tyre, kurrë nuk kishin udhëtuar jashtë vendit, të gjithë e donin Shqipërinë të bëhej si Evropa. Ky nuk ishte thjesht një slogan që përfaqësonte një aspiratë a ëndërr. Ai përfaqësoi besimin e patundur në mundësitë e vendit.

Ai përfaqësoi thirrjen për identitet; qëndroi si kërkesë për t’iu kthyer udhës nga e cila breza të tërë ishin shmangur me forcë. Ai përfaqësoi shprehjen e qartë të vullnetit të popullit. Që prej asaj kohe, të gjitha partitë politike në Shqipëri kanë deklaruar se duan integrimin në Bashkimin Evropian, si synimin qëndror të programeve të veta partiake e qeverisëse.

Në vitin 1992, Bashkimi Evropian filloi të funksiononte si i tillë. Ky ishte viti i Traktatit të Mاستrihtit, me anë të të cilit Komuniteti Evropian u bë Bashkimi Evropian dhe hodhi themelet për një bashkim aktiv dhe efektiv, përmes objektivave të demokratizimit të institucioneve të BE-së, zhvillimit të një politike të përbashkët të jashtme e të sigurisë, si edhe krijimit të bashkëpunimit policor e gjyqësor për çështjet penale; e thënë ndryshe, nëpërmjet ngritjes së shtyllave kryesore të Bashkimit Evropian.

Po atë vit, Shqipëria përjetoi çeljen e një epoke të re me zgjedhjet elektorale të marsit të vitit 1992, kur më në fund, pas më shumë se 40 vitesh totalitarizmi, një parti politike erdhi në pushtet për hir të votës së lirë të popullit e në përfaqësim të aspiratave dhe vullnetit të tij.

Megjithatë, ishte rrugë e gjatë për t’u bërë që Evropa e Bashkuar ta jetëonte këtë unitet të saj në kuptimin e një identiteti të përbashkët, që do t’u mbizotëronte identiteteve kombëtare, në kuptimin që institucionet evropiane do të kishin një zë vendimtar mbi atë të institucioneve kombëtare, në aspektin e tregjeve të përbashkëta evropiane që funksionojnë mirë, përfshirë edhe një monedhë të vetme të përbashkët

---

<sup>4</sup>Fjala e Kryeministrit Edi Rama në Forumin e Liderëve Botërorë në Universitetin e Kolumbias në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. (faqe interneti)

evropiane që nuk do të haste përherë kërcënimin për t'u hedhur tutje, sa herë që një qeveri evropiane përjetonte vështirësi ekonomike.<sup>5</sup>

Po ashtu, ishte më se e sigurt, se Shqipëria kishte rrugë të gjatë për të bërë për ndërtimin e institucioneve të shtetit demokratik, shoqërisë civile, një sistemi gjyqësor të mosvarur nga politika, një administratë shtetërore të imunizuar nga korrupsioni. Megjithatë, sfidat me të cilat Shqipërisë iu desh të përballlej ishin edhe më kritike, ndërsa ajo kërkonte anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Që prej asaj kohe, Bashkimi Evropian u bë një nxitës kyç për demokratizim e modernizim. Brukseli u bë udhëheqës i demokratizimit dhe modernizimit të vendit.

Pas viteve të gjata të një kujdestarie të tillë, Shqipëria arriti një kuadër ligjor që pak a shumë, u përgjigjet kërkesave të Brukselit, por, nga ana tjetër, përjetojmë një realitet rrënjësisht të ndryshëm nga çka Brukseli e pret. Aktualisht, detyrat i kemi bërë në "mënyrë shumë krijuese"! I kemi paraqitur Brukselit shumë letra të mbushura përplot, si perde të bukura që varen teposhtë e fshehin përmbas një të vërtetë kryekëput të ndryshme.

Për aq sa Brukseli ka parë së brendshmi përtej këtyre dritareve dhe nga aq legjislacion e projekte të ndryshme të përbashkëta me BE-në që kanë ndikuar në realitetin e përditshëm të këtij vendi, Shqipëria tashmë ka nënshkruar e Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe ka marrë statusin e vendit kandidat.<sup>6</sup>

Evropa nuk është destinacion krah nesh, përtej apo jashtë nesh, ajo është pikëmbërritja brenda nesh; është demokracia e përditshme në vendin tonë, është vetëdija se veprimet tona si vendimmarrës, ditë pas dite, ndikojnë në jetën dhe mundësitë e njerëzve të sotëm dhe brezave të nesërm, gjeneratave të ardhshme të Evropës<sup>7</sup>.

Element-çelës për këtë qasje të re programore të zgjerimit të BE-së në Evropën Juglindore duhet të jetë vetëdijase, e ardhmja e përbashkët e Evropës së Gjeneratës Tjetër ndërtohet në vendet e saj anëtare, që do të thotë, edhe në vetë Evropën Juglindore.

Kësisoj, pyetja që shtrohet nuk duhet të jetë si ta bëjmë Evropën Juglindore të gatshme për të hyrë në Bashkimin Evropian, por se si të gjithë bashkë të mund të ndërtojmë Evropën e Bashkuar, se si të gjithë bashkë të mund të krijojmë një të ardhme të përbashkët evropiane! Ajo çka programi i ri i zgjerimit të BE-së i vendos përballë rajonit të Evropës Juglindore është një bashkëpunim më i gjerë, më intensiv dhe trishtresor:

Bashkëpunim brenda rajonit të Evropës Juglindore;

Bashkëpunim mes rajonit dhe BE-së;

---

<sup>5</sup> Po ai, po aty.

<sup>6</sup> Po ai, po aty

<sup>7</sup> Po ai, po aty.

Bashkëpunim i secilit vend me BE-në;

Dy të parat shpjegohen si kombinim i objektivave të Strategjisë për Evropën Juglindore 2020 dhe Programit “Evropa 2020”. Sërish, mbetet rrugë për t’u bërë në këtë kombinim, pasi besojmë se ka mjaft për t’u bërë për bashkëpunimin rajonal dhe shndërrimin e Programit “Evropa 2020” në hapa konkrete që prekin cilësinë e jetës dhe demokracinë e përditshme të çdo vendi.

Kështu, ne nuk përballemi vetëm me sfidën për të forcuar më tej lidhjen midis nivelit kombëtar dhe atij rajonal apo sfidën e plotësueshmërisë në nivel kombëtar me Evropa 2020. Të gjithë së bashk, shtete kandidatë dhe anëtare, jemi ballë sfidës për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm, përfshirës, të integruar dhe të zgjuar, si edhe një qeverisje për zhvillim, secila prej të cilave është e përfshirë në Vizionin e Evropës Juglindore për vitin 2020 në mënyrë koherente dhe e shkrirë me programin “Evropa 2020”.

Sfida që hasim të gjithë njëherazi është vendosja e demokracisë së përditshme, cilësisë së jetës së qytetarëve dhe shtetit të përmirësuar të së drejtës në zemër të një programi të orientuar për nga zhvillimi i qëndrueshëm dhe rritja. Kjo shkallë bashkëpunimi sjell qasjen, *histoire croisée* (histori të kryqëzuara) dhe refleksivitet (e dy studiuesve francezë të shkencave shoqërore, Bénédicte Zimmermann dhe Michael Werner).

## **I.2. Dukuria e Globalizmit: histori e shkurtër**

Ideja e globalizmit është e lidhur me zgjerimin e hapësirave të komunikimit midis njerëzve, duke shpërfillur e tejkaluar ndarjet e moçme gjeopolitike, etnike dhe kulturore. Globalizmi është term, kuptimi i të cilit nuk është i qartë aq sa duhet, prandaj edhe ekzistojnë dallime të mëdha mes autorëve reth përkufizimit të tij. Disa e shohin si një proces, i cili çon drejt bashkimit të njerëzve, shteteve dhe kulturave të ndryshme, si një proces, i cili synon ta shndërrojë botën në një “fshat global”, fshat të vogël, ku të gjithë do të jetonin në marrëdhënie të përbashkëta ndërshtetërore. Nëqoftëse do të kishte ekzistuar një kuptim i vetëm për globalizimin, atëherë ai do të ishte “integrim në nivel botëror”.<sup>8</sup>

Autorëtë tjerë, e shohin si proces që mundëson lidhjen e njerëzve nga mbarë bota dhe krijimin e përfitimeve për të gjithë, ndërsa disa të tjerë që janë më tepër kundër globalizimit, e shohin si proces që individëve dhe shteteve të pasura u mundëson të pasurohen edhe më tepër në kurizim e të varfërve. Në një farë mënyre, globalizimi i kulturës do të thotë universalizim dhe, së këndejmi, edhe sinkretizime madje unifikim ose uniformizim.<sup>9</sup>

Kjo është arsyeja që, në shumë vende të botës, ka pasur e vijon të ketë dy rrjedha; njëra, që e dëshiron, e përkrah dhe e mbështet fuqishëm globalizmin në shkallë botërore (sikundër na e thotë edhe vetë termi që përmban rrënjën “glob” (rruzull, univers), duke vlerësuar të mirat që sjell një jetë ekonomiko-shoqërore dhe kulturore e përfshirë ngakahet e reja dhe modernizimi i sotëm; kurse tjetra, që e

---

<sup>8</sup> Shih: Etem Aziri, “Sociologjia”, f. 425

<sup>9</sup> Shih: Etem Aziri, “Sociologjia”, f. 425

kundërshton me forcë globalizmin, duke parë tek ai një armik të etnive dhe të kulturave të popujve të vegjël.

Së këndejmi vijnë me denduri edhe fjalë e terma të përdorshme në Bashkimin Evropian e më gjerë, ku shquajnë, sidomos, fjalë që fillojnë me parashtesat **-inter, anti-, super-, multi-, pluri** – etj, si interkultural, interetnik, internacional; antidemokratik, antinjerëzor, antitank, antiamerikan, antishqiptar; supernjeri, superfuqi, supermiliarder,; multietnik, multilinguizëm, multifunksional, multivitamin etj; pluralitet, pluralizëm, pluridimensional; sporti multietnik, hoteli multietnik, shtet multietnik, fshat multietnik etj.

Me fjalë të tjera, mund të themi se globalizmi ngjan me udhëte mëdha të tipit të autostradave, që presin drejt e shpien larg, që nuk pyesin për asnjë pengesë dhe ngrënë ura apo çelin tunele madhështore për të mos e penguar mbërritjen e shpejtë në desitacion nga një vend në tjetrin, duke pasur si motiv themelor pragmatizmin dhe lehtësitë që krijohen nga bashkimi i hapësirave aq të mëdha në të njëjtin qëllim.

Përkundrazi, antiglobalistët janë për të mbetur edhe më tej në ndarjen dhe kufijtë tradicionalë të hapësirave gjeopolitike, kërkojnë të ruhen tiparet dalluese të çdo etnie e kombi, nuk e shohin për mbarë as uniformizimin, as njësimin e konformizimin, qësynohet në një botë të re, pa kufijtë e ndarjete vjetra, e projektuar duke pasur si synim një jetëmë të mirë për të gjithë globin e për ta konsiderar njeriun si qytetar të botës, si qenie që i jepen mundësi dhe hapësira të njëjta kudo që të shkojë, pavarësisht nga kombësia apo etniciteti i origjinës.

Së fundi, por jo nga rëndësia, duhet të themi se një ide e globalizmit ka qenë shprehur qysh në kohët e lashta në maksimën” *Ubi bene, ubi patria*”(Aty ku është mirë, aty është atdheu), porse ajo ka pasur edhe shumë kundërshtime nga pikëpamja e atdhetarizimit. E kundërt me tëka qenë fjala e urtë: ”*Guri i rëndë në vend të vet*”.

Globalizimi prek, në radhë të parë, fushat që janë më të afërta me politikën, si: ekonominë, marrëdhëniet publike dhe marrëdhëniet me jashtë, krejt sistemin e komunikimeve me shkrim e me gojë dhe, në këtë kuadër të gjerë, më shumë ndikon edhe në procesin e marrëdhënieve ndërgjuhësore, të cilat, në qoftë se deri vonë ndiqnin kryesisht sistemin e kalimeve binare (ose të ndikimeve të ndërsjella nga një kulturë në tjetrën, përkatësisht nga një gjuhë në tjetrën), tani, krahas kësaj udhe që mbetet edhe mëtej, prirjen të ndjekin edhe udhën e ndërkëmbimeve të shumëfishta.

Është e qartë, pra, se po del në plan të parë procesi i globalizimit, të cilin ndoshta për ta pasur më të qartë mund ta thoshim me një fjalë tjetër shqipe, procesi i botërorizimit, që kalon së pari nëpërmjet procesit tashmë të njohur të evropianizimit. Ne synojmë me shumë zell “të hyjmë në Evropë”, porse kjo duhet kuptuar si hapi i parë drejt hyrjes në Botë, duke e kuptuar këtë si hyrje a përbashkim me mbarë rruzullin a globin.

Nuk është qëllimi i studimit tonë, por nuk mund të mos përmendim kalimthi, këtu, se zhvillimi i përgjithshëm i përparimit kulturor, letrar e gjuhësor në të gjitha epokat e njohura nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi, është karakterizuar nga një farë “kampëzimi”, ose thënë më qartë; nga një **ndarje në kampe**: në kohën e hershme ndarja e kulturave të Evropës në dy hapësira të njohura **Lindja** dhe **Perëndimi**, pastaj në vijim dhe në gërshetim me këtë ndarje ka shkuar procesi i kampëzimit sipas ndarjes fetare: së pari, ndarja midis botës së krishterë dhe jo të

krishterë (përkatësisht pagane), më vonë me lindjen e fesë islame bëhet një ndarje tjetër shumë e madhe midis dy qytetërimeve, atij kristian dhe atij mysliman, të cilat i ka shpjeguar gjerë dhe gjatë Samuel P. Huntington në librin e tij të famshëm “*Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit të ri botëror*”.

Duke përmbledhur mendimin që të shkojmë drejt çështjes që na intereson, njerëzit e përcaktojnë veten nga pikëpamja e paraardhësve, besimit, gjuhës, historisë, dokeve, vlerave, zakoneve dhe institucioneve. Në mendësinë e tyre çojnë peshë grupet ose bashkësitë etnokulturore, si: fiset, grupet etnike, bashkësitë fetare, kombet dhe në nivelin më të gjerë qytetërimet.<sup>10</sup>

Grupimet më të rëndësishme të shteteve nga një shekull në tjetrin, nga një epokë në tjetrën kanë kaluar nëpërmjet përkatësisë në kampe ose grupime të ndryshme, herë në dy, herë në tri e herë në më shumë. Në qoftë se në kohën e Luftës së Ftohtë, përkatësisht në vitet 60’ ishin **tri blloqe** (bota e lirë, blloku komunist, vendet e paangazhuara), pas viteve 90’ mund të flasim për **shtatë** ose **tetë grupime** (perëndimore, latino-amerikane, afrikane, islamike, simike, hindu, ortodokse, budiste, japoneze).<sup>11</sup>

Në këtë botë të re, ku shihet qartë se shoqëritë joperëndimore gjithnjë e më tepër ngulitin vlerat e tyre kulturore dhe hedhin poshtë ato të imponuara nga Perëndimi, vihet re një risi që politologët e përkufizojnë duke u nisur nga dy polet e politikës së sotme botërore, politika vendore (lokale) dhe rruzullimore (globale), ose lokalizmi dhe globalizmi; le ta themi këtë me fjalët e një politologu të famshëm: “...në këtë botë të re, politika lokale është politikë e etnicitetit, politika globale është politikë e qytetërimeve. Rivaliteti ndërmjet superfuqive është zëvendësuar nga përplasja e qytetërimeve”.<sup>12</sup>

Ndërkaq, në hyrjen e kësaj parashprese nuk mund të mos theksojmë edhe një përfundim interesant, gjithashtu të rëndësishëm, se në botën pas Luftës së Ftohtë *kultura është forcë, njëkohësisht, si ndarëse ashtu edhe bashkuese*. Njerëzit e përçarë nga ideologjia, por të bashkuar prej kulturës, lidhen bashkë, ashtu siç bënë dy Gjermanitë dhe ashtu siç kanë nisur të bëjnë dy Koretë dhe disa vende të Kinës. Shoqëritë e bashkuara nga ideologjia a nga rrethanat historike, por të përçara nga qytetërimi, ose copëtohen siç ndodhi me Bashkimin Sovjetik, Jugosllavinë e Bosnjën, ose vuajnë nga tensione të fuqishme, siç është rasti në shumë vende të tjera të botës. Më së fundi, shtetet me afëri kulturore bashkëpunojnë ekonomikisht e politikisht. Organizatat ndërkombëtare të mbështetura në shtetet me përbashkësi kulturore, si Bashkimi Evropian, kanë më tepër sukses, sesa ato që përpiqen t’i sipërkalojnë kulturat.

Fundshekulli që u mbyll dhe fillimi i mijëvjeçarit të tretë i vunë njerëzimit përpara një prej shfaqjeve më të rëndësishme: *komunikimin global*. Përmasa e mbisundimit të komunikimeve globale nga Perëndimi është burim kryesor i pakënaqësisë së popujve joperëndimorë ndaj tij. Këtu sigurisht janë me shumë rëndësi: **gjuha** dhe **feja** e njerëzimit, si elemente të rëndësishme të çdo qytetërimi. Ka filozofë që mendojnë se, nëse po përftohet qytetërimi universal (globalist, ose

<sup>10</sup>Shih: S.P Huntington, *Përplasja e qytetërimeve*, Përkthyer nga anglishtja, Logos-A 2004, f. 21.

<sup>11</sup>S.P Huntington, *Përplasja e qytetërimeve*, Përkthyer nga anglishtja, Logos-A 2004, f. 21, Harta 1, 2, 3.

<sup>12</sup>S.P Huntington, *Përplasja e qytetërimeve*, Përkthyer nga anglishtja, Logos-A 2004, f. 22

gjithëbotëror) atëherë duhet të ketë prirje drejt përfuturit të një gjuhë universale dhe të një feje universale.

Ky synim është shprehur shpesh lidhur me gjuhën. Le të kujtojmë ndër të tjera pohimin “*Gjuha botërore është anglishtja*”, siç e ka shprehur redaktori i *Wall Street Journal*<sup>13</sup>. Kjo mund të pranohet vetëm në një kuptim, anglishtja që është gjuhë e huaj e parë për 92% të botës nuk mund të jetë gjuhë botërore, por ajo mund të cilësohet si e tillë duke nënkuptuar se ajo është gjuha e përdorur nga njerëzit e grupeve dhe e kulturave të tjera gjuhësore për të komunikuar me njëri-tjetrin, pra nëse e pranojmë anglishten si *lingua franca* e botës ose, me terma të gjuhësisë, si gjuha e komunikimit më të gjerë, d.m.th. si gjuha kryesore e botës.

Diplomatët, biznesmenët, shkencëtarët, turistët dhe shërbimet që bëhen për ta, pilotët e linjave ajrore e kontrollorët e qarkullimit kanë nevojë për një mjet komunikimi me njëri-tjetrin. Sot për këtë shërben kryesisht anglishtja, pra, në një farë mënyre, jemi në atë raport që ishte *latinishtja* në periudhën klasike dhe mesjetare, *frëngjishtja* për disa shekuj në Perëndim, *swahili* në shumë pjesë të Afrikës. Këtë rol të një *lingua franca* e ka marrë anglishtja në gjysmën e dytë të shek XX dhe, siç po duket, do të vijojë me hapa e ritme më të shpejta në mijëvjeçarin që sapo ka filluar.

Evropianizimi dhe botërorizimi i kulturës shfaqet dukshëm edhe në gjuhë, në stilin e të shkruarit dhe të folurit, në etnografinë e sjelljes dhe në etnografinë e komunikimit, pra edhe në gjuhën e shkruar e të folur. Njohja dhe studimi i thelluar i gjuhës së brezit të ri a më saktë të fëmijëve të emigrantëve shqiptarë në Itali, qoftë për vlerat e ditura si shqipe e shkëputur nga trangu amtar, qoftë për ndikimin që po pësojnë nga italishtja, ka rëndësi shkencore.

Shpesh, duke përmendur këtë koncept, mendja të shkon tek “hegjemonia” e anglishtes, e cila, në kuadrin e një “*lingua franca*” po shtrihet shumë shpejt nëpër botë, duke ndikuar ndjeshëm mbi gjuhët vendase. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për shqipen, ku huazimet nga anglishtja duket se po përceptohen si një normalitet për shkak të fluksit të dendur e të papërbalueshëm të tyre.

Më poshtë do të shtjellojmë se si konteksti global dhe proceset integruese po mishërohen në sistemin e shqipes, cilat janë flukset a shtysat më aktive në ditët tona që po orientojnë modelet e komunikimit të shqiptarëve dhe cilat janë pasojat e tyre në gjuhën shqipe.

Shoqëria shqiptare, gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, është gjendur para ndryshimesh të shumta politike, shoqërore, kulturore, demografike etj. Në qendrat më të mëdha qytetare (urbane) vërehet shtim dhe përqëndrim mjaft i madh i popullsisë. Përkatësia e origjinës së tyre gjeografike nuk përputhet më plotësisht me karakterizimin gjuhësor të para 20 viteve. Shndërrimet e mëdha shoqërore dhe ekonomike, si edhe marrëdhëniet e afërta me kulturat dhe gjuhët e popujve të tjerë kanë sjellë ndryshime të dukshme edhe në sjelljen gjuhësore të shqiptarëve në mbarë hapësirat e Republikës, por edhe më gjerë, sidomos në hapësirat kombëtare shqiptare, në trojet kompakte ballkanike, madje, deri në diasporat e hershme historike ende shqipfolëse (përk. arvanite /arbërore, arbëreshe, arbneshë, arnaute etj. ).

<sup>13</sup>Shih: Bozeman, *Strategic intelligence and statecraft*, f. 26.

Hapja e Shqipërisë dhe e hapësirave të tjera etnike shqiptare ndaj botës dhe, sidomos, ndaj Evropës, shtimi i pakufizuar tashmë i shtegtimin fizik dhe virtual të njerëzve dhe të informacioneve e botimeve, kuptuar kjo: e fjalës së shkruar dhe të folur, e gjuhëve dhe e kulturave të ndryshme në shkallë evropiane e, me kohë, edhe ndërplanetare, edhe pse i shumëpritur e i mirëseardhur jo vetëm politikisht, po edhe kulturalisht, nuk mund të mos sillte me vete, krejt natyrshëm, edhe trysinë e sistemeve të ndryshme nga ai i shqipes, mbi shqipen e shkruar, po edhe mbi formën e saj të folur.

Edhe në Shqipëri tashmëndihet ndikimi i globalizimit dhe kjo në radhë të parë shprehet me prirjen e fortë nga anglishtja, anim që të kujton pemët e larta që epohen e shkojnë andej nga fryn era; por procesi i globalizimit duhet kuptuar jo vetëm si arë e mbjellë që e zë breshri dhe bën kërdrinë mbi të, por edhe si përpjekje për ta ruajtur gjuhën nga asimilimi dhe për ta rreshtuar shqipen me dinjtet krahas gjuhëve të tjera evropiane.

Ne, si popull, sikundër është theksuar edhe nga korifejtë e albanologjisë, si A. Buda, E. Çabej, Shaban Demiraj, Rexhep Qose, etj. jemi pjesë e familjes evropiane, por të jesh pjesë e kësaj familjeje të madhe nuk do të thotë harrim i vetvetes, nënshtrim ndaj ndonjë gjuhë tjetër, qoftë ajo edhe anglishtja, që shumëkush e quan sot “gjuha e botës”.

Në këtë bashkësi qytetërimesh ne duhet të përfshihemi, në radhë të parë, me identitetin tonë kulturor e kombëtar. Gjuha është pjesë themelore dhe shprehësja më e dukshme e këtij identiteti, tipari dallues më kryesor i mbijetesës sonë si komb.

Antiglobalizimi është qëndrim politik, për të perceptuar aspektet negative të globalizimit. Kofi Anan ka thënë se “*të kundërshtosh Globalizimin është sikurse të kundërshtosh kundër ligjit të gravitacionit*”. Lëvizja përkatëse është e njohur gjerësisht si lëvizje e antiglobalizimit dhe është kryesisht një përpjekje bazë, me mbështetje nga disa elita intelektuale.

Antiglobalizmi është nocion që më së shpeshti përdoret për të shënuar lëvizjet, ideologjitë ose politikat shtetërore, të cilat në këtë ose në atë mënyrë kundërshtojnë proceset e globalizimit, fuqinë politike të korporatave shumëkombëshe dhe pushtetin e ushtruar përmes kontratave tregtare. Termi “antiglobalizim”, është një term që më shumë e preferojnë mediat. Kjo mund të çojë në disa ngatërime, sepse veprimtarët i kundërshtojnë vetëm disa aspekte apo forma të globalizimit, e jo edhe vetë globalizimin.

Vetë veprimtarët, për shembull Noam Chomsky, kanë thënë se ky emër është i pakuptimtë, ngase qëllimi i kësaj lëvizjeje është globalizimi i drejtësisë (shtrirja e drejtësisë sociale në mbarë globin), “lëvizja për drejtësi globale” është një emër i përbashkët për ta. Shumë aktivistë ndërkaq bashkohen nën sloganin “një botë tjetër është e mundur” (Rejhan Neziri “Globalizimi”).

Lëvizja Antiglobaliste është mjaft e gjerë, duke përfshirë grupet e kishës, grupe çlirimtare, parti të majta, parti nacionaliste, ambjentaliste, bashkimet fshatare, grupe antiracizëm, anarkiste, e tjerë. Sidoqoftë, shumica janë reformatorë, të cilët luftojnë për një formë më njerëzore të kapitalizmit. Disa të tjerë janë më revolucionarë, duke besuar tek një sistem më njerëzor sesa tek kapitalizmi.

Protestat e lëvizjes për drejtësi globale i kanë detyruar takimet e larta (samitet) ndërkombëtare të mbahen larg qyteteve të mëdha ku mbaheshin zakonisht, në lokacione të vetmuara ku protestat janë të pamundshme.

Si organizata më të njohura antiglobaliste janë Fifty Years is Enough, International Forum on Globalization, ATTAC, Global Exchange, Globalise Resistance, Ruckus Society, Ya Basta (sipas thënies së njëjtë zapatiste që do të thotë "Mjaft më!), Indymedia (Independent Media Center), Black Bloc, Food not Bombs (FNB), Friends of Earth, Public Citizen etj. Antiglobalistët mbrojnë tezën se politikat që po zhvillon Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe korporatat transnacionale janë shkaktare për problemet globale, si ngrohja e atmosferës së tokës, vrima e ozonit, apo shpyllëzimi i pyjeve tropikale.

Një aspekt tjetër, që kundërshtohet nga antiglobalistët është dimensionin shoqëror. Padyshim, bota po shndërrohet në një "global village". Përveç komuniteteve tradicionale si familja apo fqinjësia, po dalin në skenë komunitete të reja komunikimi (chat, e-mail, facebook), por ato nuk i zëvendësojnë dot këto hapësira tradicionale komunikimi.

Nëse do kalonim pastaj në dimensionin kulturor të globalizimit, ata thonë se si rezultat i afrimit të kulturave të ndryshme, vjen deri te shkatërimi dhe zhdukja e disa kulturave. Këtu vlen të përmendet zhdukja e kulturave Indiane, si dhe ajo e Majëve dhe Actekëve, kultura këto të cilat edhe pse ishin të mëdha, nën ndikimin e kulturës Amerikane dhe Meksikane, pothuajse janë zhdukur plotësisht.

Kur jemi te kultura duhet të përmendim edhe shembullin e Hollywood-it, ku prej një qendre lançohen prodhime, të cilat mund të shihen në të gjithë botën e kësaj nuk duhet mohuar një lloj "amerikanizimi" i kulturës. E njëjta gjë po ndodh edhe me gjuhën. Kohëve të fundit vërehet shfrytëzimi çdo ditë e më i madh i gjuhës angleze, si në komunikimin zyrtar ashtu edhe në komunikimin e përditshëm nëpërmjet futjes së fjalëve angleze në formë të internacionalizmave.

### **I.3. Bashkimi Evropian dhe strukturat e tij**

Guri i themelit për krijimin e Bashkimit Evropian u vendos nga Ministri i Jashtëm Francez, Robert Schuman, në deklaratën e tij të 9 majit të vitit 1950, në të cilën ai parashtroi idenë e përpunuar më parë me Jean Monnet për bashkimin e industrive evropiane të qymyrit dhe çelikut. Sipas tij, kjo do të përbënte një nismë historike për ndërtimin e një "Evrope të organizuar dhe vitale", pa të cilën paqja në botë do të ishte e pamundur. Plani i Schuman-it u bë realitet me nënshkrimin në Paris të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut më 18 prill të vitit 1951. Në nënshkrimin e traktatit merrnin pjesë Gjermania, Franca, Belgjika, Italia, Holanda dhe Luksemburgu.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm erdhi disa vjet më vonë me Traktatet e Romës, të 25 marsit të vitit 1957, kur shtetet e lartpërmendura krijuan Komunitetin Ekonomik Evropian dhe Komunitetin Evropian të Energjisë Atomike (EUROATOM). Këto bashkësi a komunitete etnolinguistike filluan nga puna me hyrjen në fuqi të traktateve më 1 janar të vitit 1958. Krijimi i Bashkimit Evropian me Traktatin e Matrihtit shënoi një hap të mëtejshëm në rrugën e bashkimit politik të Evropës. Megjithëse ky traktat u nënshkrua më 7 shkurt të vitit 1992, një numër pengesash gjatë procesit të ratifikimit (miratimi nga qytetarët e Danimarkës vetëm pas një referendumi të dytë; procesi

gjqësor në Gjermani për deklarimin antikushtetues të miratimit) bënë që Traktati të mos hynte në fuqi deri më 1 nëntor të vitit 1993.

Traktati i Mاستrihtit i referohet vetvetes si “një fazë e re në procesin e krijimit të bashkimit edhe më të ngushtë ndërmjet popujve të Evropës”. Krahas një numri ndryshimesh për Traktatet e Komunitetit Evropian dhe Euroatomit, ai përmban edhe instrumentin për krijimin e Bashkimit Evropian - procesi për krijimin e të cilit konsiderohej ende si i papërfunduar. Traktati përbën hapin e parë në rrugën drejt krijimit të një sistemi kushtetues evropian, në të cilin do të përfshihen edhe vetë komunitetet.

Bashkimi Evropian mori zhvillim të mëtejshëm me Traktatin e Amsterdimit, i cili u nënshkrua me 1 tetor të vitit 1997 dhe hyri në fuqi më 1 maj të vitit 1999, pas ratifikimit nga të gjitha shtetet anëtare. Traktati i Amsterdimit ka modifikuar përmbajtjen e Traktatit të Mاستrihtit në pesë fusha kryesore: liria, siguria dhe drejtësia; qytetaria e Bashkimit; politika e jashtme; institucionet e BE-së.

Gjatë Samitit të Nicës më 7-11 dhjetor 2000, kryetarët e shteteve dhe të qeverive, si dhe ministrat e jashtëm të shteteve anëtare, pas një maratone të gjatë bisedimesh, ranë dakord për miratimin e një kushtetute për Bashkimin Evropian. Traktati i Nicës përmban dispozita mbi ndarjen e pushteteve dhe procedurat vendimmarrëse të BE-së. Traktati u miratua në mënyrë përfundimtare nga qeveritë e shteteve anëtare më 26 shkurt të vitit 2001, datë kur u nënshkrua nga ministrat e jashtëm. Pas kësaj, hyri në fuqi më 1 shkurt 2003, pas ratifikimit nga parlamentet e të gjitha shteteve anëtare.

Ka edhe mendime se Bashkimi Evropian **është një projekt i papërfunduar**<sup>14</sup>.

Projekti Evropian që ideuan Jean Monet dhe Robert Schuman në fund të viteve 1950 synonte krijimin e një shteti të bashkuar evropian, i cili të kishte qeverinë, kushtetutën, parlamentin, gjykatën, bankën, monedhën, politikën e jashtme, ushtrinë dhe politikën e vet të brendshme. (Malcoln 1955). Ky projekt do të realizohej sipas metodës funksionaliste, përmes integritit gradual të ekonomive të vendeve evropiane perëndimore, gjë që, sipas tyre do të çonte eventualisht në unifikimin politik të këtyre vendeve. Sipas vizionit të Schuman-it, Evropa e Bashkuar nuk do të krijohet “menjëherë” apo “sipas një plani të vetëm”, por gradualisht, “përmes arritjeve konkrete, të cilat krijojnë së pari solidaritet *de facto*”.<sup>15</sup>

Sot, kur kanë kaluar 56 vjet që nga nënshkrimi i Traktatit të Romës, më 1957, me të cilin nis historia e krijimit të Bashkimit Evropian, shumë nga institucionet e përmendura më sipër janë bërë realitet. Këshilli i Evropës, Parlamenti Evropian, Komisioni Evropian, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut janë krijuar dhe funksionojnë si institucione supernacionale për të 27 vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Prej tyre, 17 vende të njohura si **Eurozonë**, kanë adoptuar euron si monedhën e tyre dhe i nënshtrohen një politike monetare të përbashkët, e cila koordinohet dhe drejtohet nga banka Qendrore Evropiane.

Në vitet 1980, Presidenti francez **François Mitterrand**, Kancelari gjerman **Helmut Kohl** dhe drejtues të tjerë të disa shteteve anëtare të Komitetit Evropian

<sup>14</sup> Shih: Fatos Tarifa, *Pamundësia e projektit evropian*, Minerva, Tiranë, 2013, f.29..

<sup>15</sup> Shih: Fatos Tarifa, *Pamundësia e projektit evropian*, Minerva, Tiranë, 2013, f. 31.

*shpreheshin hapur se qëllimi politik final i “projektit European” ishte krijimi in një shteti european federal. (Malcoln, 1955).*

Edhe pse samiti i BE-së, i mbajtur në Lisbonë, në dhjetor 2007, arriti në një farë mase të rinegocionte një dokument kushtetues, pas dështimit të projektit të Kushtetutës Europiane më 2005, duke e vënë veprimtarinë e BE-s në baza demokratike, Bashkimi Evropian akoma nuk e ka kushtetutën e vet, akoma nuk e ka ushtrinë e vet, akoma nuk e ka një politikë të vetën të jashtme të sigurisë dhe, rrjedhimisht, nuk ka sovranitetin e një formacioni politik, si ai i një shteti kombëtar. Bashkimi European vazhdon të mbetet një **“Projekt european” ende i papërfunduar.**<sup>16</sup>

#### **I.4 Struktura e BE-së dhe shtyllat e saj. BE-ja mbështetet në disa shtylla kryesore, si vijon:**

**Shtylla e parë** janë: Komunitetet Evropiane, të cilat përbëhen nga tri Komunitetet Evropiane (Komuniteti Evropian, Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe Çelikut dhe Euroatomi). Në çastin e themelimit të BE-së, Komuniteti Ekonomik Evropian mori emrin Komuniteti Evropian. Një ndryshim i tillë synon të shprehë kalimin nga një komunitet tërësisht ekonomik në një bashkim politik. Përfshirja e të trija komuniteteve në një shtyllë të vetme nuk nënkupton ndonjë unifikim të tyre. Shtylla e parë përfaqëson juridiksionin komunitar në formën e tij më të lartë.

Brenda kuadrit të Komunitetit Evropian, institucionet komunitare mund të hartojnë normat komunitare në fushat përkatëse të veprimtarisë së tyre, të cilat zbatohen drejtpërdrejt mbi shtetet anëtare dhe kanë epërsi ndaj së drejtës së brendshme. Në zemër të KE-së qëndron tregu i përbashkët me katër liritë e tij themelore (liria e lëvizjes së personave, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit) si dhe rregullat mbi konkurrencën.

**Shtylla e dytë** : Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët: Përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Bashkimit Evropian, bashkëpunimi politik ndërmjet shteteve rregullohej nga marrëveshjet e vitit 1970 “Mbi bashkëpunimin politik evropian” si dhe nga “Akti i Përbashkët Evropian”. Këto marrëveshje parashikonin konsultime të rregullta ndërmjet ministrave të jashtëm dhe kontakte të vazhdueshme ndërmjet departamenteve qeveritare. Megjithatë, të gjitha vendimet merreshin me unanimitet. Përsa u përket çështjeve të sigurisë, bashkëpunimi kufizohej vetëm në aspektet politike dhe financiarë. Megjithatë, krizat ndërkombëtare të viteve ‘90 (Lufta e Gjirit, lufta civile në ish-Jugosllavi) treguan se instrumente të tilla të politikës së jashtme nuk ishin në gjendje t’i siguronin Bashkimit Evropian ndikimin e merituar në arenën ndërkombëtare.

Me Traktatin e Bashkimit Evropian, Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive ranë dakord të zhvillonin një politikë të jashtme dhe sigurie të përbashkët. Pjesa më e madhe e vendimeve, në kuadër të kësaj politike, merren ende nëpërmjet bashkëpunimit të shteteve. Megjithatë, janë parashikuar një sërë mjeteve të reja si, për shembull, pozicionet e përbashkëta, masat dhe veprimet e përbashkëta si dhe vendimet kuadër.

**Shtylla e tretë** : Bashkëpunimi në fushat e Drejtësisë dhe të Punëve të Brendshme: Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe policore të shteteve anëtare synon t’u ofrojë qytetarëve evropianë liri, siguri dhe drejtësi, duke parandaluar dhe luftuar bashkërisht krimin, racizmin dhe ksenofobinë. Bashkëpunimi

<sup>16</sup> Shih: Fatos Tarifa, *Pamundësia e projektit evropian*, Minerva, Tiranë, 2013, f. 32

gjyqësor ka të bëjë gjithashtu me lehtësimin dhe përsheptimin e bashkëpunimit në fushën e zbatimit të vendimeve penale, lehtësimin e ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare, vendosjen e normave penale uniforme në luftën ndaj krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikut të drogës. Njëlloj si në fushën e politikës e jashtme dhe sigurisë së përbashkët, bashkëpunimi në fushën e drejtësisë dhe të punëve të brendshme zhvillohet jashtë kuadrit vendimmarrës të Komunitetit Evropian.

Sipas prof. dr. Rexhep Mejdanit, BE-ja duhet parësi “si replikë e shtetit-komb”. Ai argumenton sa vijon: “Pesë kolonat bazë të zhvillimit politik në Europë janë: shtet-formimi, zhvillimi kapitalist, komb-formimi, demokratizimi e sistemi i mirëqenies sociale. Vetë procesi i integrimit evropian mund të konsiderohet si faza e gjashtë e këtij zhvillimi, ku pjesë bazike është trajtimi i kufijve, “bërja” e “ribërja” e tyre drejt një sistemi politik shumë më të hapur e racional që, ndryshe nga sistemi vestfalian, është në thelb një lloj çintegrimi. Me këtë sy, procesi i anëtarësimit mund të shihet si një dinamikë integrimi- çintegrimi, e krahasuar me atë të formimit të shtetit-komb.

Kanë qenë pikërisht dobësitë e këtij shteti-komb në shmangien e luftërave shkatërrimtare apo menaxhimin e drejtë të konkurrencës ekonomike, që nxitën krijimin e një bashkimi shtetesh-kombe (BE-së), ndërkohë që paaftësia ushtarake u mënjanua nga një bashkim tjetër (NATO-ja). Këto dy strukturime të mëdha dhe proceset integruese në to i kanë përqaftuar në mënyrë masive, që në fillimet e tranzicionit, politika e qytetari shqiptar. Veçse, aktualisht, integrimi evropian si një fazë e gjashtë po eklipsohet jo pak nga një fazë e shtatë – nga globalizimi.

Është ky i fundit që po provokon dita-ditës erozionin e kufijve tej nivelit evropian. Por ka një dallim, integrimi evropian ka të bëjë me zhvendosje, lëvizje e ndërtim kufijsh, ndërsa globalizimi është më tepër një çështje transcendence e kufijve, e kapërcimit të tyre, shoqëruar edhe me krijimin e qendrave të reja globale të qeverisjes. P.sh., kufijtë e ndërtuar në nivel evropian nuk ofrojnë mbrojtjen e duhur ndaj prodhimeve kineze; bile, në tërësi, konkurrenca në nivel global i ka tejkaluar kufijtë e sapo ndërtuar të BE-së.

Edhe pse në strukturimin e saj BE-ja e ka tejkaluar shtetin-komb, deri duke lëvizur kufij të ndryshëm (ekonomikë, ushtarakë, kulturorë etj.), ajo po krijon replikën e tij, duke dimensionuar veçori të tilla të shtetit-komb si: njëfarë shtet-formimi, aftësi e cilësi demokratike, kapacitete shpërndarëse (pavarësisht që, në erën e globalizimit, shteti i mirëqenies sociale po e humbet “shëndetin” e vet).

Këtu përfshihen dhe mjaft probleme legjitimiteti në nivel evropian (në fakt, të deficitit të legjitimitetit) apo të së ardhshmes së demokracisë parlamentare evropiane. Në shumicën e rasteve, vendimet në nivel evropian bazohen në vullnetin e qeverive kombëtare, për këtë arsye Europa ka nevojë për më tepër demokraci për të legjitimuar veten. Por, dhe shqiptarët për më shumë miq brenda Evropës. Sidoqoftë, në një të ardhme të afërt, legjitimiteti i shtetit-komb nuk do të garantojë dot legjitimitetin e BE-së, sepse vetë reformimi e strukturimi i BE-së po e kufizon në vazhdimësi atë.

Pra, shteti-komb (ende me legjitimitet të vetin) dhe BE-ja (me legjitimitet më tepër të qeverive kombëtare) janë dy faza zhvillimi në një proces permanent të prishje – ndërtimit të kufijve të llojllojshëm. E thënë ndryshe, duhet të merren parasysh, efektet e njëkohshme të lëvizjes së kufijve në shtetet-kombe anëtare dhe të ndërtimit

të kufijve të rinj në nivel evropian. Dhe, për këtë duhet të përgatitet (pse jo dhe të përfitojë) jo vetëm politika shqiptare, por dhe qytetari shqiptar, sidomos në Shqipëri e Kosovë.

Pavarësisht prej këtyre zhvillimeve, ndryshe nga ShBA-ja si superfuqi globale, në një formë gati klasike të një shteti-komb, BE-ja është një strukturë e re makropolitike e qeverisjes, me mjaft dobësi të brendshme, me një politikë monetare ende pa politikë fiskale. Në mjedis ndërkombëtar të qetë këto dobësi janë të kapërcyeshme, por jo në situata krize. Madje, një Evropë e Bashkuar përballë një krize ushtarake ka nevojë të sillet si një shtet unitar me kufijt e vet! Një evolucion i tillë duhet kuptuar. Bile, çështja më e rëndësishme për qytetarin shqiptar, ashtu si çdo qytetar evropian, është të kuptuarit e procesit të integrimit, në përputhje me rolin dhe interesat e tij, qofshin ato të natyrës politike-ekonomike, social-kulturore, territoriale, grupore apo elektorale.

Po ashtu, në lidhje me anëtarësimin evropian, ai duhet të bëjë dallimin midis projektit, procesit e produktit të integrimit. Sepse projekti i integrimit u referohet përpjekjeve të intelektualëve, elitave politike e lëvizjeve masive për të krijuar një ndërveprim e ndërlidhje, njëfarë politike evropiane, që duhet kuptuar e ndjerë, pse jo dhe për të kontribuar.

Kurse procesi i integrimit evropian i referohet bashkimit të shteteve-kombe të Europës në një sistem më të integruar ekonomik, legal e politik, duke mishëruar anët më pozitive në trajektoren e ndryshimit pas kolapsit të Perandorisë Romake (që nga qeverisjet në kuadër të *polis*-it, perandorisë, *regnum*-it, shtetit absolut, monarkisë kushtetuese) dhe ndërtimit të shtetit modern, duke kombinuar më mirë perspektivat e ndryshme të natyrës makro e mikro.

Së fundi, produkti i integrimit i referohet rezultatit të këtij procesi, ndërtimit të institucioneve, politikave, legjislacionit e praktikave konkrete të BE-së bazuar në parimet kryesore demokratike, në përfshirjen dhe zbatimin e të cilave kërkohet punë e angazhim tërësor”.<sup>17</sup>

### **I.5 Institucionet e BE-së. Këshilli Evropian**

Këshilli Evropian lindi nga Samitet e Kryetarëve të Shteteve dhe të Qeverive të vendeve anëtare. Në Samitin e Parisit të mbajtur në dhjetor 1974, u vendos që këto takime të mbaheshin tri herë në vit dhe të merrnin emrin Këshill Evropian. Në vitin 1987, Akti i Përbashkët Evropian e bëri Këshillin Evropian pjesë të strukturës institucionale të Komunitetit, tashmë ai është pjesë e Bashkimit Evropian.

Kryetarët e Shteteve dhe të Qeverive si dhe Presidenti i Komisionit takohen rregullisht të paktën dy herë në vit. Ata shoqërohen nga Ministri i Jashtëm si dhe një anëtar i Komisionit.

Funksioni themelor i Këshillit Evropian është përcaktimi i drejtimeve dhe strategjive kryesore politike për integrimin Evropian. Ai e realizon një gjë të tillë duke

---

<sup>17</sup>Shih: R.Mejdani, *Integrimi evropian u shërben qytetarëve, jo politikës*, “Ese rreth temës së integrimit evropian të Shqipërisë”, faqe në internet.

marrë vendimet kryesore politike, si dhe duke instruktuar Këshillin ose Përfaqësuesit e Shteteve Anëtare. Në këtë mënyrë, Këshilli Evropian ka drejtuar punën për bashkimin ekonomik dhe monetar, zgjedhjen e drejtpërdrejtë të parlamentit, si dhe një numër aplikimesh për aderim.

### **Këshilli i Ministrave të Bashkimit Evropian:**

Këshilli i Ministrave duhet dalluar nga Këshilli Evropian, edhe pse këto dy institucione janë të lidhura ngusht në mes veti. Në fakt, Këshilli Evropian nuk konsiderohet institucion i BE-së. Këshilli Evropian përbëhet nga kryetarët e shteteve dhe të qeverive, të cilat takohen dy herë në vit. Tubimet e Këshilit Evropian quhen Samite.

Roli i Këshillit Evropian është i përqendruar kryesisht në përcaktimin e kahës politike të UE-së. Ky institucion ekziston nga vitit 1974, kur u miratua propozimi i Zhiskar D'Esten-it, që udhëheqësit e shteteve të takohen në formë dhe në mynyrë të rregullt për të diskutuar çështjet e bashkësisë që kanë të bëjnë me politikën e jashtme. Kurse Këshilli i Ministrave, ekziston që nga themelimi i BE-së.

### **Parlamenti Evropian:**

Origjina e Parlamentit Evropian fillon në vitet '50-të me traktatet themeluese. Parlamenti Evropian përbëhet nga 730 deputete, të cilët zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga qytetarët e shteteve anëtare. Kjo do të thotë, se Parlamenti Evropian gëzon legjitimitet demokratik dhe se është i vetmi organ përfaqësues i qytetarëve të Bashkimit. Zgjedhjet parlamentare mbahen një herë në pesë vjet dhe të drejtën e votës e gëzon çdo qytetar evropian që është regjistruar si votues. Përsa i përket zgjedhjes në mënyrë të drejtpërdrejtë, anëtarët e Parlamentit, sipas traktateve themeluese "*janë përfaqësues të popujve të shteteve që bëjnë pjesë në Komunitete*".

Megjithatë, për një kohë të gjatë ata kanë qenë delegatë të shteteve anëtare dhe zgjidheshin sipas procedurave të veçanta nga secili shtet. Një mënyrë e tillë zgjedhjeje nuk siguronte përfaqësim të mjaftueshëm të grupeve opozitare të parlamenteve të shteteve anëtare, duke çuar kështu në një "deficit demokratik". Në vitin 1976, Këshilli nxori një vendim lidhur me zgjedhjen e përfaqësuesve në Parlament me votim të përgjithshëm dhe të drejtpërdrejtë.

Zgjedhjet e para të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta janë mbajtur në vitin 1979. Që prej asaj kohe, Parlamenti ka shprehur vullnetin politik të 374 milionë qytetarëve të Bashkimit dhe ka përfaqësuar interesin e tyre në marrëdhënie me institucionet e tjera të BE-së. Parlamenti Evropian i zhvillon punimet e tij në Francë, Belgjikë dhe Luksemburgu. Sesionet plenare mujore, në të cilat merr pjesë çdo eurodeputet, zhvillohen në Strasburg, qytet i cili konsiderohet edhe selia e Parlamentit Evropian.<sup>18</sup>

Takimet e komiteteve parlamentare dhe çdo takim plenar shtesë zhvillohet në Bruksel, ndërsa Luksemburgu është qendra e administratës së Parlamentit (Sekretariati i Përgjithshëm).

Parlamenti ushtron tri funksione themelore:

---

<sup>18</sup> Shih: F.Tarifa, *Parlamenti Evropian dhe legjimiteti i tij*, në "Pamundësia e projektit evropian", Minerva, 2013, f.43-50.

1. Ai ushtron pushtetin legjislativ në bashkëpunim me Këshillin. Fakti që është një organ i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë bën që Parlamenti të jetë garanti kryesor i legjitimitetit të së drejtës evropiane.

2. Këshilli i BE-së dhe Komisioni Evropian janë të detyruara të kërkojnë mendimin e Parlamentit, përpara se të adoptojnë një akt legjislativ, sa herë që traktatet e parashikojnë shprehimisht një gjë të tillë. Konsultime të tilla mund të jenë edhe opsionale.

3. Parlamenti ushtron kontroll demokratik mbi të gjitha institucionet e BE-së, veçanërisht mbi Komisionin. Ai gëzon të drejtën për të pranuar ose refuzuar emërimin e Komisionarëve ; mund të paraqesë mocion mosbesimi ndaj Komisionit në tërësi dhe Komisioni është i detyruar t'u përgjigjet pyetjeve të Parlamentit.

Ai ushtron, në bashkëpunim me Këshillin, pushtetin mbi buxhetin e BE-së, duke ndikuar kështu mbi shpenzimet e Bashkimit. Parlamenti gëzon të drejtën të miratojë ose të rrëzojë buxhetin në tërësi.

Veprimtaria e Parlamentit ndahet në dy faza kryesore :

- Përgatitja e sesioneve plenare. Kjo bëhet nga anëtarët e Parlamentit në komisionet parlamentare të cilat janë të specializuara në fusha të veçanta të aktivitetit të Bashkimit. Çështjet për debat diskutohen edhe nga grupet politike.

- Sesionet plenare. Gjatë këtyre sesioneve Parlamenti shqyrton propozimet legjislative si dhe voton dhe propozon amendamente përpara se të votojë tekstin në përgjithësi.

Në veprimtarinë e Parlamentit Evropian bëjnë pjesë edhe “komunikimet” me Këshillin dhe Komisionin si dhe seancat e pyetjeve lidhur me gjendjen e Bashkimit dhe situatën në botë.

### **Këshilli i Bashkimit Evropian:**

Këshilli është organi kryesor vendim-marrës i Bashkimit. Sikurse Parlamenti Evropian edhe Këshilli është krijuar nga dispozitat e traktateve gjatë viteve ‘50. Ai përfaqëson shtetet anëtare dhe në takimet e tij merr pjesë një ministër nga secila prej qeverive të shteteve anëtare të BE-se, me varësi të natyrës së çështjeve që do të diskutohen në atë takim. Marrëdhëniet e Bashkimit Evropian me pjesën tjetër të botës mbahen nga “Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme dhe Marrëdhënieve me Jashtë”.

Por një konfigurim i tillë i Këshillit ka përgjegjësi të gjera edhe për çështje të politikës së përgjithshme, prandaj takimet e tij mund të ndiqen nga secili prej ministrave të qeverive të shteteve anëtare, sipas zgjedhjes së vetë qeverive.

Gjithsej ekzistojnë nëntë konfigurime të ndryshme të Këshillit :

- Çështjet e Përgjithshme dhe Marrëdhëniet me Jashtë.
- Çështjet Ekonomike dhe Financiare (ECOFIN).
- Drejtësia dhe Punët e Brendshme.
- Punësimi, Politikat Sociale, Shëndeti dhe Çështjet e Konsumatorit.
- Konkurrenca (Tregu i Brendshëm, Industria dhe Kërkimet).

- Transporti, Telekomunikacionet dhe Energjia.
- Bujqësia dhe Peshkimi.
- Mjedisi
- Edukimi, Rinia dhe Kultura.

Gjithsesi, Këshilli mbetet një institucion i vetëm.

Secili prej ministrave në Këshill gëzon plotfuqishmëri. Kjo do të thotë, se deklarimet dhe veprimet e tij janë plotësisht të afta për të angazhuar qeverinë që ai përfaqëson. Me fjalë të tjera, nënshkrimi i ministrit është nënshkrim i qeverisë, që ai përfaqëson. Gjithashtu, çdo ministër i Këshillit është përgjegjës ndaj parlamentit të vendit të tij, si dhe ndaj qytetarëve që ky parlament përfaqëson, duke siguruar kështu legjitimitetin e vendimeve të Këshillit.

Këshilli ushtron gjashtë funksione themelore :

1. Miraton normat komunitare. Në disa fusha të caktuara, këtë pushtet ai e ushtron në bashkëpunim me Parlamentin Evropian.
2. Bashkërendon politikat e përgjithshme ekonomike të shteteve anëtare.
3. Lidh marrëveshje ndërkombëtare, në emër të Bashkimit Evropian, me shtete ose organizata ndërkombëtare.
4. Miraton buxhetin e Bashkimit, së bashku me Parlamentin Evropian.
5. Zhvillon Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit, në bazë të direktivave të Këshillit Evropian.
6. Bashkërendon bashkëpunimin midis gjykatave dhe forcave policore të shteteve anëtare në çështjet penale.

Shumica e përgjegjësive të Këshillit kanë të bëjnë me fusha të veprimit komunitar, në të cilat shtetet anëtare kanë hequr dorë nga sovraniteti i tyre, duke ua deleguar pushtetin vendimmarrës organeve të BE-se. Kjo fushë veprimi përben “shtyllën e parë” të Bashkimit Evropian. Megjithatë, dy funksionet e fundit kanë të bëjnë me fusha në të cilat shtetet anëtare nuk kanë hequr dorë nga sovraniteti i tyre, por thjesht kanë pranuar të punojnë së bashku. Ky quhet “bashkëpunim ndërqeveritar” dhe përfshin “shtyllën” e dytë dhe të tretë të Bashkimit.

Veprimtaria e Këshillit të BE-se është e organizuar si më poshtë :

- COREPER. E gjithë puna e Këshillit përgatitet dhe koordinohet nga Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm (COREPER), i cili përbehet nga përfaqësuesit e përhershëm në Bruksel të të gjitha shteteve anëtare si dhe nga ndihmësit e tyre. Vetë puna e COREPER-it përgatitet nga 250 komitete dhe grupe pune, të cilat përbehen nga delegate të shteteve anëtare.

- Presidenca e Këshillit. Secili prej shteteve anëtare kryeson takimet e tij për një periudhë gjashtëmujore, duke promovuar vendimet politike dhe legjislative të Bashkimit, si dhe duke realizuar kompromisin ndërmjet shteteve anëtare.

- Sekretariati i Përgjithshëm. Ky është një organ ndihmës i Presidencës dhe ka për detyrë të sigurojë funksionimin normal të punimeve të Këshillit në të gjitha nivelet.

### **Komisioni Evropian:**

Komisioni është një organ i pavarur politikisht, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e Bashkimit Evropian në tërësi. Ai përbën mekanizmin drejtues të BE-së. Komisioni Evropian përbëhet nga 25 anëtarë, të cilët emërohen një herë në pesë vjet, pa kaluar gjashtë muaj nga data e zgjedhjeve për Parlamentin Evropian.

Procedura e emërimit është e tillë :

### **Parlamenti Evropian:**

- Qeveritë e shteteve anëtare bien dakord mbi emrin e personit, që do të drejtojë Komisionin për pesë vjetet e ardhshëm.
- Presidenti i Komisionit zgjedh, në bashkëpunim me qeveritë e shteteve anëtare, anëtarët e tjerë të Komisionit.
- Parlamenti Evropian miraton përbërjen e Komisionit të ri, në tërësi. Në rast se miratohet, Komisioni fillon nga puna janarin e ardhshëm.

Selia e Komisionit Evropian është në Bruksel, por ai ka një numër zyrash në Luksemburg, përfaqësi në të gjitha shtetet anëtare të BE-së, si dhe delegacione në disa prej kryeqyteteve të botës.

Komisioni Evropian ushtron katër funksione themelore :

1. Propozon aktet normative në Parlament dhe në Këshill;
2. Administron dhe zbaton politikën e BE-së si dhe buxhetin ;
3. Është “gardiani” i Traktateve (së bashku me Gjykatën e Drejtësisë);
4. Përfaqëson Bashkimin Evropian në arenën ndërkombëtare.

Vetë Komisioni vendos fushën e veprimtarisë të secilit komisioner, si dhe shpërndarjen e përgjegjësisë në rast se është e nevojshme. Stafin e Komisionit është i organizuar në departamente, të njohura ndryshe edhe si “Drejtori të Përgjithshme”. Secila prej këtyre drejtorive është përgjegjëse për një fushë të veçantë të aktivitetit të BE-së dhe kryesohet prej një Drejtori të Përgjithshëm, i cili është përgjegjës përpara njërit prej komisionarëve.

### **Gjykata Evropiane e Drejtësisë.**

Gjykata e Drejtësisë është krijuar në vitin 1952 me Traktatin e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut. Detyra e saj është të sigurojë, që e drejta e BE-së të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë uniforme në të gjitha shtetet anëtare. Gjithashtu, Gjykata ka pushtetin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve gjyqësore ndërmjet shteteve anëtare, institucioneve të Bashkimit, personave fizikë dhe juridikë.

Gjykata është e përbërë nga një gjyqtar prej secilit shtet anëtar, duke siguruar, në këtë mënyrë, përfaqësimin e sistemeve ligjore të të gjithë shteteve anëtare të BE-së. Gjykata ndihmohet nga tetë “avokate të përgjithshme”, të cilët kanë për detyrë të japin mendimin e tyre për çështjet që shtrohen për zgjidhje përpara gjykatës. Mendimet e tyre jepen publikisht dhe duhet të jenë të paanshme. Gjyqtarët dhe avokatët e përgjithshëm emërohen me marrëveshje të përbashkët të të gjithë

shteteveanëtare, për një mandat gjashtë-vjeçar, i cili mund të ripërtërihet me një ose dy periudha të mëtejshme tre-vjeçare.

Çështjet kryesore që shtrohen për zgjidhje përpara Gjykatës :

1. kërkesa për gjykim paraprak ;
2. procedimi për shkelje të detyrimeve që rrjedhin nga traktatet ;
3. procedimi për anulim të një vendimi ;
4. procedimi për mosveprim.

Për ta ndihmuar Gjykatën e Drejtësisë për të zgjidhur numrin e madh të çështjeve që shtrohen përpara saj, si dhe për t'u siguruar një mbrojtje më të mirë ligjore qytetarëve të Bashkimit, në vitin 1989 u krijua "Gjykata e Shkallës së Parë". Kjo gjykatë është përgjegjëse për zgjidhjen e një numri të caktuar çështjesh, në mënyrë të veçantë të atyre që paraqiten nga individët dhe çështjet që kanë të bëjnë me raste të konkurrencës së pandershme midis ndërmarrjeve.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë dhe Gjykata e Shkallës së Parë kanë nga një President, të zgjedhur ndërmjet gjyqtarëve për një mandat trevjeçar.

**Politika ekonomike. Bashkimi tregtar :** Që në origjinën e tij, BE ka përcaktuar një treg të vetëm ekonomik përgjatë territorit të të gjithë anëtareve të saj. Aktualisht është në përdorim një kurs i vetëm këmbimi në 16 anëtarët e eurozonës. E konsideruar si një ekonomi e vetme, BE gjeneron një GDP nominale prej 18,39 trilion dollarësh amerikan, që arrin gjeri në 22 % të output-it tërësor ekonomik të botës në terma të *purchasing power parity*, gjë që e bën atë ekonominë më të madhe në botë për nga GDP nominale dhe e dyta si bllok ekonomik tregtar. Është gjithashtu eksportuesi më i madh i mallrave (të mirave), importuesi i dytë më i madh dhe partneri tregtar më i madh i disa vendeve si India dhe Kina.

Nga 500 korporata, 170 prej tyre i kanë selitë të vendosura në vendet e BE. Në maj 2007 papunësia e BE ishte 7 % kurse investimet 21,4 % të GDP. Ka një variacion të madh në të ardhurat vjetore për kokë të vendeve të BE, nga 7000\$ deri në 69 000 \$.

Shtetet anëtare të BE-së kanë dizeno pasaporte të standardizuara me fjalët "Bashkimi Evropian" në gjuhët amtare (nacionale). Dy nga objektivat kryesore të Komunitetit Ekonomik Evropian janë zhvillimi i një tregu të përbashkët që u quajt më pas tregu i vetëm dhe bashkimi i doganave midis shteteve anëtare. Tregu i vetëm përfshin qarkullimin falas të të mirave, kapitalit, njerëzve, shërbimeve brenda BE-së dhe bashkimit të doganave që përfshin aplikimin e një tarife të vetme të jashtme për të gjitha të mirat që hyjnë në treg. Kur të mirat janë pranuar në treg, ato nuk mund të bëhen më subjekt i taksave doganore, diskriminuese apo kuotave të importit kur qarkullojnë brenda shteteve të BE-së.

Shtetet joanëtare të BE-së si Islanda, Norvegjia, Zvicra marrin pjesë në tregun e vetëm, por jo në bashkimin doganor. Kjo gjysmë-tregti është e mbuluar nga legjislacioni i BE-së. Lëvizja e lirë e kapitalit është menduar që të lejojë investimet si p.sh. : blerja e pronave. Deri në bashkimin monetar kjo pjesë ka qenë shumë e ngadaltë, më pas pati zhvillim të shpejtë. Lëvizja e lirë e kapitalit deri tani është unike sepse lejohet në mënyrë të barabartë edhe shtete jo anëtare. Lëvizja e lirë e personave nënkupton që qytetarët mund të lëvizin lirisht ndërmjet shteteve anëtare për të jetuar,

punuar, studiuar apo për të dalë në pension. Kjo kërkoi uljen e formaliteteve administrative dhe njohjen e kualifikimeve profesionale të shteteve të tjera.

Një ndër objektivat kryesorë të BE-së, që ishte “kursi i vetëm këmbimi” u bë e ditur që në 1969 dhe u realizua jo më vonë se në 1 janar 1999. Propozimi i 11 vendeve nga 15 anëtare ishte përdorimi i euros. Lidhur me këtë po citojmë një vlerësim të politologut F. Tarifa, i cili shkruan: “*Sot, kur kanë kaluar 56 vjet nga nënshkrimi i Traktatit të Romës, më 1957, me të cilin nis historia e krijimit të Bashkimit Evropian, shumë nga institucionet. e përmendura janë bërë realitet*”.<sup>19</sup>

Të gjitha vendeve të tjera të BE, përveç Danimarkës dhe Britanisë së Madhe, u është lejuar të bashkohen tek “euro” kur të kenë plotësuar kushtet ekonomike. Vetëm pak vende kanë leje për të hyrë. Suedia do bashkohet ekonomikisht, të bëhet pjesë e euros por jo të jetë anëtare, pa i plotësuar kushtet e anëtarësimit.

Qëllimi i krijimit të euros është: lehtësimi i lëvizjes së qytetarëve dhe i mallrave, duke shmangur problemet e shkëmbimit, nëpërmjet blerjes transparente të çmimit, duke krijuar një treg financiar të vetëm, me çmime të qëndrueshme dhe interesa të ulëta, me kurs këmbimi ndërkombëtar të mbrojtur nga dyndjet e mëdha tregtare në eurozonë. Ajo është gjithashtu e nënkuptuar si simbol i integritit dhe stimulues për më shumë. Eurozona dhe politikat monetare për ato vende që i kanë adaptuar ato me konsensusin e BE-së, janë nën kontroll të Bankës Qendrore Evropiane.

Marrëveshja e Romës parashihte marrjen e vendimeve në mënyrë të njëzëshme. Me rritjen dhe me zgjerimin politik dhe ekonomik, vendimet filluan të merren me shumicë votash. Pas vitit 1980, dukej që kjo bashkësi kishte arritur nivelin në të cilin stagnonte. Pas shumë diskutimesh që u zhvilluan në Këshillin e Evropës dhe pas paraqitjes së disa raportimeve nga komitetet speciale, u arrit pajtimi që të kalohet në fazën e Tregut Unik Evropian.

Ky akt juridik, që u quajt “Single European Act”, në shkurt të vitit 1986, u nënshkrua nga të gjitha shtetet anëtare, kurse hyri në fuqi më 1 korrik 1987. (Jones, 1994, f. 44). Akti ishte i rëndësishëm së madhe ekonomike dhe politike. Ky ishte një amandament që iu bë Marrëveshjes së Romës, e që kishte për qëllim tregtinë e lirë brenda bashkësisë. Sipas kësaj marrëveshjeje të re, deri në fund të vitit 1992, duheshin zhdukur të gjitha barrierat që pengonin tregtinë dhe lëvizjen e lirë të mallrave dhe të qytetarëve të këtyre shteteve anëtare.

Marrja e vendimeve me shumicë votash nënkuptonte se të gjitha shtetet nuk do të kenë numër të njëjtë të përfaqësuesve për votim. Marrëveshja ishte që Gjermania, Britania e Madhe, Franca dhe Italia të kenë 10 vota, Spanja - 8, kurse nga 5 vota kishin Belgjika, Greqia, Holanda dhe Portugalia. Shtetet, që u bashkuan më vonë, siç ishte Suedia dhe Austria, u vendos të kenë nga 4 vota, nga 3 vota për Irlandën, Danimarkën dhe Finlandën, kurse 2 vota për Luksemburgun. Gjithsej ishin 87 votues, kurse për vendim me shumicë absolute votash duhej votuar 62 përfaqësues nga të gjitha shtetet, siç ishte paraparë. Ky sistem që ideuar në mënyrë që shtetet e mëdha të

<sup>19</sup>Shih: F.Tarifa, *Bashkimi Evropian një projekt i papërfunduar*, në “Pamundësia e projektit evropian”, Minerva, 2013, f.30.

mos kenë mundësi që t'ua imponojnë shteteve të vogla pikëpamjet e tyre. (Hill, 1998, f. 8).

Rëndësia tjetër e këtij akti ishte se tri bashkësitë evropiane tashti mund të bashkoheshin në një union të vetëm. Këshilli Evropian tashti kishte dalë si organi më i lartë suprem i këtij organizimi të ri. Tri ndryshimet e rëndësishme, që solli ky akt ishin : mënyra e votimit në Këshillin e Ministrave dhe marrëdhënia legislative në mes të Këshillit të Ministrave dhe Parlamentit Evropian, i cili sapo ishte formuar. Si pikë e tretë ishte paraparë edhe një gjykatë, vendi i së cilës do të rregullohej veçanërisht. (Swann, 1992, f. 16).

Para marrjes së vendimit për të kaluar në këtë fazë, Komisioni Evropian, nën udhëheqjen e lordit Kokfield, që autorizuar të përgatiste një raport për të sqaruar problemet e deriatëhershme të tregut dhe për të bërë propozimet për të ardhmen. Komisioni autorizoi ekonomistin Paolo Çeçini që të hartojë një raport në lidhje me implikimet e Librit të Bardhë të vitit 1985, që titullohej “Kompletimi i Tregut të Brendshëm”.

Nga Raporti Çeçini shihej se tregu i deriatëhershëm i brendshëm UNIONI EVROPIAN funksiononte me shpenzime të larta administrative, pasi që ishin të angazhuara burokraci të numërta e të ndryshme nacionale. Në përgjithësi, dilte se shpenzimet që bëheshin ishin të panevojshme dhe se ato duhej mënjanuar për shkak të uljes së harxhimeve dhe të rritjes së konkurrencës. Për të përmirësuar këtë të metë, Raporti i Çeçinit parashihte që ndërrimet të bëheshin nëpërmes 282 propozimeve. (Noble, 1996, f. 87). Raporti identifikoi tri lloje të pengesave të tregtisë së lirë. Pengesat ishin të natyrës fizike, teknike dhe fiskale.

Në pengesat teknike bënte pjesë kontrolli kufitar dhe formaliteti i tepruar burokratik, që kërkonte një mori dokumentesh të ndryshme, që ndikonte në rritjen e shpenzimeve. Italia “akuzohej” si një vend që paraqiste komplikime të tilla. Barrierat teknike kishin të bënin me standardet kombëtare dhe me rregulloret e prodhimit. Në këtë fushë, p.sh., binin pengesat e transportit në relacion me sistemet bankare. Problemet fiskale kishin të bënin me ratat e ndryshme të taksave të shtuara të vlerës.

Raporti sugjeronte për vënien e bazave nga të cilat do të përfitonte industria në konkurrencë të shëndoshë e të rregulluar. Ashtu si është parashikuar ky aktivitet, në periudhën afatshkurtër, ndikoi në zvogëlimin e vendeve të punës, por më vonë numri i vendeve të punës filloi të rritej. Pas disa vitesh, pamja e ekonomisë ishte pozitive, por nuk pati mundësi të kthehej në nivelin e viteve të gjashtëdhjeta dhe të shtatëdhjeta, kur qe shënuar një lulëzim i madh i ekonomisë evropiane.

Sidoqoftë, efekti i heqjes së pengesave doganore, krijimi i kushteve të volitshme për shërbime publike, liberalizimi i shërbimeve publike dhe efekti i përndarjësë mallrave ndikoi në mënyrë të favorshme në ngritjen dhe në përparimin e makroekonomisë. (Cecchini, 1988, f. 97). Ndryshimet që u bënë në tregun e punës, po ashtu, filluan të japin efektet e para pozitive, të cilat po në këtë mënyrë u reflektuan edhe në makroekonomi. Shtetasit e kësaj bashkësie, tashti ishin në gjendje të punësoheshin dhe të themelonin firma të afarizmit dhe kompani të natyrave të tjera, kudo brenda territorit të të gjitha shteteve anëtare.

Megjithatë, disa probleme të kësaj natyre mbetën të pazgjidhura dhe deri më 1992. Tregu i punës nuk ishte tërësisht i lirë dhe i hapur, pasi që paraqiteshin tendencat proteksioniste. Disa nga shtetet anëtare, siç ishte Franca, krijonin pengesa kundër mobilizimit të punëtorëve, me qëllim që të ruhej tregu i tyre i brendshëm i punës. (Owen & Dynes, 1993, f. 118). Për të pasur parasysh këto vështirësi, të cilat kërkonin zgjidhje të favorshme për tregun unik, në strukturat e bashkësisë u formuan shumë agjenci dhe organizata të tjera të ndryshme, që kanë për qëllim lehtësimin e funksionimit në një hapësirë më të madhe ekonomike.

Këto organizata ndihmojnë në ofrimin e informatave, të cilat zakonisht nuk merren lehtë, në zbutjen e lehtësimin e vështirësive që paraqiten gjatë harmonizimit të ndryshimeve. Në përgjithësi, personave dhe kompanive, në këtë mënyrë u lehtësohet puna dhe u rritet numri i mundësive të depërtimit në treg nga ku paraqitet përfitimi ekonomik i rregulluar me rregullat e ndryshme. (Andersen, 1993, f. 19).

### **I.6. Gjuhët e Bashkimit Evropian dhe statusi i anglishtes**

Gjuhët e Bashkimit Evropian janë gjuhë që përdoren nga njerëz brenda shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Ato përfshijnë 23 gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian. BE-ja pohon se ajo është në favor të larmisë gjuhësore dhe aktualisht ka një Komisioner Evropian për shumëgjuhësinë, Leonard Orban.

Në Bashkimin Evropian, politika gjuhësore është përgjegjësi e shteteve anëtare. BE nuk ka një politikë të përbashkët për gjuhën, institucionet e Bashkimit Evropian luajnë rol mbështetës në këtë fushë, të bazuar në parimin "e subsidiaritetit". Roli i tyre është për të nxitur bashkëpunimin në mes të shteteve anëtare dhe për promovimin e dimensionit evropian në vendet anëtare të politikave gjuhësore. BE-ja inkurajon të gjithë qytetarët e saj të flasin në shumë gjuhë, veçanërisht, inkurajon ata të jenë në gjendje të flasin dy gjuhë përveç gjuhës së tyre amtare.

Megjithëse BE-ja ka ndikim shumë të kufizuar në këtë fushë si dhe përmbajtja e sistemeve arsimore është përgjegjësi e vendeve të veçanta, një numër i fondeve të programeve të BE-së të për gjuhën në mënyrë aktive promovojnë të mësuarit dhe larminë gjuhësore.

Sipas statistikave të folur më gjerësisht gjuhën amtare në BE janë gjermanët, ndërsa shumica mund ta kuptonin anglisht dhe flasin gjermanisht, anglisht, frëngjisht, italisht, si dhe gjuhën amtare. Frëngjishtja është gjuhë zyrtare e përbashkët për të tre qytetet që janë qendra politike e Bashkimit Evropian: Bruksel (Belgjikë), Strasburg (Francë) dhe qyteti i Luksemburgut (Luksemburg).

Gjuhë zyrtare : bullgarisht, çekisht, danisht, holandisht, anglisht, estonisht, finlandisht, frëngjisht, gjermanisht, greqisht, hungarisht, irlandeze, italiane, letonisht, lituanisht, malteze, polonisht, portugalisht, rumanisht, sllovakisht, sllovenisht, spanjisht dhe suedisht.

Gjuhë gjysëm- zyrtare: katalane, galiciane dhe baske.

### **I.7. Statusi i shqipes në Republikën e Shqipërisë dhe në hapësirat shqiptare në Ballkan e më gjerë.**

Sot shqipja flitet në Shqipëri, në Kosovë, në Luginën e Preshëvës, në trojet shqiptare në Mal të Zi, në Maqedoninë Perëndimore, në Çamëri dhe në hapësirat veriore të Greqisë rreth Kosturit. Flitet shqipja edhe në diasporat e moçme arbëreshe në Greqi (*arvanitika*): si në Atikë, në Eube, në Peleponez dhe në ishujt Andros, Specë, Salaminë, Hidra, Poros, Luca etj.; në Itali shqipja, e quajtur *arbëresh* ose *arbërisht*, flitet në Kalabri, në rreth njëzet ngulime kryesisht rreth qendrave të Kozencës, Katanzaros e Krotones; në krahinën e Abruzzos (rreth Peskarës), në krahinën e Bazilikatës (me qendër Potencën), në krahinën e Kampanias (me qendër Avellinon); në Molize (rreth Kampobasos), në Pulia (rrethet e Foxhës, Tarantos) dhe në Sicili (krahina e Palermos). Shqipja ruhet dhe flitet edhe në Arbënesh të Zarës (Dalmaci), në Bullgari (katundi Mandricë), në Ukrainë (disa ngulime rreth Odesës).

Shqiptarë ka edhe në Turqi, në Siri, në Egjipt, në Belgjikë dhe në tërë Evropën Perëndimore, Gjermani, në Zvicër, në Rumani, në Suedi, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada, në Australi etj., pa përmendur ngulime ose grupe të vogla arbëreshësh e shqiptarësh edhe në shumë vende të tjera të botës, pothuajse në krejt rruzullin tokësor.

Kudo që është ruajtur gjuha e tyre e hershme, arvanitët a arbërorët, arbëreshët (ose arbneshtët), arnautët, arbanasit flasin shqip, natyrisht në forma dialektore të dallueshme nga shqipja e Shqipërisë së sotme dhe e trojeve shqiptare kompakte ballkanike, por në thelbin e vet të njëjtë dhe etnikisht e kombëtarisht të cilësuar si të tillë: *arvanit, arbëresh, arbnesht, arbanas, arnaut*.<sup>20</sup>

Gjuha shqipe është gjuhë indoevropiane që flitet në Shqipëri, Kosovë, Republikën e Maqedonisë, Serbinë jugore dhe nga shqiptarët etnikë në pjesë të tjera të Ballkanit jugor. Gjuha shqipe flitet gjithashtu edhe përgjatë bregdetit lindor të Italisë dhe në Sicili, në jug të Greqisë si dhe në Gjermani, Suedi, Shtetet e Bashkuara, Kanada, Ukrainë dhe Belgjikë. Shqipja është një ndër gjuhët moderne që përfaqëson një degë më vete në familjen e gjuhëve indoevropiane.

Shqipja flitet sot nga më shumëse gjashtë milionë vetë në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë, në viset shqiptare të Maqedonisë, të Malit të Zi, të Serbisë jugore, si dhe në viset e Çamërisë në Greqi. Shqipja flitet gjithashtu, në ngulimet shqiptare në Itali, në Greqi, në Bullgari, në Ukrainë, si dhe në shqiptarë të mërguar në viset e ndryshme të botës para Luftës së Dytë Botërore dhe në këtë dhjetëvjeçar in e fundit.

Gjuha shqipe mësohet dhe studiohet në disa universitete dhe qendra albanologjike në botë, si në Paris, Romë, Napoli, Kozencë, Palermo, Shën-Pjetërburg (Leningrad), Pekin, München, Bukuresht, Selanik, Sofie etj.

Gjuha dhe kultura e shqiptarëve, lashtësia dhe karakteri origjinal i tyre, kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e studiuesve të huaj dhe shqiptarë që në shekullin XVIII dhe më parë. Në mënyrë të veçantë, gjuha, historia dhe kultura e shqiptarëve,

<sup>20</sup> Shih: *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë, 2008, vëll.II; Gjinari-Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHBLU, 1998.

tërhoqi vëmendjen e botës gjermane. Me të u mor edhe një filozof i madh, siç ishte Gotfrid Vilhelm Leibnitz, që punoi një shekull para lindjes së gjuhësisë krahasimtare. Ai mendonte, se studimi krahasues i gjuhëve ishte themelor për të ndërtuar një histori universale të botës, për ta kuptuar dhe për ta shpjeguar atë. Në disa letra, që ai i shkruante një bibliotekari të Bibliotekës Mbretërore të Berlinit, në fillim të shekullit XVIII, shprehet edhe për natyrën dhe prejardhjen e gjuhës shqipe dhe pas disa luhatjeve, arriti në përfundimin, se shqipja është gjuha e ilirëve të lashtë.

Megjithatë, studimet shkencore për gjuhën shqipe, si dhe për shumë gjuhë të tjera, nisën pas lindjes së gjuhësisë historike-krahasuese nga mesi i shekullit XIX. Një nga themeluesit e kësaj gjuhësie, dijetari gjerman Franz Bopp, arriti të provonte që në vitin 1854, se shqipja bënte pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane dhe se zinte një vend të veçantë në këtë familje gjuhësore. Pas tij, studiues të tjerë, si G. Meyer, H. Pedersen, N. Jokli, studiuuan aspekte të ndryshme të leksikut dhe të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe. G. Meyer do të hartonte që në vitin 1891 një Fjalor Etimologjik të Gjuhës shqipe (*Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Strasburg 1891), i pari fjalor i këtij lloji për shqipen.

Përveç këtyre, një varg i madh gjuhëtarësh të huaj, si F. Miclosich, G. Weigand, C. Tagliavini, St. Man, E. Hamp, A. Desnickaja, H. Ölberg, H. Mihaescu, W. Fredler, O. Bucholtz, M. Huld, G. B. Pellegrini, etj. kanë dhënë kontribute të shënuara për studimin e historisë së gjuhës shqipe, të problemeve që lidhen me prejardhjen e saj, me etimologjinë, fonetikën dhe gramatikën historike, si edhe në studimin e gjendjes së sotme të shqipes.

Ndërkohë, krahas studimeve për gjuhën shqipe të albanologëve të huaj, lindi dhe u zhvillua edhe gjuhësia shqiptare. Ajo i ka fillimet e saj që në shekullin XVII, kur Frang Bardhi botoi të parin fjalor të gjuhës shqipe "*Dictionarium Latino-Epiroticum*" (1635). Gjatë Rilindjes Kombëtare u botuan disa gramatika të gjuhës shqipe. Kështu, në vitin 1864, Dhimitër Kamarda, një nga arbëreshët e Italisë, botoi veprën "*Laggio della grammatica comparata sulla lingua albanese*", Livorno 1864, vëll. II "*L'Appendice al saggio dalla grammatica comparata sulla lingua albanese*", Prato 1866.

Më 1882, Kostandin Kristoforidhi botoi "*Gramatikën e gjuhës shqipe*" dhe më 1806, Sami Frashëri botoi "*Shkronjëtoren e gjuhës shqipe*", dy vepra gjuhësore të rëndësishme të shekullit XIX për gramatologjinë e gjuhës shqipe. Nga fundi i shekullit XIX, Kostandin Kristoforidhi përgatiti edhe një "*Fjalor të gjuhës shqipe*", i cili u botua në vitin 1904 dhe përbën veprën më të rëndësishme të leksikografisë shqiptare, që u botua para Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1909, botohet *Fjalori* i shoqërisë "Bashkimi".

Pas shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, u botuan një varg gramatikash dhe fjalorë dygjuhësh, për të plotësuar nevojat e shkollës dhe të kulturës kombëtare. Në fushën e gramatikës u shqua sidomos Prof. Dr. Aleksandër Xhuvani (1880-1961) i cili kreu studimet e larta në Universitetin e Athinës. Veprimtaria e tij për studimin e gjuhës shqipe dhe arsimin kombëtar, nisi që gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare. Bëri një punë të madhe për pajisjen e shkollës sonë me tekste të gjuhës shqipe, të letërsisë, të pedagogjisë dhe të psikologjisë. Drejtoi e punoi për hartimin e udhëzuesve drejtshkrimorë në vitet 1949, 1951, 1954, 1956.

A. Xhuvani pati një veprimtari të gjerë në fushën e pastërtisë së gjuhës shqipe e të pasurimit të saj dhe botoi veprën “*Për pastërtinë e gjuhës shqipe*” (1956). Bashkëpunoi me profesorin Egerem Çabej, për hartimin e veprave “Parashtesat” (1956) dhe “Prapashtesat e gjuhës shqipe” (1962), trajtesa themelore në fushën e fjalëformimit të gjuhës shqipe. Botoi dhe një varg punimesh monografike për pjesoren, paskajoren dhe parafjalët e gjuhës shqipe.

Ai ishte njohës i mirë dhe mbledhës i pasionuar i visarit leksikor të gjuhës së popullit. Fjalët dhe shprehjet e mbledhura, u botuan pjesërisht pas vdekjes, në formën e një fjalori. Përgatiti një botim të dytë të “*Fjalorit të gjuhës shqipe*” të Kristoforidhit (1961). Vepra e plotë e tij, e projektuar në disa vëllime, ende nuk është botuar. Në vitin 1980 është botuar vëllimi i parë.

Një zhvillim më të madh njohu gjuhësia shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XX, kur u krijuan edhe institucione shkencore të specializuara, si Universiteti i Tiranës, Universiteti i Prishtinës dhe Akademia e Shkencave, Universiteti i Shkodrës, më vonë, Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Gjirokastrës, Universiteti i Vlorës, Universiteti i Tetovës, etj. Gjatë kësaj periudhe, u hartuan një varg veprash përgjithësuese nga fusha të ndryshme të gjuhësisë.

Në fushën e leksikologjisë dhe të leksikografisë, përveç studime leksikologjike, u hartuan edhe një varg fjalorësh të gjuhës shqipe dhe fjalori dygjuhësh, nga të cilët, më kryesorët janë: “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954), “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*” (1980), “*Fjalorii shqipes së sotme*” (1984), “*Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*” (1976), “*Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*” (1973), etj. Kohët e fundit kanë dalë edhe “*Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*” (2000) dhe “*Fjalor frazeologjik ballkanik*” (1999).

Në fushën e dialektologjisë është bërë përshkrimi e studimi i të gjithë të folurave të shqipes dhe është hartuar “*Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*”, vepër madhore e gjuhësisë shqiptare, botuar në Napoli nga Universita Orientale, vëll I, Napoli-Tiranë, 2007, vëll. II, Napoli-Tiranë, 2008. Është bërë gjithashtu, studimi i fonetikës dhe i strukturave gramatikore të gjuhës shqipe përmes studimeve të veçanta dhe përmes gramatikave të ndryshme, niveleve të ndryshme, nga të cilat, më e plotë është “*Gramatika e gjuhës shqipe*” I Morfologjia (1995), II Sintaksa (1997), hartuar nga Akademia e Shkencave, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, me kryeredaktor Mahir Domin.

Një vend të gjerë në studimet gjuhësore të këtij gjysmëshekulli, kanë zënë problemet e historisë së gjuhës shqipe, problemet e etnogjenezës së popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, të etimologjisë, të fonetikës dhe të gramatikës historike, etj. Disa nga veprat themelore në këto fusha janë: “*Studime etimologjike në fushë të shqipes*” në 7 vëllime, nga E. Çabej; “*Meshari*” i Gjon Buzukut (E.Çabej); “*Gramatika historike e gjuhës shqipe*” (Sh. Demiraj); “*Fonologjia historike e gjuhës shqipe*” (Sh. Demiraj); “*Gjuhësia ballkanike*” (Sh. Demiraj), etj. Eqrem Cabej (1908-1980) mbetet studiuesi më i shquar i historisë së gjuhës shqipe dhe një nga personalitetet më në zë të kulturës shqiptare.

Pasi bëri studimet e para në vendlindje (Gjirokastrë), studimet e larta i kreu në Austri, në fushën e gjuhësisë së krahasuar indoevropiane. Me kthimin në atdhe fillon

veprimtarinë shkencore e arsimore në vitet '30 të këtij shekulli dhe punoi në këto fusha për një gjysëm shekulli, duke lënë një trashëgimi të pasur shkencore.

Eqrem Çabej solli dhe zbatoi në gjuhësinë shqiptare metodat dhe arritjet shkencore të gjuhësisë evropiane, duke kontribuar shumë në ngritjen e nivelit shkencor të studimeve gjuhësore shqiptare. Eqrem Cabej punoi shumë në disa fusha të dijes, por u shqua sidomos në fushën e historisë së gjuhës, në trajtimin e problemeve të origjinës së gjuhës shqipe, të autoktonisë së shqiptarëve e të etimologjisë dhe të filologjisë së teksteve të vjetra.

Veprat themelore të tij janë: “Studime etimologjike në fushë të shqipes”, në shtatë vëllime, I “Hyrje në historinë e gjuhës shqipe”, II “Fonetikë historike” (1958), “Meshari i Gjon Buzukut” (1968), “Shqiptarët midis perëndimit dhe lindjes” (1944). Ai është bashkautor edhe në një varg veprash në fushën e gjuhës së sotme, siç janë: “Fjalor i gjuhës shqipe” (1954), “Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe” (1972), “Fjalori drejtshkrimor”.

Përveç veprave, ai ka botuar një varg studimesh në revista shkencore brenda e jashtë vendit dhe ka mbajtur dhjetëra referate e kumtesa në kongrese e konferenca kombëtare e ndërkombëtare, të cilat kanë bërë të njohura arritjet e gjuhësisë shqiptare në botë, duke rritur kështu prestigjin e saj.

Veprat e prof. Eqrem Çabejt janë botuar në tetë vëllime, në Prishtinë, me titullin “*Studime gjuhësore*”. Me veprimtarinë e shumanshme shkencore e me nivel të lartë, E. Çabej ndriçoi shumë probleme të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, duke argumentuar lashtësinë dhe origjinën ilire të saj, vitalitetin e saj ndër shekuj dhe marrëdhëniet me gjuhët dhe kulturat e popujve të tjerë.

Gjatë kësaj periudhe, gjuhësia shqiptare zgjidhi edhe problemin e gjuhës shqipe letrare kombëtare, të njësuar me çështjet teorike të së cilës është marrë veçanërisht prof. Androkli Kostallari. Në kuadrin e punës që është bërë në fushën e gjuhësisë normative dhe të kulturës së gjuhës, janë hartuar dhe një numër i madh fjalorësh terminologjikë për degë të ndryshme të shkencës e të teknikës.

Përveç veprave të shumta që janë botuar në fushën e gjuhësisë, veprimtaria e gjuhësisë studimore e studiuesve shqiptarë pasqyrohet në botimin e disa revistave shkencore, nga të cilat më kryesoret sot, janë: “*Studime filologjike*” (Tiranë); “*Gjuha jonë*” (Tiranë), “*Studia albanica*” (Tiranë); “*Studime albanologjike*” (Prishtinë), “*Gjuha shqipe*” (Prishtinë); “*Jehona*” (Shkup) etj.

Studime të rëndësishme mbi gjuhën shqipe janë bërë nga gjuhëtarë në Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, ku janë botuar një numër i konsiderueshëm veprash mbi historinë e gjuhës shqipe, fonetikën, gramatikën, leksikun etj. Prof. Idriz Ajeti shquhet për kontributin e veçantë që ka dhënë në këtë fushë.

Kontribut të rëndësishëm për gjuhën shqipe kanë dhënë edhe shqiptarët e vendosur në Itali, të njohur si “Arbëreshë”. Disa nga figurat më të shquara të gjuhësisë shqiptare të këtyre dy shekujve të fundit, janë : Dhimitër Kamarda (arbëresh i Italisë), Kostandin Kristoforidhi, Sami Frashëri, Aleksandër Xhuvani, Eqrem

Çabej, Selman Riza, Kostaq Cipo, Mahir Domi, Shaban Demiraj, Androkli Kostallari, Idriz Ajeti etj.<sup>21</sup>

### **I.8. Shqiptarët dhe plurilinguizmi në Europën e Bashkuar**

Kohë më parë, studiuesit A. Ballhysa e M. Lala, në kumtesën e tyre me titull “Shqiptarët dhe plurilinguizmi në Europën plurikulturore” trajtojnë edhe problematikën vërtet me rëndësi për kohën tonë e pikërisht atë të identitetit kombëtar në Europën e Bashkuar, madje edhe duke prekur me guxim nevojën e krijimit të një identiteti të ri, duke ideuar e projektuar edhe gjetjen e rrugëve përkatëse.<sup>22</sup>

Evropa dhe evropianët që janë në BE, d.m.th. që kanë vite që jetojnë në atë status të një bashkësie unike, janë të vetëdijshëm se sot duhet të sigurohet “një unitet më i madh i anëtarëve” dhe se kjo mund të arrihet nëpërmjet një qëndrimi të përbashkët në fushën kulturore.<sup>23</sup>

Madje, duhet të themi se ky synim i Këshillit të Europës shprehet qartë në Rekomandimet e Komitetit të Ministrave, ku thuhet shprehimisht:

“Të përgatisë evropianët për sfidën e dëndësimit të lëvizjes ndërkombëtare dhe të një bashkëpunimi më të ngushtë me njëri-tjetrin, jo vetëm në arsim, kulturë dhe shkencë, por dhe në tregti dhe në industri.

Të zhvillojë kuptimin dhe tolerancën reciproke, respektin e identiteteve dhe të ndryshimeve kulturore me anën e një komunikimi ndërkombëtar më të efektshëm.

Të mirëmbajë dhe të zhvillojë larminë kulturore në Evropë, nëpërmjet njohjes së ndërsjellë (reciproke) të gjuhëve kombëtare dhe ajonale, duke përfshirë edhe ato më pak të njohurat.

T’u përgjigjet nevojave të një Europe shumëgjuhëshe, duke zhvilluar në mënyrë të dukshme aftësinë e evropianëve për të komunikuar me njëri-tjetrin, përtej kufijve gjuhësorë dhe kulturorë.

Të shmangen rreziqet që mund të vinin nga lënia mënjanë e atyre që nuk zotërojnë aftësitë e nevojshme.<sup>24</sup>

Evropa e sotme, pra, kërkon shtetas shumëgjuhësh apo plurilingë, natyrisht edhe me synimin që ata, duke u përfshirë në BE të bëhen sa më parë edhe plurikulturorë.

Tashmë dihet se Këshilli i Evropës, si dhe Komisioni i Evropës, dëshmojnë interesim të barabartë për ta mbikëqyrur dhe mbështetur larminë kulturore dhe pasurinë gjuhësore të Evropës, duke e parë këtë si gurrë që sjell pasurimin e BE-së. Së këndejmi dhe, me të drejtë, tashmë është shtruar edhe kërkesa për *lifelong language learning* d.m.th. të nxënë të gjuhëve gjatë gjithë jetës, i cili bashkëpërkon dhe lidhet

---

<sup>21</sup> Shih: *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë, 2008, vëll.I, f.865.

<sup>22</sup> Shih: Ballhysa A.,-Lala M., *Shqiptarët dhe plurilinguizmi në Evropën plurikulturore*, në UT, Studime Albanologjike, II, Tiranë, 2011, f.382-392.

<sup>23</sup> Shih: Kuadri i përbashkët i referencave për gjuhët, Filara, Tiranë, 2006, f.4.

<sup>24</sup> Ballhysa A.,-Lala M., *Shqiptarët dhe plurilinguizmi në Evropën plurikulturore*, në UT, Studime Albanologjike, II, Tiranë, 2011, 383, shënimi nr 2.

me *liveside language learning* (=zotërim gjuhësor në shkallë të gjerë) për të cilat UNESCO, qysh më 2003, ka vënë në zbatim edhe projekte përkatëse.<sup>25</sup>

Që të dy kahet e lartpërmendura, d.m.th. të nxëniet e gjuhës gjatë gjithë jetës dhe të nxëniet e gjuhës sa më gjerë, kanë rëndësi të madhe për ecurinë dhe ardhshmërinë e shumëgjuhësisë dhe të shumëkulturosësisë në BE.

Qysh më 2004, në Konferencën me temë “Giornata Europea delle Lingue” (Dita Evropiane e Gjuhëve) është folur pikërisht për “lehtësinë e plurilinguizmit si kusht për të ndërtuar qytetarinë evropiane. Pra, mund të thuhet se plurilinguizmi duhet kuptuar si aftësia e përdorimit të gjuhëve të ndryshme për qëllime komunikative dhe për pjesëmarrje në ndërveprimet ndërkulturore.

Kjo lidhet, natyrisht, edhe me aftësitë e çdo individi për të qenë, sipas rastit, dygjuhësh, tregjuhësh apo shumëgjuhësh. Madje, edhe aftësia e të shprehurit herë në dalket, herë në standard, përfshihet në këtë aftësi. Kujtojmë, me këtë rast, edhe konceptin e “bilinguizmit dialektal”, për të cilin kanë folur qysh herët dialektologët italianë Francesco Coco<sup>26</sup> dhe në mjediset shqipatre Gj. Shkurtajt.

### **1.9. Gjuhët kombëtare dhe gjuhët zyrtare në Bashkimin Evropian**

Sot jetojmë në një kohë kur ka një lëvizje të madhe të njerëzve nga një vend në tjerin për arsye ekonomike, kulturore ose politike dhe kur këto lëvizje, si dhe shkëmbimet kulturore kërkojnë aftësi të mira komunikimi, të cilat realizohen nëpërmjet gjuhës. Ne jetojmë në një botë ku po kapërcehen kufijtë e ndarjeve të ngushta shtetërore, etnike dhe kombëtare, duke synuar të bëhemi pjesë e Bashkimit Evropian, i cili është themeluar mbi idenë e bukur të bashkimit të të ndryshmeve, që do të thotë: nëpërmjet politikave të reja të shkohet drejt hapjse së kufijve shtetërorë dhe njerëzit të e mbarë Evropës, ndonëse me prejardhje, gjuhë, kultura, zakone dhe besime të ndryshme të vihen në kushte të reja dhe të atilla që të mund të bashkëveprojnë e të bashkëjetojnë

Kjo do të thotë se Evropa dhe evropianët në kuadrin e BE-së do të jenë në kontakte më të afërta me njëri-tjetrin, prandaj edhe gjuhët e kulturat e tyre do të marrin një kah të ri zhvillimi e ndërndikimi. Gjuha është shprehje e drejtpërdrejtë e kulturës, e cila shpreh dhe jep mundësi të formësohet edhe identiteti apo e veçanta e secilit komb. Kjo cilësi e gjuhëve do të mbetet edhe më tej, sepse gjuha është mjeti më i fuqishëm i njerëzimit nëpërmjet së cilës ne zhvillojmë mendimet tona, krijojmë përvojën personale, zbulojmë dhe përvetësojmë zakonet e shoqërisë ku jetojmë, ndërtojmë marrëdhënjet në një bashkësi të caktuar, përcaktojmë vlerat dhe shprehim shpresat dhe mendimet tona.<sup>27</sup>

Kjo është arsyeja që larmia apo diversiteti gjuhësor dhe kulturor shihen si pjesë përbërëse e identitetit evropian.” Ajo është një trashëgimi e përbashkët, një pasuri, një

<sup>25</sup> Ballhysa A., -Lala M., *Shqiptarët dhe plurilinguizmi në Evropën plurikulturore*, në UT, Studime Albanologjike, II, Tiranë, 2011, f.384

<sup>26</sup> Shih: Francesco Coco, *Introduzione allo studio della dialettologia italiana*, Patron Editore, Bologna, 1977.

<sup>27</sup> Shih: Gj. Shkurtajt, “Sociolinguistikë e shqipes”, Morava, 2009, f.180-193.

sfidë dhe një vlerë për Evropën“<sup>28</sup>. Pra, BE-ja, nuk do të thotë aspak ecje kundër vlerave të gjuhëve kombëtare përkatëse, por pranëvënie e mundësi shkëmbimi e afrimi e popujve me gjuhë të ndryshme në një hapsirë jetike të përbashkët e unike, në BE-në, që, edhe më tej, do të mbetet shumëetnike dhe multilinge. “Nxitja dhe zhvillimi i gjuhëve evropiane më pak të përdorura përfaqëson një ndihmesë të rëndësishme për shumëgjuhësinë. Evropa është një bashkësi shumëgjuhësore.

Me rëndësi, në këtë mes, është në kohën tonë edhe kuadri i përbashkët evropian i referencave për gjuhët. Kuadri i referencës ka si qëllim të rëndësishëm t’i shërbejë forcimit të mësimdhënies, nxënës të gjuhës në shtete anëtare të BE-së, duke nxitur e ndihmuar një lëvizje të madhe dhe sidomos komunikimin ndërkombëtar sa më të efektshëm, që të respektojë identitetet dhe larminë e ndryshimin a dallimet kulturore.

Pra, kërkohet një shumëfishim i shkëmbimeve ndërpersonale e ndërgrupore, përmirësim i marrëdhënieve të punës dhe të kuptimit tëndërsjellë (reciprok).

Për të mbërritur në këtë, nxënësia e gjuhëve duhet të vazhdojë gjatë gjithë jetës dhe është me vend të zhvillohet, të lehtësohet në të gjithë sistemin edukativ e arsimor, qënga sistemi parashkollor e deri në mësimin në shkollat e larta.

Kuadri i përbashkët i referencës për mësimin e gjuhëve në të gjitha nivelet ka për qëllim:

a) Zhvillimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit të institucioneve arsimore në vende të ndryshme të BE-së.

b) Vendosjen e një baze të mirë për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve në gjuhë.

c) T’u vijë në ndihmë nxënësve, mësuesve, hartuesve të programeve, organizmave të certifikimit dhe administruesve të arsimit për të bashkërenduar përpjekjet e tyre.

Shumëgjuhësia, pra, duhet vendosur në kontekstin e shumëkulturorësisë. Gjuha nuk është vetëm mjeti themelor i kulturës, por është, gjithashtu, mjeti kryesor për të arritur të shprehurit e kulturës.

Kulturat e ndryshme, qoftë kombëtare, krahinore ose rajonale përfaqësojnë me njëra-tjetrën, ndikojnë dhe kundërveprojnë ndaj njëra-tjetrës dhe, kështu, ato, në tërësinë e tyre, ndihmojnë për të përfutur një aftësi humëkulurore të pasuruar dhe të integruar.<sup>29</sup>

Mësimi i gjuhëve amtare në komunitetin e shoqërive shumëgjuhëshe merr vlera të rëndësishme për t’u mësuar. Por si rezultat i këtyre kërkesave të reja të kohës vihet re një përdorim i tejkaluar i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe, sidomos të huazuara nga anglishtja, italishtja dhe frëngjishtja. Këto futje ndeshen në shtypin e shkruar dhe pamor. Gjuha e medias, krahas ndihmesës që jep për përdorimin e gjuhës në formën

---

<sup>28</sup> Council Resolution of 21 November 2008 on a European strategy for multilingualism, Official Journal C 320, 16/12/2008 P. 0001– 0003 )

<sup>29</sup> Shih: E. Shiroka, *Kuadri i përbashkët evropian i referencave për gjuhët*, në UT, “Studime Albanologjike”, II, Tiranë, 2011, f.365-366.

më të mirë standarde të saj, përcjell në forma dhe struktura nga më të larmishmet, duke strehuar në leksikun e shqipes, fjalë e struktura që emigrojnë nga gjuhët fqinje apo edhe më larg, për arsye objektive dhe subjektive.<sup>30</sup>

Këto ndikojnë në gjuhën e përdorur nga brezi i ri të cilët përdorin shpesh struktura dhe fjalë të huaja kur kemi fjalët tona. Kjo situatë bëhet edhe më e vështirë duke ditur se brezi i ri është në lidhje të vazhdueshme me internetin, ku kryesisht përdoret anglishtja.

Shtrohen pyetjet: Pse duhet ta ruajmë dhe mbrojmë gjuhën tonë amtare? Si do të veprojmë me gjuhën shqipe mbas përfshirjes në BE? A do të thotë kjo, se gjuha shqipe do shkojë drejt prishjes, do të mbushet me fjalë e shprehje të huaja dhe ne do të rrimë indiferentë, apo është detyra jonë ta mbajmë të pastër, të bukur dhe ta pasurojmë për të qenë e denjë përkrah gjuhëve të tjera evropiane?!

Në kuadrin e të nxënimit të anglishtes, si gjuha e dytë ndërkombëtare kryesore në Evropë e në Botë që është, secila gjuhë, pra edhe shqipja, duhet të jetë, nga ana e vet, gjuhë e përpunuar, gjuhë që në kuadrin e hapësirave ku ajo përdoret, të jetë gjithmonë e tillë: tipar i dallueshëm i shqiptarisë. Sikundër thotë shpesh prof. Gj. Shkurtaç, ne do të hyjmë në Evropë, do ta mësojmë anglishten dhe gjuhë të tjera, por do të mbetemi edhe më tej të veshur me gjuhën dhe kulturën shqiptare<sup>31</sup>.

Gjuha amtare është gjuha e përbashkët, që flitet rrjedhshëm nga të rriturit në shtëpi dhe jashtë saj dhe që pasqyron kulturën dhe prejardhjen etnike të folësit. Ajo është një mjet me anë të së cilës grupe të ndryshme brenda një shoqërie të dhënë mbajnë dhe ruajnë identitetin e tyre. Kultura dhe traditat zhvillohen krah për krah me gjuhën. Gjuha letrare është *“forma më e përpunuar e gjuhës së një populli, e cila ka norma të caktuara, të ngulitura në të shkruar e në të folur dhe arrin njësimin më të lartë në kohën e krijimit të kombeve e të shteteve kombëtare”*<sup>3233</sup>.

Rëndësia e mësimin të gjuhës amtare qëndron në atë, se çdo fëmijë duhet të marrë bazat e arsimimit përmes të lexuarit, të shkruarit dhe numërimit në atë gjuhë që është më e njohura për të. Vetëm përmes gjuhës mund të kalohet nga e njohura te e panjohura. Nëpërmjet saj trashëgohen vlerat kulturore të vendit dhe zhvillohen aftësitë e tyre komunikative. Ka mjaft konventa ndërkombëtare që theksojnë rëndësinë e mësimin të gjuhës amtare, si për shembull : Deklarata e të Drejtave të Njeriut që njeh të drejtat gjuhësore të çdo individi për ta përdorur gjuhën amtare (1992).

Siç thekson prof. Shkurtaç: *“ Edhe përpjekjet tona të sotme për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës letrare shqipe synojnë të mos lënë të humbasin vlerat e gjuhës popullore shqipe, të ruajnë lidhjet e saj me gjuhën letrare dhe të mos lejojnë që strukturat leksikore-fjalëformuese e sintaksore të marrin karakter hibrid. “*<sup>34</sup>

Këto qëllime shprehen edhe në programin mësimor të gjuhës amtare, ku thuhet se gjuha amtare si lëndë parësore e me karakter kombëtar synon:

<sup>30</sup> Mimoza Gjokutaj, *Mësimi i gjuhës shqipe përballë braktisjes së fshehtë* - QTKA Konferenca Kombëtare *“Shanse të barabarta për secilin nxënës – Braktisja e fshehtë”* 27 Tetor 2006

<sup>31</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Kundrimet gjuhësore*, Tiranë, 2006.

<sup>33</sup> GA, *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë 1984, f. 391

<sup>34</sup> Gj. Shkurtaç, *Kultura e gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006, f.186

1. Të mundësojë formimin dhe zhvillimin vetjak intelektual, emocional, shoqëror, estetik dhe moral të çdo nxënësi.

2. Të përvetësojnë gjuhën amtare në atë nivel e cilësi, që të mundësojë të mësuarit e tyre të vazhdueshëm gjatë gjithë jetës.

3. Të aftësojnë nxënësit të realizojë komunikimin me shkrim dhe me gojë për nevoja vetjake saktë dhe me kulturë gjuhësore.<sup>35</sup> Struktura e këtij programi e orienton mësuesin në tri boshte kryesore:

1. Shprehi komunikative, duke synuar të folurit, leximin dhe shkrimin.

2. Njohuri rreth gjuhës e dukurive të saj.

3. Shprehi informative. Nga mësuesit kërkohet që të mos kufizohen vetëm me tekstin, por edhe të gjejnë vetë modelet më të mira të shqipes së shkruar e të folur, sidomos të ndjekin botimet e reja.

Kjo politikë për mësimin e gjuhës amtare theksohet edhe njëherë kur flitet për rëndësinë e mëimit të anglishtes si "*lingua franca*". Që në fillim duhet thënë, se themelore është zotërimi i mirë i gjuhës amtare. Kalimi nga arsimit bazë 8-vjeçar në atë 9-vjeçar dhe nga arsimit i mesëm nga 4-vjeçar në atë 3-vjeçar, është rasti për të korigjuar disa gabime të së shkuarës dhe për të vënë mësimin e shqipes në baza të shëndosha, sepse, pavarësisht nga domosdoshmëria për të nxënë anglishten si gjuhë e parë e madhe në BE, gjuhët kombëtare, pra edhe gjuha shqipe shërben për të ruajtur trashëgiminë tonë kulturore".<sup>36</sup>

Mësuesit luajnë rol të veçantë në përvetsimin, pasurimin dhe mbrojtjen e gjuhës amtare. Kjo detyrë nuk i takon vetëm mësuesve të gjuhës amtare dhe të letërsisë, por të gjithë mësuesve. Ata kanë një përgjegjësi unike. Mënyra se si ndërveprojnë me nxënësit formon mendjet e tyre, dëshirat, aspiratat, vlerat dhe ndjenjën e përgjegjësisë për rolin e tyre në shoqëri. Mësuesit luajnë rol të rëndësishëm në përgatitjen e nxënësve për një të ardhme të globalizuar dhe forcojnë identitetin e tyre.

Në "Parimet e përbashkëta evropiane për kompetencat dhe kualifikimin e mësuesve"<sup>37</sup> midis kompetencave-bazë të një mësuesi theksohet: *Kompetenca gjuhësore*. Kjo përfshin aftësinë për komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhë të ndryshme; talentin e mësuesit që të informojë nxënësit e tyre në mënyrë të qartë për lëndën, duke përdorur mënyra mësimdhënie efektive. Për më tepër, nga mësuesit e sotëm kërkohet që transmetimi i njohurive të kryhet në mënyrë të tillë, që ta ndihmojë dhe ta bëjë nxënësin për të vazhduar punën në mënyrë të pavarur.

Një nga kompetencat kryesore të mësuesit evropian dhe shqiptar është të njohë mirë një gjuhë të huaj me qëllim që të vetkualifikohet për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe të lehtësojë mbijetesën e nxënësve të tij. Por kjo njohje e thellë e

---

<sup>35</sup> Program mësimor për shkollat 9-vjeçare, Lënda: *Gjuha amtare* (klasa VIII) Tiranë, 2006

<sup>36</sup> Gazeta "Panorama" 27/05/2008.

<sup>37</sup> Common European Principles for Teacher *Competencies and Qualifications*. – Brussel: European Commission (2003).

ndihmon atë të mbrojë dhe përpunojë gjuhën shqipe. Kështu, nëse mësuesit e dinë vetë mirë gjuhën e huaj, ata do të jenë në gjendje të ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë atë që flasin dhe të gjejnë barasvlerëset e shqipes për shumë fjalë që kanë mbushur fjalorin e tyre.

Në këtë mënyrë jo vetëm mbrohet gjuha standarde, por krijojmë te nxënësit një vlerësim të mirë për gjuhë tonë dhe për mundësitë e gjera të shprehjes që ajo zotëron. Gjuha standarde dallohet nga pasuria e saj, ajo është në zhvillim dhe pasurim të përditshëm, sidomos për funksione të veçanta në jetën publicistike, letrare e shkencore. Këtu një segment të veçantë e shumë të rëndësishëm përbën terminologjia e shumëllojshme dhe shumë e pasur që përdoret në të gjitha fushat e dijes.

Duke trajtuar problemin e gjuhëve të sotme evropiane në kuadrin e BE-së, gjuhëtari i shquar italian Tulio de Mauro, në një parashtrësë shumë interesante me titullin “*Evropa e gjuhëve*”, ka shqyrtuar aty mjaft gjerë domosdoshmërinë e sotme për një gjuhë të përbashkët zyrtare për të gjithë bashkësinë<sup>38</sup>. Këtë temë, ndërkaq, e kanë trajtuar edhe studiues të tjerë në këto pesëmbëdhjetë-njëzet vitet e fundit, *duke parashtruar edhe një farë qëndrimi a përgjigjeje ndaj shqetësimeve të ligjshme që lindin në masën e gjerë të njerëzve përballë shtrirjes dhe përmasave aq të mëdha, ndoshta edhe kërcënuese, të anglishtes si gjuhë e marrëveshjes dhe e komunikimit zyrtar në Bashkësinë Evropiane*. Na duket me vend të theksojmë disa nga dukuritë dhe kahet më kryesore të kësaj perspektive gjuhësore e kulturore të BE-së.

#### **I.10 Anglishtja në kuadrin e BE-së, aspekte politiko-shoqërore dhe gjuhësore**

Ndër problemet e para që duhet të përballojë BE-ja sot është edhe ai i komunikimit zyrtar midis shteteve anëtare, duke qenë se, qysh në fillimet e krijimit të saj, kjo njësi mbishtetërore (ende në hapat e parë, por me perspektivë të sigurtë që të forcohet e të fuqizohet më tej) është karakterizuar nga një larmi e madhe gjuhësh kombëtare. Një zgjidhje e parë është gjetur me deklarinimin si gjuhë zyrtare të BE-së *gjuhën letrare kombëtare të çdo shteti anëtar*, për një tërësi prej nëntë gjuhësh; *çdo komunikim duhet të përkthehet në këto gjuhë*.

Porse, në planin praktik shpejt do të shihej se, një zgjidhje e tillë nuk ishte as praktike as e efektshme; *multilinguizmi zyrtar rezulton të jetë një peshë shumë e rëndë si në pikëpamje të kostos, ashtu edhe përsa i përket ritmit të administrimit të institucioneve komunitare*. Veç kësaj, duhet pasur parasysh se, në procesin e integritimit evropian gjuha ka edhe *karakter simbolik*, prandaj është menduar të favorizohet *përdorimi i gjuhëve të ndryshme të shteteve komunitare si gjuhë të huaja me status zyrtar të barazvlerëshëm*, duke bërë kështu hapin e parë drejt një pluralizmi të përhapur gjerë e idealisht të barabartë.

Nisma më e re në këtë drejtim ka qenë “*Projekti gjuha*” që, ndonëse në zbatim e nën tutelën e identitetit gjuhësor të shteteve të veçanta, paraqet një provë serioze nga ana e autoriteteve komunitare për të nxitur shumëgjuhësinë (*plurilinguizmin*) e shumëkulturorësinë (*plurikulturalizmin*) në shkallë evropiane. Projekti parashikon si pikëmbërritje që të favorizojë kuptimin e ndërsjellë (reciprok) midis shteteve anëtare

<sup>38</sup> Shih: De Mauro T., *Europa delle lingue*, Roma, 2000.

dhe si qëllim të afërt (imediati) ka *shtimin e efektshmërisë së mësimit të gjuhëve të huaja në sistemin shkollor dhe të përmirësojë kompetencën në botën e punës e të marrëdhënieve ndërkombëtare.*

Synimi politik i njësimit është nisur, siç dihet, nga sektori ekonomik, me krijimin e *tregut të përbashkët* për qarkullimin e lirë të mallrave, por ky i fundit, *parakupton se ekziston edhe një prodhim dhe një qarkullim kulturor mjaft uniform.* Porse, ndërkaq, vihet re një *mospërputhje midis rezultateve të arritura në fushën ekonomike-financiare dhe të ndërtimit të identitetit evropian,* që përbën premisa të domosdoshme të homogjenitetit shoqëror-kulturor dhe, bashkë me këtë, të qarkullimit të të mirave dhe të shërbimeve të çdo tipi brenda sistemit politik.

Në fakt, ndërsa integrimi evropian kryhet gjatë veprimtarisë së organeve politiko-administrative dhe juridike, të cilat punojnë për ndërtimin e mirëkuptimit politik dhe për përpunimin e një të drejte të përbashkët nëpërmjet traktateve e kodeve, si dhe të veprimtarisë juridike, *mjaft më e vështirë rezulton të jetë arritja e një farë niveli të ndërkuptueshmërisë midis shteteve me anën e përgjithësimin të detyruar të një gjuhë të përbashkët,* edhe pse të kufizuar vetëm në funksionet e komunikimit zyrtar të organeve komunitare.

Rezistenca e shteteve anëtare është historikisht e motivuar, qoftë nga pushteti simbolik që tradicionalisht i atribuohet gjuhës amtare në formimin e identitetit etnik, qoftë nga funksioni i kohezionit shoqëror-politik që ushtron gjuha kombëtare. *Lidhja midis gjuhës dhe kombit,* gjithashtu, në Evropë ka rrënjë të forta; gjuha zyrtare është e lidhur sa me arsimin shtetëror qysh në zanafillën e vet – siç shihet edhe në ndërtimin ideologjik të gjuhëve të mëdha evropiane, të kulturave të kodifikuara mirë në fjalorë normativë kombëtarë-, aq edhe në përdorimet e veta publike.

*Integrimi evropian në një “bashkësi gjuhësore” të njëjtë (unike) është i papërfytyrueshëm, edhe pse kjo gjë do të parakuptonte një autoritet politik mbikombëtar të pajisur me institucione që të ishin në gjendje t’i impononin njohjen e gjithmbarshme(universale) të një gjuhë zotëruese.* Në mungesë të një gjuhe zyrtare të vetme (unike) mbeten për t’u realizuar mundësitë e ndërkuptimit dhe të shkëmbimeve mbi një bazë të re. Zgjedhja politike që po shkon duke u përvijuar është ajo e plurilinguizmit të përhapur, porse, në planin praktik, *është parë tashmë pohimi progresiv i dy gjuhëve: i frëngjishtes dhe i anglishtes.*

Ndërtimi i atij mjeti që quhet *gjuha e përbashkët* e një vendi privilegjon konstantet gjuhësore të njohura si përdorime të ligjshme apo si *“normë” me bashkëjetesë të varianteve sociologjiksht sinjifikative.* Porse, edhe ky kod, i ndërtuar kështu, nga ana e vet është i përfshirë në një lloj tregu gjuhësor, ku çdo gjuhë është e pajisur me vlera jo vetëm simbolike, po edhe shoqërore ekonomike. Gjuhët, në fakt, bëjnë pjesë në konfiguracionet shoqërore të bazuara mbi hierarkitë e pushtetit politik dhe ekonomik, prandaj edhe domosdoshmëritë për të mësuar gjuhë të tjera varen, në radhë të parë, nga pozicioni që ato zënë në një hierarki të tillë.

Në këtë perspektivë rezulton, natyrisht, një pozicion i ndryshëm ndërkombëtar i gjuhëve, si p.sh. anglishtja dhe irlandishtja, pavarësisht se të dyja janë gjuhë zyrtare të barabarta të BE-së dhe pavarësisht se irlandishtja do të ketë brenda Republikës së Islandës një pozicion të privilegjuar, si shprehje e identitetit kombëtar. *Gjuhët komunitare nuk janë, pra, të gjitha të barabarta dhe jo rastësisht janë zgjedhur frëngjishtja dhe anglishtja.* Sot ekziston një konflikt midis kërkesës praktike për të

pakësuar numrin e gjuhëve të punës dhe asaj politike-kulturore për të mos lejuar të vijë një unifikim evropian nën sundimin e një gjuhë të vetme.

*Vlerësimi që çdo vend i atribuon gjuhës së vet është, në fakt, ende shumë pozitiv, pavarësisht se fragmentarimi gjuhësor evropian zakonisht gjykohet në mënyrë negative, sepse ai shihet si pengesë për integrimin kulturor dhe politiko-shoqëror. Një nga shenjat kryesore të një qëndrimi të tillë është edhe metafora e “pritave” apo pengesavegjuhësore (“des barrieres linguistiques”)që takojmë shpesh kur diskutohet për krijimin e një “uniteti evropian”. Siç thotë edhe K. Obermajer-i: “The single most important key to success in creating a genuine international understanding lies in a breakdown of the linguistic barrier between nations”.*

Fjala është për një metaforë politiko-shoqërore të lidhur me paradigmen e internacionalizmit dhe me atë që i kundërvihet nacionalizmit. Nga pikëpamja e nacionalizmit gjuha kontribuon për të përcaktuar kufijtë e grupit etnik dhe paraqet kështu një faktor të rëndësishëm të homogjenitetit të brendshëm; ajo ndihmon qarkullimin dhe shkëmbimin e ideve dhe të normave të përbashkëta brenda bashkësisë etnike dhe, në të njëjtën kohë, përbën një pengesë (barrierë) në ndikimet nga jashtë.

Nga pikëpamja ndërkombëtare, përkundrazi, gjuha kombëtare përbën një pengesë për qarkullimin e lirë të prodhimeve materiale dhe kulturore, që sot i tejkalon shumë kufijtë e shteteve të veçanta. Kemi, pra, një kontrast brenda bashkësisë që vë përballë, nga njëra anë, pohimin e gjuhëve kombëtare të kuptuara si entitete historikisht të formuara dhe mbartëse të vlerave simbolike e kulturore që përcaktojnë shtetin-komb dhe, nga ana tjetër, kërkesën për të pasur një mjet komunikimi mbikombëtar (supernacional).

*Vlera e kësaj gjuhë të shkëmbimit, sidoqoftë, nuk do të mundet kurrë të jetë ekskluzivisht instrumentale. Në fakt ekziston një lidhje e ngushtë midis përdorimit të një gjuhë dhe ligjshmërisë së institucioneve që i shërbejnë; rrënjësia e besimit se institucionet që i shërbejnë bashkësisë janë të justifikueshme, bëhet, në fakt, nëpërmjet gjuhës zyrtare, e cila shpreh pikërisht atë sistem vlerash, zgjedhja e të cilit nuk mund të jetë kurrë shoqërisht dhe politikisht asnjë (neutrale).*

Ekziston, gjithashtu, një përputhje midis përdorimit gjuhësor dhe formës së organizimit shoqëror që, ndonëse duke mos qenë sistematike dhe e drejtpërdrejtë, *nuk mënon së ndikuari mbi ndërtimin e një diskutimi ideologjik e kulturor, që bëhet mbi bazën e qëllimeve komplekse dhe të strategjive individuale të tipeve të ndryshme, por gjithnjë brenda kuadrit që çdo shoqëri i imponon asaj që ka një synim.* Edhe zgjedhja e një gjuhë të përbashkët pune për BE-në nuk është (dhe nuk mund të jetë) e pavaruar (asnjanëse apo neutrale) nga pikëpamjet politiko-shoqërore dhe kjo shpjegon edhe “ngërçet” e shumta që ka shkaktuar përdorimi pothuajse ekskluziv i anglishtes dhe i frëngjishtes.

Qysh nga formimi i BE-së gjuha më e përdorshme e punës ka qenë frëngjishtja, qoftë për pozicionin e Francës midis shteteve themeluese, qoftë për një traditë të gjatë të përdorimit të frëngjishtes në diplomaci dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Përfshirja në BE e Anglisë (apo siç quhet ndryshe e Mbretërisë së Bashkuar) i dha shtysë të re përdorimit të anglishtes si gjuhë e komunikimit ndërkombëtar, përderisa **sot anglishtja është e para në hierarkinë e dobishmërisë** në fushën ekonomike dhe në atë teknologjiko-shkencore; ky pozicion e bën anglishten mjaft të kërkuar si gjuhë të huaj përkrah gjuhës së vet amtare të çdo vendi anëtar të BE-së.

Për këtë arsye, sot, frëngjishtja dhe anglishtja janë gjuhët e punës më të përdorshme për të hartuar dokumentet komunitare, ndonëse tekstet nuk janë gjithnjë origjinale; kur teksti original është në frëngjisht (rasti më i dendur), atëherë ai anglisht është i përkthyer. Sot për sot, puna e zyrave komunitare ka funksione kryesisht juridike dhe administrative të përgjithshme, pra, veprimtari që kanë në themel të drejtën: kjo do të thotë se kemi një *anglishte juridike në kontekstin evropian*, ndaj së cilës, përherë e më shumë do të drejtohet vëmendja dhe interesimi i evropianëve.

Anglishtja që është pranuar në këto dekadat e fundit si gjuhë e komunikimit ndërkombëtar bazohet mbi variantin standard që ka ardhur duke u përdorur në përmbushje të këtij funksioni; ajo është larguar mjaft nga veçoritë më të theksuara të varieteteve të anglishtes që ekzistojnë sot në Angli dhe në Amerikë, prandaj edhe shërben si *një mjet ndërmjetës, midis anglishtes "së përbashkët" dhe anglishtes "së specializuar"*.

Funksioni i gjuhës së institucioneve juridiko-administrative evropiane e vë anglishten në një fazë të re të zhvillimit të saj, që paraqet aspekte të përpunimit gjuhësor mjaft kompleks, sepse ky funksion nuk është thjesht "veikolar" apo instrumental; përkundrazi, ai ka si referente një kulturë ligjore ende në rrugën e formimit (kultura evropiane) dhe, sidoqoftë, mjaft më të ndryshme nga ajo britanike.

Kjo ka sjellë edhe një veprimtari të rivështrimit të akteve legislative dhe administrative komunitare për të shmangur një ngjyresë të tepërt në kuptimin kombëtar dhe për të siguruar ndërpërkthyeshmërinë më të madhe në gjuhët e tjera të BE-së; *efekti gjuhësor i një vepre të tillë ka qenë thjeshtimi i madh i strukturës sintaksore, si dhe një standartizim i shkajshëm i formulave juridike*.

Në dokumentet e shkruara në frëngjisht dhe në anglisht vihet re një gjuhë më e thjeshtë, aq sa studiuesit kompetentë flasin aty për një "*anglishte ligjore*" në të cilën mungojnë tiparet më evidente të anglishtes "ligjore" britanike, si p.sh. përshtimet dhe përkufizimet e stërholluara e të stërzgjatura (prolikse), frazat e gjata e të ndërlikuara, arkaizmat, termat tekniko-juridikë të lidhur me traditën e "*cammon-law*".

Kështu, sot ka një ndryshim gjuhësor të dukshëm midis dokumentacionit ligjor të Anglisë dhe të atij të shkruar në anglisht në aktet e BE-së. Në këto të fundit shquajnë synimet drejt shpersonalizimit dhe teknikizmit, gjë që ndodh, jo vetëm për domosdoshmërinë praktike të një komunikimi më të shkathët dhe të një përkthyeshmërie më të lehtë në frëngjisht, por edhe sepse është gjuhë e BE-së, e kuptuar si një prodhim kolektiv i ritualizuar, që nuk ka ende pika referimi të qarta kulturore.

Kjo ndodh edhe për faktin se identiteti evropian është ende në rrugën e zhvillimit dhe organizimi politik i tij, në udhën e legjitimizimit apo, sidoqoftë, në një fazë që nuk duket ta ketë kaluar stadin e organizimit instrumental fillestar të lidhjeve politiko-shoqërore dhe ekonomike. Mungon, pra, një bashkëlidhje e qartë midis sistemit të vlerave dhe besimeve shoqërisht të rrënjosura dhe të diskutimit institucional.

Anglishtja e këtyre dokumenteve është e ndryshme nga ajo që ka si referim organet politiko-administrative britanike apo amerikane. Fjala është për një gjuhë, në mos tërësisht veikolare, sepse gjuha juridike nuk mund të ekzistojë pa një kulturë

politike ligjore të përpiktë, që paraqet karakteristikat e anglishtes standarde ndërkombëtare; ajo mund të përkufizohet si jopersonale dhe anonime, -përderisa është e zhveshur nga treguesit shumë të qartë të asaj culture, ku anglishtja është gjuhë e parë e bashkësisë; ajo është përdorur, pra, *për qëllime të ndërkomunikimit ndërmjet shteteve që kanë gjuhë e kultura të ndryshme nga ato anglo-amerikane të anglishtfolësve autoktonë.*

Natyrisht, gjuha apo ligjërimi i shkruar i institucionit shpreh dhe simbolizon autoritetin politik dhe shoqëror, gjë që duket edhe në mëkëmbjen e përgjithshme të gjuhëve kombëtare. Rëndësia që u është atribuar vlerave dhe dobisë së shërbimit nga së paku njëra prej gjuhëve të mëdha të BE-së, bën që qytetari evropian të orientohet zakonisht ndaj anglishtes për shkak të përparësive dhe dobive të saj praktike.<sup>39</sup>

### I.11. Koncepti i sociolinguistikës së sotme ndaj gjuhëve kombëtare të BE-së

Rreth njëzet vjet më parë kishte njerëz që, si e thotë T.de Mauro, *profetizonin, se pas krijimit të BE-së nuk do të kishte më hapësirë për mjaft gjuhë të ndryshme dhe se të gjithë do të përfundonim të flisnim gjithnjë dhe vetëm anglisht.*<sup>40</sup> Natyrisht, miliona njerëz e kanë mësuar anglishten dhe qindra miliona e përdorin atë si gjuhë të dytë, por përhapja e anglishtes si gjuhë e dytë (ashtu si edhe e gjuhëve të tjera mbikombëtare, si e kinezishtes, rusishtes, arabishtes klasike, spanjishtes, frëngjishtes etj.) nuk e ka çrrënjësuar aspak larminë e normën e gjuhëve amtare.

Tashmë është e qartë se kishin të drejtë ata që i kundërviheshin kësaj profecie. Shumë fakte na bëjnë t'u japim të drejtë atyre. Dhe janë fakte që vijnë pikërisht nga profetët e anglicizimit planetar. Këto janë, në sintezë: përhapja e teknologjive të komunikimit, rritja botërore e shkollimit (dhe, sidomos, e anglishtes si gjuhë e dytë) dhe, së fundi, ajo që ka rëndësi më të madhe, kahu (sensi) gjithnjë e më i fortë, i shtrirë dhe i rrënjësuar për dinjitetin e barabartë të gjithë njerëzve dhe të të gjithë popujve.

Si fryt i konvergimit të gjithë këtyre faktorëve, sot, shihet se disa gjuhë pak të përhapura dhe që, ndoshta, në epoka të tjera do të ishin zhdukur dalëngadalë, kanë marrë një forcë të jashtëzakonshme, një prestigj të ri, një jetësi të re. Kështu, sot, çështjet gjuhësore janë në rend të ditës gati në të gjithë Planetin. Evropa nuk bën përjashtim. Përkundrazi, krijimi i tregut të përbashkët të BE-së, pastaj edhe i vetë BE-së e bëjnë edhe më aktuale çështjen e raportit ndërmjet gjuhëve. Dhe shumëkush pyet: *a do të mbijetojnë në BE gjuhët e veçanta? Apo, së afërmi, njëra do ta shkatërrojë tjetrën? Dhe cila do të mbisundojë? Anglishtja? Apo (sugjeron dikush) një gjuhë artificiale si esperantoja?*

*“Profecive të lehta nuk dëshirojmë t'u shtojmë një tjetër të tillë, -thekson De Mauro-por na duket e dobishme të përvijojmë para nesh faktet dhe prirjet që vihen re për të kërkuar që të mos themi (e të mos bëjmë) shumë marrëzira”.* Le të mos flasim këtu për kuadrin gjuhësor të mbi dyzet vendeve të Këshillit të Evropës. Le të kufizohemi në Bashkimin Evropian.

<sup>39</sup> Shih: Gabriela del Lungo Camiciotti, *L'inglese nell'ambito della Comunità Europea*, në “Quaderni del Dipartimento di Linguistica” di Firenze, 3, 1992, pp.29-46.

<sup>40</sup> Shih: De Mauro T., *Europa delle lingue*, Roma, 2000.

Rreth 390 milionë banorë të 15 vendeve të BE-së flasin një numër të madh idiomash mjaft të ndryshme për nga natyra dhe struktura. Gati të gjitha i përkasin familjes së madhe të gjuhëve indoevropiane. Me përjashtim të finlandishtes, dhe po të mos konsiderojmë idiomat e grupeve të parëndësishme të emigrantëve (turq, arabofonë, filipinas etj.) idiomat e tjera joindoevropiane të vendbanimeve të lashta janë baskishtja, edhe sot e gjallë në Spanjën veriore e në Francën jugore, pastaj laponishtja, familja e gjuhëve ugrofine si finlandishtja. BE-ja dhe vetë anëtarët e saj nuk i vënë të gjitha idiomat në të njëjtin plan. Disa prej tyre janë quajtur “*langues moins repandues*” (gjuhë më pak të përhapura), si galishtja në Britaninë e Madhe, bretonishtja ose oksitanishtja në Francë, katalanishtja në Spanjë.<sup>41</sup>

BE-ja përpiqet të sigurojë një gjuhë të vetme e të njëjtë për këto gjuhë më pak të përhapura dhe gati të gjitha vendet (së fundi edhe Italia qysh më 1999) kanë ligje dhe programe shkollore që synojnë pikërisht në këtë. Idioma të tjera janë konsideruar dialekte.

Profanët pyesin shpesh-thotë me një farë ironie De Mauro- nëse ka dallim ndërmjet gjuhës dhe dialektit. Dikush përgjigjet me shaka: “*Gjuha është një dialekt me ushtri dhe me pasaportë*”. Kjo thënie nuk është e vërtetë qind për qind. Ka pasur dhe ka gjuhë të mëdha të kulturës letrare e shkencore dhe të qytetërimit njëzëror, gjuhë që kanë ndikuar mjaft mbi të tjerat, gati i kanë plazmuar për shekuj, ndonjëherë për mijëra vjet, dhe që, megjithatë, nuk kishin as ushtri as pasaportë.

Një shembull ekzemplar është në Evropën mesjetare përhapja e latinishtes (dhe brenda latinishtes ka një burim të fuqishëm prej greqishtes klasike) shumë përtej kufijve të Perandorisë Romane; në Indi ka qenë rasti i sanskritishtes. Në Lindjen e afërt, djepi i qytetërimit evro-aziatik, një rast i ngjashëm ka qenë ai i sumerikishtes, që mbijetoi shumë shekuj pas rënies së shtetit të popullit të vet përkatës.<sup>42</sup>

Por, pavarësisht nga këto përjashtime të shkëlqyeshme, në përgjithësi thënia e mësipërme prek në të vërtetë thelbin në kompleksitet: gjuha është një idiomë që, së paku një shtet ka vendosur ta përdorë atë si gjuhën e vet zyrtare, në ligjet dhe në shkollat e tij, në administratë, në ushtri e në mjetet e informacionit. *Po t’i shohim kështu gjërat, atëherë përmbi gjashtë mijë idiomat sot reduktohen në botë me rreth disa qindra “gjuhë” me pasaportë dhe me ushtri.* Dhe në BE, në krahasim me dhjetëra e dhjetëra dialekte e gjuhë më pak të përhapura, gjejmë vetëm pak gjuhë zyrtare në kuptimin e ngushtë të fjalës në shtetet anëtare.

Le të numërojmë në rend gjeografik dhe nga veriu në jug, nga perëndimi në lindje: suedishtja, finlandishtja, danishtja, irlandishtja, anglishtja, gjermanishtja, flamingishtja, luksemburgishtja, frëngjishtja, portugalishtja, spanjishtja, italishtja, greqishtja e re. *Këto gjuhë janë me origjinë dhe me histori të ndryshme, porse në to është e ndryshme edhe konsistenca e ngulimit të tyre demografik, shoqëror e kulturor dhe e prestigjit të tyre ndërkombëtar.*

Irlandishtja ose gaeliko-ishtja e Irlandës është, ashtu si gaeliko-ishtja e Skocisë dhe galishtja (që të dyja më të gjalla në Bretanjë) dhe me bretonishten në Francë, një nga pak mbijetesat e zotërimit të pamasë keltik që në shekujt e fundit para Krishtit shtrihej kompakte që nga ishujt britanikë deri në Gadishullin Iberik, në Gali andej e

<sup>41</sup> Shih: De Mauro T., *Europa delle lingue*, Roma, 2000.

<sup>42</sup> Shih: De Mauro T., *Europa delle lingue*, Roma, 2000.

këndej Alpeve, deri në Adriatik dhe mjaft përtej Renit, deri në Detin e Zi. Popullsitë gjermanike dhe romane (apo më mirë *romanizimi gjuhësor*) e kanë mbytur dhe tkurrur në pak areale Evropën keltike, që mbijeton, përveç se në idiomat e përmendura, në gjurmë të fjalorit dhe të shqiptimit në të folmet neolatine, që nga frëngjishtja deri në dialektet italiane veriore.

Irlandishtja sot flitet vetëm nga një pjesë e popullsisë së Irlandës, që në pjesën më të madhe është dygjuhëshe ose ka përqafuar përfundimisht anglishten. Atje është përkrahur (inkurajuar) mësimi në shkolla dhe është, bashkë me anglishten, gjuhë zyrtare e shtetit. Irlandez, thellësisht irlandez nga kultura është Xhejms Xhojsi (*James Joyce*), një nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë botërore (*Weltliteratur*), por ai ka shkruar në anglisht (dhe disa herë edhe në italisht, më shumë se në irlandisht).

Greqishtja e re është vijuese e drejtpërdrejtë e greqishtes klasike bizantine. Edhe zotërimi grek qe shumë i shtrirë, që nga Italia jugore ("*La magna Grecia*" e lashtë) në Greqinë e sotme, në Turqi, në të gjithë Lindjen e Mesme dhe në Lindjen e Afërme aziatike. Latinizimi mesjetar i jugut të Italisë, depërtimi turk e arab, si dhe ai sllav e kanë ngushtuar greqishten në hapësirat e sotme. Flitet nga rreth 10 milionë veta në Greqi (ku është përdorur në format e saj të *katareuzës*, gjuha letrare e pastër, arkaike, dhe *edimotikisë*, gjuha popullore, mjaft më përtëritëse), nga një gjysmë milioni në Qipro dhe në disa zona të diasporës greke minoritare të Shqipërisë, të Turqisë dhe të Italisë së Jugut, ku këto vitet e fundit është duke njohur një rigjallërim të jashtëzakonshëm.

Finlandishtja, ashtu si hungarishtja, është një nga më përfaqësimitaret e degës ugrofine të familjes së gjerë uraloaltaike. E dëshmuar qysh në mesjetë ajo ka një traditë të gjatë letrare. Gjuhët e tjera të Bashkimit Evropian përndahen ndërmjet dy nëngrupeve të mëdha të familjes indoevropiane: grupit gjermanik dhe grupit neolatin.

Janë gjuhë gjermanike: suedishtja (me rreth 9 milionë folës në Suedi e pjesërisht në Finlandë, danishtja (5 milionë folës në Danimarkë), nederlandishtja apo fiamingishtja apo holandishtja (13 milionë e gjysmë folës në Belgjikë), luksemburgishtja, deri para pak vjetësh e konsideruar si dialekt i gjermanishtes, tashti e ngritur në rrangun e një gjuhë letrare të Luksemburgut, dhe, së fundi, gjermanishtja dhe anglishtja. Këto dy gjuhë brenda Bashkimit Evropian fliten përkatësisht nga 90 milionë veta (të përqendruar në Gjermani, Austri e Luksemburg dhe në arealen e pakicave në Alsat, Itali, Belgjikë) dhe nga 62 milionë në Britaninë e Madhe e në Irlandë.

Por këto shifra, ndonëse të konsiderueshme, më të mëdha se të folësve evropianë të të gjitha gjuhëve të tjera në BE, na japin vetëm një llogari të vogël të një pjese të "potencës" së të dy këtyre gjuhëve. Përveç se në Austri, gjermanishtja është gjuhë kombëtare zyrtare në Zvicër dhe flitet nga miliona gjermanofonë të lindur, të shpërndarë në gjithë Evropën Lindore, nga Rumania e Hungaria deri në Rusi. Nëpërmjet një dialekti të saj, hebreogjermanishtes apo yidish-it ajo është e pranishme në miliona persona edhe në diasporën e madhe hebraike. Por as kjo nuk mjafton.

Gjermanishtja është gjuha e Gëtes dhe e Kafkës, e Moxartit dhe e Brahmsit, e Kantit dhe e Ajnshtajnit, e Luterit dhe e Marksit. Po ashtu është gjuhë e Austrisë, pra jo vetëm e valcit po edhe e Frojdit, e Vitgenshtajnit etj. *Në të gjitha fushat e artit, të studimeve historike, filologjike, gjuhësore etj. dhe në çdo sektor të teknikës një trashëgimi e pamasë historike dhe aktuale imponojnë mësimin e gjermanishtes.* "Me

*këtë nuk duam të themi se Evropa duhet të përgatitet të flasë gjermanisht, por sigurisht do të jetë e vështirë të jetohet pa njohjen e saj”- thekson De Mauro.<sup>43</sup>*

Së fundi, ndërmjet gjuhëve gjermanike, duhet përmendur anglishtja. Po të ishin vetëm anglofonët britanikë e irlandezë do të vlen të ajo që thamë më lart për gjermanishten (dhe që nuk është pak). Por gjuha e Shekspirit dhe e Darvinit ka, në krahasim me gjermanishten, dy përparësi të rëndësishme. Njëra, sepse u imponohet sidomos syve (dhe veshëve) të shumë evropianëve dhe të neolatinëve.

Në shekujt mesjetarë saksonët kulturoheshin në takim me frankofonët dhe merrnin së andejmi fjalorin. Gati 27 % e fjalëve të anglishtes, që nga *facility* tek *master* apo *table* është me origjinë franceze. Por kjo nuk mjafton: me Rilindjen, kur u fiksua “*Modern English*”, anglezët kanë marrë me të dy duart nga latinishtja: që nga *alusion*, *antipathy*, *apendix*, *atmosphere*, *autograph*, *abjest*, *agile*, *appropriate*, *to adapt*, *to alineate* etj. si *vivid*, *vocal*, *zeal* e *zone*.

Pra, drejtpërdrejt apo tërthorazi, nëpërmjet frëngjishtes, më shumë se gjysma e fjalëve të përgjithshme të anglishtes është me origjinë latine, pra, është shumë më e tejdukshme (transparente) dhe e kuptueshme sesa gjermanishtja për të gjithë neolatinofonët evropianë: portugezët, spanjollët, italianët, francezët.

Përparësia e dytë e anglishtes, jo vetëm ndaj gjuhëve të Bashkimit Evropian, por edhe të çdo gjuhë tjetër të botës, është sasia e madhe numerike e shpërndarjes planetare të anglishtfolësve: janë gjashtë vende të mëdha të botës (ndër të cilat edhe SHBA-ja) në të cilat anglishtja është gjuhë kombëtare e, me një përdorim kombëtar prej rreth 300 milionë vetash; pastaj janë edhe rreth 60 vende ku anglishtja është gjuhë zyrtare, gjuhë e zakonshme e getove të mënjauara, apo gjuhë e dytë e me përdorim të gjerë të përditshëm, pra kjo për rreth një miliard e dyqind milionë persona.

*Më shumë se një miliard e gjysmë njerëz sot praktikojnë aktivisht dhe në mënyrë të zakonshme anglishten. Gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë anglishtja fitoi në botë përparësinë e gjuhës “transglosike” dmth. të gjuhës që është e zonja t’u sipërvihet gjuhëve të tjera amtare, duke iu pranëvënë atyre si gjuhë e një komunikimi të gjerë kombëtar e ndërkombëtar. Kjo është një përparësi që nuk kërcënon asnjë gjuhë amtare, as arabishten, as kinezishten, as rusishten etj. Pra, është e vështirë të mendohet se për arsye keqkuptimesh nacionaliste sistemet shkollore të të gjithë Bashkimit Evropian të mos e shfrytëzojnë këtë cilësi të anglishtes të konsoliduar në pjesën tjetër të planetit.*

Natyrisht, po flasim për përhapjen e anglishtes si gjuhë e dytë e zakonshme dhe jo si një gjuhë që vjen të zhdukë të tjerat. *Tashmë ka një përvojë historike që tregon se gjuhët e mëdha me përdorim ndërkombëtar nuk i kanë hequr nga përdorimi gjuhët amtare, përkundrazi, në shumë raste ka ndodhur që nën dritën e tyre gjuhë më pak të përhapura janë afirmuar.* Në botën antike latinishtja, pastaj edhe disa prej gjuhëve sllave, bënë hapa të rëndësishëm në konsolidimin e tyre, pikërisht gjatë mbizotërimit të greqishtes.

Pastaj, në Evropë, mbizotërimi i latinishtes jo vetëm nuk pengoi, por favorizoi dhe adresoi pohimin progresiv të gjuhëve të mëdha kombëtare evropiane neolatine e

<sup>43</sup> Shih: De Mauro T., *Europa delle lingue*, Roma, 2000.

gjermanike dhe plazmoi thellësisht fjalorin dhe sintaksën e tyre. *Hegjemonia e anglishtes në Indi është shoqëruar me konsolidimin e të folmeve amtare si gjuhë kombëtare*. Pra, nga përhapja e anglishtes si gjuhë e dytë nuk kanë pse të kenë frikë as gjermanishtja as gjuhët e tjera gjermanike, dhe as gjuhët e mëdha neolatine apo romane. Secila prej tyre ka hapsira të mëdha për të luajtur në mënyrë që të vlejnjë jo vetëm për sot por edhe për të ardhmen.

Në BE folësit e portugalishtes janë vetëm rreth 10 milionë. Kjo mund të duket një sasi e vogël, por prapa shpinës së atyre që janë portogezë të lindur qëndron një ushtri e pamasë të lindurish në Brazil, rreth 125 milionë, si dhe nja njëzet milionë të tjerë të shprishur që nga Angola në Timorin Lindor në njëmbëdhjetë shtete të ndryshme.

Edhe spanjishtja mund të duket se ka një pozicion modest brenda kufijve të BE-së: rreth 30 milionë të lindur në Spanjë, të cilëve u shtohen katalanët, galezët dhe baskët. *Mirëpo, pas anglishtes me rusishten, arabishtes e frëngjishtes ajo është gjuha më e rëndësishme “transglosike” e botës*. Letërsia dhe arti, fuqia ekonomike dhe shpirti i përshtatjes, depërtimi në SHBA (në disa shtete spanjishtja është gjuhë zyrtare, në të tjera është gjuha *de facto*) dhe ndërkombëtarizmi transglosik e bëjnë më shumë sesa frëngjishten një rivale të rrezikshme të anglishtes.

Dhe vijmë tek italishtja, gjuha e Dantes dhe e Makiavelit (po edhe e libreteve të Moxartit, të Verdit, gjuha e Galileit dhe e Fermit dhe, në fakt, e Kishës së Romës) flitet sot nga 95% e popullsisë prej mbi pesëdhjetë milionë banorësh që ka Italia, një nga gjashtë fuqitë e mëdha botërore dhe, sipas UNESCO-s, hapësira ku janë përqëndruar më shumë se gjysma e trashëgimisë arkeologjike e artistike botërore. Italishtja flitet, gjithashtu, nga bashkësi të lindura në Zvicër, në Francë, në Slloveni dhe në Republikën e vogël por të lavdishme të San-Marinos si dhe nga bërthama të rëndësishme emigrantësh: mbi katër milionë në SHBA, një milion e gjysmë në Argjentinë, një milion në Francë, gjysmë milioni përkatësisht në Zvicër, Australi, Kanada.

Por De Mauro thekson, se duhet të bëjmë edhe një shënim: *nuk janë të paktë në botë njerëzit që njohin latinishten dhe latinizmat klasike e teknike, të pranishme në të gjitha gjuhët e botës*. Italishtja, nga ana e saj, është më ruajtësja (konservativja) e gjuhëve neolatine: *“una specie di allegro latino”*, siç thoshte Gëtja. Kështu, (siç e dinë mirë gjithë ata klerikë të Kishës Katolike) italishtja është mjaft e tejdukshme (transparente) për cilindo që di latinishten.

Së fundi, frëngjishtja. Nëse ideja e një zhdukjeje të shpejtë të gjermanishtes, të spanjishtes apo edhe të vetë italishtes kundërshtohet nga faktet, një gjë e tillë duket e pamundshme për frëngjishten. *Ajo është gjuhë transglosike dhe pa rivale deri në dy Luftërat Botërore, gjuhë që ka ndikuar mbi të gjitha gjuhët e tjera me huazime të shumta, që nga gjermanishtja në rusishten, nga arabishtja në italishten*. Ajo është gjuhë amtare e njëqind milionë personave, që nga Franca (fuqia e katërt ekonomike botërore), në Belgjikë e në Zvicër, në Kanada dhe në disa shtete të SHBA-së, gjuhë e dytë e zakonshme në rreth njëzet e nëntë shtete të Afrikës e të Azisë.

Ndoshta më shumë sesa latinishtja, por sigurisht më shumë sesa gjuhët e tjera evropiane, frëngjishtja do të thotë Evropa. Po, thënia *“frëngjishtja është Evropa”*, shpreh Evropën në atë që vetë Evropa mund të shpresojë t'i ketë ofruar si të mirë shoqërisënjerezore: *të drejtat e njeriut, shtetin e së drejtës, administrimin e rregullt*

*dhe respektin për jetën private, tolerancën, shpirtin e solidaritetit ndaj të ndryshmëve dhe të përndjekurve, si dhe besimin në barazinë e personave dhe të popujve në liri dhe në arsyen njerëzore.*

Prandaj, sipas De Mauros, atyre që kanë frikë nga zhdukja e gjuhëve të tjera nga avantazhi i vetëm njëres, faktet e historisë dhe të së tashmes nuk u japin të drejtë. *Nuk u japin të drejtë as studimet e neuroshkencës dhe ato psikopedagogjike mbi dygjuhësinë në arsimim.*

Nga neuroshkencat dimë se truri i qenies njerëzore ka një potencial të pamasë memorizimi dhe kontrolli që zë vetëm një pjesë të vogël të tij. Mesa duket, truri njerëzor për shumë aspekte i ngjan realitetit të gjuhëve. Një gjuhë me tradita të gjata dhe e folur nga shoqëri komplekse zotëron qindra mijë fjalë; vetëm fjalori i zakonshëm arrin në rreth pesëdhjetë mijë fjalë. Por duhet të themi se, siç e dimë nga statistika gjuhësore, 95% e fjalëve me të cilat ndërtojmë tekstet e bisedat tona përbëhet nga po ato rreth tre apo katër mijë fjalë. Fjalori i përditshëm përmban gati të gjithë atë që mbetet, pra, pesë për qind.

Mundet që edhe truri punon në mënyrë të tillë: *vetëm pjesërisht trashëgimia e tij e pamasë e neuroneve përdoret për të folur një gjuhë.* Pra, ka hapësirë për gjuhë të tjera. Dhe është po kjo gjë që kujtojnë studiuesit e psikopedagogjisë. Në mënyrë të veçantë në moshën feminare, truri i të vegjëleve të species sonë nuk ka vështirësi për të thithur aftësinë e të kontrolluarit me përsosmëri të shumë gjuhëve. Porse psikopedagogët na mësojnë edhe diçka më shumë, më të hollë e që përputhet me intuicionet e filozofëve të mëdhenj si gjermani Humbolt, austriaku Vitgenstajn (Wittgenstein): *gjuha nuk është vetëm një mjet i jashtëm, një veshje. Gjuha, gjuha jonë e parë, "Heimssprache", gjuha e shtëpisë- gjë që vlen si për dialektin më të ulët ashtu edhe për gjuhën më të njohur e më të lulëzuar, bën pjesë në organizmin tonë afektiv, relational dhe kognitiv.*

Kërkime interesante të kryera në Paris nga një psikoneurolog argjentinas, Zhak Meler (Jaques Mehler) tregojnë se qysh nga dita e dytë e jetës njeriu orientohet, sintonizohet me ritmin, me melodikën e gjuhës së nënës. Gjuha amtare është në ndjenjat tona, në trupin tonë më parë sesa në intelektin tonë. Së këndejmi kuptohet mirë mësimi i dytë i madh i psikopedagogjisë: *sa më shumë të rrënjosim tek fëmija zotërimin e plotë të gjuhës së vet amtare, aq më mirë ata do ta nxënë gjuhën e shkollës, gjuhën zyrtare dhe gjuhët e tjera.*

Prandaj, De Mauro dhe shumë gjuhëtarë të tjerë të sotëm mendojnë, se *të gjithë duhet të mësojmë nga modeli suedez: çdo fëmijë, cilado të jetë gjuha që ai deklaron ta ketë si gjuhë të tij, ka të drejtë t'i mësohet atij (apo asaj) në shkollë, krahas suedishtes.* Pikënisja për ta ndërtuar këtë model ka qenë nevoja për të respektuar të drejtën njerëzore parësore. Rezultati është me interes të madh për të gjithë ne. Në qoftë se në shkollat tona dhe shoqëritë tona evropiane duam të ndjekim rrugën e përfshirjes, të oportuniteteve të njëjta për të gjithë qytetarët, modeli suedez na tregon rrugën drejt një mbërritjeje. Nuk është e lehtë, por Suedia na thotë se është njerëzisht e mundshme.<sup>44</sup>

<sup>44</sup> Shih: Ramadan Rushitaj, *Shkolla shqipe në Suedi*, 2001 dhe Murat Gecaj, *Me zemër në vendlindje*, Tiranë, 2013.

Kush kërkon unifikime të përdhunshme, Evropa pra mund t'i përgjigjet me korin e vet polifonik të gjuhëve dhe të kulturave të veta të shumta, që janë mbartëse të historive të përbashkta dhe të ndryshme, por edhe që mbartin të ardhshmen. *Ka lavdi për të gjithë*- thuhet në “Liza në botën e çudirave”. Dhe kështu, na është besuar neve të gjithëve, në radhë të parë shkollave dhe universiteteve, intelektualëve dhe atyre që janë më të ditur, detyra që të edukojmë sa më shumë e sa më mirë bashkekzistencën e një shumësie gjuhësh.<sup>45</sup>

---

<sup>45</sup>Shih: De Mauro T., *Europa delle lingue*, Roma, 2000 dhe Gabriela del Lungo Camiciotti, *L'inglese nell'ambito della Comunita Europea*, vep.cit., f. 29-46.

## KAPITULLI II

### II.1. Shqipëria dhe Bashkimi Evropian

Gjuha e globalizmit është anglishtja<sup>46</sup>. Kjo bën që edhe në Shqipëri, po t'u referohemi disa zhvillime kulturore, duhet të pranojmë se anglishtja po bëhet një gjuhë e dytë, në mos për të gjithë njerëzit, së paku për brezin e ri të qyteteve të mëdha e sidomos të qendrave me përqendrim të madh të institucioneve dhe marrëdhënieve me jashtë, siç janë sot, jo vetëm Tirana e Prishtina, si dy kryeqendrat me kah nga zmadhimi e metropolitanizimi, po edhe të tjera, si Shkupi e Tetova, pjesërisht edhe Durrësi, Shkodra, Vlora etj.<sup>47</sup>

Po përmendim, ndër të tjera, rrethanën që në një qendër shqiptare si Tetova, sot ka edhe një universitet ku mësimet zhvillohen të gjitha në gjuhën angleze dhe programet mësimore janë të njëjta me ato të Amerikës. Edhe në Tiranë ka disa vite që është çelur Universiteti i Nju-Jorkut, ku, gjithashtu mësimet zhvillohen në anglisht dhe planet e programet e lëndëve janë të njëjta me ato të Amerikës. Ndërkaq, të dhënat tregojnë se ndikimi dhe anësimi nga anglishtja është edhe më i shtrirë:

1. Anglishtja sot mësohet që në moshën parashkollore dmth. qysh në kopshtet e fëmijëve.

2. Në jetën politike e shtetërore shumë “drafte” e ligje hartohen duke u bazuar tek modele të huaja, të cilat janë të formuluar në anglisht. Vetë fjala “draft” (në vend të projekt), “implementoj” në vend të zbatoj, vë në jetë, “rurale” në vend të malore, “aplikoj” në vend të plotësoj, mbush një formular etj. na flasin pikërisht për “erën” anglo-amerikane të të shkruarit.

3. Shumë organizata të huaja që veprojnë në vendin tonë dhe në Kosovë operojnë në gjuhën angleze. p.sh. OSBE, NATO, PNUD, KFOR etj.

4. Literatura që përdoret sot për çështje të ndryshme ndërkombëtare, po edhe të gjitha marrëdhënieve ndërshtetërore është në gjuhën angleze.

5. Anglishtja është gjuhë e dytë zyrtare në Kosovë.

6. Takimet e konferencat ndërkombëtare zhvillohen kryesisht në anglisht.

7. Është bërë si diçka e zakonshme që emrat e shumë shoqërive prodhuese e kompani biznesi të emërtohen në anglisht. p.sh.:

AMC ( Albanian Mobile Communication)

NBG ( National Bank of Greece)

Alb Telecom etj.

8. Në anglisht i kanë emrat shumë hotele, bare, klube. P. sh. :

*Grand Hotel, Paradise Hotel, Tirana Internacional Hotel, Choco Bar, Flower Bar, London Club* etj.

9. Disa radio e televizione shqiptare i kanë emrat anglisht. Madje, edhe shqiptimi i fjalëve “radio” e “television” bëhet si në anglisht., p.sh.: *Top Channel*,

---

<sup>46</sup> Shih: Gabriela del Lungo Camiciotti, *L'inglese nell'ambito della Comunità Europea*, vep.cit., f. 29-

46

<sup>47</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, vep.cit.

*Vlora Channel, Agon Channel, Pop Channel, 24 News, ABC News, Vizion +, Top Radio* etj.

10. Mjaft tituj gazetash e revistash janë në anglisht, p. sh.: *Gazeta "Tirana Observer", "Albania", "Standard", gazeta kosovare "Express", Channel 1, Ilva tare Tunicht* etj.

11. Grupe këngëtarësh e muzikantësh i kanë emrat në anglisht. Madje, shpesh, edhe këngët janë në anglisht. P.sh. *West Side Family, Big Mamma, Hana Band, The dreams* etj.

12. Reklama, postera e njoftime në gazeta dhe revista i gjejme në anglisht. p. sh. *"Tirana Airport Partners SHPK is seeking for Traffic Manager on Duty who will report to Airport Service Director..."*  
*"Wester Union. Unë ju dërgoj ndihmë!"*

13. Gjuha e kompjuterave, e elektronikës është në anglisht.

14. Në gjuhën e politikës e të shtypit përdoren shumë fjalë anglisht.

15. Shumë fjalë anglisht kanë hyrë në gjuhën e përditshme p.sh.:

DJ, VIP (<Ver important person), TASK FORCE, Hitet e javës, Muzikë House, Film horror, luk,-u (*ndryshoj lukun, kujdesem për lukun, me një luk të ri*), kurrikulla (<cv), shou(*top-shou, shoumen*)etj.

16. Emërtime të ideuara sipas anglishtes ndeshim tashmë edhe në emrat e qendrave të mëdha tregtare, si TEG = *Tirana East Gate* etj.

Siç shihet edhe në gjuhën shqipe kemi vërshimin e shumë fjalëve anglisht, duke përfshirë këtu edhe emrat e përveçëm. Këto hyjnë kryesisht nga gjuha e shkrimit, si: përkthimet politike, letrare, ekonomike, nga gazetatat, nga gjuha e folur e televizioneve, radiove, intervistave e konferencave të shtypit etj.

Si pasojë vihen re shmangie e shkelje gjuhësore në të gjitha rrafshet, p.sh. në rrafshin e leksikut, të morfologjisë, të sintaksës e kryesisht të drejtshkrimit, ku drejtshkrimi (dhe drejtshqiptimi) i emrave të përveçëm të huaj duhet parë si një çështje më vete, që ka jo pak probleme e mëdyshje për t'u zgjidhur.

Ruajtja e grafisë sëgjuhës së huaj po karakterizon vitet e fundit shkrimit e emrave të përveçëm të huaj të njerëzve e të vendeve, veçanarisht ata të përdorur rishtas, por edhe të tjerë me traditë përdorimi më të hershme në shqipen. Po vihet re një praktikë "e re", e cila është në kundërvënienë të plotë parimin fonetik të të shkruarit. Disa e përpiqen ta përligjin (justifikojnë) këtë praktikë me faktin, se numri i emrave të huaj që po hyjnë në gjuhën shqipe është aq i madh, saqë është e vështirë që të mësosh shqiptimin e tyre dhe pastaj t'i shkruash ato duke zbatuar grafinë e gjuhës shqipe.

Aq më tepër duhet bërë kujdes, sot kur përballemi me epokën e superzhvillimit të teknologjisë së informacionit, të kontakteve pa fund të gjuhëve e të kulturave, jo vetëm përmes shkrimit e botimeve, por edhe nëpërmjet postës elektronike, botimeve në faqet e internetit, si edhe përmes takimeve të drejtpërdrejta, si rezultat i lëvizjes së lirë të njerëzve, të ekspansionit të anglishtes dhe të shndërrimit të saj në "gjuhë globale".

Historikisht në gjuhën tonë, për shkak të nevojës që kishte, janë futur fjalë të reja nga gjuhë të ndryshme, si nga latinishtja, greqishtja, turqishtja etj. Në kohën më të re edhe nga anglishtja e nga ndonjë gjuhë tjetër. Veçmas, në periudhën e pasluftës, depërtimi i fjalëve të huaja në fjalorin e përditshmërisë në Kosovë ka qenë mjaft i theksuar, dhe shumë fjalë shqipe janë zëvendësuar me ato të huaja, kryesisht angleze.

Tashmë fjalët: *bord, departament, shopping, trust, okej* e shumë fjalë të tjera kanë zënë vend pothuajse në fjalorin e zakonshëm. Interesant është edhe fakti se në shumë reklama, udhëzime, madje edhe në mbishkrimet e shumë lokaleve afariste është i vendosur vetëm një emër në gjuhën e huaj, kryesisht angleze.

Një depërtim i fjalëve të huaja, sipas gjuhtarëve, është shumë herë i panevojshëm. Sipas tyre, ka edhe disa anë pozitive, por ka edhe pasoja. Gjatë huazimeve të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe duhet pasur kujdes për ato terma, të cilët nuk janë të nevojshëm dhe duhen ruajtur e përdorur ato të shqipes. Megjithatë, përdorimi i fjalëve të gjuhëve të huaja në gjuhën shqipe si në të shkruar, edhe në të folur në njëzet vitet e fundit është mjaft i dendur dhe ndikimet e anglishtes në gjuhën shqipe janë bërë të përditshme.

Në ditët tona gjuha shqipe është e hapur përballë gjuhëve të huaja, sidomos përballë anglishtes e veçanërisht ndër emigrantët përballë italishtes e greqishtes, prej të cilave ka marrë e do të marrë fjalë që nuk i ka vetë. Shumë emërtime të fushës së informatikës, të financave, të ekonomisë së tregut, të biznesit, të arteve moderne etj., që sot kanë marrë zhvillim të veçantë, vijnë në shqipe bashkë me konceptet që shprehin dhe mbushin zbrazëtitë e leksikut.

Ky huazim ka vlerën e vet pasuruese, por, nëse bëhet pa kurrfarë kontrolli e pengese, kthehet në një dukuri të dëmshme për gjuhën tonë, sidomos kur mbushet me fjalë të huaja ligjërimi i folur ose shtresa leksikore e përdorimit të përgjithshëm. Prandaj *duhet të bëhen përpjekje për të penguar huazimin e fjalëve nga gjuhë të tjera ose për të hedhur jashtë përdorimit fjalët e huaja, kur për ato kemi fjalë shqipe, plotësisht me të njëjtin kuptim, më të njohura, të përpikëta e të qarta për folësit e shqipes*. Veprimtaria e gjerë e shkrimtarëve, e gazetarëve, e veprimtarëve politikë e shoqërorë, e njerëzve të kulturës e të artit etj. për pastrimin e pasurimin e gjuhës standarde, konkretizohet edhe me zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë shqipe, një pjesë e të cilave janë botuar në librin "Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj" (1998).

Çështja e pastërtisë së leksikut lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e gjuhës amtare, si tipar themelor i kombësisë, nga çdo përzierje e huaj, si edhe me kristalizimin e normave të gjuhës standarde në leksik. Në këtë sistem norma letrare, siç e kemi thënë më parë, është më e çlirët, sesa në fonetikë e në gramatikë. Kjo do të thotë që, përveç disa varianteve leksikore (siç janë sinonimet), gjuha standarde pranon edhe fjalë të huaja, të domosdoshme për përmbajtjen e tyre dhe për kërkesat e disa fushave, si terminologjia, ligjërimi shkencor etj. Por është krejt i papërligjur vërshimi pa kufizim i fjalëve të huaja të panevojshme, siç ndodhi në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX e siç po vijon edhe sot, sidomos në publicistikë e në ligjërimin politiko-shoqëror.

Në një prononcim për "Kosova Sot", me një dozë kritike, duke folur për këtë fenomen, prof. dr. Agim Vinca është shprehur se prej themelimit të saj në vitin 1960, pra mbi gjysmë shekulli, Dega e Gjuhës Shqipe e Fakultetit Filozofik/ Filologjik të Universitetit të Prishtinës është quajtur "degë", pra shqip. Tani, ka thënë ai, quhet "departament" (nga angl. department - degë, seksion), kështu që edhe Dega e Letërsisë Shqipe dhe të gjitha degët e tjera të Fakultetit të Filologjisë kanë marrë emërtimin e ri. *"S'ke pse shkon më tutje! Ky është proces prapakthyes ose retrograd, siç do t'u pëlqente atyre që i kanë qejf fjalët e huaja, sepse u tingëllojnë më mirë ose kujtojnë se bëhen më të mençur kur i përdorin"* (një prononcim për "Kosova Sot").

Naim Berisha, hulumtues në Institutin Albanologjik të Prishtinës, është shprehur, se duke pasur parasysh se gjuha shqipe në vazhdimësi po i nënshtrohet trysnisë së gjuhëve të huaja, të cilat janë në një shkallë shumë më të lartë të zhvillimit, kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet pengimit të depërtimit të fjalëve të panevojshme, për të cilat ekziston fjala shqipe. Gjithsesi, ka thënë ai, duhet të vepohet me maturi ndaj huazimeve, nuk duhet të lejohet me çdo kusht nxjerrja e fjalëve të huaja nga përdorimi edhe kur ato janë të nevojshme.

Në kuadër të kësaj, duhet të dallohen ndërkombëtarizmat, fjalët të cilat kanë hyrë së bashku me objektin, termat e fushave të ndryshme, si dhe nocione të cilat gjuha shqipe nuk i ka, prandaj fjalët e këtyre kategorive domosdo duhet të lejohen që të përdoren, sepse shqipja nuk ka fjalë gjegjëse për zëvendësimin e tyre, por duhet shtuar se huazimet gjuhësore janë një proces normal për të gjitha gjuhët e botës.

### **Këshilli i Ministrave të Bashkimit Evropian:**

Por, sipas tij, marrja dhe përdorimi i fjalëve të huaja për të cilat ekzistojnë fjalë shqipe, përdorimi i të cilave nuk është përshtatur me natyrën e gjuhës shqipe, është proces shumë i dëmshëm dhe mund të ndihmojë në krijimin e një komunikimi jo të natyrshëm. *"Është detyrë e institucioneve shkencore dhe arsimore që në mënyrë institucionale të botohen lista për zëvendësimin e fjalëve të huaja të panevojshme me fjalë shqipe"*.

Edhe pse është konstatuar përdorimi pa vend i fjalëve të huaja, deri më tani nuk është bërë ndonjë studim i hollësishëm rreth huazimeve të viteve të fundit. Por, gjatë takimeve të ndryshme shkencore, gjuhëtarët kanë thënë, se përdorimi i fjalëve nga anglishtja në njëzet vitet e fundit edhe në Kosovë, ashtu si në Shqipëri ka qenë shumë i dendur. Në sajë të statusit dhe tëpranisë administrative ndërkombëtare, prania dhe ndikimet e anglishtes në gjuhën shqipe janë bërë të shpeshëta.

Marrja vend e pa vend e fjalëve nga gjuhë të huaja është një e keqe, por ka edhe më keq, kur ato përdoren plotësisht gabimisht. Ta marrin vetëm fjalën anglishte *Nation*. Në anglishte ajo do të thotë komb dhe shtet. Përkthyesit dhe të tjerët, në vend që ta perkthejnë shtet ose komb, e përdorin vetëm atë nacionale. Në vend tëvetëdije kombëtare, e *institucion shtetëror*, për të dy rastet përdoren ajo *nacionale*. E sa për emrat e ndërmarrjeve e të këngëve etj., as mos të flasësh. Duke ecur nëpër Prishtinë, kur i shikon firmat në të dy anët e rrugës, të shkon mendja se je në Londër, apo në Birmingham. Kjo ka të bëjë me një marrosje të një kombi të tërë, e jo me përjashtime.

Në ditët tona përpos specialistëve të gjuhës, për një ide të tillë zotohet edhe akademik Rexhep Qosja, i cili thekson: *"Mund të thuhet se përdorimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhët e popujve të tjerë, është i domosdoshëm. Purizmi, që bazohet në parimin e përjashtimit prej gjuhës kombëtare të të gjitha fjalëve të huaja, është i dëmshëm, po ashtu është siç është i dëmshëm edhe përdorimi i tyre, natyrisht në rastet kur nuk janë, vërtet, të domosdoshme. Gjuha, më në fund, i përvetëson fare lehtë dhe fare natyrshëm dhe i hedh ato që nuk i përgjigjen dhe që nuk i duhen"*. (Rexhep Qosja "Nocione të reja albanologjike")

Në këtë kuadër, është tashmë një domosdoshmëri studimi i gjuhës shqipe në të gjitha arealet gjuhësore. Për këtë duhet bërë punë e kujdeshme dhe e vëmendshme, në mënyrë që të realizohet përshtatimi sa më i plotë dhe i saktë i varieteve

sociolinguistike, të krijuara për shkak të përkatësisë gjeografike, gjinore, moshore, arsimore e, në disa raste, edhe fetare.

Së pari, ndryshime vihen re në ligjërimin publik (si në formë, edhe në përmbajtje), në gjinitë dhe stilet e përdorura ku ndihet bindshëm ndikimi i gjuhëve të huaja, kryesisht i anglishtes. Ky ndikim pasqyrohet në fjalor, në struktura gjuhësore të huazuara, në modelet e ndjekura për hartimin e raporteve të shkruara, kërkesave, projekteve, kjo për arsye të bashkëpunimit me organizata, institucione dhe partnerë të huaj. Madje, jo të rralla shfaqen rastet kur edhe vetë komunikimi/dialogimi kryhet tërësisht në anglisht, edhe pse veprimtaritë a mbledhjet zhvillohen në Shqipëri e në mjediset tona shqiptare.

Mund të sjellim këtu përvojat e njohura gjatë punës me organizata të huaja, ku shqiptarët marrin pjesë në hartimin (në anglisht/ frëngjisht ose italisht) dhe zbatimin e projekteve, duke u angazhuar në tryeza të rrumbullakëta ku punohet në gjuhën angleze, prej nga mund të nxjerrim disa konkluzione në lidhje me faktin se shqiptarë të punësuar në OJF (organizata jofitimprurese) me kohë kanë fituar disa shprehje sociale - kulturore dhe gjuhësore të huaja (të kulturës perëndimore) gjatë punës dhe qëndrimit me të huaj në raport me të tjerë shqiptarë, që kanë pasur pak ose aspak kontakte me kultura të huaja.

Mjaft të përdorshme në këtë lloj kontesti janë huazime leksikore e strukturore si: *implementim projekti, ndërtim i kapaciteteve, resurse humane / resurse natyrore; partnership; investime publike, workshop-e* etj. *solucion* në vend të zgjidhje, gjeneron për lind, shkakton, *bilaterale* për dypalëshe, *multilaterale* në vend të shumëpalëshe, *bodigard / bodiguard* në vend të truprojeë, roje personale, *implementoj* në vend të zbatoj, kryej, realizoj, *kostitucionale* në vend të kushtetuese, *draft* në vend të projekt a skicë, *staf* në vend të grup drejtues, shtab; *inicioj* në vend të filloj, zë fill, nis; *konsensus* në vend të marrëveshje, të marrë vesh; *lider*, në vend të kreu, udhëheqësi, *leadership* kryesia a udhëheqësia; *spacio* në vend të hapësirë, vend; *kredibilitet* në vend të besueshmëri, *parlament* në vend të kuvend, *atakoj* në vend të sulmoj, godas, prek, ngacmoj; *difensiv* në vend të mbrojtës; *impreditor* në vend të sipërmarrës; *menaxhoj* e në vend të; *menaxhim* në vend të qeverisje, drejtim, *koordinoj* e *koordinim* në vend të bashkërendoj e bashkërendim; *violencë* në vend të dhunë, *violent-e* në vend të i dhunshëm, e dhunshme; *starton* në vend të fillon, nis, zë fill; *konciz* në vend të i përmbledhët, i shkurtër; *interferoj* në vend të ndërhyj, ndërndikoj; *interferim* në vend të ndërhyrje, ndërndikim; *ekuivalent-e* në vend të i barazvlershëm; *stagnacion* në vend të amulli, pezullim; *rurale* në vend të fshatare, e fshatit; *agravoj* në vend të keqësoj, rëndo, përkeqësoj; *axhendë* në vend të rend dite, ditar veprimesh, ditar pune; *impas* në vend të rrugë e verbër, udhë pa krye, gjendje pa rrugëdalje e të tjera.

Madje, siç ka vënë në dukje edhe shkrimtari Ismail Kadare, disa politikanë dhe shtetarë, jo vetëm nuk ndreqen, nuk duan t' ia dinë aspak për dëmin që po i sjellin shqipes, po edhe vazhdojnë të "kërkojnë" për të prurë sa më shumë fjalë të huaja, të reja.

Këtij ndikimi, mendojmë se është e pamundur t'i shpëtohet plotësisht, pasi prirja është e qartë, ajo lidhet me aspiratat e shqiptarëve për integrim në Evropë, por çështja është që huazimet të përdoren me kriter, siç është rasti kur shqipja mund të paraqesë mungesë fjale për një koncept të ri (p.sh. *kompjuter, biznes, manager*), ose kur fjala e huaj mbart një ngjyrim kuptimor e stilistikor që nuk e ka në shqip, p.sh.

themi “fansat e Maikell Xhekson-it” dhe jo “tifoizat e Maikell Xhekson-it” ; do të shoh një film me “serial killer” dhe jo “me vrasës në seri”, sepse mendohet se ka tjetër ngarkesë emocionale në anglisht.

Gjuha shqipe është përballur me modele të huaja gjuhësore e kulturore gjerësisht këta dy dhjetëvjeçarët e fundit, sidomos nga shtypi i shkruar dhe media televizive. Këto modele e kanë tejkaluar sensin e masës, aq sa gjuha e sotme e shtypit i ngjan një antimodeli të shqipes. Fjalë dhe shprehje (kryesisht nga anglishtja dhe italishtja), si: *leadership, fizibilitet, bipartizan, kompromis, konstitucional, katarsis (greq), implementim, tur elektoral, bestseller, trendi, evakuim, i paprecedent* etj. janë kthyer në një dukuri normale në faqet e gazetave, duke e lodhur e munduar lexuesin e thjeshtë dhe duke revoltuar intelektualin që kërkon të lexojë shqip.

E si për të mos mjaftuar me kaq, këtyre u shtohen edhe një mori strukturash të komplikuar e aspak të njohura për shqipen me fjali të gjata, me një varg të gjatë përcaktorësh, me shumë abstragime, aq sa as vetë ata që i shkruajnë dhe i shqiptojnë nëpër artikuj e debate televizive nuk i kuptojnë.

P.sh. një natë, një ndeshje futbollit shumë të rëndësishme në supersport më ka bërë përshtypje komentatori i saj, i cili imitonte komentatorë të huaj (italianë), duke përsëritur shpesh “*Cfarë ka humbur Ronaldo!*” me një intonacion aspak të natyrshëm për shqipen. Deri edhe pasthirmat kanë filluar të huazohen nga gjuhë të huaja. Shikoni, ndër të tjera, vrullin e pamirë të pasthirmës “uau!”, në një kohë kur shqipja, sikundër kanë treguar dialektologët dhe leksikologët, është nga gjuhët më të pasura me mjete të ligjëritim gojor e sidomos me pasthirmat, urime, mallkime etj.

Shpesh në rubrikat e lajmeve dëgjojmë gazetarë që huazojnë trajta si “*ka bërë aksident*” (marrë nga anglishtja) në vend të “është aksidentuar / ka pësuar aksident”.

Rëndom ndodh që emrat e përveçëm të mos lakohen sipas rregullave të shqipes dhe të mos shqipërohen në të shkruar. Kështu thuhet “... u takua me *Tony Blair*...”, *vdekja e Arafat, fjalimi i Obama* etj., pa u kujtuar aspak se aty kemi një shkelje të rëndë të strukturës gramatikore të shqipes. Rrallë ndodh shqipërimi i tyre, por kësaj i thonë të punosh me dy standarde, ndaj duhet zgjidhur sa më parë.

Komunikimi është në themel të jetës sonë dhe komunikimi njerëzor në çdo rast, është i shumëllojshëm, sepse mbart dhe përcjell mesazhe të ndryshme, jo vetëm ide dhe mendime, por edhe ndjenja, sjellje apo qëndrime. Pra, komunikimi në çdo rast është mendim, ndjenjë dhe sjellje. Këto tri pjesë përbërëse shprehen në forma të ndryshme, herë të qarta dhe të kuptueshme dhe herë në forma të ngatërruara, që kërkojnë shpjegime dhe sqarime për të zbuluar dhe kuptuar mendimet, ndjenjat dhe sjelljet që mbartin, për t’i deshifruar dhe interpretuar këto, për të shmangur kështu, vështirësitë në komunikim dhe keqkuptimet midis subjekteve që komunikojnë.

Qenia njerëzore as që mund të përfytyrohet jashtë shumëllojshmërisë komunikimeve. Sipas shumë studimeve, rezulton se rreth 75% të ditës e shpenzojmë në komunikim, por kjo është vetëm sasi kohore, që nuk shpreh cilësinë e komunikimeve tona, e cila mund të jetë e diskutueshme. Në mjaft raste mund të lerë për të dëshiruar, të jetë me mangësi apo defekte serioze dhe të bëhet shkak për të ulur efektivitetin e komunikimit, për ta penguar apo shmangur atë nga rrjedha normale.

Si shprehje të këtyre shmangieve në komunikim, interpretohen shumë nga mosmarrëveshjet, keqkuptimet, grindjet, situatat e mbarsura me një trysni a peshë të theksuar nervore, që shpesh shpërthejnë në konflikte të hapura dhe në skandale, në revolta, në prishjen e marrëdhënieve të prindërve me fëmijët etj.

Përmes komunikimit dhe në situata të ndryshme kumtuese shprehen qartë psikika, vetëdija, nënvetëdija dhe personaliteti ynë, mendimet, ndjenjat, sjelljet dhe veprimet tona, shkalla e zhvillimit dhe e formimit të çdo qënieje njerëzore, ndikimet mbi ne dhe ndikimi ynë mbi të tjerët.

Komunikimet tona janë vetë jeta jonë. Ne jemi të përfshirë në qerthullin e tyre qysh kur ngjizemi në barkun e nënës dhe në të gjitha periudhat e jetës. Kudo dhe kurdoherë jemi në komunikim. Komunikojmë me veten, me të tjerët dhe me botën. Komunikojmë me të njohur dhe të panjohur, me grupe dhe organizata të ndryshme, me shtetin dhe institucionet e tij dhe me publikun e gjerë. Pra, komunikojmë parreshtur, ne me të tjerët dhe të tjerët me ne. Padyshim që në këtë komunikim të ndërsjellë jo çdo gjë mund të ecë mirë. Ka dhe do të ketë edhe probleme, ndërlikime apo situata të ndërlikuara, të cilat e vështirësojnë aktin e komunikimit.

*Një person, i pajisur me një kompetencë thjesht gjuhësore, "do të shihej si një lloj përbindëshi kulturor". Ky individ do të njihte mirë rregullat gramatikore të gjuhës, por nuk do të ishte në gjendje të komunikonte, të përcaktonte variantet sociolinguistike më të përshtatshme për një situatë të caktuar (Giglioli, 1987).*

Të folurit merr karakter publik në komunikimin në masmedia, përmes mjeteve të kulturës dhe të propagandës, përmes radios, televizionit, shtypit, me veçoritë e ndikimit dhe të efektit të këtyre mjeteve në masën e njerëzve.

Fjala ka qenë gjithmonë nxitëse e madhe për të gjitha veprimet e jashtëzakonshme. Të gjithë udhëheqësit e mëdhenj kanë pasur nevojë për fjalën. Për të treguar rëndësinë e madhe të fjalës, do të mjaftonte t'i hidhnim një sy listës së shpikjeve të kohëve të fundit, e do të bindeshim se pothuaj të gjitha i janë kushtuar fjalës, ruajtjes dhe përhapjes së saj. Kush do të mund të mendonte, vetëm tridhjetë vjet më parë, se një fjalë do të mund t'i rrotullohej globit për disa sekonda e të shkonte në të gjithë veshët e botës?

Por fjala nuk është e njëjtë për të gjithë. Prifti nuk duhet të flasë siç flet avokati. Edhe kandidati politik, duhet t'a ndryshojë mënyrën e tij të të folurit, kur bëhet deputet dhe akoma më shumë kur zgjidhet ministër. Nëse nuk ndodh kështu, atëherë do të kemi një shmangie nga normat e komunikimit, që përcaktohen nga rolet që ndërmarrin njerëzit. Çdo kategori shoqërore ka tipin e vet karakteristik të elokuencës, për faktin e thjeshtë se çdo kategori shoqërore i drejtohet një grupi të ndryshëm dëgjuesish.

Duket se e tërë ekzistenca jonë rrëshqet mbi rrotat monotone të temave të detyrueshme (moti, politika, situata ndërkombëtare, mbarëvajtja e punëve, thashetheme të zakonshme). Sekretin për të ditur të bisedosh dhe t'u përmbahesh normave të komunikimit qëndron në atë që të mos dukesh as "kokë e madhe", as tepër banal apo mendjelehtë.

**Gjuha e mediave dhe kahu globalizues i saj :** Kanale komunikimi si masmedia, janë bërë të modës për të siguruar komunikimin mes anëtarëve të grupeve

të ndryshme politike, profesionale, etnike apo të çfarëdolloj natyre qofshin ato. Kështu, kthimi i përgjigjeve, komentimi dhe analizat e ndryshme të ngjarjeve, intervistat e përbëjnë një mjet të rëndësishëm komunikimi mes grupeve të ndryshme sociale ose grupeve të publikut të gjerë.

Zhvillimi i medias dhe tregtimi i një sasi të konsiderueshme organesh të shtypit, si: gazeta, revista, guida, buletine etj. ka realizuar mundësinë që lajmi dhe informacioni të përcillen në mënyrë të shpejtë, por jo gjithnjë cilësore. Duket se, megjithë kalimin e viteve, nuk është fituar sa duhet profesionalizmi, etika dhe përgjegjshmëria që duhet të karakterizojë një grup drejtues serioz, i cili ka në dorë një nga mjetet më të shpejta dhe më të efektshme të shpërndarjes së lajmit: shtypin.

Po aq të rëndësishme në këtë rol janë dhe mediat elektronike që shtohen në sasi, por jo gjithmonë në cilësi. Shpesh ato përdorin fjalë të mëdha dhe komente të përfryra, që ndikojnë në mënyra të ndryshme në perceptimin e masës apo grupeve sociale që i ndjekin. Ata që flasin me më shumë njerëz njëherësh, siç janë gazetarët dhe analistët, jo gjithmonë shfaqin elokuencë dhe më e keqja nuk i përmbahen një kodi të caktuar etik, shkelja e të cilit rrezikon seriozisht komunikimin e qëndrueshëm me publikun, kështu dhe marrëdhëniet sociale.

Si shembull mund të përmendim situatat e shpeshta në kanalet televizive shqiptare, ku njerëzit i mbyllin bisedit me shije të hidhur, sepse u është fyer "*partia e zemrës*" opo "*liderii parapëlqyer*", madje ndonjëherë ndodhin dhe grindje mes simpatizuesve të partive të ndryshme. Kështu krijohen mosmarrëveshje për faktin se kush duhet të drejtojë, si duhet të vijojë biseda dhe në shumë situata, gjithçka degjeneron në monologje, ku secili thotë atë që mendon duke pretenduar të dëgjohet vetëm fjala e tij, pa respektuar fjalën e tjetrit.

Por thyerjet më të gjithanshme të normës së komunikimit nuk i gjejmë vetëm në deklaratat, bisedit, fjalimet dhe emisionet politike, të cilat kanë ndikim jashtëzakonisht të madh në jetën e shqiptarëve, por dhe në gazetatat e përditshme vihet re se thyhen përditë normat drejtshkrimore morfologjike dhe sintaksore sikurse ndodh edhe me normat e pikësimit (mungesa apo përdorimi i 'ë'-së).

E njëjta gjë ndodh dhe në disa prejveprave letrare, të cilat blihen gjithnjë e më rrallë dhe rrjedhimisht lexohen më pak, se sa lexohen gazetatat, dëgjohet radioja dhe shikohet televizioni, i cili është bërë institucion me ndikimin më të madh në vetëdijen politike, kulturore dhe gjuhësore të njerëzve. Gjuha e tij, si gjuhë e propagandës, përfaqëson cënime të rënda të kulturës gjuhësore<sup>48</sup>. Këtu është fjala për gjuhën e mbledhjeve, të konferencave, të referateve, të akteve zyrtare, të deklaratave, të bisedave në radio e televizion.

Çdo ditë dhe më shumë kulturën tonë gjuhësore po e cënojnë dhe fjalët e huaja të panevojshme, të cilat po vërshojnë në mënyrë të jashtëzakonshme. Këto fjalë janë të panevojshme, pasi për to, gjuha shqipe ka fjalë shqipe. Kemi të bëjmë me një komunikim të ndërlikuar artificialisht, ku disa nga folësit të lenë përshtypjen se dëshirojnë të duken "të kulturuar" pa marrë në konsideratë se jo të gjithë dëgjuesit mund t'i kuptojnë. Natyrisht, për të ditur të flasësh nuk është e nevojshme të kesh të dhëna të jashtëzakonshme apo prirje mbinatyrore.

<sup>48</sup>R. Qosja, *Fjalor demokratik*, TOENA, Tiranë, 1997.

Ja disa nga termat e huaja në vend të termave shqip si: *asistova në një miting* (mora pjesë në një takim), *asociacion* (shoqatë), *resurset* (burimet), *influencoj* (ndikoj), *indikator* (tregues), *insistoj* (këmbëngul), *kontribuoj* (ndihmoj), *axhustoj* (ndreq, rregulloj), *adaptoj* (përshtas), *inicioj* (nis), *stopoj* (ndaloj), *markoj* (shënoj), *aplaudoj* (duartrokas), *startoj* (filloj), *ranxhoj* (rradhis), *miksoj* (përziej), *preventivoj* (parandaloj), *komplikoj* (ndërlikoj), *facilitoj* (lehtësoj), *distribucioni* (shpërndarja), *violent* (i dhunshëm), *e agravuar* (e përkeqësuar), *e pasuportueshme* (e padurueshme), *immediat* (i menjëhershëm), *konfondohej* (ngatërrohem), *konfidoj* (besoj) etj.

Shembujt e sipërpërmendur janë vetëm disa prej shumë të tjerëve që përdoren gjithmonë e më dendur në radiotelevizionet tona.

Në shumë studime të viteve të fundit, gjuhëtarët kanë bërë objekt vëzhgimi gjuhën e mjeteve të informimit masiv dhe kanë argumentuar e theksuar edhe kahet e sotme të ndikimit prej gjuhëve të huaja, duke u ndalur sidomos në gjuhën e mjeteve të informimit.

Prof. Hajri Shehu, gjuhëtar dhe njohës imirë i anglishtes, në një nga trajtesat e tij të vlefshme thekson, se shumica e fjalëve të huaja (të panevojshme ose të nevojshme qofshin ato) hyjnë nga gjuha e shkrimit (kryesisht nga gazetatat, lajmet televizive, përkthimet politike, informative etj.) dhe nga gjuha e folur e televizioneve dhe e radiove, të cilat, kurdoherë, preken më të parat nga ndikimet integruese dhe globalizuese.<sup>49</sup> Kur flasim për mjetet e informimit masiv, siç u tha, kemi parasysh edhe gjuhën e shkruar - gazetatat, lajmet, filmat televizivë e programet e tjera të televizioneve e të radiove, që parapërgatiten, edhe gjuhën e folur - konferencat e shtypit, intervistat, takimet e bisedat politike etj. që nuk parapërgatiten.

Por, edhe pse e parapërgatitur, gjuha e folur është formë e gjuhës, e normativizuar dhe e lëvruar deri në kufijtë e gjuhës së shkruar, domethënë, edhe në një bisedë, intervistë etj. folësi domosdo duhet të orientohet nga normat e gjuhës së shkruar. Prandaj, edhe gjuha e folur nuk është e nuk mund të jetë më pak standarde se gjuha e shkruar. Veç të tjerash, edhe për arsye jashtëgjuhësore, shpërdorimi i fjalëve të huaja (si në gjuhën e shkruar, ashtu edhe në gjuhën e folur) është në udhë të kundërt me standardizimin e mëtejshëm të gjuhës.

Është fakt i njohur e shumë domethënës që në mjetet tona të informimit masiv ka shkrime, ligjërime e kumtime mjaft të mira edhe në punë të gjuhës e veçanërisht, të zgjedhjes së fjalës. Por ka edhe shkrime, ligjërime e kumtime, ku përdoren shumë fjalë të huaja të panevojshme, sidomos anglicizma, ose formime nga fjalë të huaja, gjithashtu, të panevojshme, për të thënë gjëra fare të zakonshme e kur shqipja i ka mjetet e saj të shprehjes. Kësisoj, duken edhe të habitshme.

Ja disa shembuj (në skedarin tonë kemi edhe shumë shembuj të tjerë): *divizioni i shpërndarjes së energjisë elektrike; shkelin kondicionet e sigurisë; drejtues të shtetit që janë investuar direkt në arrestimin e tij; autoritetet sanitare botërore; jam një njeri që persistoj; skuadra duhet të performojë; kemi alokuar fonde; Shqipëria vinte pas dy*

<sup>49</sup> Hajri Shehu, *Mjetet e informimit masiv mund të ruajnë veten, por mund të ruajnë edhe të tjerët*, 23 Shkurt 2007

*shokeve të forta; ndarje fraxhile e Kosovës; ekonomi në oshilacione; për ta agravuar situatën; ka një handicap; personazhe që janë involvuar; një bestseller; kam qenë interlokutor; njëpjesë e policisë suportojnë krimin; për evadimin e mbetjeve urbane; rreth 10000 performues morën pjesë në paradë; nuk besoj që marrëdhëniet tona të dipendojnë nga një bisedë politike; qeveria mund të ishte e premierit; e konsideroj një defekt gjeneral; a ka disraport...?; vendi më atraktiv; burime hidrike; dekonfliktohem; shërbim inovativ; kanë asistuar punën...; interferojnë interesat; në një kompeticion; Komiteti internacional i selektimit; risku i moskthimit të thesarit; sa e sa punime të tjera ... janë prova tangibile të një personaliteti madhor; shifrat janë shumë irrelevante; në gjithë faktorët relevantë; në margjinat e konferencës do të komunikoj me të; është kondicionuar nga shumë suporte; në rast se ka indiferenca; për të dhënë definicion; për të dhënë previzionin; për ta shprehur nominalisht; nuk do të bjerë në dependencë; lider okult; kredo politike; fundamental për afrimin e Shqipërisë...; (doni muzikë) laiv apo plejbek etj.*

Lidhur me këtë prirje të shprehur e gjuhëprishëse, me të drejtë prof.dr.Hajri Shehu, jo vetëm përmend vargje të tëra fjalësh të huaja e të panevojshme, plotësisht të zëvendësueshme, por edhe thekson me të drejtë: *Është e habitshme të vëresh se si fjalë të huaja, më së shumti, anglicizma po zëvendësojnë fjalë a formime shqipe me jetë të qëndrueshme nëgjuhë jo vetëm në ligjërimin libror, por edhe në ligjërimin bisedor, të përditshëm. Me tepri janë shtuar formimet me top: perveçtop story, top shou, top model, top list, top sekret, top nivel, top person, top ekzekutiv e të tjera.<sup>50</sup>* Sidoqë më pak, në mjetet e informimit masiv ka edhe huazime të panevojshme kuptimore e përkthimore. Këto e dëmtojnë më shumë ligjërimin, sepse sjellin krejt mekanikisht mënyra të huaja të menduarit dhe përkthimit. Shihni shembujt e mëposhtëm: *prodhon pasoja, të dorëhiqet kryeministri; të bëhet më tepër i konsiderueshëm; bashkësia ndërkombëtare e ka mbledhur më në fund guximin për ...; do të vuajmë mungesa; pedagogë të rekrutuar për këto universitete; të vihet në operimet tona të kredisë etj.*

Ata e ato që dinë anglisht, nuk e kanë aspak të veshtirë të gjejnë prejardhjen e drejtpërdrejtë të këtyre fjalëve, shprehjeve a përkthimeve. Ka edhe sajesa të habitshme fjalëformimi e bashkëlidhjeje fjalësh, nisur keq nga gjuha e huaj, të cilat edhe pse janë vënë në tehun e kritikës së gjuhëtarëve e njohësve të mirë të shqipes e të anglishtes, sikundër është edhe prof. Shehu. Ai, madje, ndër të tjera ka përmendur edhe shartesa të çuditshme, të tilla si: *multiplikatoj, multigrindje (!), superoj veten* për të thenë, tejkaloj *emetojnë dashamirësi*, (pra, nuk emetohen vetëm kartëmonedha, por edhe dashamirësia (!) ; jam *kultivuar* atje (kultivohen vetëm bimët e lulet, por ja që gazetarët thonë edhe për njerëzit (!).<sup>51</sup>

A ka arsye për ardhjen e fjalëve të huaja? Sigurisht, ka; më së shumti, subjektive. Ndër arsyet subjektive (kemi parasysh përdorimin pa vend e pa nevojë të fjalëve të huaja, sidomos angleze) mund të veçoheshin: formimi i pamjaftueshëm gjuhësor i gazetarëve, redaktorëve, politikanëve etj. e njohja e pamjaftueshme e kulturës sëgjuhës. Të njohësh kulturën e gjuhës, nuk do të thotë të njohësh vetëm normat gramatikore, drejtshqiptimore e drejtshkrimore, por edhe normën leksikore e stilistikore, pra ta zgjedhësh e ta përzgjedhësh fjalën, shprehjen etj.

<sup>50</sup> Hajri Shehu, *Mjetet e informimit masiv mund të ruajnë veten, por mund të ruajnë edhe të tjerët*, 23 shkurt 2007.

<sup>51</sup> Hajri Shehu, *Mjetet e informimit masiv mund të ruajnë veten, por mund të ruajnë edhe të tjerët*, 23 shkurt 2007

Ja disa shembuj: “Do të startojnë ditët e trashëgimisë kulturore...; P. D.starton zyrtarisht fushatën e zgjedhjeve”. “Apdejtimi i kuadrit...”. Nga pikëpamja fonetike e gramatikore, sajestat *startojnë* e *apdejtimi* janë të rregullta: njëra folje me -oj, tjetra emër me -im, siç mund të ishin fluturoj e fluturim. Por ato nuk janë të rregullta nga pikëpamja e normës leksikore e stilistikore – nuk janë fjalë vendi, janë fjalë të huaja (nga anglishtja start “nis, filloj” e update “përditësoj, freskoj, rifreskoj”), krejt të panevojshme, sepse kemi fjalën shqipe a formimin shqip (nis, filloj / përditësim, freskim, rifreskim), pra, janë barbarizma.

Fjalët e huaja të panevojshme (më së shumti, anglicizma) në mjetet e informimit masiv janë të tilla që nuk i kërkon as ligjërimi i ngritur (p.sh. ky shou u mundësua nga ...; ka një bekgraund të pasur; ka asistuar në...; Turqia merr lidshipin e BE-se; është një triangël; komision bipartizan; shqyrtoi veprat e paraqitura në kompeticion; nën promocionin e një politike; Moisiu in Nano’s; luku i saj tërheqës; ligji i luftës është një nonsens; mori pjesë edhe first-leidy; etj.), as ligjërimi i përditshëm (shih, p.sh. që, për të thënë se ndeshja mund të shihet pa pagesë, në gazetë shkruhet për ta parë ndeshjen free dhe për të na mësuar si lahen rrobat, në reklamë dëgjohet: *mënyre e larjes perfekte*; për tullat: *tulla me cilësi perfekte*; kurse në një lajm, për koshat e plehrave thuhet: *inekzistenca e koshave të plehrave*, dhe për karnavalet: *nuk kanë resurse për karnavalet*).

Politikanët janë po aq përgjegjës sa edhe gazetarët për praninë shqetësuese të huazimeve të tipit: *pacifik, infiltrim, purifikim, proporcional, asocim - stabilizim, impakt, intervenim* etj. Madje, sikundër ka vënë re prof.Gj.Shkurtaaj, *viteve të fundit, sikur të mos mjaftonin fjalët e huaja që kanë vërshuar rishtazi, ka pasur edhe një kthim mbrapa, duke u përdorur fjalët e huaja në vend të një sasive të madhe fjalësh shqipe, që ishin bërë pothajse të përgjithësuara në gjuhën e shkruar*.

Ja disa prej fjalëve të huaja të panevojshme, të cilat vite më parë kanë qenë mënjanuar me sukses nga fjalët shqipe përkatëse: *eksperiencë* (përvojë), *ambient* (mjedis), *evitaj* (shmang, mënjanoj), *dedikoj* (përkushtoj), *presion* (trysni), *iniciativë* (nismë), *kurioz-e* (kureshtar-e), *kuriozitet* (kureshtje), *distancë* (largësi), *distancoj* (largoj), *prezent-e* (i pranishëm, e pranishme), *elektoral-e* (zgjedhor-e), *lokal-e* (vendor-e), *kartë identiteti* (letërnjoftim), *persekutoj* (përndjek), *total-e* (tëresor-e), *totalisht* (tëresisht, krejtësisht), *likuidoj* (shlyej, laj, asgjësoj), *likuidim* (shlyerje, larje, asgjësim), *abuzoj* (shpërdoroj), *abuzim* (shpërdorim), *prezencë* (prani), *okazion* (rast, rastësi), *ofensivë* (sulm, sulmim, mësymje), *suprem* (më i larti), *nordik-e* (verior-e), komunitet (bashkësi, ngulim), nacional-e (kombëtar-e), internacional-e (ndërkombëtar-e), direkt-e ( i, e drejtpërdrejtë), *deciziv-e* (vendimtar-e), *unik-e* (i vetëm, evetme), *unifikoj* (njësoj), *unifikim* (njësim, njëjtësim), *komercial-e* (tregtar-e), *apel* (thirrje), *apeloj* (bëj thirrje), *prefekt-e* (i e përsosur), *statuetë* (shtatore), *asimilim* (përvetim, përvetësim), *dekadë* (dhjetëvjeçar, dhjetëditësh), etj.<sup>52</sup>

Me të drejtë prof. dr. Hajri Shehu nënvizon se “përdorimi pa vend i fjalës së huaj e burokratizon gjuhën e shtypit, të televizioneve e të radiove. Në përmasa të ndryshme, këtë soj burokratizimi e sheh në mjetet tona të informimit masiv. Fjalë a shprehje të huaja, të marra drejtpërdrejt a të përkthyer drejtpërdrejt keq nga gjuhët e huaja, kryesisht nga anglishtja janë bërë simbol e stil të kumtuari e janë kthyer gati-gati në zhargon (*staf e draft, impakt e implementim, selektoj e artikuloj, certifikoj e involvohem, eficensë e bekgraund, shou e emergjencë, kompeticion e prioritet, asistoj*

<sup>52</sup>Shih: Gj.Shkurtaaj, "Analfabetët me diplomë" ose kushtrim për mbrojtjen e gjuhës, në librin "Kultura e gjuhës", SHBLU, Tiranë, 2006.

*e inicioj, lider e leadership, risk e resurs, lancoj e monitoroj, promocion e akses, opsion e handicap, suport e suportoj, supervizoj e investigoj, prononcim e kontestim, evazion fiskal etj.).*

Jo rrallë, ato dëshmojnë jo vetëm për thënie stereotipe, por edhe për keqkuptime e gabime në shprehjen e mendimeve (shih, p.sh. pasi u instalua qeveria e re / u instaluan policë rreth ambasadës; strategji e instaluar; shërbim inteligjent / për shërbim zbulimi; policia veproi sipas inteligjencës; veprimtaria e Etnas nuk mund të predikohet / nga predict(!) parathem, parashikoj; të procedojmë me një politikë të re; operojnë jashtë ligjit / kam operuar në të gjithë territorin; ajo që duhet ekzekutuar në këtë çast; shndërrim aksidental; polici kriminale; borxh korent; për promovimin e grave në zgjedhje etj.).<sup>53</sup>

**Gjuha e reklamave.** Gjuha e reklamës eklipsoi fjalët e bukura dhe u zëvendësua me fjalë të huaja. Hap televizorin dhe përballesh me një shqipe, që nga dita në ditë po shndërrohet në një gjuhë të mbushur me shumë fjalë të huaja e gjithnjë e më pak fjalë shqipe. Televizionet të duket se janë vënë në garë kush e kush të zëvendesojë fjalë të bukura shqipe me fjalë të huaja, madje edhe të vështira në shqiptim (aq sa shpesh herë edhe shqiptohen gabim). Shqiptari i shqetësuar del në rrugë e menjëherë perballat me emra lokalesh e reklamash, ne pjesën dërmuese në gjuhë të huaja, aq sa të krijohet ndjesia se ndodhesh në të njëjtën kohë në shumë vende të huaja.

Kjo duket qysh nga emrat e televizioneve kryesore private, si Top-Channel Tv, Top Neuws Tv, Channel one tv, Top-Albania Radio, Neuws-24, Agon-Channel, Explorer Shkence Tv, Explorer Nature Tv, Digitgold ppv. Tv, Tring Super, Tring Lifer, Tring 3 plus, Tring Fantasy, Tring Living, Tring Planet, BBF Musik, ABC Neus, ABC TV, A1Report Tv, Ora News Tv, Superfolk Tv, News Tv Kosova, Albanian Screen etj. Po ashtu edhe rubrikat e televizioneve, si Big Brother, Dancing With the Stares, Show Biz, Sport-Live, Inside, Tuniht-Elva Tare, Top Select dhe aq shumë emisione që nisin pikërisht me Top.

Reklamat e bizneseve të ndryshme në media kanë për qëllim të vënë në dijeni për daljen e mallit të ri; për të njohur klientët me cilësinë e mallrave; për të prezantuar çmimin e mallit; për të zbuluar qytetin me pllakat (*billboard*); për të ndihmuar në ngritjen e standardit të jetesës përmes shtimit të prodhimit dhe, së fundi, për të edukuar shijen dhe për kulturë të re në qëndrimin ndaj mallit të ri. Kuptohet që reklama ka për qëllim nxitjen për konsumim, por ajo ka edhe anët negative të saj, duke krijuar stres për personat që nuk mund të arrijnë të blejnë produktin e caktuar. Reklamat e shfaqura nëpër gazeta apo emisione radio-televizive thyejnë monotoninë e përmbajtjes dhe të dizajnit të zakonshëm. Reklama informon, edukon, argëton, apo thjesht nxit një konsum gjithnjë në rritje.

Prej këtu kuptohet që do të rritet parreshtur konsumi nga muaji në muaj dhe sikurse shtohet prodhimi, bie kostoja e produktit në një njësi kohe dhe ulet çmimi i tij në treg. Nga kjo mund të themi se ka bërë një vërshim në familjet tona, duke konsumuar një produkt të caktuar. Pra, reklama ndikon jo vetëm për të thyer monotoninë nëpër shtyp dhe në televizione, por edhe për të përmirësuar standardet e

<sup>53</sup> Hajri SHEHU, *Mjetet e informimit masiv mund të ruajnë veten, por mund të ruajnë edhe të tjerët*, 23 Shkurt 2007.

jetës. Media në një farë mënyre "ushqehet" prej saj, por në anën tjetër i hap rrugë biznesit për sukses dhe shitje të produkteve. Ja, kjo është një linjë e fuqishme midis medias dhe biznesit!

**Reklama në televizion.** Në krahasim me bartësit e tjerë të reklamës, televizioni na ofron një komunikim të drejtpërdrejtë me më shumë kanale. Reklamat në televizion kanë një potencial pjesëmarrës shumë të madh ngaqë si një medium shumëplanëshl i bashkon të gjitha elementet efektive: fotografinë, gjuhën, muzikën, ngjyrën, lëvizjen dhe emocionin. Çdo element ndihmon që të ruajmë në kokë më mirë gjërat që ne i shikojmë. Fuqia e kujtesës dhe ndikimi janë në nivel shumë të lartë.

Televizioni na lehtëson marrjen e informacionit ngaqë na dhuron informacione që i kuptojmë më lehtë dhe na jep mesazhe pamore-dëgjimore të cilat nuk kanë nevojë për deshifrim. Televizioni si një platformë reklamuese, na jep një spekter të gjerë informacionesh për shkak të vetive të tij unikalë. Krahas anëve shumë të gjera cilësore televizionin e bëjnë edhe shumë faktorë sasiore si bartës ideal të reklamave.

Veçantia e reklamave televizive qëndron në atë që reklamat televizive në krahasim me shpalljet nëpër gazeta dhe reklamave në radio përdorin 2 kanale bartëse: Lajmi ose informacioni bartet edhe me fotografi edhe me zë. Në qoftëse e marrim parasysh mundësinë për bartjen dhe vendosjen e njëkohshme të fotografisë, zërat dhe tekstit vijmë në përfundimin që spotet televizive janë shumë efektiv dhe karakteristikat e një produkti mund të barten deri te përdoruesi a marrësimë mirë nëpërmjet reklamave televizive. Në këtë lloj reklame gjinden edhe mediat më ndikuese që janë fotografia dhe gjuha.

Gjuha, në radhë të parë, nxit mendimet logjike-analitike dhe shërben për drejtimin racional të sjelljes. Fotografia jep shtysa jogjuhësore dhe qëndron për mendime dhe ndjenja intuitive dhe e drejton sjelljen emocionale të marrësit. Edhe pse një fotografi çliron edhe domethënie gjuhësore dhe një fjali konkrete nxjerr edhe imagjinata fotografike vlen në përgjithësi: Gjuha qëndron për argumentimin racional dhe fotografia për ndikim emocional.

Nuk është aspak e rastësishme nëse në një reklamë televizive dëgjojmë gjuhën që përdorin të rinjtë apo edhe njerëzit në moshë të shtyrë. Është plotësisht e lejueshme sipas ekspertëve të reklamave, sepse është mënyra më e mirë për të tërhequr një grup të caktuar konsumatorësh ose për të tërhequr pikërisht ata për të cilët është bërë produkti. Në mes gjuhës së përditshme dhe gjuhës së reklamave ekziston një bashkëveprim, i cili nuk duhet nënvlerësuar dhe që, nga njëra anë, mund të shprehet që gjuha e reklamave shpreh prirje të gjuhës së përditshme ose, nga ana tjetër, e zgjeron gjuhën e përditshme me përdorimin dhe marrjen e teksteve të reklamave në përdorimin e gjuhës së përditshme.

Me gjithë përpjekjet që t'i qëndrojnë sa më afër gjithë reklamës asaj të përditshmes, përsëri gjuha e reklamave është artificiale dhe nuk zotëron një realitet të të folurit, por është formuar për të krijuar efekt. Nga ana tjetër, ajo i qëndron afër gjuhës së folur. Por, qëllimi kryesor që një person bën tekstin e një reklame është koncepti i mesazhit. Mesazhi duhet patjetër të ketë efekt bindës, me qëllim që mos të humbas qëllimin e tij. Është detyra e konceptimit që të gjitha argumentet, informacionet, thirrjet e ndryshme dhe fjalimet t'i ngushtojë në atë mënyrë që qëllimi kryesor i informacionit të dërgohet deri te grupet qëllimore (target group).

Megjithatë, nuk mund të hedhim poshtë rolin e pamohueshëm të medias televizive në kultivimin e gjuhës shqipe në mbarë diasporën, veçanërisht me paketat e mrekullueshme të Digitalb-it ku flitet shqip, duke u mundësuar të gjithë shqiptarëve dhe emigrantëve të ruajnë dhe pasurojnë gjuhën e tyre amtare.

Mijëvjeçari i dytë dhe fillimi i të tretit, për fatin e mirë të shqiptarëve e të shqiptarisë, u mbyll me pohimin e realitetit, se gjuha shqipe sot është në nivelin më të lartë të mundshëm, është gjuhë shteti në Shqipëri dhe në Kosovë, është gjuhë e njohur me ligj edhe nga Kuvendi i Maqedonisë dhe, në masë të kënaqshme, po përfilllet edhe në Mal të Zi e në diasporat e hershme arbëreshe e mërgatat shqiptare të reja. Deri në Suedi, madje edhe në Amerikë e në Australi, ka sot ngulime shqiptare, ku, krahas gjuhëve të vendit, mërgimtarët shqiptarë përpiqen e punojnë të mbajnë gjallë edhe shqipen<sup>54</sup>. Deri larg në Melburn, një shoqatë shqiptarësh me emrin “Ded Gjon Luli” mëton të mos harrohen as gjuha shqipe, as emri i Shqipërisë dhe historia e vlerat etnokulturore të saj.

Sot, gjithandej në Evropë e në vende të tjera të Botës janë shtuar edhe të huajt që flasin e shkruajnë shqip, ka kërkesa për libra mësimorë e abetare të shqipes dhe, mbi të gjitha, dashuria e shqiptarëve tekdo që gjenden për gjuhën e kulturën shqiptare është tregues i mallit dhe i dashurisë së tyre për Shqipërinë.

## **II.2. Shqipja përballë gjuhëve të Evropës. Kufijtë shtetërorë dhe shtrirja truallësore e shqipes.**

Shqiptarët janë rreth 11 milion, megjithëse sot më shumë se gjysma e shqiptarëve jeton jashtë Shqipërisë dhe Kosovës, ndërkohë që pjesa dërrmuese e tyre jeton në Ballkan. Sot shqipja flitet në Shqipëri, në Kosovë, në Luginën e Preshevës, në trojet shqiptare në Mal të Zi, në Maqedoninë Perëndimore, në Çamëri dhe në hapësirat veriore të Greqisë rreth Kosturit. Flitet shqipja edhe në diasporat e moçme arbëreshe në Greqi (*arvanitika*): si në Atikë, në Eube, në Peleponez dhe në ishujt Andros, Specë, Salaminë, Hidra, Poros, Luca etj.; në Itali shqipja, e quajtur *arbëresh* ose *arbërisht*, flitet në Kalabri, në rreth njëzet ngulime kryesisht rreth qendrave të Kozencës, Katanxaros e Krotones; në krahinën e Abrucos (rreth Peskarës), në krahinën e Bazilikatës (me qendër Potencën), në krahinën e Kampanias (me qendër Avelinon); në Molize (rreth Kampobasos), në Pulia (rrethet e Foxhës, Tarantos) dhe në Sicili (krahina e Palermos). Shqipja ruhet dhe flitet edhe në Arbënesh të Zarës (Dalmaci), në Bullgari (katundi Mandricë), në Ukrainë (disa ngulime rreth Odesës).<sup>55</sup>

Shqiptarë ka edhe në Turqi, në Siri, në Egjipt, në Belgjikë dhe në tërë Evropën Perëndimore, në Gjermani, në Zvicër, në Rumani, në Suedi, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada, në Australi etj., pa përmendur ngulime ose grupe të vogla arbëreshësh e shqiptarësh edhe në shumë vende të tjera të botës, pothuajse në krejt rruzullin tokësor. Kudo që është ruajtur gjuha e tyre e hershme, arvanitët a arbërorët, arbëreshët (ose arbneshët), arnautët, arbanasit flasin shqip, natyrisht në forma dialektore të dallueshme nga shqipja e Shqipërisë së sotme dhe e trojeve shqiptare

<sup>54</sup> Shih: F.Altimari, *Comportamento linguistico e condizionamenti socioculturali nella situazione plurilingua di un' area albanofona della Calabria*, in “Studi linguistici arbëreshe”, “Quaderni di Zjari”, 1988, pp.5-29; Schader Basil, *Shqyrtime rreth kontaktit mes shqipes dhe gjermanishtes*, Shtëpia Botuese Kristalina K-H,Tiranë, 2005; Ramadan Rushitaj, *Shkolla shqipe në Suedi*, 2001 dhe Murat Gecaj, *Me zemër në vendlindje*, Tiranë, 2013.

<sup>55</sup>Shih: *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Vëll.I, Tiranë, 2008, f. 860-861.

kompakte ballkanike, por në thelbin e vet të njëjtë dhe etnikisht e kombëtarisht të cilësuar si të tillë: **arvanit, arbëresh, arbnesh, arbanas, arnaut.**<sup>56</sup>

Shqipja nëpër botë është e vjetër, e pamoshë. Përtej Formulës së Pagëzimit. Përtej Kastriotëve, Gazullorëve e Barletit. Përtej Arbëreshëve. Kuvendarët shqiptarë folën shqip gjatë Mesjetës, në kuvendet e këtushme dhe ato ndërballkanike, ashtu si dhe në shkollat e para shqipe, fëmijët e tyre. Nga mesi i shekullit XIX, për disa dhjetëvjeçarë, kombi shqiptar ishte duke u përlindur dhe iluminizmi e romantizmi ishin boshti politik e poetik i kohës, ndaj kemi aq shumë shkolla shqipe gjatë Rilindjes dhe disa vjersha himnizuese kushtuar gjuhës shqipe, nga Naimi, Mjeda, Fishta, Lasgushi etj.

Por sot, pas njëqind vjetësh të shtetit shqiptar, është e udhës të pyesësh, jo vetëm sa shqiptarë flasin në gjuhë të huaj, por dhe sa të huaj e kanë mësuar shqipen nëpër botë? Sa gjuha jonë u është dashur atyre? A botohen libra dhe gazeta shqip në vende të tjera? Çdo shqiptar do të lakmonte e uronte që gjuha e tij amtare të shkruhej e flitej në mediumet e qytetërimit bashkëkohor. Ashtu siç qe shkruar shqip qysh me 1555 në Europë “*Meshari*” i Buzukut. Apo “*Kuvendi i Arbnit*” me 1703. “*Flamuri i Arbërit*” i De Radës e “*Albania*” e Konicës një shekull më vonë. “*Dielli*” e “*Vatra*” e Bostonit. E sa stacione të tjera historike kësisoj të të folurit e të të shkruarit shqip nëpër botë. Derisa të mbërrihej te “margaritari i kurorës”, botimi vite më parë, nga “*Fayard*” -Francë, i veprës së Kadaresë në shqip e frëngjisht, si një lartësi e gjuhës shqipe në kohë moderne.

Pa gjuhë asnjë popull nuk mund ta zhvillonte kulturën e vet. Gjuha e shkruar, e ngritur mbi bazën e ligjërimit të folur dhe në bashkëvjajtje e konkurrencë të natyrshme me të, gjatë shekujve ka ndihmuar në zhvillimin e përparimin e dijes, shkencës, teknologjisë dhe industirsë. Në kohët e reja, së shkruarës tradicionale, me anë të librave e botimeve të tjera, qysh nga gazetatat e revistat deri te publiciteti me anë të fjalës së shkruar, përkthimet me subtitrim etj., i janë shtuar tashmë edhe aq shumë mjete e forma të reja kumtimi e publikimi nëpërmjet atyre që në sociolinguistikën e sotme i quajmë “flukse të padukshme” ose postë elektronike (përkat. botime “on-line”), që si një hapësirë gjigande e nëndheshme i është veshur sot botës së komunikimit, duke e konkuruar dukshëm e përditë e më masivisht gjuhën e shkruar në letër.

Krahas ligjërimit të shkruar e botimeve në faqe librash, gazetash a revistash, që natyrisht vazhdojnë e shtohen, kanë fituar rëndësi të madhe mediat e shkruara dhe të folura “on line”: radioja, televizioni, posta elektronike me internet si dhe, mundësi e forma të tjera të botimit a publikimit elektronik, që qarkullojnë në mënyrë të padukshme nga njëri vend në tjetrin, nga njëri kontinent në tjetrin dhe që, tashmë, bota dhe ecja përpara e saj as që mund të kuptoheshin pa përdorimin e tyre.

Mund të themi se sot, ndërsa ka pasur e ka jo shumë njerëz që kishin mundësi të blinin e të përdornin në shtëpinë e vet ndonjë fjalor të madh ose enciklopedi, me shtimin e interentit nëpër zyra, në qendra pune e biznesi dhe deri në familje, kushdo, brenda disa sekondash, mund të futet në sitet e Enciklopedive “on-line” dhe të gjejë informacionin që i duhet. Prandaj, mund të thuhet se edhe në komunikimin gjuhësor,

<sup>56</sup>Shih: J.Gjinari-Gj.Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHBLU, 2009 dhe Gj.Shkurtaç,*Dialektet e shqipes*, Tiranë, 2012.

sot, globalizimi vështrohet si dukuri që çon në rritjen marramendëse të ndikimit të anglishtes si gjuhë pune e informacioni me peshë aq të madhe në botë.

Përkundër këtij ndikimi të anglishtes, i cili bëhet kryesisht përmes mediave dhe internetit, risitë teknologjike janë duke krijuar hapësira të reja edhe për përdorimin e gjuhëve të tjera të botës. Hapja e Shqipërisë ndaj ekonomisë së tregut dhe futja e investimeve të huaja, si dhe zhvillimi i madh i teknologjisë së prodhimit, i mediave dhe i teknologjisë informative kanë krijuar hapësira për përparime cilësore në kuadër të bashkësisë shqiptare, e cila, ndonëse me ritme e veçanti të dallueshme nga Evropa, sidoqoftë nuk mund të mos i nënshtrohej ndikimit të globalizimit.

Globalizimi është dukuri që ndikimin e tij e shtrin edhe në proceset gjuhësore dhe ky ndikim nuk mund të ngushtohet vetëm në ndikimin që anglishtja si gjuhë e sotme globale është duke ushtruar në gjuhët e tjera dhe as si ndikim në kuptimin e përhapjes së huazimeve prej saj në gjuhët e ndryshme të Botës. Ky kah i ecjes së sotme të njerëzimit në mbarë rruzullin tokësor nuk mund të shihet vetëm si dukuri që rrezikon t'i gërryejë e t' i zhdukë dalëngadalë gjuhët kombëtare të popujve të vegjël. Aq më pak mund të shihet sot përhapja e gjerë dhe e shpejtë e internetit dhe e ndikimeve që vijnë me të si "armik" i përparimit dhe zhvillimit të kulturës e gjuhës kombëtare.

Mjetet e reja të komunikimit masiv kanë marrë shtrirje të gjerë. Shumica e brezave aktivë sot shërbehen jo vetëm nga telefonia fikse, por edhe nga telefonia e lëvizshme a celulare, korrin përherë e më shumë në hapësirat e internetit, qoftë me anë të E-mail-eve, sistemit të chatimeve me të shkruar, si dhe me ato pamore "skypes". Këtu vlen të përmendim komunikimet e të rinjve me njëri-tjetrin me anë të mesazheve me internet dhe me celularë, duke u krijuar, madje, edhe një fushë e re e hulumtimeve sociolinguistike të ligjërimit rinor me anë të shkurtimeve e shkurtesave tejet të veçanta.

Mund të shohim aty, natyrisht, edhe ployën e ndikimeve të pamira në gjuhën shqipe, sidomos të pakujdesisë ndaj rregullave të gramatikës e të drejtshkrimit, duke u bindur se përveç përparësive në lehtësinë e komunikimit, vihen re dhe deformime e dëmtime të rënda të kulturës së gjuhës shqipe, të cilat nuk ishin shfaqur dikur as në "flukset e dukshme" që kanë ekzistuar gjithmonë (letërsia artistike, teatri, filmi, shkollat, radio-televizioni publik), ku gjuha shqipe shfaqej me origjinalitetin e saj.

Gjuha shqipe në internet ose në mesazhe me celular karakterizohet nga synimi për shkurtësi dhe shpejtësi kumtuuese, çka është edhe e kuptueshme, le të themi edhe e pranueshme, por bashkë me këtë cilësi po shumohen në atë lloj ligjërimit edhe elemente të "ligjërimit të fshehur" e ku, krahas anonimatit e përdorimit të shtuar të pseudonimeve, po vërshojnë edhe shkruarje fjalësh mbrapsht, fjalë banale etj. karakteristike të zhargonit rinor. Deri këtu, sidoqoftë, nuk do të ishte rasti për t'u shqetësuar, porse puna është se shprehjet e përdorura gjatë komunikimit në internet që krijohen për të kursyer kohë gjatë bisedave, ( si "flm", "ska ps", tkxh. etj.), kalojnë edhe në praktikën shkollore, duke mos i kushtuar kujdes aspak të folurit dhe të shkruarit letrar, madje këto kalojnë në shprehi, të cilat bartin me vete shumë ndikime negative tek nxënësit.

Duke shqyrtuar këtë lloj ligjërimit a zhargoni të të rinjve, një pasuniversitare e sistemit MND te FGJH shkruan : *'Nuk konsiderohesh komunikues i mirë nëse nuk përdor këtë lloj gjuhë, prandaj kjo formë e bisedave në mes njëri tjetrit te disa të rinjë*

*bëhet edhe e imponuar, nëse nuk e praktikon nuk mund të jesh “modern”. Këto ndikime mund të vërehen edhe me rastin kur nxënësit pyeten apo vlerësohen nga mësuesit”.*

Në rrafshin e shqipes, dukuria e globalizimit ka ndikuar që shqipja t'i nënshtrohet një procesi të rishkallëzimit ose të ripërshtatjes në rrafshin global, dhe lokal. Ky proces është duke u shoqëruar dhe me ndryshimin e diskurseve, zhanreve dhe stileve të komunikimit të gjuhës shqipe.

Një tjetër dukuri, e cila është e lidhur ngushtë me përhapjen e proceseve globalizuese është Interneti. Siç u tha më lart, përkundër faktit që interneti konsiderohet nga shumë autorë si mjete kryesor për përhapjen e anglishtes si gjuhë globale dhe për ndikimin e saj në gjuhët e tjera, duhet të themi se ky mjet i komunikimit dhe i publikimit “on-line” ka krijuar edhe hapësira a fusha të reja për përdorimin e shqipes. Shqipja sot është gjuhë e shumë siteve elektronike në gjuhën shqipe, e email-it, e forumeve dhe blog-eve të ndryshme në internet, në të cilat shqipja del në format e saj të shkruara: herë në formë standarde, herë në forma të varieteteve të tjera të shqipes dialektore ose, sidoqoftë, jostandarde.

Prandaj, duke e mbyllur këtë dukuri, duhet të themi se ndikimi i globalizimit në shqipen nuk mund të shihet vetëm si ndikim i anglishtes dhe që shprehet nëpërmjet huazimeve e barbarizmave.

Globalizimi dhe proceset integruese janë të lidhura fort edhe me aspektet e zhvillimeve të përgjithshme politike, ekonomike, kulturore, letrare dhe, pa dyshim, gjuhësore, që kanë ndikuar edhe në larminë apo llojshmërinë e ligjërimeve a diskurseve të shqipes së sotme, duke i pasqyruar të gjitha këto procese ekonomike, politike dhe kulturore nëpër të cilat po kalon shoqëria shqiptare.

Media e shkruar këto njëzet vitet e fundit ka fituar të drejtën e lirisë së shprehjes. Ajo shpërtheu furishëm e fuqishëm pas viteve të rënies së sistemit totalitar. Në vitet e para të ndryshimit të sistemit shoqëror, pas viteve ‘90-të u ruajt për “inerci” standardi i gjuhës së shkruar. Nëpër mediat tona të shkruara i kushtohet vëmendje normës drejtshkrimore. E njëjta rëndësi iu kushtua edhe normës drejtshqiptimore, leksikut e ndërtimit strukturor të fjalisë. Ngjarjet rrodhën vrullshëm. Lëvizje demografike të papara ndonjëherë ndodhën në një periudhë të shkurtër kohore. Shumë zona rurale, gati u zbrazën dhe u krijuan zona të mëdha urbane.

Në këto kushte është me vend të pranojmë që në gjuhësi u kalua nga dialektologjia rurale në një dialektologji urbane, “*të paorientuar*”. Një bum mediash çelën si lule pranvere. Një numër i konsiderueshëm shtëpishë botuese filluan veprimtarinë e tyre. Dhe s’kishte si të ndodhte ndryshe. Mediat audiovizive e ato të shkruara u gjendën përpara vështirësive të mëdha, ato s’kishin specialistë të aftë e të kualifikuar.

Megjithatë zhvillimet e nisura nuk mund të prisnin përgatitjen e specialistëve e pastaj të fillonin nga puna. Pas viteve 2000 situata filloi të ndryshojë. Nëpër universitetet tona u hapën degë gazetarie, filluan të kthehen studentët që u shkolluan jashtë për të marrë në dorë fatet e zhvillimit të vrullshëm të medias shqiptare. Sot, mund të gëzojmë që mjaft media kanë përjasje me ato simotra nëpër Evropë. Edhe studentët që u shkolluan në universitetet tona u përballën me një konkurrencë jo të lehtë.

Ajo që trajtojmë në këtë studim nuk e zbeh optimizmin, por nxit për arritje të mëtejshme sidomos në zhvillime e ardhme cilësore. Nuk është për t'u toleruar shmangia apo kafshimi i normave, rregullsive pse jo dhe ligjeve të zhvillimit të gjuhës sonë në mijëvjeçarin e ri. Mjaft botues, drejtorë, kryeredaktorë duhet të jenë më të përgjegjshëm kur pranojnë materiale të cinguara, me gabime të pafalshme gjuhësore, që dalin përtej çdo norme a rregulli. Artikujshkruesit, i quaj të tillë sepse nuk mund t'i emërtosh gazetarë, dalin jashtë çdo norme gjuhësore ndonjëherë. Këtu nuk kemi të bëjmë as me të ashtuquajturën "*sociolinguistikë rurale*", por thjeshtë me mosnjohje në nivelin mesatar të një shqipfolësi. Vetëkuptohet që pjesa më e madhe e artikujshkruesve kanë zgjidhur problemin e punësimit në një organ shtypi edhe pse mund të mos e kenë as arsimin përkatës, as prirjen për të qenë gazetarë e për të mos e tepruar, u mungon kultura e duhur për të shkruar në një revistë, gazetë apo libër.

Në zona të mëdha urbane ka prurje pa mbarim dhe jo shterje. Gjejmë gabime në strukturën e ndërtimit logjik të fjalive, në përdorimin e shenjave të pikësimit, në leksikun që shkruasi as vetë nuk e njeh, madje për t'u paraqitur si "bashkëkohorë" përdorin edhe fjalë të huaja vend e pavend. Tashmë dihet që shumë fjalë të huaja në gjuhën shqipe e kanë marrë shtetësinë shqiptare, mjaft të tjera kërkojnë ta marrin dhe do ta marrin, ashtu si edhe të tjera kanë për t'u futur normalisht në leksikun tonë.

Arsyet e pranimit të fjalëve të huaja në shqipen mendoj se janë trajtuar dhe s'kemi pse i përmendim. Për të ilustruar shmangiet nga norma e gjuhës në median e shkruar po rendisim disa shembuj: Në gazetën 'Panorama' (25 maj 2011 f.20): -Sado simbolik, një çmim në Festivalin e Berlinit, tanimë i vetmi i mbetur larg *komercialitetit* është shumë i rëndësishëm. Artikullshkruesi përdor fjalën që e kemi shënuar *me blu*, pa qenë vetë i sigurtë në domethënien e saj e për më tepër ai nuk gjen fjalën e duhur të shqipes për ta përdorur.

...Artikulli "*Jahjaga në Varshavë, Tadiç bojkoton Samitin. Disa shteteve kjo nuk iu konverton, por...*" Artikullshkruesi sajton një trajtë të shkurtër të bashkuar, e cila nuk i përmbahet asnjë rregulli gramatikor të gjuhës sonë. Nuk është as krahinore. Gjithashtu, *konverton*, është një tjetër fjalë, e cila nuk ka gjasë të kuptohet nga një lexues i zakonshëm i cili duhet me patjetër të ketë njohuri nëgjuhën angleze për të marrë kuptimin e një artikulli të shkruar nëgjuhën shqipe.

"Gazeta Shqiptare" (25 maj 2011): "*Studimet në Itali, nisin procedurat e regjistrimit*" - Është paraqitja e kërkesës për para-regjistrim. Nuk mund të marrim në analizë përdorimin e fjalës me vizë në mes kur fjala mund të shkruhej pa vizë ndarje. "...studentët që dëshirojnë të fillojnë procedurën e para-regjistrimit". Pra, vijohet me të njëjtën llogjikë. "...Dokument tjetër është edhe formulari i autentikimit të fotografisë." Fjala e marrë nga italishtja mund të zevendësohet me fjalë shqipe.

Nga "Gazeta Shqiptare" (25 maj 2011 f.25): "...Pas akordimit të liberalizimit të vizave për disa vende të Ballkanit Perëndimor." Mendimi që do të përcjellë shkruasi mund të jepet shumë qartë e lehtë me fjalë të përdorimit të përditshëm të gjuhës sonë.

"...Vendimi për pezullimin e heqjes së vizave nuk do të jetë automatik."  
 "...temperaturat e larta të stinës së verës mund të ndikojnë në ri-dëmtimin e tyre."

".....E.C. është një prej restauratoreve, që po merret me rikthimin në identitet të këtyre ikonave." .. por edhe rikthimin në gjendjen e tyre më të mirë të mundshme, duke bërë edhe unifikimin nga ana koloristike."

Gjithashtu, do të vija në dukje edhe prirjen për të emërtuar tituj artikujsh apo rubrikash në gjuhë të huaj, sidomos në anglisht. Kjo prirje është shumë e theksuar, veçanërisht në gazetën “sensacionale”, të cilat shfaqin të reja apo pasqyrojnë pjesë të jetës së njerëzve të njohur të të gjitha fushave, atë televizive, të botës së spektakleve, të filmit, të ashtuquajturit “VIP-a”, njerëz shumë të rëndësishëm.

Po sjellim këtu një gazetë të re me titullin “Celebrity”. Që nga titulli i kësaj gazete, pra me zgjedhjen e një fjale të gjuhës angleze, d.m.th njerëz të famshëm të botës së artit, spektaklit etj, kuptohet prirja “moderne” dhe “sensacionale” e gazetës në fjalë. Rubrikat, më së shumti, janë të emëtuara në gjuhën angleze, si p.sh. rubrika “Gossip”, thashethemet rreth njerëzve të njohur, apo rubrika “Vip & Gossip”, e tëra në anglisht.

Hasim edhe ndërthurjen e gjuhës angleze me shqipen si rubrika “Vip-kuzhina”; rubrika “Ai & Ajo”, ku vëmë re përdorimin e një simboli (d.m.th *edhe*) që i përket gjuhës angleze dhe aspak gjuhës shqipe. Një tjetër rubrikë është ajo “Paparaci”, ku pasqyrohen fotot e shkrepura në momente nga jeta e përditshme e “vip-ave”.

Gjithashtu, e shumëpërfolura edhe në median elektronike, ajo e “Show Biz”, e cila në gjuhën shqipe nuk mbart asnjë kuptim, është një tjetër rubrikë që, sipas ideuesve të gazetës, ngërthen vëmendjen e lexuesve. Pra, siç shihet gjuha shqipe është në një farë mënyre e lënë mënjanë dhe është pëlqyer të përdoret një term nga një gjuhë e huaj sikur ajo shqipe e njëvlershme të mos ekzistonte apo të mos të përcillte dot të njëjtin kuptim.

Po në këtë gazetë, gazetën e përmuajshme “Celebrity” (të datës 27 maj 2011) nga një kërkim janë vënë re përdorime të fjalëve të reja, të cilat do të përbënin mbase fjalë të futura përmes të ashtëquajturës “flukse të padukshmë”, siç është interneti. Citojmë (nga f.27 e rubrikës “Plus Info”); .. “Cilado qoftë tendenca juaj fetare, fillimi i mundshëm i fundit të botës është diçka që nuk duhet shpërfillur, madje AOL, ka ngritur një blog të drëjtpërdrejtë. Vijon i njëjti artikull ku shkruhet “ Në momentin që po shkruajmë, *if the world ends on Saturday*, është e treta në renditjen botërore të temave të Twitter”. Shkurtimi i *rapture regrets* duket se ka fituar goxha vëmendje dhe disa cicërues ...” etj etj.

Siç e shohim, gazetari nuk shpjegon asnjë gjë në lidhje me frazat e përdorura në gjuhën angleze. Cila është lidhja e tyre me logjikën me të cilën ai vazhdon më poshtë? Askush që nuk ka njohuri të mira në këtë gjuhë, nuk arrin ta kuptojë thelbin e materialit të paraqitur. Po në këtë faqe është dhënë edhe një artikull tjetër kushtuar kultit të kompanisë Apple. Në këtë artikull, ajo që të bie në sy është përdorimi i fjalës *fetare* e pastaj ndryshohet në atë *religjoze*. Pra në fillim të artikullit flitet për *imazhe fetare*, e në rreshtat e fundit të artikullit, ato emërtohen si *imazhe religjioze*. Pse bëhet kjo vallë? Për tu dukur njohës i mirë i gjuhëve të huaja apo për të dhënë pak prirje “modernizmi” materialit të shkruar?

Shembujt e mësipërm i dhamë si ilustrim të realitetit të sotëm në lidhje me gjuhën e mediave të shkruara që gjithmonë e më shumë po mbushen me anglicizma a fjalë të tjera të huaja të panevojshme. Në asnjë vend tjetër të botës nuk do të mungonte deri në këtë shkallë ruajtja e gjuhës amtare, siç po ndodh me mediat shqiptare në vendin tonë. Besoj se një politikë mbrojtëse ndaj gjuhës shqipe dhe një vëmendje më e madhe ndaj saj në përgjithësi do ta zbuste këtë dukuri dhe do të çonte në një rivlerësim të merituar të gjuhës sonë.

Por, ndoshta, krahas lavdisë së mosbjerrjessë shqipes në shekuj, do të trishtohemi pak në ditët e sotme, pasi ka shqiptarë në tokë të huaj, që disi e kanë “harruar” shqipen, ani se duke u ndjerë mbase më shumë evropianë, amerikanë, australianë etj. Ndërkohë që kombe dhe qeveri të huaja përpiqen ta shtrijnë sa më shumë hartën e të folurit së tyre nëpër botë, ku jo rastësisht ka mbretërim të anglishtes, ditë të frankofonisë, ngarendje të spanjishtes, nxitim të kinezishtes etj. Jemi padyshim për t’u bërë pjesë e qytetërimit të botës, por duke shkuar andej me të dyja këmbët, autoktonen dhe gjuhësoren.

Do të ishte bukur nëse do të mund të thoshim me krenari se sa përpara e kemi çuar ëndrrën rilindase për këtë “gjuhë të perëndisë”, siç e quante Fishta. Mes të tjerësh, sa frytdhënëse i kemi shkollat shqipe në Greqi, Belgjikë, Itali, Zvicër, Angli, Amerikë për fëmijët e emigrantëve? Sa efikase kanë qënë këto mote katedrat e gjuhës shqipe në: Palermo, Kozencë, Napoli, Vjenë, Mynih, Shën Peterburg, Bukuresht, Pekin etj, në gjurmë të albanologëve të mëdhenj europiane të dy-tre shekujve të fundit. Apo vetëm dy-tre sosh ndihen, kurse të tjerat janë shuar, kanë mbetur si kujtime e natyrisht dhe si arkiv?

Kemi një model unik të ruajtjes së shqipes, atë të arbëreshëve të Italisë, në pesëqind vjet, ku dhe sot e kësaj dite vazhdon të gjallojë arbërishtja e tyre e pabjerrë. Ata sa herë i merrte malli dhe sa herë iu kërcënohej gjuha dhe identiteti kthenin kryet këndeje nga Arbëria që iu kujtonte se “*na të huaj jemi te ky dhë*”. S’bëhet fjalë për paralele, pasi rrojmë në tjetër epokë dhe në kohë integrimesh të gjithëmbarshme, ama nuk mjaftojnë kremtimet familjare a komunitare të emigrantëve me flamurin kombëtar dhe pak fjalë shqipe me fëmijët pas punës, ashtu si në vrap, për ta mbajtur gjallë e kultivuar shqipen në emigracion. Vetëm pesëdhjetë vjet duhen që dikush me prindër shqiptarë, i trojeve shqiptare, ta quajë veten turk, amerikan, kinez dhe shqipen e prindërve të tij ta ketë si gjuhë të dytë.

Kjo do të ishte një bjerrje e gjuhës e ngadaltë, por e frikshme. Ndaj dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me të drejtë, ka hartuar një strategji për mbrothësinë e shqipes në emigracion, me programe dixhiitale të posaçme, teskte në gjuhën shqipe për fëmijët e emigrantëve etj. Për më tepër “*në çastin kur vendet ku jetojnë emigrantët tanë do të lejojnë futjen e gjuhës shqipe si lëndë me zgjedhje në kurrikul, atëherë qasja jonë do të jetë tjetër*”, duke shtuar se “tashmë një praktikë e tillë zbatohet për emigrantët italianë, në Gjermani dhe në shumë vende të tjera.”

Problemi i shqipes së emigracionit është i dyfishtë, si për fëmijët që vazhdojnë të mësojnë atje, ashtu dhe për ata që tashmë janë kthyer. Duke qenë se në vitin 2012 janë regjistruar mbi 2700 fëmijë, të cilët kanë rinisur mësimet në shkollat shqiptare, organet e arsimit kanë hartuar një plan kombëtar veprimi, për t’u ardhur në ndihmë atyre, që të aftësohen në shqipen e folur e në drejtshkrim, përmes kurseve verore etj. Por mosbjerrja e shqipes në emigracion është një sipërmarrje më e gjerë se ajo shtetërore, jemi të gjithë që mund të luajmë një rol në këtë mes. Ashtu siç “Top Channel” i kushton vëmendje herëpashere kësaj problematike, përfshirë dhe njërin nga emisionet e mëngjesit. Apo dy prindër të rinj, që e kishin sjellë te të afërmit në Shqipëri djalin e tyre (të lindur në Itali), një vit përpara se të fillonte klasën e parë, që të përshtatej me shqipen që në kopsht dhe të mos kishte vështirësi kur të niste abetaren.

Bjerrja e shqipes së emigracionit shpesh i ka “rrënjët” këndeje, kur të rinj shqiptarë analfabetë nga zonat malore mbërrijnë deri në Suedi, Belgjikë e Angli për të kërkuar azil prej “gjakmarrjes”, por që nuk dinë të flasin e shkruajnë gjuhën e tyre. Ata kërkojnë të integrohen në Evropë si individë, por dhe një shoqëri e tërë siç jemi

ne, e kemi të vështirë integrimin qoftë dhe prej analfabetizmit, që vërtet nuk është kronik si ai i viteve '30 të shekullit të kaluar, por jo për t'u shpërfillur, pasi sot më shumë se kurrë ballafaqohemi me botën, teknologjinë, qytetërimin evropian<sup>57</sup>. Le të shohim, p.sh. një fragment se si përdoren këto fjalë në shkrime të ndryshme bashkohore, ku mund të shihet përdorimi i fjalës *interkultural*:

“Çfarë janë Qendrat Interkulturele e cili është roli i tyre në territor? Kur flitet për Qendra Interkulturele i referohemi eksperiencave të ndryshme mes tyre e që i bashkon fakti i veprimit në një drejtim të caktuar, atë kultural. Ka qendra të cilat i drejtohen veçanërisht realitetit të shkollave, si CD/LEI e Bolonjës që merret me mbledhjen e dokumentacionit didaktik të tipit interkultural, që nga formimi i mësueseve, labororet në klasa etj. Qendra të tjera kërkojnë të bëhen pika takimi për shoqatat e emigrantëve, por edhe për individët. Pastaj ka qendra të cilat janë të interesuara nga një tematikë gjinie që merren me gratë e huaja, të tjera akoma me promovimin e pjesmarrjen në qytet nga ana e qytetarëve të rinj.

Interesante në këtë drejtim është qendra e Ravenës në kuadrin e të cilës është punuar për krijimin e Konsultës Komunale, që është zgjedhur së fundi. Kemi të bëjmë edhe me eksperiencën si Forum ose shkolla për Paqe që në qendër të vëmendjes kanë temën e interkulturës. Pra, bëhet fjalë për një ofertë shërbimesh të ndryshme e kryesisht të nivelit të dytë, ndërhyrje në shkolla, shoqata, iniciativa komunikimi, një njohje korrekte e emigracionit, e si rrjedhim për të luftuar diskriminimin që në përgjithësi lidhet me injorancën.

Qendra Zonarelli është e vetmja qendër interkulturele institucionale në qytetin tonë. Është hapur që prej 5 vjetësh e varet nga Komuna e Kuartieri San Donato. Lindi si shërbim i gatshëm për të dhënë një kontribut në realizimin e një laboratorit interkultural të përhershëm në qytetin tonë, me qëllimin e krijimit të iniciativave të përbashkëta mes Italianëve e të huajve, për shkëmbimin e eksperiencave kulturele. Zonarellit i referohen 70 shoqata të ndryshme, 50% përfqësojnë komunitete të huaja, 50% shoqata italiane me drejtim interkulturaliteti. Qendra është hapur në '98, vit i kalimit të administratës së qendrës së majtë. Me ndryshimin e administratës interesi është ulur e është pikërisht kuartieri San Donato që është duke vazhduar këtë eksperiencë.

### **II.3. Rreth dygjuhësisë në bashkësinë gjuhësore shqiptarenë hapësirat truallësore shqiptare në Ballkan dhe në diasporë**

Për problematikën e kontakteve gjuhësore, interferimit nga njëra gjuhë në tjetrën, dygjuhësisë dhe dukurive të tjera edhe etnokulturore, që rrjedhin prej tyre, është shkruar mjaft. Por, me zhvillimin e shoqërisë edhe gjuha ndryshon dhe në gjithmonë mund të themi diçka, që, ndoshta, më parë nuk është thënë...

Ç'është dygjuhësia (bilinguizmi)? Dygjuhësia është aftësia e një ose disa personave për të zotëruar dhe përdorur dy gjuhë në të njëjtën kohë.

<sup>57</sup>Shih:Ndue Dedaj, *Shqipja e bjerrë e emigracionit* “Shqip”, 21 mars 2013.

Sado i thjeshtë të duket në vështrim të parë, dygjuhësia në vetvete është mjaft e ndërlikuar. Ajo mund të ekzistojë në njerëz të veçantë ose të përdoret nga një masë e madhe njerëzish. Për ta bërë më të përceptueshme dukurinë, nga studiues të ndryshëm kanë mbërritur një serë klasifikimesh të dygjuhësisë mbështetur në kritere të ndryshme. Interes paraqet klasifikimi sipas gjuhëtarit Gjovalin Shkurtaç, i cili në librin e tij “Sociolinguistika” flet për këto lloje të dygjuhësisë: dygjuhësi familjare që rrjedh nga martesat e përziera dhe dygjuhësi të emigracionit.<sup>58</sup>

Deri vonë, disa hapësira e treva shqiptare, sidomos ato më qendrore, kanë qenë pak ose aspak të përziera, pra edhe pa dukuri të përzierjeve etnike në familje. Vetëm në një periudhë të caktuar, që nuk pati as jetë të gjatë as shtrirje të madhe si dukuri shoqërore, një numër personash, kryesisht studentë e kuadro që qenë dërguar në Rusi dhe në vendet e “Kampit Socialist”, qenë martuar me gra të huaja. Tek-tuk si dukuri, martesat etnikisht të përziera ndër shqiptarë kishin qenë edhe më parë, sidomos nga djem shqiptarë që kishin studiuar në Perëndim dhe, qoftë edhe pse tejet të ralla, disa prej tyre edhe kanë funksionuar.

Në Shkodër e Tiranë ka pasur ndonjë familje të përbërë; burri shqiptar dhe gruaja italiane, ndonjë rast edhe martesat me ndonjë sllovene në Shkodër e gjetkë, ndërsa në hapësirat anësore e në takim më të ngushtë gjeografik me etnitë e tjera, si me grekët në Jug dhe me sllavët në Veriperëndim e Verilindje, rastet e dygjuhësisë në përgjithësi dhe të dygjuhësisë nëpërmjet martesave të përziera kanë qenë më të hershme, ndonëse tepër të ralla.

Në rastet e martesave të përziera është vënë re se çon peshë më shumë **gjuha e nënës**, d.m.th. në rastin kur gjuha e nënës është e njëjtë me atë të mjedisit apo të bashkësisë shoqërore, atëherë gjuha e babait është *allogjene*; kur gjuha e babait është ajo e mjedisit, atëherë gjuha e nënës është *allogjene* dhe, në këtë rast, gjuha e fëmijës në kuptimin e vërtetë “amtare” vihet në minoritet nga mjedisi, çka mund të përftojë edhe situata konfliktuale.

Kjo gjë vërtetohet në shumë raste edhe nga anketimet tona në diasporën arbëreshe të Italisë. Shkurtaç ka sjellë shembullin interesant të regjistruar në Karfici të Katanaxarës, ku shumica e arbëreshëve janë shqipfolës, edhe gra nga qyteti i Katanaxaros ose katunde italiane përreth të martuara me karficiotë, kanë qenë të detyruara të mësojnë mirë gjuhën shqipe të mjedisit dhe, për pasojë, fëmijët e tyre e flasin shumë mirë shqipen në varietetin e atij ngulimi.

Dygjuhësia e emigracionit karakterizohet nga fakti se fëmija duhet të përballojë jashtë mjedisit familjar, përgjithësisht njëgjuhës (monoling), një gjuhë të ndryshme, që nuk e flasin medoemos prindërit e tij ose që e flasin keq. Ky tip i dygjuhësisë ka prirje të zhvillohet e të përhapet shumë aktualisht në vendet e pasura, si pasojë e dyndjes së punëtorëve të krahut nga vise të huaja. Me interes do të jetë, në studimet sociolinguistike, shqyrtimi e studimi sa më konkret i situatës dhe i shfaqjeve konkrete të dygjuhësisë së emigracionit arvanit, arbëresh dhe i emigracioneve më të reja shqiptare në dhe të huaj si në Bullgari (fshati Mandrica e ndonjë tjetër), në Zare (Dalmaci), në Ukrainë (Rusi), në Gjermani, Suedi, në SHBA, në Kanada, në Australi etj.

<sup>58</sup>Shih: Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2009 dhe F. Tarifa, *Imagjinata sociologjike dhe bota jonë sociale*, Onufri, Tiranë, 2014.

Disa studime paraprake janë bërë dhe, sikundër dihet, edhe janë përfillur e përmendur në librat “*Dialektologjia*” (Gjinari-Shkurtaj, 1996) dhe në “*Ligjërmet arbëreshe*” (Shkurtaj, 2006).

Në rastin e bërthamave familjare të përziera gjendja është e tillë:

a) *nëna arbëreshe shqipfolëse, babai arbëresh joshqipfolës*<sup>59</sup>, i cili e kupton pasivisht shqipen, por nuk e flet. Në këtë rast fëmijët janë shqipfolës dhe italishten zënë ta mësojnë kryesisht në shkollë;

b) *nëna arbëreshe trigjuhëshe* (shqip, italisht dhe dialektin italian të krahinës përkatëse-kalabrez, sicilian, molizan etj) *babai joarbëresh* (kalabrez, sicilian, molizan etj.), i cili, gjithashtu, është dygjuhësh, p.sh. italisht-kalabrisht (përkatësisht: italisht-sicilianisht, italisht-molizanisht etj.) dhe vetëm pasivisht mund të njohë edhe shqipen. Fëmija, në këtë rast, të shumtën e herës është një trigjuhëshe: shqip-italisht-dialekti i krahinës (përk. sicilian, kalabrez, molizan). *Gjuhë e parë e fëmijës është shqipja, të cilën ai e përdor në kumtim me t’ëmën, ndërsa me t’atin përdor italishten ose një dialekt të saj*(sipas krahinës përkatëse).

c) *kur nëna është italiane, të shumtën e herës fëmijët janë italishtfolës*, por ka edhe raste që vetë nëna italiane, e ndodhur në një bërthamë familjare brenda një ngulimi ku ruhet me forcë arbëreshësia dhe gjuha shqipe dhe ku arbërishtfolësit zotërojnë si, p.sh., në Piana, në Plataçi, në Shën-Benedikt e gjetkë, ka mësuar mirë shqipen dhe për rrjedhojë edhe fëmijët mësojnë shqipen.

Dyjuhësia gjeopolitike është ajo që rezulton kur dy bashkësi gjuhësore të ndryshme, me të drejta të njohura të barabarta, jetojnë në të njëjtën hapësirë gjeografike dhe politike. Situata të tilla janë ato të një dyjuhësie të pranuar e të njohur apo institucionale, që ushtron një veprim pak a shumë shtrëngues mbi individët e njërës apo tjetrës bashkësi.

Në këto situata, individit mund edhe ta injorojë me dashje situatën e dyjuhësisë dhe ta refuzojë njërën prej gjuhëve. Kështu, kanadezët anglofonë mund të jetojnë në Monreal pa folur frëngjisht apo, më saktë: të heqin dorë nga frëngjishtja, për të përfitur nga avantazhet që u jep mësimi i anglishtes dhe përdorimi vetëm i asaj, duke u deklaruar edhe njëgjuhës anglofonë dhe jo dygjuhës: frëngjisht-anglisht.

Në disa raste, gjuha e një pakice etnike të nënshtruar politikisht ndaj një entiteti administrativ më të gjerë mund të mos e ketë statusin zyrtar në këtë entitet administrativ. I tillë është rasti i të folmeve krahinore të shpërfillura nga një pushtet centralizues, që e ka njëgjuhësinësi parim unifikues. Kemi atëherë situata të diglosisë, ku gjuha e pakicës konsiderohet në mënyrë të pashpallur si më e ulët (inferiore). P.sh., rasti i shqipes në shumicën e viseve shqiptare në ish-Jugosllavinë, sot në Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni etj.

<sup>59</sup>. Prof.Shkurtaj ka sjellë edhe raste të arbëreshëve joalbanofonë nga ngulime arbëreshe, që kanë bjerrë shqipen në kohët e vona si p.sh. nga Mongresano e Cervikati në Kalabri, nga Marçeduza në Katanxaro, nga Palac Adriano në Sicili etj, si dhe të tjerë të shpërngulur nëpër qytetet e mëdha të Italisë së Jugut si në Kozencë, Korilano, Bari, Palermo etj., për të mos folur për ata që janë shpërngulur më larg në Torino, Milano etj., por që kanë gjithashtu situatën gjuhësore në fjalë.

Në Kosovë, pas vitit 1999, për fatin e mirë të shqiptarëve që janë shumicë në Bashkësinë Shoqërore të atij vendi, pushoi dygjuhësia e imponuar me serbishten dhe aty kemi të bëjmë tashti me një *“dygjuhësi të braktisur”* dhe kalimin atje në një bilingualitet të ri: shqip-anglisht, sidomos në nivelin e komunikimit zyrtar. Deri në fundin e Luftës së Dytë Botërore shqiptarëve të Kosovës nuk u njihej e drejta e shkollës shqipe dhe e gjuhës së shkruar. Dygjuhësia ishte kryesisht në nivelin e gjuhës së folur. Shqipja në Kosovë ndeshej me serbishten standard në të gjitha sferat e përdorimit të saj. Situatë të njëjtë kanë pasur edhe shqiptarët në Maqedoni, porse edhe atje, më 13 gusht 2001, në Ohër, u pranua që gjuha shqipe të njihet si gjuhë zyrtare në disa pjesë të vendit.

Dygjuhësia **tekniko-ekonomike** po bëhet e zakonshme për shqiptarët e Shqipërisë. Një e pesta e tyre si emigrantë tashmë jetojnë rregullisht me një gjuhë tjetër të dytë. Një pjesë tjetër dalin jashtë vendit dhe kthehen përsëri në atdhe në mënyrë të përsëritur. Brenda vendit jo vetëm nëpërmjet arsimit të rregullt, por edhe me shumë rrugë të tjera (e sidomos nëpërmjet televizionit për italishten) gjithashtu mjaft prej tyre kanë përvetësuar një gjuhë tjetër të dytë. Konstatimi i përgjithshëm është se tashmë 30 për qind e shqiptarëve të Shqipërisë është dygjuhëshe.<sup>60</sup>

Gjuhët e huaja që zënë vendin kryesor janë: italishtja, greqishtja dhe anglishtja. Po ashtu duhet ditur se Shqipëria është përfshirë tashmë në rrjedhat e globalizimit dhe po plotëson standardet për t’u përfshirë e pranuar në Bashkimin Evropian. Për këtë arsye, mund të jetë i drejtë vlerësimi i studiuesve, se sot *“më shumë se gjysma e shqiptarëve janë dygjuhësh”* dhe se vendin e parë do ta zërë anglishtja në një të ardhshme të afërt. Tashmë anglishtja është zyrtarisht gjuha e dytë në Kosovë. Njëkohësisht do të ketë më shumë shqiptarë jashtë vendit, sesa brenda Shqipërisë.

Koncepti i Shkurtajit për dygjuhësinë si problem e si proces shprehet kështu: Situata sociologjike e dygjuhësisë paravendon përdorimin e njëhershëm dhe konkurrent të dy gjuhëve në të njëjtën hapësirë gjeografike, ekonomike ose politike, për pasojë, aty janë të pranë dy bashkësi të dallueshme dhe mund të shihet mjaft lehtë se statusi individual është dygjuhësia. Ndërkaq, duhet thënë se, mund të jetohet në një situatë politiko-shoqërore të dygjuhësisë, pa qenë të gjithë anëtarët e bashkësisë dygjuhës (bilingë).

Kështu, p.sh., në trevat shqiptare të mbetura jashtë kufijve të sotëm shtetërorë të Republikës së Shqipërisë, në ish-Jugosllavi (Mal i Zi, Serbi, Maqedoni) janë të shumtë njerëzit që nuk dinë asnjë fjalë sllavisht (stokavisht, serbisht, maqedonisht), sepse ata flasin e shkruajnë vetëm shqip, porse atje, duke qenë nën suazën e një shteti (sot të disa shteteve) tjetër, statusi gjuhësor është ai i dygjuhësisë ku gjuhë zyrtare shtetërore janë shqipja dhe gjuhët sllave përkatëse (serbokroatishtja, maqedonishtja).

Anasjelltas, mund të jesh dygjuhës edhe jashtë çdo konteksti shoqëror e politik të dygjuhësisë. Kjo është tipike për të shpërngulurit në vende të huaja, ku gjuhën e tyre të parë e dinë dhe, me raste, mund ta ushtrojnë, porse, aty ku ndodhen, nuk është një gjuhë e njohur. Kemi, pra, një dygjuhësi (bilinguizëm) të heshtur, të pushpallur.

<sup>60</sup>Shih: Xh.Lloshi, *Shqipja standarde në rrethanat e dygjuhësisë*, St.fil., 2001, nr.3-4, f. 50.

Nga sa u tha, mund të përfundojmë, se situatë e dygjuhësisë është atëherë kur njeriu shërbehet rrjedhshëm, sipas situatave të jetës së tij të përditshme, nga dy gjuhë për të komunikuar me të tjerët dhe kur këtë komunikim dygjuhësor e pranojnë si mjedisi ashtu edhe situata e përgjithshme sociolinguistike. Mbi këtë bazë, sigurisht, do të dallojmë dygjuhësinë e një grupi apo të një bashkësie të tërë gjuhësore nga të folurit e një gjuhë të dytë, të mësuar në shkollë e, gjithnjë, në kushte artificiale. Sot edhe në Shqipëri ka mjaft njerëz që kanë mësuar një ose disa gjuhë të huaja, porse ata nuk janë njësoj si dygjuhësit e bashkësive gjuhësore me status të njohur të dygjuhësisë. Për këtë tip gjuhë të huaj të dytë përdoret termi *bilingualitet* dhe jo *bilinguizëm* (=dygjuhësi).<sup>61</sup>

Me fjalë të tjera, quajmë dygjuhësi ose diglosi një gjendje dygjuhësie kolektive, kurse për dygjuhësinë individuale pa status, përdorim termin *bilingualitet*. Deri vonë ka pasur një prirje për ta quajtur situatën e njëgjuhësisë (monolinguizmit) si më normalen, sepse ajo ishte, së paku në dukje, mbizotëruese dhe për këtë përdoreshin si dëshmi edhe statistikat. Por, në gjysmën e dytë të shekullit XX ndodhi një evolucion i shpejtë dhe një njohje më e mirë e situatës gjeopolitike të një numri rajonesh të rruzullit si dhe një rinjohje e sqarim më i mirë i të dhënave rreth situatave të vjetra, duke bërë të qartë kështu, se kudo në botë, situatat gjuhësore të njëgjuhësisë ishin më të pakta sesa ishte menduar dhe se, përkundrazi, dygjuhësia apo shumëgjuhësia, janë në shumë raste një situatë normale edhe nga pikëpamja konstitucionale e shumë shteteve të botës.

Pranë grupimeve gjeopolitike të vjetra, që përfshijnë në gjirin e tyre bashkësi gjuhësore të ndryshme, një numër i të cilave shpie në një dygjuhësi faktike, duhet parë edhe zgjidhja e konflikteve pas kolonializimit ushtarak, politik ose ekonomik gjë që ka detyruar disa kombe të reja të pranojnë domosdoshmërinë e një gjendjeje të pjesshme të dygjuhësisë; kjo situatë mund të jetë e përkohshme apo e vijueshme, por që sot na shfaqet në formën e një realiteti të qartë. Në shumë vende “të botës së tretë” apo ish-koloniale, krahas gjuhëve të vjetra vendase, përdoren gjuhët e mëdha të administratës koloniale, që, me kohë, janë shtrirë edhe më gjerë.

Të gjitha këto na shpien në nënvizimin e një situatë përherë e më të qartë të dygjuhësisë. P.sh., në Algjeri, Tunizi etj. gjuhë zyrtare është frëngjishtja; atë e njohin edhe masat e gjera si gjuhë e komunikimit të përditshëm, porse atje, edhe sot, krahas frëngjishtes, përdoret edhe gjuha arabe vendase dhe, pothuajse kudo, ka situatë dygjuhësie apo diglosie. Një situatë të dygjuhësisë së shqipes standarde me anglishten në kuadrin e Bashkësisë Evropiane e më gjerë mund të pranohet edhe për shqiptarët. Shqipëria ka qenë dhe është pjesë e Ballkanit dhe dihet që historikisht ky gadishull ka qenë një trevë bashkëjetese e kryqëzimi të popujve dhe etnive të ndryshme fqinje apo sikundër e quan ndonjë gjuhëtar “një lloj kulle Babiloni”<sup>62</sup>.

Sipas gjuhëtares bullgare Petja Asenova, dygjuhësia në Ballkanin shumëtnik, sidomos pas pavarësimit nga pushtimi otoman dhe pas formimit të shteteve të pavarura ballkanike, ishte dygjuhësi kolektive e tipit dialekt i një gjuhë (dA) + gjuhë e shkruar zyrtare tjetër (B). Ky është rasti i dialekteve bullgare në Rumani, në Greqi dhe në Shqipëri, i dialekteve greke (veriore) dhe rumune (vllaho-oltene) në Bullgari, i

<sup>61</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2009, f.278.

<sup>62</sup> Shih: R. Memushaj, *Vështrim mbi dygjuhësinë në Shqipëri*, “Studime albanologjike”, 1997,2, f.101.

dialekteve arumune në Greqi dhe në Shqipëri, i dialekteve shqipe (toske) në Greqi etj.<sup>63</sup>”

Studiuesit kanë vënë re se dygjuhësia kolektive në Shqipëri është e kufizuar vetëm tek pakicat që jetojnë në territore etnikisht kompakte, konkretisht tek pakica greke dhe maqedone, por edhe tek pakicat gjuhësore vllahe dhe rome. Pakica greke është e vendosur në tri zona të Shqipërisë së Jugut: Gjirokastrë, Sarandë e Delvinë, që të tria enklava gjuhësore a ngulime të krijuara vonë, nga të cilat më të mëdhatë janë e Dropullit dhe e Vurgut. Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë të viti 1989, pakica greke përbën 1.85 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë<sup>64</sup>.

Sot, në kushtet shoqërore të globalizmit, natyrisht që edhe panorama gjuhësore ka ndryshuar në përmasa të ndjeshme në raport me disa dhjetëvjeçarë më parë, madje ajo njihet më në thellësi. Endrra për një Evropë të përbashkët, për një botë pa kufij, ndesh edhe në barrierën gjuhësore. Dëshira për një komunikim pa pengesa midis gjithë njerëzimit ka motivuar deri përprjekjet për krijimin e një gjuhë artificiale, siç është *esperanto*.

Edhe tek ne deri para 15 a 20 vjetësh përse i përket dygjuhësisë kishim një pamje krejt tjetër. Por emigracioni i madh i viteve të tranzicionit, jeta e përbashkët me shoqëritë e tjera (të huaja deri dje për ne), nevoja e madhe për komunikim ka shtuar jo vetëm njohuritë për gjuhët e huaja, por edhe përdorimin e përditshëm të tyre në kontekstet e sipërpërmendura. Dygjuhësia tek ne është tipike sidomos tek moshat e reja dhe fëmijët. Bëhet fjalë sidomos për një pjesë të mirë të shoqërisë shqiptare që jeton dhe punon në pjesën më të madhe të kohës jashtë vendit.

Rritja dhe shkollimi në mjedis shoqëror dygjuhësh (bilingual) nënkupton edhe të qenit dygjuhësh të fëmijës. Sigurisht, pozita e një numri jo të vogël të fëmijëve e të rinjve të larguar në mërgim (përmendim rastet e panumërta të studentëve që shkollohen jashtë) është tipike dygjuhëshe, madje mund të themi edhe trigjuhëshe. Ata, natyrisht, kalojnë nëpër të gjitha shkallët e sistemit arsimor, përkatësisht edhe me kontaktet me gjuhën e vendit pritës në jetën publike (çerdhe, kopshte, shkolla, shoqëri, media, koha e lirë dhe loja), kështu që përdorimi i gjuhës së vendit pritës është pothuajse i natyreshëm.

Në literaturën shkencore kushtuar dygjuhësisë, shpesh diskutohet për dygjuhësi të hershme dhe për pasojat e saj mbi zhvillimin e përgjithshëm dhe intelektual të fëmijës. Duhet theksuar që shumica e studiuesve psikologë e pedagogë flasin për një ndikim pozitiv të bilinguizmit të hershëm, duke dëshmuar se zhvillimi dygjuhësh jo vetëm që nuk vonon zhvillimin dhe mundësitë njohëse tek fëmijët, por, përkundrazi, e zgjeron ndjeshëm atë.

Shumë familje gjenden në situata ku njëri ose të dy prindërit flasin një gjuhë të parë përveç një gjuhe tjetër. Për këtë arsye, pyetjet më të zakonshme që ata bëjnë janë: “*Si duhet t’u flasim fëmijëve?*”. Zakonisht dy janë këshillat që u jepen prindërve në këto raste: së pari, prindërit duhet të komunikojnë me fëmijën në mënyre sa më

<sup>63</sup>. Shih: P.Asenova, *Gruaja monolingje në Ballkanin biling*, në “Studime albanologjike”, Tiranë, 1996, nr.1, f. 86.

<sup>64</sup>. Shih: R.Memushaj, *Vështrim mbi dygjuhësinë në Shqipëri*, “Studime albanologjike”, 1997,2, f.101

natyrale; dhe e dyta, prindërit të jenë të qëndrueshem dhe këmbëngulës në mënyrën si do t'ua paraqitin fëmijëve të tyre të dyja gjuhët. Literatura dhe përvoja tregojnë se përvetësimi i gjuhëve nga fëmijët mund të bëhet njëkohësisht (të dyja gjuhët prezantohen paralelisht që në fëmijëri) ose njëra pas tjetrës (mësohet në fillim njëra, pastaj tjetra).

Në ç'raste mund të hasim përvetësime të njëkohshme të të dy gjuhëve?

Kjo është situata më e mundshme tek bilinguizmi familjar që rrjedh nga një martesë e përzier, ku secili nga partnerët i përket një komuniteti të ndryshëm kulturor - gjuhësor, ndaj secili komunikon me fëmijën në gjuhën e vet. Njihen raste të ndryshme martesash të këtij tipi, qoftë shqiptare të martuara me grekë, që jetojnë në Greqi, ashtu edhe të huaja që janë martuar me burra shqiptarë (p.sh. disa rumune që janë martuar me djem korçarë, pasi këta kanë kryer studimet në Rumani), që kanë krijuar familjet në Korçë. Ka edhe italiane të martuara me shqiptarë, por sidomos shumë shqiptare të martuara me italianë e të larguara në Itali, disa syresh edhe banojnë në Shqipëri.

Mund të ndodhë që prindërit kanë të njëjtën gjuhë dhe kujdestarët e fëmijës një gjuhë tjetër. Këtu mund të jap shembullin e një pedagoqeje shqiptare, e cilau martua në Belgjikë me një shqiptar të shkolluar dhe me pozitë të lartë shoqërore; ajo gjithashtu arriti me aftësitë e veta të ngjitej në shkallët e karrieres. U martuan dhe lindën një vajzë. Angazhimet profesionale, si dhe mundësitë e mira ekonomike ia lejonin çiftit të bënin një zgjedhje për të punësuar një belge (*baby - sitter*) për rritjen e vajzës së tyre derisa ajo të bëhej në moshë për në kopsht. Në këtë rast vajza u bë njëkohësisht dygjuhëshe për shkak të komunikimit me dadon në frëngjisht dhe prindërit në shqip.

Familjet në emigracion, p.sh. mund të ndiejnë nevojën që fëmija e tyre të flasë rrjedhshëm gjuhën sunduese të vendit ku jetojnë (zakonisht për të ecur mirë me shkollën, ose, siç thotë një studente që ka jetuar në Greqi, për të mos u kuptuar nga vendasit që janë të huaj në mjedise publike), por ndërkohë duan edhe të mbajnë gjallë gjuhën shqipe.

Një familje që ka synim të zhvendoset diku në të ardhmen mund të punojë me fëmijën e vet për njohjen paraprake të gjuhës së vendit ku do të shpërngulet. Kështu, shumë korçarëve, që u del llotaria për në SHBA preokupohen t'u mësojnë mirë anglishten fëmijeve qysh kur janë të vegjël.

Përvetësimi i njëkohshëm i gjuhëve kalon domosdoshmërisht në disa faza:

1. Fëmija ka një sistem gjuhësor të padallueshëm, që rezulton me një leksik me fjalë nga të dyja gjuhët. Kështu, për një koncept mund të përvetësohet një fjalë e marrë nga secila gjuhë dhe të shprehet si një përzierje. Shembull: Një fëmijë shqiptaro-grek mund të thotë "papu-gjyshi" kur thërret gjyshin.

2. Fëmija fillon t'i dallojë sistemet leksikore të gjuhëve, por përzier dukshëm gramatikën e tyre. Zakonisht në këtë fazë gjuha me sistem më të thjeshtë gramatikor bëhet dominuese për një kohë një deri dy vjet, pastaj do të mbyllet kjo fazë.

3. Të dyja gjuhët tashmë dallohen nga fëmija në fjalor dhe sintaksë. Ai mund t'i lidhë gjuhët me njerëz ose kontekste të veçanta. Kështu shprehet një rumune, e martuar prej disa vitesh në Korçë, për vajzën e saj të vogël. *Kur Sofia shkon ne*

*Bukuresht tek gjyshërit nga e ëma, e kupton se duhet të flasë rumanisht, sa kthehet në Korçë flet shqip.*

Dy gjuhët mund të përvetësohen edhe në mënyrë të njëpasnjëshme. Kjo ndodh kur një gjuhë e dytë mësohet mbasi gjuha e parë është përfunduar mirë. Mosha 3 vjeç shihet si çasti kur fëmija ka krijuar bazën për kompetencën komunikative në gjuhën e parë.

Në ç'raste mund të hasim përvetësime të njëpasnjëshme të gjuhëve?

Kur familja emigron pasi fëmija e tyre e ka përvetësuar gjuhën e parë dhe pastaj është ndeshur me gjuhën e huaj nëpërmjet ndjekjes së arsimit parashkollor e shkollor (shqiptarët që shkojnë në Amerikë e gjetkë).

Në familje emigrantësh, që jetojnë në një bashkësi ku flitet gjuha e minoritetit dhe flasin vetëm gjuhën e parë me fëmijën e tyre derisa ajo shkon në shkollë, p.sh., në zonën e Dropullit pakicat greke, ose arbëreshët e Italisë etj.

Kur një familje emigrantësh siguron bazën e gjuhës së parë për vitin e parë të jetës tek fëmija e tyre dhe pastaj kalojnë në gjuhën e dytë në shtëpi teksa afron koha e shkollës.

Përvetësimi dygjuhësor i njëpasnjëshëm kalon në disa faza:

1. Faza **bashkëvepruese** – gjatë së cilës shumë fëmijë që po mësojnë një gjuhë të dytë fillojnë me përpjekjen për të siguruar marrëdhënie shoqërore; fillimisht me komunikim pa fjalë (me gjeste e mimikë) e më tej gjatë lojës, duke përvetësuar copëza bisede, psh., ‘radha ime’, ‘ma jep mua’.

2. Ndërhyrja (**përzierja**) - në etapat fillestare të përvetësimit të dy gjuhëve njëherën pas tjetrës, fëmija përdor sistemin e gjuhës së parë për të bërë dallimin ndaj gjuhës së dytë. Kjo çon në një lloj përzierjeje, ku fëmija bën gabime normale, pasi rregullat e gjuhës së parë i përdor në gjuhën e dytë dhe anasjelltas. P.sh. *ma jep rruksak-in* (në rastin e shqiptarëve të Zvicrës gjermanofone), ku rruksak është gjermanisht, por lakimin e emrit e bën sipas shqipes.

3. Periudha e **heshtur** - shumë fëmijë kalojnë një periudhë qetësie kur ndeshen me gjuhën e dytë. Zgjatja e kësaj faze lidhet me personalitetin dhe mënyrën e të mësuarit; kështu, fëmijet e çiltër e të shoqërueshem e arrijnë më shpejt rrjedhshmërinë e gjuhës së dytë.

4. **Ndryshimi i kodit** - përbën një proces normal të kalimit të të dy gjuhëve, brenda së njëjtës fjali ose të njëjtit fragment ligjërimor. Fëmijët e bëjnë këtë kalim nga gjuha në gjuhë pasi ata dëgjojnë të rriturit që i praktikojnë ato. Ajo mund të jetë një mënyrë e zakonshme për të folur me njerëzit e bashkësisë dygjuhëshe.

5. **Humbja e gjuhës** - kur një gjuhë zëvendësohet në mënyrë të menjëhershme nga një gjuhë e dytë, pa vazhduar të flitet e para, vihet re një formë ‘dygjuhësie rrafshuese’, ku fëmija mund të humbasë në një masë aftësitë e tij në gjuhën e parë, duke rezultuar, kështu, me pasoja negative për gjuhën dhe identitetin e vet (siç ka ndodhur e ndodh me mjaft familje shqiptare –për fat të keq- në emigracion, të cilat nuk i kanë kushtuar vëmendje komunikimit në gjuhën shqipe në familje dhe për

rrjedhojë, ka edhe raste që fëmijët nuk dinë as të përshendesin në gjuhën e mëmës dhe të babait).

Së fundmi, po japim një përmbledhje të disa konkluzioneve nga një situatë dygjuhëshe në *emigracion*, ku gjuha e dytë është përvetësuar në mënyrë *të njëpasnjëshme* dhe bilinguizmiaty është i përpjesëtuar apo barazvlershëm.

Një studente na ka kumtuar disa aspekte të rëndësishme lidhur me situatën dygjuhëshe në familjen e saj për një periudhë relativisht të gjatë.

Prindërit e saj emigruan në Greqi që në fillim të viteve '90 dhe i morën të dy vajzat kur ato mbushën përkatësisht 7 vjeç dhe 5 vjeç e motra. Në këtë çast filloi për to nxënja e gjuhës së dytë (greqishtes). Fillimisht për vajzat ishte tepër e vështirë, sepse nuk kishin kontakte me fëmijë grekë. "Greqishten e kemi mësuar vetë me ndihmën e prindërve, të cilët e dinin gjuhën pasi kishin shkuar që më parë në Greqi. Ata përpiqeshin të na flisnin vetëm greqisht në shtëpi derisa e mësuam gjuhën, më pas flisnim vetëm shqip në familje, me përjashtim të situatave në vende publike (në pazar apo në autobus), sepse nuk donim të na merrnin vesh që ishim jogreke."

Më tej vajzat shkuan në shkollë greke. Në këtë periudhë ato filluan të komunikonin vetëm greqisht edhe me njëra-tjetrën, sepse në atdhe nuk kishin qenë në shkollë dhe greqishtja "u vinte më kollaj". Jo vetëm kaq, por edhe në prani të shoqeve greke e kishin bezdi të flisnin shqip, pasi donin të ndiheshin jo të ndryshme dhe detyroheshin të fshihnin prejardhjen, nga frika e ndonjë diskriminimi të mundshëm (dukuri jo e rrallë në Greqi për shumë arsye). Ndërkaq, prindërit dendësuan përpjekjet, që vajzat të mësonin mirë edhe shqipen, duke u sjellë atyre abetaren shqipe.

Qëndrimi në Greqi zgjati 8 vjet. Në moshën 15-vjeçare motrat u kthyen përfundimisht në atdhe. Por sërish atyre iu desh të përballeshin edhe me një situatë tjetër të vështirë gjuhësore (kalimin nga greqishtja në shqip). Në fillim vajzat flisnin vetëm greqisht në mënyrë të pavetëdijshme, kjo edhe për arsyen se kishin mjaft boshllëqe në gjuhën shqipe..."dhe për këtë ndiheshim vërtet keq, pasi shoqet e tyre shqiptare filluan t'i etiketonin si "greke", ngaqë u dukej sikur ato kërkonin të hiqeshin si të tilla, duke pëlqyer greqishten e jo shqipen. "Kjo ishte një periudhë relativisht e gjatë dhe e vështirë, thujse dy vjet,-tregojnë vajzat- gjatë së cilës na u desh të kapërcenim "hendekun" gjuhësor me moshatarët tanë, si dhe në shkollë me mësimet". Vajzat pohojnë, ndërkaq se, njohja e dygjuhëve i ka ndihmuar në nxënien edhe të gjuhëve të tjera të huaja.

#### **II.4. "Flukset e dukshme" dhe "të padukshme" në kohën e sotme dhe pasojat e tyre kulturore e gjuhësore**

Vetë termat "flukse të dukshme" e "të padukshme" duket se janë në një dinamizëm, ecuri e ndryshueshmëri të vazhdueshme, pasi, me kohë, vetë shoqëritë njerëzore ndryshojnë, ndryshojnë kushtet në të cilat ato ndërveprojnë, rrethanat etj, e kësajsoj ndryshon dhe gjuha bashkë me to. Ende midis tyre mund të përdorim një lloj kufiri për sa i përket vendeve ku ato zhvillohen e gjallërohen. Tek "flukset e dukshme", sipas prof. Shkurtajt, klasifikohen pazaret, shkollat e bibliotekat, teatrot, kinematë, diskotekat etj e gjuha që haset në to ndërsa në flukset e padukshme

klasifikohen radioja, teleksi, televizioni, faksi, e-maili, internet, gazetatat, revistat, librat etj.<sup>65</sup>

Me të drejtë shumë gjuhëtarë i qëndrojnë besnik faktit se fjala duhet të përpunohet para se ajo të hyjë në standardin dhe përdorimin e gjerë të gjuhës. Por vetë gjuha duke qenë dinamike dhe shpeshherë e përdorur me subjektivizëm nga përdoruesit e saj tentohet të përdoren në të fjalë apo elemente gjuhësore që hyjnë nga flukset e padukshme. Tani nuk është vetëm gjuha e letërsisë artistike, teatri dhe filmi, por dhe radio-televizioni, organet e shtypit. Media është sot pa asnjë dyshim një nga ndikueset më të mëdha në gjuhë. Shqetësim i mjaft gjuhëtarëve është shpërdorimi që bëhet këtu me të drejtën e botimit të artikujve, ku shpeshherë shtrembërohet standardi dhe për rrjedhojë dilet në një lloj keqinformimi gjuhësor të lexuesve.

Te “flukset e dukshme”, natyrisht, rolin kryesor e ka pasur dhe e ka shkolla. Shkolla, që do të thotë aty, në radhë të parë, të nxëniet e gjuhës shqipe si lënda kryesore e formimit të shkollarëve deri në fund të maturës shtetërore. Gjuha shqipe nuk ka nevojë t’i zërë diellin asnjë lënde tjetër, po edhe as të jetë nën hijen e ndonjë lënde tjetër, qoftë edhe të letërsisë. Gjuha shqipe i duhet letërsisë, sepse letërsi të bukur pa gjuhë të mirë, të pasur e të kujdesur nuk ka e nuk mund të ketë. Porse gjuha shqipe u duhet edhe njerëzve që nuk merren me letërsi, prandaj lidhja me letërsinë nuk është dhe nuk ka pse të jetë e kushtëzuar.

Ka pasur e ka shumë njerëz që nuk merren me letërsi, por shkruajnë e flasin shumë bukur, sikundër ka, për fat të keq, edhe aq shumë njerëz që merren me letërsi dhe që shkruajnë aq keq, me fjalor të varfër e me mangësi të mëdha të formimit gjuhësor – thotë Gj. Shkurtaj, duke argumentuar se *ka pasur një rendje të natyrshme pas gjuhëve të huaja. Kjo është punë shumë e mirë. Hyrja në Evropë nuk bëhet pa njohur gjuhët e mëdha të komunikimit, sidomos anglishten, frëngjishten etj. Mirëpo, të mësosh dhe të vlerësosh gjuhët e huaja, nuk do të thotë aspak të mos vlerësosh (e aq më pak të nënvlerësosh) gjuhën tënde?! Tashti kemi shumë njerëz që i dinë mirë, (ndoshta edhe sa s’ka ku të vejë më mirë), gjuhët e huaja. Kjo duhet vetëm të na gëzojë. Por, kemi pak, shumë pak njerëz që e dinë mirë gjuhën shqipe, që mund ta shkruajnë e ta flasin bukur e pa gabime.*

*Shikoni si flasin e shkruajnë sot pushtetarët, zyrtarët dhe gazetarët tanë! Plot fjalë të huaja të panevojshme, plot shtampa gjuhësh të huaja e kundër natyrës së shqipes, me dukuri që tregojnë mosnjohje të plotë jo vetëm të gjuhës së njësuar (standard), po edhe me elemente të çoroditjes së sintaksës. Pra, nuk dimë të flasim e të shkruajmë shqipen, gjuhën tonë amtare, ndërsa mëtojmë (dhe arrijmë përherë e më shumë) të flasim dhe të shkruajmë jo pak gjuhë të tjera.*<sup>66</sup>

Komunikimi është në themel të jetës sonë dhe komunikimi njerëzor, në çdo rast, është i shumanshëm dhe i ndërlidhur, sepse mbart dhe përcjell mesazhe të ndryshme, jo vetëm ide dhe mendime, por edhe ndjenja, sjellje apo qëndrime. Pra, komunikimi në çdo rast është mendim, ndjenjë dhe sjellje. Këto tri pjesë përbërëse shprehen në forma të ndryshme, herë të qarta dhe të kuptueshme dhe herë në forma të ngatërruara, që kërkojnë shpjegime dhe sqarime për të zbuluar dhe kuptuar mendimet, ndjenjat dhe sjelljet që mbartin, për t’i deshifruar dhe interpretuar këto, për të shmangur kështu, vështirësitë në komunikim dhe keqkuptimet midis subjekteve që komunikojnë.

<sup>65</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2009, f.41.

<sup>66</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, *Si të shkruajmë shqip-baza të shkrimit akademik*, Tiranë, 2012, f.120.

Qenia njerëzore as që mund të përfytyrohet jashtë kompleksit të komunikimeve. Sipas shumë studimeve, rezulton se rreth 75% të ditës e shpenzojmë në komunikim, por kjo është vetëm sasi kohore, që nuk shpreh cilësinë e komunikimeve tona, e cila mund të jetë e diskutueshme. Në mjaft raste mund të lerë për të dëshiruar, të jetë me mangësi apo defekte serioze dhe të bëhet shkak për të ulur efektivitetin e komunikimit, për ta penguar apo shmangur atë nga rrjedha normale. Si shprehje të këtyre shmangieve në komunikim, interpretohen shumë nga mosmarrëveshjet, keqkuptimet, grindjet, situatat e mbarsura me një trysni të theksuar psikike, që shpesh shpërthejnë në konflikte të hapura dhe në skandale, në revolta, në prishjen e marrëdhënieve të prindërve me fëmijët etj.

Përmes komunikimit dhe në situata të ndryshme komunikative shprehen qartë psikika, vetëdija, nënvetëdija dhe personaliteti ynë, mendimet, ndjenjat, sjelljet dhe veprimet tona, shkalla e zhvillimit dhe e formimit të çdo qenieje njerëzore, ndikimet mbi ne dhe ndikimi ynë mbi të tjerët.

Komunikimet tona janë vetë jeta jonë. Ne jemi të përfshirë në qethullin e tyre, qysh kur ngjizemi në barkun e nënës dhe në të gjitha periudhat e jetës. Kudo dhe kurdoherë jemi në komunikim. Komunikojmë me veten, me të tjerët dhe me botën. Komunikojmë me të njohur dhe të panjohur, me grupe dhe organizata të ndryshme, me shtetin dhe institucionet e tij dhe me publikun e gjerë. Pra, komunikojmë parreshtur, ne me të tjerët dhe të tjerët me ne. Padyshim që në këtë komunikim të ndërsjellë jo çdo gjë mund të ecë mirë. Ka dhe do të ketë edhe probleme, ndërlikime apo situata të ndërlikuara, të cilat e vështirësojnë aktin e komunikimit.

Kanale komunikimi si masmedia, janë bërë të modës për të siguruar komunikimin mes anëtarëve të grupeve të ndryshme politike, profesionale, etnike apo të çfarëdolloj natyre qofshin ato. Kështu, replikimi i përgjigjeve, komentimi dhe analizat e ndryshme të ngjarjeve, intervistat, etj. përbëjnë një mjet të rëndësishëm komunikimi mes grupeve të ndryshme sociale ose grupeve të publikut të gjerë. Zhvillimi i masmedias dhe përhapja e organeve të shtypit, si: gazeta, revista, buletinë, etj. ka nxitur mundësinë që lajmi dhe informacioni të përcillen në një mënyrë të shpejtë, por jo gjithnjë cilësore. Duket se, megjithë kalimin e viteve, nuk është fituar sa duhet profesionalizmi, etika dhe përgjegjshmëria që duhet të karakterizojë një grup drejtues serioz, i cili ka në dorë një nga mjetet më efikase të shpërndarjes së lajmit: shtypin.

Po aq të rëndësishme në këtë rol janë dhe mediat elektronike që shtohen në sasi, por jo gjithmonë në cilësi. Shpesh ato përdorin fjalë të mëdha dhe komente të caktuara, që ndikojnë në mënyra të ndryshme në perceptimin e masës apo grupeve sociale që i ndjekin. Ata që flasin me më shumë njerëz njëherësh, siç janë gazetarët dhe analistët, jo gjithmonë shfaqin elokuencë dhe më e keqja nuk i përmbahen një kodi të caktuar etik, shkelja e të cilit rrezikon seriozisht komunikimin e qëndrueshëm me publikun, kësisoj dhe marrëdhëniet sociale.

Si shembull mund të përmendim situatat e shpeshta në kanalet televizive shqiptare ku njerëzit i mbyllin bisadat me shije të hidhur sepse u është ofenduar "partia e zemrës" opo "*lideri* i parapëlqyer", madje ndonjëherë ndodhin edhe grindje mes simpatizantëve të partive të ndryshme. Kështu krijohen divergjenca për faktin se kush duhet të drejtojë, si duhet të vijojë biseda dhe në shumë situata, gjithçka

degjeron në monologje, ku secili thotë atë që mendon duke pretenduar të dëgjohet vetëm fjala e tij, pa respektuar fjalën e tjetrit.

Por thyerjet më të gjithanshme të normës së komunikimit nuk i gjejmë vetëm në deklaratat, bisedat dhe fjalimet dhe emisionet politike, të cilat kanë ndikim jashtëzakonisht të madh në jetën e shqiptarëve, por dhe në gazetatat e përditshme vihet re se thyen përditë normat drejtshkrimore morfologjike dhe sintaksore sikurse ndodh edhe me normat e pikësimit (mungesa apo përdorimi i ‘ë’-së).

E njëjta gjë ndodh dhe në disa prejveprave letrare të cilat blihen gjithnjë e më rrallë dhe rrjedhimisht lexohen më pak, se sa lexohen gazetatat, dëgjohet radioja dhe shikohet televizioni, i cili është bërë institucion me ndikimin më të madh në vetëdijen politike, kulturore dhe gjuhësore të njerëzve. Gjuha e tij, si gjuhë e propagandës, përfaqëson çënime të rënda të kulturës gjuhësore<sup>67</sup>. Këtu është fjala për gjuhën e mbledhjeve, të konferencave, të referateve, të akteve zyrtare, të deklaratave, të bisedave në radio e televizion.

Çdo ditë dhe më shumë kulturën tonë gjuhësore po e çënojnë dhe fjalët e huaja të panevojshme, të cilat po vërshojnë në mënyrë të jashtëzakonshme. Këto fjalë janë të panevojshme, pasi për to, gjuha shqipe ka fjalë shqipe. Kemi të bëjmë me një komunikim të ndërlikuar artificialisht, ku disa nga folësit të lenë përshtypjen se dëshirojnë të duken "të kulturuar" pa marrë në konsideratë se jo të gjithë dëgjuesit mund t'i kuptojnë. Natyrisht, për të ditur të flasësh nuk është e nevojshme të kesh të dhëna të jashtëzakonshme apo prirje mbinatyrore.

Ja disa nga termat e huaj në vend të termave shqip si: *asistova në një miting* (mora pjesë në një takim), *resurset* (burimet), *influençoj* (ndikoj), *indikator* (tregues), *insistoj* (këmbëngul), *stopoj* (ndaloj), *facilitoj* (lehtësoj), *distribucioni e agravuar* (e përkeqësuar), *e pasuportueshme* (e padurueshme), *konfondohe* (ngatërrohem), *konfidoj* (besoj) etj. Shembuj si këta janë ajo çfarë arrita të shënoj gjatë dëgjimit të dy emisioneve televizive shqiptare (*emisione me shikueshmëritë lartë*). Merret me mend sa e gjatë do të kishte qenë lista, nëse do të kisha ndjekur dhe të tjerë...

*Një person, i pajisur me një kompetencë thjesht gjuhësore, "do të shihej si një lloj përbindëshi kulturor". Ky individ do të njihnte mirë rregullat gramatikore të gjuhës, por nuk do të ishte në gjendje të komunikonte, të përcaktonte variantet sociolinguistike më të përshtatshme për një situatë të caktuar (Giglioli, 1987).*

Të folurit merr karakter publik në komunikimin në masmedia, përmes mjeteve të kulturës dhe të propagandës, përmes radios, televizionit, shtypit, me veçoritë e ndikimit dhe të efektit të këtyre mjeteve në masën e njerëzve.

Fjala ka qenë gjithmonë nxitëse e madhe për të gjitha veprimet e jashtëzakonshme. Të gjithë udhëheqësit e mëdhenj kanë pasur nevojë për fjalën. Për të treguar rëndësinë e madhe të fjalës, do të mjaftonte t'i hidhnim një sy listës së shpikjeve të kohëve të fundit, e do të bindeshim se pothuaj të gjitha i janë kushtuar fjalës, ruajtjes dhe përhapjes së saj. Kush do të mund të mendonte, vetëm tridhjetë vjet më parë, se një fjalë do të mund t'i rrotullohej globit për disa sekonda e të shkonte në të gjithë veshët e botës?

<sup>67</sup>R. Qosja, *Fjalor demokratik*, TOENA, Tiranë, 1997.

Por fjala nuk është e njëjtë për të gjithë. Prifti nuk duhet të flasë siç flet avokati. Edhe kandidati politik, duhet ta ndryshojë mënyrën e tij të folurit, kur bëhet deputet dhe akoma më shumë kur zgjidhet ministër. Nëse nuk ndodh kështu, atëherë do të kemi një shmangie nga normat e komunikimit, që përcaktohen nga rolet që ndërmarrin njerëzit. Çdo kategori shoqërore ka tipin e vet karakteristik të elokuencës, për faktin e thjeshtë se çdo kategori shoqërore i drejtohet një grupi të ndryshëm dëgjuesish.

Duket se e tërë ekzistenca jonë rrëshqet mbi rrotat monotone të temave të detyrueshme (moti, politika, situata ndërkombëtare, mbarëvajtja e punëve, thashetheme të zakonshme). Sekretin për të ditur të bisedosh dhe t'u përmbahesh normave të komunikimit qëndron në atë, që të mos dukesh as "kokë e madhe", as tepër banal apo mendjelehtë.

## II.5. “Flukset e padukshme” si përçuese të së resë në ligjërim

Media ka aq ndikim të madh në jetën e njeriut në ditët e sotme sa që kufiri midis realitetit dhe virtualitetit po prishet, madje nganjëherë edhe nuk mund të dallohet. Modelet nëpër revista nuk e kanë fytyrën pa pore, dhe në fakt nuk janë edhe aq të dobëta. Shumica e milionerëve (të paktën në Amerikë), sipas një studimi, nuk jetojnë një jetë super-luksoze siç portretizohen në media. Në fakt, njeriu që tani është më i pasuri në botë, Warren Buffet, i ka dhëmbët e verdhë nga kafeja, dhe jo të bardhë akull siç pretendohet të jetë parametri në shoqërinë e sotme.

Po kështu media luan edhe me gjuhën. Nuk është aspak e rastësishme nëse në një reklamë televizive dëgjojmë gjuhën që përdorin të rinjtë. Ndoshta kjo është mënyra më e mirë për të tërhequr një grup të caktuar konsumatorësh ose për të tërhequr pikërisht ata për të cilët është bërë produkti. Në mes gjuhës së përditshme dhe gjuhës së reklamave ekziston një bashkëveprim, i cili nuk duhet nënvlerësuar dhe që nga njëra anë mund të shprehet që gjuha e reklamave përdor tendenca të gjuhës së përditshme ose nga ana tjetër, e zgjeron gjuhën e përditshme me përdorimin dhe marrjen e teksteve të reklamave në përdorimin e gjuhës së përditshme.

Një shembull konkret për qenien edhe të të dy mundësive është shprehja: “it’s cool man!” prejardhja e së cilës pa dyshim që ka qenë nga gjuha e përditshme (gjuha e të rinjve), por pas përdorimit të kësaj fjalie në një reklamë, nxiti një valë të re kulturore dhe me këtë në gjuhën e përditshme mori një drejtim të veçantë. Megjithë përpjekjet, që gjuha e reklamave t'i qëndrojë sa më afër asaj të përditshmes, përsëri gjuha e reklamave është artificiale dhe nuk përmban një realitet të të folurit, por është formuar për të krijuar efekt. Nga ana tjetër ajo i qëndron afër gjuhës së folur.

Por, qëllimi kryesor që një person bën në tekstin e një reklame është koncepti i mesazhit. Mesazhi duhet patjetër të ketë një efekt bindës, me qëllim që të mos e humbë qëllimin e tij. Është detyra e konceptimit që të gjitha argumentet, informacionet, thirrjet e ndryshme dhe fjalimet t'i ngushtojë në atë mënyrë që qëllimi kryesor i informacionit të dërgohet deri të grupi qëllimor (target group). Mbi grupin qëllimor duhet të kemi të gjitha informacionet e mundshme, para se të fillojmë ta punojmë konceptin. E gjuha është mjeti më i fuqishëm për të arritur bindjen te njerëzit. Po përmendim disa nga reklamat më të dëgjura kohët e fundit në Shqipëri,

të tejmbushura me shembuj huazimesh apo përdorimesh të gjuhës së huaj edhe në rastet kur nuk është e nevojshme.

*Vodafone Club, pay the 1<sup>st</sup>* (Vodafon, paguaj vetëm të parën) “*Le të vazhdojë festa me supër ofertën e Vodafone Club* (vodafon kllëb). Paguani vetëm të parën e gjithçkaje çdo ditë dhe flisni e dërgoni sms e mms falas në Vodafone Club. Gjithashtu, *përfitoni deri në 5 minuta kombëtare dhe 1800 mb (megabajt) internet falas në muaj. Telefoni në 131 për të blerë paketën mujore prej 700 lekësh. Vodafone Club, komuniteti numër një në Shqipëri. Vodafone, power to you* (pauwr tu ju).

Rimbush elektronikisht, bonus, shërbimi e top up (i top ap), telefonata pa limit, planet e reja me kontratë, ju ofrojnë opsione të ndryshme, paketa me megabitë (megabajt) për navigim në internet, oferta Vodafone tune me (tjun mi), that’s ok (dhets okej),

Dhe, si për çudi, në një nga reklamën e kompanisë së telefonisë celulare Vodafon, gjithçka jepet me titra në gjuhën angleze: *Vodafone Voice message. Send a voice sms. Make the most of now.* Fjalë e shprehje të tjera që të vrasin veshin, ndërsa dëgjon reklama të tjera të kësaj kompanie janë: *Rimbush elektronikisht, bonus, shërbimi e top up (i top ap), telefonata pa limit, planet e reja me kontratë, ju ofrojnë opsione të ndryshme, paketa me megabit (megabajt) për navigim në internet, oferta Vodafone tune me* (tjun mi), *that’s ok* (dhets okej).

E njëjta gjë ndodh në reklamën e kompanisë tjetër celulare *Eagle Mobile* (igëll mobajll) shfaqet vetëm aktori i njohur James Belushi duke folur anglisht, pavarësisht se gjithçka që ai thotë përkthehet me titra në shqip. Shumëkush pyet: *Përse duhet të informohemi në një reklamë në gjuhën angleze ndërkohë që kemi gjuhën tonë shqipe?* Përgjigja është: sepse jemi në udhëtimin drejt Evropës, jemi në “moshën e interentit”, jemi duke u “abdejtuar” e duke u njohur me tërejtat e asaj që kaq shumë e kemi pritur e dëshiruar, ndoshta, edhe pa e ditur se sa do të na kushtonte kjo kulturalisht e gjuhësisht. Përfshirja në rrjedhat e sotme të zhvillimit e të evropianizimit, d.m.th. të globalizmit, do të thotë edhe të “pagush një haraç” jo të lehtë dhe të përhershëm.

Në botën e *What’s up* përfitoni internet dhe zlango falas. Për të aktivizuar ofertën, hyr në *AMC easy* (izi). *What’s up*, çdo gjë është e mundur.

Fjalë dhe shprehje të tjera nga AMC janë: Thuaje fort me *What’s up* supër splash (*uats ap supër splash*). *What’s up, the youth too* (dhë juth tu).

Në një reklamë tjetër, të një dyqani muzikor, përmenden edhe huazime nga bota e kompjuterit, të cilat mund të përdoren pa problem, pasi ato nuk ekzistojnë në gjuhën shqipe: *Music shop*, ju ofron muzikë shqip dhe të huaj në audio dhe në DVD disqe, *usb* (ju es bi), karta memorie, pjesë për *play station* (pllei stejshën). Gjithashtu bën edhe montimin e kartelave për *play station*.

Ja edhe një reklamë e ujit të Pejës: *Don Aqua*, ujë i freskët i Pejës. *Gjithkush don aqua* (me kuptimin: gjithkush do ujë). Këtu është bërë një përzjerje e gjuhës shqipe me gjuhën italiane.

Por jo vetëm në televizion apo në radio mund të ndeshemi me të lartpërmendurat, por edhe në shkrime në gazeta e revista, ligjërimi e kumtime, ku përdoren shumë fjalë të huaja të panevojshme, sidomos anglicizma, ose formime nga fjalë të huaja, por të panevojshme, për të thënë gjëra të zakonshme e kur shqipja i ka mjetet e saj të shprehjes. Prandaj, duken edhe të habitshme e deri diku të pakuptueshme nga brezi i tretë. Ja disa shembuj:

- *divizioni* i shpërndarjes së energjisë elektrike;
- shkelin *kondicionet* e sigurisë;

- drejtues të shtetit që *janë investuar direkt* në arrestimin e tij;
- *autoritetet sanitare* botërore;
- jam një njeri që *persistoi*;
- skuadra duhet të *performojë*;
- kemi *alokuar* fonde;
- Shqipëria vinte pas dy *shokeve* të forta;
- ndarje *fraxhile* e Kosovës;
- ekonomi në *oshilacione*;
- për ta *agruar* situatën;
- ka një *handikap*; personazhe që janë involvuar;
- një *bestseller*;
- kam qenë *interlokutor*;
- një pjesë e policisë *suportojnë* krimin;
- për *evadimin* e mbetjeve *urbane*;
- rreth 10000 *performues* morën pjesë në paradë;
- ndërhyrjet njerëzore – *aksesorë* në dëmtimin e tubacionit;
- nuk besoj që marrëdhëniet tona të *dipendojnë* nga një bisedë politike;
- qeveria mund të ishte *premierit*; e konsideroj një *defekt gjeneral*; a
- ka *disraport*...;
- vendi më *atraktiv*;
- burime *hidrike*;
- *dekonfliktohem*;
- shërbim *inovativ*;
- kanë *asistuar* punën...;
- *interferojnë* interesat;
- në një *kompeticion*;
- ka *kapacitetet* e duhura për të *certifikuar* situatën në vend;
- kur u *signatua* nga qeveria shqiptare;
- do të njoftoj për *intensionet* e qeverisë;
- *incentiva* që jep qeveria;
- *prohibicion* apo emancipim;
- *opozita* kontestoi;
- *maturimi* i marrëdhënieve;
- Tirana – zonë *e diversifikuar*;
- a do ta pranojë Kosova *secesionin* gjuhësor;
- në *derbin* e kryeqytetit;
- për shkak të *eskalimit* të dhunës;
- *nominohet* kandidatë;
- në anketat e *pollet* që bëhen;
- *mjuzikhollet* do të sjellin diçka të re;
- rrugë*terciare* në Tiranë;
- *presing* i skuadrës;
- *depression* i madh në ekonomi;
- *Komiteti internacional i selektimit*;
- *risku* i moskthimit të thesarit;
- sa e sa punime të tjera ... janë prova *tangibile* të nje personaliteti madhor;
- shifrat janë shumë *irrelevante*;
- në gjithë faktorët *relevantë*;
- në *marginat* e konferencës do të komunikoj me të;
- nuk mund ta bëjmë *target*...;

- ka përgatitur raportin *integral*;
- *radiacioni* i këtyre shpërthimeve ka prekur ...;
- arriti ta *prevenojë* ...;
- jam e *fascinuese* nga...;
- Aleanca po të kishte *akseptuar* ...;
- ligji të *adoptohet* në kushte të reja;
- ndeshja do të jetë *deçizive*;
- do të merren masa *komplementare*;
- takimi synonte një *mediacion* në mes vendeve të botës arabe;
- *recesioni* botëror; sapo u festua...;
- disa *impresione* për këtë; për të *suportuar* këtë kërkesë në rritje;
- qytetërim *vulnerabël*; ka rëndësi *aparenca*; linja e *interkoneksionit*...;
- ambasadorët dhe vendet *respektive*;
- marrëdhëniet *bilaterale*;
- për të *gjeneruar kontributet*;
- është *gjeneroz*;
- ka punonjës *abuzivë*;
- *vaniteti* i disa qarqeve politike;
- *prezentatori* i mirënjohur; *ripublikimet* më luajale;
- i kemi qëndruar *opsionit*; nuk ka *aset*;
- ka *inkompatibilitet*;
- t'i japë *suport* industrisë;
- ky fjalor është *induktuar* nga...;
- *prezantimi* i *performancës*, i cili duhet të jetë *kompatibël*;
- shoqëria të *absorbojë*;
- është *kondicionuar* nga shumë *suporte*;
- për të dhënë *definicion*;
- për të dhënë *previzionin*;
- për ta shprehur *nominalisht*;
- nuk do të bjerë në *dipendencë*;
- lider *okult*;
- *kredo* politike;
- *fundamental* për afrimin e Shqipërisë ...;
- (doni muzikë) *laiv apo plejbek*.

Pra, duke pasur parasysh që jo të gjithë shqiptarët dinë të flasin anglisht, (sepse nuk është e domosdoshme), më duket e palogjikshme që progamet televizive të kenë tituj në gjuhën angleze. Dhe, gjithashtu, më duket e palogjikshme që intelektualët përdorin fjalë angleze në një kohë kur të gjitha fjalët e përdorura, si ato më lart, mund të përkthehen në gjuhën shqipe, pa asnjë vështirësi, në mënyrë që të gjithë shqiptarët t'i kuptojnë. E për të ruajtur “shëndetin” e gjuhës, mjetet e informimit masiv dhe gazetarët duhet të ndërgjegjësohen të përdorin sa më shumë fjalë shqipe. Duhet pasur frikë nga fjala e huaj, sepse duke u përdorur shpesh, ajo ka shumë gjasa të futet në gjuhë.

Gjuha është pasqyrë e edukatës, e koncepteve dhe e moralit të një shoqërie, të një mjedisi të saj, por edhe e çdo individi të veçantë që e përdor gjuhën kombëtare.

Shoqëria njerëzore po zhvillohet me hapa të shpejtë. Dita-ditës jemi dëshmitarë të ndryshimeve, që po pëson shoqëria jo vetëm në mendësi, nga ana kulturore, ekonomiko-shoqërore, por këto ndryshime po pasqyrohen dukshëm edhe në përdorimin e gjuhës sonë.

Gjithnjë njeriu ka ndjerë nevojën për të jetuar në bashkësi, prandaj, për të komunikuar, për të shprehur mendimet e tij, ndjenjat, opinionet, pikëpamjet etj., përdor gjuhën. Por, duhet thënë që zhvillimet teknologjike kanë bërë të mundur finalizimin e komunikimit në largësi, që e motivoi njeriun të zbulojë sistemekomunikimi të ndryshme nga i tij dhe që sot janë pjesë e rëndësishme e çdo shoqërie të organizuar e moderne.

Zhvillimi i teknologjisë së përparuar, mësimi i gjuhëve të huaja, përdorimi në masë i kompjuterit, televizionit, telefonisë celulare, postës elektronike etj (pra, të gjitha “flukset e dukshme e të padukshme”), po ndikojnë drejtpërdrejt në pasurimin dhe, në të njëjtën kohë, në “shtrembërimin” e gjuhës sonë kombëtare.

Leximi i librave ka kaluar në plan të dytë, për të mos thënë që tashmë shumë rrallë mund të shikosh apo dëgjosh të rinjtë të shprehin kënaqësinë e të lexuarit të një libri artistik. Përkundrazi, tani çdo gjë merret e gatshme nga televizioni, interneti, radioja etj.

Vetë termat “flukse të dukshme” e “të padukshme” duket se janë në një dinamizëm, ecuri e ndryshueshmëri të vazhdueshme, pasi me kohë vetë shoqëritë njerëzore ndryshojnë: ndryshojnë kushtet në të cilat ato ndërveprojnë, ndryshojnë rrethanat etj, dhe, kësaj dhe gjuha ndryshon bashkë me to. Ende midis tyre mund të përdorim një lloj kufiri, për sa i përket vendeve ku ato zhvillohen e gjallërohen. Tek “flukset e dukshme” sikundër është thënë, klasifikohen: pazaret, shkollat e bibliotekat, teatrot, kinematë, diskotekat e gjuha që haset në to, ndërsa në flukset e padukshme klasifikohen: radioja, teleksi, televizioni, faksi, e-maili, internet, gazetatat, revistat, librat etj.

Me të drejtë shumë gjuhëtarë i qëndrojnë besnikë faktit *se fjala duhet të përpunohet para se ajo të hyjë në standardin dhe përdorimin e gjerë të gjuhës*. Por vetë gjuha, duke qenë dinamike dhe shpeshherë e përdorur me subjektivizëm nga përdoruesit e saj, mbushet e përmbytet nga fjalë apo elemente gjuhësore, që hyjnë pikërisht nga flukset e padukshme. Tani nuk është vetëm gjuha e letërsisë artistike, teatri dhe filmi, por dhe radio-televizioni, organet e shtypit. Media është sot pa asnjë dyshim një nga ndikueset më të mëdha në gjuhë. Shqetësim i mjaft gjuhëtarëve është shpërdorimi që bëhet këtu me të drejtë e botimit të artikujve ku shpeshherë shtrembërohet standardi dhe, për rrjedhojë, dilet në një lloj keqinformimi gjuhësor të lexuesve.

*Prej shumë vjetësh- thekson Gj. Shkurtaj- dhe ne kemi shprehur shqetësimin e ligjshëm mbi gjuhën e mediave. Gazetarët, punonjësit e medias në përgjithësi, kur flasim apo kur shkruajnë, përveç punës si gazetarë ata kryejnë dhe një rol tjetër shumë të rëndësishëm, atë të mësuesit të gjuhës shqipe. Atëherë, si duhet ta shohim në këtë fakt si pozitiv apo negativ? Televizioni dhe radioja si elementë të fluksit të padukshëm si duhen parë?*<sup>68</sup>

Përveç aspektit edukativ dhe informues, ku media paraqet dukuri, fenomene, kultura të caktuara, të dhëna historike etj, ajo bën të mundur pasurimin e secilit prej nesh duke marrë më shumë njohuri dhe dije nga ambjenti ku ne jetojmë e bota që na rrethon. Nga ana tjetër, media ka karakterin zbavitës duke pasur vërtetë një ndikim të jashtëzakonshëm tek anëtarët e një bashkësie gjuhësore. Një spektakël televiziv, një film, një koncert apo një dramë, një debat apo një shfaqje kuiz bën që ne të

<sup>68</sup>Gjovalin Shkurtaj, *Sociolinguistika e Shqipes*, Tiranë, 2009, f. 41-44

qëndrojmë të lidhur pas saj si shenjë e marrjes së një kënaqësie dhe përjetimi emocionesh të veçanta. Kështu, parë në këtë prizëm, ato mund të shihen si mjaft pozitive, pasi realizimi i mesazheve të tyre përdor gjuhën, duke bërë që vetë ne të gjendemi brenda saj e ta përdorim atë si mjet të rëndësishëm.

Televizioni e radioja, nëpërmjet një gjuhe të përpunuar, synojnë të arrijnë objektivat e tyre dhe janë konkurrese të njëra-tjetrës, duke afirmuar sukseset e tyre në anën publicitare nëpërmjet reklamave.

Por, nga ana tjetër, nga një vend në një tjetër, dhe ndikimet e tyre janë nga më të ndryshmet. Çfarë mund të thuhet sot në mjediset shqiptare mediatike? Në garën për të qenë të parat ato shpesh përdorin shumë fjalë të huaja si “shenjë e inovacionit”, e futjes të së resë, modernes, asaj që përbën bashkëkohoren. Por, në secilin rast të tillë, përveç synimit për të pasuruar, ato sjellin dhe shtrembërime dhe çorientim gjuhësor, pasi ndjekësit e tyre jo rrallëherë e gjejnë veten mes mëdyshtesh dhe pakuptueshmërisë.

Për më tepër në kushtet e shoqërisë së lire, por dhe kalimit të viteve disi të vështira ekonomikisht shpesh vihet në pikëpyetje cilësia e tyre tek realizimet apo punonjës të caktuar mediatik që nuk kanë kualifikimet e duhura për të kryer një rol të tillë. Ata nuk janë gjithmonë të kualifikuar me një diplomë të gazetarisë apo të paktën të një dege shoqërore. Pozitat financiare të një radioje, gazete apo televizioni të caktuar nuk favorizojnë shumë përzgjedhjen e njerëzve të duhur në ushtrimin e aktivitetit të tyre. Plus faktit që vështirë se shihet qartë censurimi i gjuhës së përdorur si e papërshtatshme nga ana e tyre.

Pavarësisht nga fakti se media është më e thjeshtë për të pasur një audiencë të lartë, ajo nuk vepron njësoj si letërsia artistike e shkruar, e cila nxit dhe fantazinë e lexuesit duke zhvilluar më me përparësi kompetecën gjuhësore të tij. Larmia e fjalëve dhe e kombinimeve të tjera gjuhësore mbetet më mbrapa.

Kështu, mund të flitet për një ndikim të dyfishtë nga televizioni dhe radioja tek ne dhe nëgjuhëtonë. Krahas rolit edukativ, informues dhe zbavitës, media ndihmon duke e mbajtur gjuhën gjallë dhe duke e pasuruar atë, por, nga ana tjetër ajo nuk do parë si burim i vetëm në ndikimin në gjuhë, për faktin se atomund të përfaqësohen ndonjëherë me një gjuhë të kultivuar mirë, me huazime të tepërta e fjalë të huaja, por edhe me një gjuhë e cila me raste duhejredaktuar.

Të ndërgjegjshëm për këtë ndikim, gjuhës duhet t'i lëmë hapësirë dhe drejt flukseve të tjera të dukshme dhe të padukshme. Sipas prof. Shkurtajt “*sektori i shërbimeve, i cili vë në lëvizje grupe të mëdha njerëzish, zhvendos kufirin e klasave shoqërore dhe, duke lëvizur personat dhe klasat, lëviz më fuqishëm se kurrë dhe gjuhën*”. Sot, shihet qartë që lëvizjet demografike të popullsisë dhe motorët e zhvillimit social ekonomik janë të ndryshëm me ato të disa dhjetëra viteve më parë. Nevojat dhe ndryshimet e vazhdueshme të anëtarëve të bashkësisë shoqërore sjellin lëvizje e shndërrime të shumta gjuhësore.

Në kohën kur termat fshat apo qytet nuk përbëjnë më dy vende përkatësisht me dy grupime të ndryshme gjuhësore bëhet ende edhe më e qartë situata e ‘hibridëve të çuditshëm’ gjuhësorë dhe kulturorë. Ndër këto ndikime e të tjera radioja dhe televizioni të shtrira gjithandej e kudo në territorin e Shqipërisë janë e do të vazhdojnë

të jenë përçuese të pandërprera të mënyrës së funksionimit e përdorimit gjuhësor. Mbetet që mjeshtërit e gjuhës të thonë përherë fjalën e tyre.

## **II.6. Roli i shkollës dhe i librit në kultivimin e gjuhës shqipe letrare**

Në çdo bashkësi shoqërore, që synon të ketë përparim dhe jetë të denjë për pjesëtarët e saj, detyrë e dorës së parë është përgatitja e gjithanshme e njerëzve të formuar mirë, me kulturë e dituri të shumta, të aftë dhe të gatshëm për t'i vënë ato në shërbim gjatë veprimtarisë së tyre. Plotësimi të kësaj detyre i shërben tërë puna arsimore e programuar që bëhet në shkollë dhe jashtë saj nga institucionet shkollore, familja dhe krejt bashkësia shoqërore përkatëse. Kuptohet se në këtë mes një vend të posaçëm ka edukimi i breznive të reja të kombit tonë me dashurinë për gjuhën amtare dhe me aftësinë për ta përdorur drejt tërë pasurinë e saj.

Gjuha është një nga arritjet më të mëdha të forcës krijuese të popullit, në të cilën shprehet thelbi dhe thellësia e jetës së tij; ajo është mbartëse e diturive, ideve dhe ndjenjave nga një brez njerëzor tek tjetri. Edhe në bashkësinë shoqërore shqiptare, pavarësisht nga pengesat dhe ngërçet që kanë prodhuar në rrjedhë të moteve, nga njëra anë, analfabetizmi shumëshekullor e gati masiv dhe, nga ana tjetër, trysnia gjuhëve të huaja të pushtuesve, shqipja ka shërbyer dhe shërben si mjet i shprehjes së kulturës së shqiptarëve, si mjet dhe armë e përhapjes së ideve, si mjeti kryesor për shprehjen dhe zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare dhe, në kohët më të reja, si baza e nisjes për krejt praktikën shtetërore e publike me karakter zyrtar, për të gjitha mediat dhe si gjuhë e folur e mbarë shqiptarëve.

Gjuha është në të njëjtën kohë edhe mjet arsimimi, mjet edukimi, prandaj në programet shkollore të vendit tonë, si në ciklin e ulët ashtu edhe në të lartin, lënda e gjuhës zë vend kryesor. Madje, për fat të mirë, kjo praktikë zbatohet prej kohësh njësoj edhe në hapësirat shqiptare jashtë kufijve shtetërorë të Republikës së Shqipërisë, në shkollat shqiptare të Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Nuk kanë munguar edhe sprovat e përpjekjet për ta nxënë gjuhën shqipe me programe të rregullta shkollore edhe në diasporën arbëreshe të Italisë, si dhe në disa prej diasporave shqiptare më të reja, si në Suedi, Zvicër etj.

Mirëpo fëmija fillon të shkojë në shkollë në moshën 6- vjeçare, që do të thotë se, derisa të arrijë në moshën shkollore, është detyrë e familjes dhe e institucioneve parashkollore përkatëse (d. m. th. e çerdheve, kopshteve, shtëpive të fëmijës) që të krijojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e të folurit të tij. Përvoja tregon se në atë periudhë prindët dhe edukatorët janë të shqetësuar për mirërritjen dhe të ushqyerit e fëmijës (dhe bëjnë shumë mirë), por është e domosdoshme të theksohet se fëmija ka nevojë po aq shumë edhe për ushqim shoqëror e gjuhësor: për t'i folur sa më shumë e sa më bukur, për ta ushqyer me këngë e rrëfime të përshtatshme, për t'i dhënë kështu drejtimin dhe kahun e mbarë të formimit gjuhësor.

Për fat të keq, këtë ushqim shpirtëror, kulturor dhe përgjithësisht formues të fëmijës, ende nuk e kemi shumë merak. Kjo është një e metë e madhe e punës së prindëve dhe e institucioneve parashkollore publike ose private, të cilat ndonjëherë e harrojnë ose e nënvlerësojnë faktin se, që nga mosha më e njomë, është e domosdoshme të komunikohet me fëmijën, gjithmonë, në gjuhë të pastër dhe të qartë,

mundësisht sa më të atillë që të shkojë nga standardi, me qëllim që kështu t'i jepet atij modeli i të folurit.

Sigurisht që këtu dalin një varg problemesh me karakter psikologjik, sociologjik dhe gjuhësor të cilat duhet të njihen mirë dhe të zbatohen nga prindët, edukatorët dhe nga e gjithë bashkësia jonë shoqërore, në qoftë se duam ta përsheptomë dhe t'i prijimë së mbari përvetësimit të gjuhës amtare nga brezi ynë i ri me tërë bukurinë, hijeshinë dhe larinë e saj.

Studimi i të folurit të fëmijëve ka rëndësi për një varg disiplinash shkencore si për gjuhësinë, sociologjinë, psikologjinë, antropologjinë kulturore etj., po në shkallën më të lartë paraqet interes për pedagogjinë dhe planifikimin kulturor e dituror të një vendi, sepse njohja e ligjeve të zhvillimit të gjuhës tek fëmija shërben si bazë për udhëheqjen e këtij zhvillimi në moshën parashkollore dhe shkollore.

Shkolla sot më shumë se kurrë luan dhe duhet të luajë rolin e një mjedisi shoqëror e gjuhësor institucional ku punohet me brezin e ri jo vetëm në drejtim të përvetësimit të dijeve, të personalitetit, por edhe të aftësive e shprehive komunikuese në shqipen standarde, pasi duhen kapërcyer kufijtë e dialekteve që të kemi një gjuhë që t'u shërbejë të gjithëve, siç kanë thënë gjuhëtarët tanë me emër, një gjuhë që të jetë simbol bashkimi mes shqiptarëve kudo ku janë. Realiteti shkollor sot është paksa i hidhur për arsye se aty takohen individë që vijnë nga mjedise me nivele të ndryshme kulturore, sociale e arsimore, gjë që krijon një polaritet në klasë, i cili reflektohet edhe në modelet gjuhësore që fliten.

Zbutja e këtyre mospërputhjeve kulturore-arsimore-gjuhësore është një arsye më tepër pse institucioni i shkollës dhe strukturat përgjegjëse më të larta duhet të mendojnë seriozisht në drejtim të përmirësimit të programeve, shpërndarjes së ngarkesës, metodologjisë së mësimdhënies, punës për vetëdijen gjuhësore dhe veçanërisht cilësisë së teksteve dhe librave me të cilët punohet. Në këtë drejtim duhet bërë kujdes me pseudopërkthyesit e kohëve tëfundit, të cilët jo vetëm tingëllojnë të paqartë, por edhe bëhen mbartës të një kulture të dëmshme gjuhësore, duke ofruar modele të huaja, të papërpunuara në shqip.

Le të hedhim vështrimin e të frymëzohet secili prej nesh sado pak në krijimtarinë e pasur të Ismail Kadaresë, D. Agollit, të mos mohohet veprimtaria e kontributi i brezave të studiuesve të mëparshëm, por të merren ata si modele. Shkolla dhe shteti kanë për detyrë që fëmijët të mësojnë mirë, t'u japin libra të mirë, gramatika të mira, të ketë mësues të mirë, por vetëm kjo nuk mjafton; *duhet që e gjithë shoqëria të jetë në këtë tryzni, pra të kujdesemi për gjuhën edhe në strukturat që nuk janë shtetërore.*

Shteti, ndërkaq, duhet të luajë rolin e vet. Institucionet publike, qofshin shtetërore ose joshtetërore, përdërisa janë të lejuara nga shteti, kanë për detyrë të respektojnë normat e gjuhës standarde. Ajo çka thuhet mund të jetë private, personale, që i intereson vetëm një grupi a një personi, kurse mënyra sesi thuhet një gjë me karakter publik nuk është personale; *gjuha është e shoqërisë shqiptare, e kulturës shqiptare, e traditës shqiptare.*

Është çasti kur veçanërisht ne mësuesit e pedagogët e fushës se gjuhësisë nuk duhet të heshtim përballë një dukurie të tillë. Le të japim ndihmesën tonë në funksion të mbrojtjes së institucionalizuar të shqipes që të krenohemi nesër me brezat që do të vijnë.

Mësuesi është modeli më i mirë dhe më i përshtatshëm për t'u imituar e ndjekur nga nxënësit. Tradicionalisht qëkur ka lindur shkolla, nxënësi e konsideron gjuhën e mësuesit si më cilësore dhe më të pranueshme për nivele akademike dhe mundohet ta imitojë, herë në mënyrë të vetëdijshme, herë në mënyrë të pavetëdijshme. Prandaj, mësuesit duhet ta ruajnë gjuhën nga barbarizmat, të cilat janë *“fjalë ose shprehje e huazuar pa nevojë nga një gjuhë tjetër”*<sup>69</sup>, ose si i quan prof. dr. Aleksandër Xhuvani : *“Të folme të marra nga gjuhë të huaja dhe të përdorura nga një gjuhë pa ndonjë nevojë të madhe.”*<sup>70</sup>

Kjo kërkon që mësuesi duhet të njohë mirë kulturën e gjuhës, e cila nuk përfshin vetëm njohjen e normave gramatikore, drejtshqiptimore e drejtshkrimore, por edhe normën fjalësore (leksikore) e stilistikore, pra ta zgjedhë h e ta pë rzgjedhë sh fjalen, shprehjen etj. Pë r thë nien teë de. Mësuesi evropian duhet të dijë mirë edhe së paku një gjuhë të huaj. Kjo e mundëson atë të modifikojë njohuritë në të dy gjuhët, të japë një përkthim të saktë të fjalëve të huaja dhe të përdori njesitë e duhura gjuhësore për të shprehur idenë e kërkuar.

Mësuesi duhet të punojë vazhdimisht për zhvillimin e tij profesional. Kjo duhet të fillojë, së pari, me zhvillimin e tij si përdorues dhe mbrojtës i gjuhës amtare. Ka shumë burime literature që mund të shfrytëzohen si fjalorët shpjegues të gjuhës së sotme shqipe (1954, 1980, 1984, 2002, 2006), fjalori *“Për pastërtinë e gjuhës shqipe”*, fjalorët e sinonimeve të shqipes, fjalorët e posaçëm të degëve të shkencave (terminologjike) të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, të Akademisë Ushtarake etj., **“Fjalor i fjalëve të huaja”** (Prishtinë), **“Fjalor i gjuhës shqipe”** i Mehmet Elezit e shumë fjalorë të tjerë krahinorë të shqipes, **“Gjuha letrare shqipe për të gjithë”**, A. Xhuvani, vepra I, dy revistat **“Gjuha jonë”** (Tiranë), **“Gjuha shqipe”** (Prishtinë), **“Gramatika e gabimeve”** (Shkup) etj.

Mësuesi mund t'i ndihmojë nxënësit të ruajnë dhe zhvillojnë gjuhën amtare, duke u dhënë atyre mesazhe pozitive për vlerat e njohjes mirë të gjuhës së vet, si dhe të një gjuhë tjetër, për vlerat e gjuhëve të huaja të mëdha, por gjithmonë duke mos nënvlerësuar gjuhën amtare për hir të gjuhës së huaj. Disa veprimtari që mund të zhvillohn janë (a) rritja e ndërgjegjësimit të tyre për gjuhën duke bërë hulumtime për fjalë dhe shprehje që përdoren në krahinë, duke i regjistruar ato dhe duke i lidhur me përdorime të ndryshme, si dhe (b) gjetja e fjalëve shqipe në vend të fjalëve të huaja që ata përdorin.

Ndodh shpesh që ata përdorin fjalë të huaja edhe kur fjala shqipe egziston si : *prioritet* =përparësi, *iniciativë-nismë*, *startojnë* – fillojmë, *abdejt*oj -përditesoj, freskoj, rifreskoj; *luku* –pakja, hieshia; *shou* = shfaqje, *leadership*i – udheheqje, *bipartizan* = dypalësh, *resurse* = burime.

Në mjaft raste përdorimi i tepruar i fjalës së huaj e dëmton komunikimin. Lexuesi ose dëgjuesi nuk arrin të kuptojë përse bëhet fjalë, sepse dëmtohet aftësia kumtuese e shprehëse e thënies, dëmtohet qartësia e kuptueshmëria e saj. Shprehje të tilla si : implementimin e ligjit antiduhan ( = zbatimin); kopje libri të dekoruara me ar ( = të zbukuruar ), kur lexuesi “ dekoroj “e lidh me dhënien e dekoratave; monedhat

<sup>69</sup> GA, *Fjalori i Gjuhës se Sotme Shqipe*, Tiranë, 1980, f. 100.

<sup>70</sup> Prof. Aleksandër Xhuvani, *Mbi thjeshtësinë e gjuhës*, “Norma Letrare Kombëtare dhe Kultura e Gjuhës”, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, (Tiranë, 1973), I, f. 44.

janë konservuar (= ruajtur), konservimin e lidhim me peshkun, mishin etj ; dosje që janë ekzekutuar (=zbatuar), ekzekutimin e lidhin me dënimin e dikujt; çështja do të ketë një solucion (= zgjidhje ), solucionin e lidhim me një tretësirë në kimi etj. Ka mjaft shembuj të tillë si në gjuhën e përditshme, në mjetet e informimit masiv,por edhe në tekste shkollore.

Detyra e mësuesit është të jetë i vëmendshëm gjatë përdorimit të tyre dhe të kërkojë nga nxënësit të shpjegojnë si e kuptojnë atë fjalë, të bëjnë analizën e fjalës, të gjejnë gjegjësen e saj në shqipdhe ta përdorin atë.Nëse kjo bëhet pjesë përbërëse e mësimit,nxënësit dojenë më të vetëdijshëm dhe të kujdeshëm në përdorimin e gjuhës amtare.

Nëpërmjet gjuhës formohen përfytyrimet dhe kuptimet fëmimore; nxënësit mësohen të vëzhgojnë, të krahasojnë dhe të arrijnë në përgjithësime. Pra, të folurit ecën gjithnjë krahas me zhvillimin e të menduarit të fëmijëve. Duke e vështruar punën për përvetësimin e gjuhës amtare si punë të lidhur drejtpërsëdrejti me zhvillimin e të menduarit të nxënësit, duhet pasur parasysh se *“fjala është thënë mirë atëherë kur ajo e shpreh mendimin me besnikëri”*.

Pra, në procesin e përvetësimit të gjuhës nga fëmija, në plan të parë del pasurimi i përmbajtjes së të folurit. Fjalët, trajtat morfologjike, ndërtimet sintaksore përvetësohen me lehtësi në qoftë se përmbajtja e tyre është e qartë dhe reale. Me fjalë të tjera, sistemi i punës për zhvillimin e të folurit të nxënësve mbështetet në teorinë mbi unitetin e gjuhës e të mendimit. Fjala ka një kuptim përgjithësues, prandaj nxënësit, duke mësuar fjalën, njohin edhe objektet e dukuritët që emërton ajo, kështu që pasurimi i fjalorit të tyre është njëherazi pasurim dhe përvetësim i kuptimeve dhe koncepteve të reja. *Kjo është arsyeja që aftësia e të menduarit të drejtë është e lidhur ngushtë me aftësinë e të folurit drejt.*

Duke zhvilluar të folurit, ne zhvillojmë njëherazi edhe të menduarit logjik të nxënësve.Kalimi nga të menduarit konkret, të figurshëm, në të menduar abstrakt tek fëmijët bëhet i mundur vetëm nëpërmjet punës për zhvillimin e të folurit që realizohet mbi bazën e ndijimeve të gjalla (vëzhgimore-dëgjimore). Parimi bazë i punës me të folurit e fëmijëve është uniteti i pandarë i përmbajtjes me formën, për realizimin e të cilit sistemi i punës për zhvillimin e të folurit të nxënësve në ciklin e ulët të shkollës nëntëvjeçare parakupton një lidhje të pashkëputshme midis përvojës jetësore të fëmijëve dhe përmbajtjes së programit mësimor-edukativ, në mënyrë që dijenitë dhe shprehitë e reja të jenë gjithnjë shtysë për zhvillimin e të menduarit të tyre.

Pedagogjia përparimtare e ka vështruar përherë gjuhën amtare jo si një lëndë mësimore të çfarëdoshme, por si mjet sintetik, i cili në shkollën fillore ka si funksion themelor zhvillimin e ndërgjegjes së fëmijëve dhe përgatitjen e tyre për një punë mendore serioze.

Të gjithë pedagogët përparimtarë i njohin shkollës fillore rolin e një zhvillimi të përgjithshëm (sigurisht fillestar) të nxënësve dhe si detyrë themelore përvetësimin dhe zotërimin praktik të gjuhës amtare (me gojë dhe me shkrim.

Gjuha e fëmijëve duhet konsideruar si themeli i formatimit të një personaliteti njerëzor, i cili kalon nga belbëzimi dhe Baby-talk tek përfytyrimi dhe mendimi i përpunuar logjik. Në kohët e reja, gjithandej në botë, po tashmë edhe në mjediset shqiptare, si pasojë e shtimit të stimujve të “ligjërimin elektronik” (lojëra me zëra,

fjalë, tinguj muzikorë etj”, si dhe të filmave vizatimorë që jepen nga kanalet televizive ose me videokaseta a DVD, po vihet re përshpejtimi i zhvillimit të përgjithshëm mendor dhe ligjërimor të fëmijëve.

## II.7. Ndikimi i internetit dhe i rrjeteve sociale në gjuhën shqipe

Duke qenë mjeti ndoshta më i sofistikuar për mbartjen e shpejtë të informacionit dhe korrespondencës, interneti është bërë mjet i pashmangshëm i veprimtarisë së njerëzve të sotëm, ndërsa përhapja dhe shtrirja e tij në rrafshin global ka ndikuar në integrimin e hapësirave komunikuese botërore dhe, si rrjedhim, ka bërë që kontaktet mes gjuhëve të shtohen. Gjuha shqipe është bërë pjesë e kësaj dukurie. Krahas revolucionit që ka shkaktuar në informim, interneti ka nxitur edhe ndryshime domethënëse strukturore në gjuhë, duke krijuar një hapësirë të re virtuale, në të cilën është reflektuar gjithë variacioni gjuhësor i botës reale. “Ky ndikim shkon edhe më tej në krijimin e formave të reja të komunikimeve, të cilat nuk janë të pranishme në botën reale,” - shprehet Shkumbin Munishi në artikullin “Gjuha shqipe dhe interneti”.

Po cilat janë hapësirat e shqipes në internet dhe cili është ndikimi i tij mbi gjuhën shqipe?

Sipas studiuesit Sh. Munishi, dëshmohet se shqipja e ka zënë vendin e saj në Internet. Mjafton të përmendim se Google-i ka futur mundësinë e përkthimeve elektronike për gjuhën shqipe, etj., për të pohuar se çdo ditë po krijohen mundësi dhe lehtësira edhe për përdorimin e shqipes (sikurse edhe të gjuhëve të tjera të botës). Veprimtaritë në internet janë të larmishme, nga *chat-et* (bisedat), *email-i* (posta elektronike), *facebook-u*, lojërat e deri tek mesazhet e çastit. Interneti ka ndikuar në shfaqjen e varieteteve të reja gjeografike e shoqërore të shqipes.

Përveç formës standarde që del në faqet zyrtare, në veprimtaritë e tjera shfaqen kryesisht në trajtë të shkruar të folmet e rastit (të përditshme), të cilat na japin panoramën e plotë të variacioneve të shqipes. Cilat janë disa tipare të komunikimit në Internet?

- Shkurtesat, si: flm (falemnderit); klm (kalofsh mirë); *mkms* (më ka marrë malli shumë); *tkshxh* (të kam shumë xhan) etj.;
- Ndërrim stili në varësi të rëndësisë që i kushton ligjërimin;
- Të folur të shkujdesur - tipik i individit;
- Përpjekje për të riprodhuar plotësisht formën e folur me shkrim, psh: *mir* (mirë); *çar ke?* (çfarë ke?);
- Mungesa e apostrofit dhe e shkronjës së madhe: *skam* të reja, puthe *Gencin*;
- Prirje për ngjitje fjalësh: *pom* duket (po më duket);
- Mungesa e ç dhe ë;
- Përdorimi i pasthirmave për të paraqitur gjendjen emocionale (shpesh shoqërohen me simbole e figura): *hahaha* (të qeshur), *mmmm* (shije e mirë, kënaqësi), *uaaaaa* (habi), *jaaak* (pështirë - nga anglishtja), *uuups* (kur kërkon të kalosh një lapsus a gabim - nga anglishtja)
- Ndryshimi i kodit nga shqipja në gjuhë tjetër (kryesisht në anglisht) ose anasjelltas;

- Shkurtesa anglisht të ngurosura: *ok* (në rregull), *lol* (laughing out loud - qesh me të madhe), *u* (you = ju), *bye/ ciao* (mirupafshim).

- Ja disa nga fjalët e huaja që ndeshen dendur nëpër forume e Chat-e të ndryshme: *ok* (në rregull), *feedback* (reagim), *impakt* (ndikim), *resurse* (burime), *satisfaction* (kënaqësi), *shopping* (blerje), *softuer / sotware*, *ueb / veb*, *e-mail / email/ imejl* (postë elektronike), *networkun / netuorkun / netvorkun* (rrjetin), *download / daunlodoj / daunladova* (shkarkoj), *lukun* (paraqitjen), *beneficioneve* (bamirësi), *definim* (pëcaktim), *elaboron* (përpunon), *lojale* (besnik), *kopirajt*( e drejta e shkrimit).

- Shkurtesa me shkronja e adoleshentëve në internet:

- **Shqip:** *flm-* faleminderit, *flmnsh* - faleminderit shumë, *sps* – s’ka përse, *skgj* – s’ka gjë, *klm* - kalofsh mirë, *klb* - kalo bukur, *gz* – gëzohem, *vpp* - vij pas pak, *psh* - përshëndetje, *nqs* - në qoftë se, *mgjth* – megjithatë, *diç* - diçka, *mgjth* - megjithatë; *mm* - mirëmëngjesi; *msg* - mesazh; *nqs* - në qoftë se; *ps* - poshtëshënim; *sh* - shumë;

- **Anglisht:** *b* - be; *cu* - see you; *lu* - love you; *firtng* - dy javë; *hi* - përshëndetje; *asps* - sa më shpejt të jetë e mundur; *cem* - krim; *ily* - (i love you) etj.

- Shkurtesa me shkronja dhe numra:

- **Shqip:** *1herë* (njëherë), *1jtë* (njëjtë), *1ra* (njëra); *1ri* (njëri); *1soj* (njësoj); *as1* (asnjë), *gjith1* (gjithnjë); *2shim* (dyshim), *2tësor* (dytësor); *3gom* (tregom), *çka ka 3* (çka ka të re); *3këndësh* (trekëndësh); *4or* (katror), *4këndësh* (katërkëndësh); *5imist* (pesimist); *7or* (shtator); *pye8* (pyetet); *bër8* (bërtet), *sh8* (shtet); *universi8* (universitet); *vër8* (vërtetë); *vi8* (vitet); *8ova* (Tetova), ; *9or* (nëntor); *10or* (dhjetor).

- **Anglisht:** *2u* “tu you”; *4 you* “for you; *b4* “bifore”; *b4n* “by for now”; *b4u* “before you”; *f2f* “face to face”; *f2t* “free to talk”; *ly4e* “love you forever”; *m2* “me too”; *m8* :”mate”; *o4u* “only”; *g2g* “got to got; *h2sys* “hop to see you soon; *h8* “hate”; *w8* “wait”

- **Shenjat:** & ose + “edhe”; ççç = “puthje”; .... “vazhdoni”; = “për”; ;) -kur ja bën me sy; :) –buzëqeshje; :D -e qeshur gojë hapur; :-O -e qeshur kur befasohesh ; :P -e qeshur me gjuhën jashtë; (H) -e qeshur e ngrohtë; :ë -e qeshur e nervozuar; :5 -e qeshur konfuze; :\$ -e qeshur e turpshme; :( -e qeshur e pikëlluar; :ë(-qarje; :| -e qeshur zhgënjyese; (A) -engjell; |-) -i pikëlluar; ç-) -i kujtuar.

Interneti ka vlera për faktin se mund të ndihmojë edhe në ruajtjen e varieteteve të rrezikuara të shqipes. Si mjet i komunikimit global ai mund të ndihmojë në afrimin midis folësve arbëreshë dhe arvanitas me botën tjetër shqiptare.

Me gjithë këto role, mund të themi se interneti përbën një risi që duhet vlerësuar, hulumtuar dhe shfrytëzuar me kujdes dhe profesionalizëm në dobi të çështjes gjuhësore dhe formimit tonë.

**Ndikime nga interneti dhe kompjuteri :**

1. *ke kjo foto ke dal sh like* – Në rrjetin e shoqërizimit Facebook, studentët kanë tri opsione kur shohin një foto. Njëra prej këtyre është folja anglisht ‘like’ që do të thotë ‘pëlqej’;
2. *-ti je akoma me disketë-* Duke qenë se disketat nuk përdoren më, qëkur kanë marrë përdorim të gjerë flash-i, CD-ja ose DVD-ja, kjo shprehje përdoret për t’iu referuar dikujt që është me “të vjetrën”
3. *-futi nai refresh* - Komanda ‘refresh’ i jepet kompjuterit kur nuk punon mirë, studentët e përdorin për t’i thënë dikujt se duhet t’i thërrasë mendjes;
4. *hidhe në recycle bin* - Studentët përdorin fjalën anglisht ‘recycle bin’, e cila është një ikonë në desktopin e kompjuterit, në të hidhet çdo dokument që do fshihet nga memoria e tij, me kuptimin: hiqe atë gjë;
5. *të është prishur screen saveri* –me kuptimin: nuk të punon truri, fjala ‘screen saver’ i referohet një programi në kompjuter, i cili vihet në funksion kur kompjuteri i ndezur nuk përdoret dhe në ekran shfaqet një figurë e zgjedhur nga pronari i tij;
6. *të ka rënë në mas laptopi* - kjo shprehje përdoret për t’iu drejtuar dikujt që nuk është në rregull;
7. *e ke mendjen offline* -me kuptimin ‘s’e ke mendjen’, fjala ‘offline’ përdoret kur dikush në facebook nuk do të çatoj (të komunikoj) me miqtë e tij;
8. *e kam hardiskun full osetë është djeg hardisku* - hardisku është një pjesë e njësisë qendrore të kompjuterit;
9. *të ka ikur interneti-* afërsisht me të njëjtin kuptim si shpreja e mësipërme;
10. *bëje shut down (mbylle)*— ‘shut down’ është komanda që i jepet kompjuterit për ta fikur;
11. *nk të punon rami-* ram-i është një nga memoret e kompjuterit;
12. *bëji formatim trurit* – formatimi është një proces që realizohet në kompjuter për të fshirë çdo të dhënë prej tij;
13. *je download* – fjala ‘download’ përdoret në internet për të shkarkuar materiale të ndryshme;
14. *janë bërë copy paste*-këto janë dy komanda që realizohen në një dokument të Microsoft Word-it kur dëshirohet, që i njëjti tekst a figurë të kopjohet dhe transferohet diku tjetër.

**Ndikime nga celulari :**

1. *futi memory card* ose *e ka Memory Card-in 7G* -celuarët e rinj kanë kartë memorie (memory card);
2. *jam bo për PUK* – PUK-u është një nga numrat që vjen bashkë me kartën e telefonit celular;
3. *memory full*—lajmërim në celular që tregon se memoria e tij është plot;
4. *Na e hoqe pinin* (më çmende) ose *Të ka humb pini, futi pukun* —PIN-i është numri sekret i një karte telefoni celular;
5. Një nga kodet sekrete të komunikimit midis një grupi vajzash mbështetëj pikërisht në mënyrën e të shkruarit të mesazheve në celular. Ato u shprehën se i shkruanin mesazhet sipas shkronjave në tastierën e celularit: p.sh. te nr 2 ndodhen shkronjat ABC dhe për të thënë babai:  $2^2 2^1 2^2 4^3$ , për të dhënë shkronjën b, nr. 2 duhet të shtypet dy herë, për të dhënë shkronjën A, ai duhet të shtypet një herë e kështu me radhë për çdo shkronjë.

## II.8. Radio-televizioni dhe organet e shtypit si shtysa integruese

Gjatë Luftës së Dytë Botërore radioja bëhet një mjet i pëlqyer dhe i përparuar propagande, po aq sa edhe një mjet i përhapjes së lajmeve. Pas Luftës së Dytë Botërore, televizori u bë një mjet i rëndësishëm dhe njerëzit menduan se “radioja vdiq”. Ajo u shndërrua në një tjetër mjet komunikimi. Nga një mjet primar, në plan të parë, të cilën njerëzit e dëgjonin në shtëpi, radioja u shndërrua në një shoqëruese të lëvizshme. Radioja zhvilloi muzikën dhe formatet e lajmeve.

Gjithashtu, ajo zhvilloi programe të specializuara për një grup të ngushtë njerëzish dhe, në vend të një audience tëpërgjithshme masive, kaloi tashmë në një mjet të përzgjedhur e të pamungueshëm sidomos në kushte e udhëtimeve të gjata me tren apo edhe me mjete të tjera. P.sh. stacione që u drejtohen vetëm adoleshentëve, programe që transmetojnë muzikën më të ndjekur sot, etj.

Radio në Tiranë lindi më 1938.<sup>71</sup> Studimet tregojnë se ata që lexojnë gazeta të përditshme dëgjojnë rregullisht lajmet e radios, shohin përditë lajmet në televizor dhe gjithashtu lexojnë lajmet e revistave të përjavshme. Kërkesat e sotme të njerëzve, qoftë të atyre që ndjekin televizorin, qoftë të atyre që kanë më për zemër radion, plotësohen nga çdo lloj kombinimi i secilës prej llojeve të medias.<sup>72</sup>

Natyrisht, zhvillimi i mediave, ka qenë i shoqëruar më kujdesin dhe porositë e gjuhëtarëve shqiptarë, nga më të parët, p.sh. akademiku Idriz Ajeti në Kosovë, i cili, shpesh në artikujt e studimet e tij ka kërkuar pikërisht *kujdesin e mjeteve të informimit për gjuhën shqipe*.

Të njëjtën vijë pune e kujdesi kanë shprehur edhe gjuhëtarë të tjerë, duke i kushtuar kulturës së gjuhës në radio e në televizion, përgjithësisht në mediat shqiptare, rreshta të rëndësishëm. *Prej shumë vjetësh - thotë prof Gj. Shkurtaç- dhe ne kemi shprehur shqetësimin e ligjshëm mbi gjuhën e mediave. Gazetarët, punonjësit e medias në përgjithësi, kur flasin apo kur shkruajnë, përveç punës si gazetarë ata kryejnë dhe një rol tjetër shumë të rëndësishëm, atë të mësuesit të gjuhës shqipe. Atëherë, si duhet ta shohim në këtë fakt si pozitiv apo negativ? Televizioni dhe radioja si elemente të fluksit të padukshëm si duhen parë?*

Edhe italianët, ndërkaq, kohët e fundit, më se një herë e kanë shtruar pyetjen programore: “*televizioni është mësues i mirë apo i keq i gjuhës?*”

Përveç aspektit edukativ dhe informues, ku media paraqet dukuri, fenomene, kultura të caktuara, të dhëna historike etj, ajo bën të mundur pasurimin e secilit prej nesh, duke marrë më shumë njohuri dhe dije nga ambjenti ku ne jetojmë e bota që na rrethon. Nga ana tjetër media ka karakterin zbavitës, duke pasur vërtetë një ndikim të jashtëzakonshëm tek anëtarët e një bashkësie gjuhësore. Një spektakël televiziv, një film, një koncert apo një dramë, një debat apo një shfaqje kuiz bën që ne të qëndrojmë të lidhur pas saj si shenjë e marrjes së një kënaqësie dhe përjetimi emocionesh të veçantë. Kështu, parë në këtë prizëm, ato mund të shihen si mjaft pozitive, pasi realizimi i mesazheve të tyre përdor gjuhën duke bërë që vetë ne të gjendemi brenda saj e ta përdorim atë si mjet të rëndësishëm.

Televizioni e radioja nëpërmjet një gjuhë të përpunuar synojnë të arrijnë objektivat e tyre duke u shfaqur konkurruese midis njëra tjetrës e duke afirmuar sukseset e tyre në anën publicitare nëpërmjet reklamave.

<sup>71</sup> Luarasi, I. *Lajmet e transmetuara*. Shkrim dhe raportim. 2000, f. 23

<sup>72</sup> Luarasi, I. *Lajmet e transmetuara*. Shkrim dhe raportim. 2000, f. 49.

Por nga ana tjetër, nga një vend në një tjetër, dhe ndikimet e tyre janë nga më të ndryshmet. Çfarë mund të thuhet sot në mjediset shqiptare mediatike? Në garën për të qenë të parat ato shpesh përdorin shumë fjalë të huaja si shenjë e inovacionit, futjes të së resë, modernes, asaj që përbën bashkëkohoren. Por në secilin rast të tillë ato sjellin përveç synimit për të pasuruar dhe shtrembërime dhe çorientim gjuhësor, pasi ndjekësit e tyre jo rrallëherë e gjejnë veten mes dilemash dhe pakuptueshmërisë.

Për më tepër, në kushtet e shoqërisë së lirë, por dhe kalimit të viteve disi të vështira ekonomikisht shpesh vihet në pikëpyetje cilësia e tyre tek realizimet apo punonjës të caktuar mediatik, që nuk kanë kualifikimet e duhura për të kryer një rol të tillë. Ata nuk janë gjithmonë të kualifikuar me një diplomë të gazetarisë apo të paktën të një dege shoqërore. Pozitat financiare të një radioje, gazete apo televizioni të caktuar nuk favorizojnë shumë përzgjedhjen e njerëzve të duhur në ushtrimin e aktivitetit të tyre. Plus faktit që vështirë se shihet qartë censurimi i gjuhës së përdorur si e papërshtatshme nga ana e tyre.

Pavarësisht faktit se media është më e thjeshtë për të pasur një audiencë të lartë, ajo nuk vepron njësoj si letërsia artistike e shkruar, e cila nxit dhe fantazinë e lexuesit duke zhvilluar më me përparësi kompetecën gjuhësore të tij. Larmia e fjalëve dhe kombinimeve të tjera gjuhësore mbetet po më mbrapa.

Kështu mund të flitet për një ndikim të dyfishtë nga televizioni dhe radioja tek ne dhe gjuha jonë. Krahas rolit edukativ, informues dhe zbavitës, media ndihmon duke e mbajtur gjuhën gjallë dhe pasuruar atë, por nga ana tjetër, ajo nuk do parë si burim i vetëm apo kryesor në ndikim në gjuhë për faktin se ato mund të përfaqësohen jo shpeshherë me një gjuhë të kultivuar mirë, me huazime të tepërta e fjalë të huaja, por edhe me një gjuhë e cila me raste duhet censuruar disi.

Të ndërjegjshëm për këtë ndikim gjuhës duhet t'i lëmë hapësirë dhe drejt flukseve të tjera të dukshme dhe të padukshme, që prekin sidomos *sektorin e shërbimeve, i cili vë në lëvizje grupe të mëdha njerëzish, zhvendos kufirin e klasave shoqërore dhe, duke lëvizur personat dhe klasat, lëviz më fuqishëm se kurrë dhe gjuhën*. Sot, shihet qartë që lëvizjet demografike të popullsisë dhe motorët e zhvillimit social ekonomik janë të ndryshëm me ato të disa dhjetëra viteve më parë. Nevojat dhe ndryshimet e vazhdueshme të anëtarëve të komunitetit sjellin lëvizje e transformime të shumta gjuhësore.

Në kohën kur termat fshat apo qytet nuk përbëjnë më dy vende përkatësisht me dy grupime të ndryshme gjuhësore bëhet ende edhe më e qartë situata e **“hibridëve të çuditshëm”** gjuhësorë dhe kulturorë. Ndër këto ndikime e të tjera radioja dhe televizioni të shtrira gjithandej e kudo në territorin e Shqipërisë janë e do të vazhdojnë të jenë përçuese të pandërprera të mënyrës së funksionimit e përdorimit gjuhësor. Mbetet që mjeshtërit e gjuhës të thonë përherë fjalën e tyre.

Televizori ka një ndikim të fuqishëm në botëkutimin e fëmijëve me anët negative dhe pozitive të tij. Gjatë kontaktit që pata me psikologun e shkollës ku unë punoj, me ofroi një rast që unë do e shqyrtoj më poshtë:

*Rast i analizuar:*

Një nënë dhe fëmija i saj 2-vjeçar paraqiten në klinikën e saj. Nënja ishte e shqetësuar, sepse ndiente se fëmija i saj kishte vështirësi të përqëndrohej kur ajo i lexonte natën. Ajo punonte me orar të zgjatur dhe e linte atë me një dado, e cila, e

mbante gjithmonë televizorin e ndezur. Për më shumë ajo shqetësohej se ajo nuk i kushtonte vëmendje aktivitetit fizik si fëmijët e tjerë.

Koha e shpenzuar përpara TV është humbja e disa aktiviteteve të rëndësishme si, ushtrimet fizike, komunikimit me moshatarët, leximit dhe detyrave. Kjo kohë që humbet nga lindja deri në moshën 5 vjeç nuk mund të kompesohet në vitet pasardhëse.

*Zhvillimi fizik:* Televizori ka qenë drejtpërdrejt i implikuar në epideminë e shtimit të dhjamosjes (majmërisë); fëmijët sa vjen bëhen më pak aktivë, sepse shpenzojnë më shumë kohë me televizor dhe me lodra, duke qenë kryesisht në kushte të palëvizshme dhe shpenzojnë me pak kohë për të luajtur jashtë mjedisit nuk dalin në natyrë e në ajër të pastër, i shmangen sportit dhe punës fizike. Edhe kjo është, pa dyshim, një nga pasojat e globalizimit dhe e rrafshimit kulturor e etnografik nëmbarrë rruzullin e qytetëruar. Shqipëria po pret me padurim të hyjë zyrtarisht në Bashkimin Evropian, porse ajo, ndërkaq, kulturalisht e gjuhësisht ka hyrë dhe është tashmë pjesë e pandashme e saj dhe e krejt globit.

*Zhvillimi i gjuhës:* Për të ndërtuar fjalorin e një fëmije kërkohet përfshirje aktive; këto aftësi përmirësohen në mënyrë të rregullt, edhe pse ritmet ndryshojnë për fëmijë të ndryshëm. Koha pasive e shpenzuar përpara TV merr nga koha e nevojshme që u duhet fëmijeve që të praktikojnë të folurën, të dëgjuarën, dhe të lexuarën në mënyrë që t'i përmirësojnë këto aftësi. Për më shumë, koha e shpenzuar përpara TV u heq fëmijëve takimin e praninë bashkë me njëri-tjetrin për zhvillimin e aftësive të nevojshme sociale.

*Sjellja:* Shumë fëmijë dhe të rinj ende nuk e kanë aftësinë për të bërë dallimin midis jetës reale edhe trillimeve të televizorit. Lidhja midis dhunës në media dhe jetës reale është mjaft e dukshme. Imazhet e dhunës dhe mesazhet ndikojnë mbi fëmijët, duke rritur frikën për botën e jashtme, duke i bërë edhe atë të dhunshëm edhe modele të sjelljeve agresive.

*Performanca në shkollë:* Media ka edhe ndikim pozitiv mbi fëmijët, të lidhur me programet edukative pas shkollës si edhe ato speciale. Tipi i programeve të ndjekura në televizor ka shumë të bëjë me përgatitjen në shkollë. Më shumë ka të bëjë vëmendja që trajnohet, duke pritur gjatë publicitetit zakonisht çdo 7 minuta.

## **II.9. Cilat janë anët pozitive dhe negative të televizionit?**

Televizioni, pa mëdyshje, ushtron ndikim pozitiv dhe negativ në fëmijët e vegjël, por jo vetëm tek ata. Pa dyshim se, qysh nga fillesat e tij, edhe procesi i globalizimit dhe i ndikimeve të ndryshme nga Evropa e Bota, kanë bulëzuar, së pari, nëpërmjet radios e televizionit. Le të kujtojmë, ndër të tjera, rolin e madh ndikues të emisionit shqip në radion “Zëri i Amerikës” në fund të viteve ’90, kur filloi shpërbërja e ish-Jugosllavisë dhe morën udhë proceset demokratike në Shqipëri e më gjerë; rolin e Radio “Vatikanit” për mbajtjen gjallë të fesë në plan botëror dhe për shembjen e kështu me radhë. Edhe Shqipëria e mbyllur, dikur, ndërsa vetë ruhej nga ndikimet e huaja, në Radio-Tirana kishte redaksi që jepnin lajme në të gjitha gjuhëte huaja kryesore dhe kishin si kryetëmë “Zëri i Shqipërisë -Zëri i së vërtetës”.

Sot, për më tepër, krahas radios, kanë marrë përmasa gjigande televizioni, telenovelat, filmat vizatimorë dhe aq shumë emisione reklame e kulture, sigurisht

edhe “*pseudokulture*”, duke krijuar edhe atë tymnjaë që, sikundër e përmendëm, sot në mbarë botën shtron edhe dilemën: ” *Televizioni është mjet i mirë apo i keq?!*”.

Ana pozitive e televizionit mund të jetë ajo argëtuese, natyrisht edhe me elemente edukative, sepse hap dritare të reja informimi për fëmijët, duke u mundësuar atyre për të “udhëtuar” virtualisht edhe atje ku nuk mund të shkohet me mjetet e kushtet e tyre materiale, u mësojnë leximin dhe shkrimin e gjuhës së vet, po edhe gjuhë të tjera, u japin njohuri për dukuritë e natyrës, kulturat e popujve të ndryshëm, të përcjellin emisione të ndryshme edukative, të mësojnë për ato gjëra në të cilat ata nuk kanë qenë pjesëmarrës, për kafshët që nuk i kanë parë etj.

Ana negative, ndërkaq, është e lidhur me modelet dhe sidomos me agresivitetin që mbjellin te fëmijët disa emisione televizive. Studiuesit kanë vënë re se kur fëmijët shikojnë një model agresiv, ata e imitojnë atë, madje mundohen të krijojnë mënyra të reja për të stimuluar sjellje të dhunshme. Por kjo nuk ndodh vetëm te fëmijët. Gjithashtu, është konstatuar se shumë burra, pasi shohin dhunë seksuale në televizor, veprojnë dhunshëm ndaj grave të tyre. Në vitin 1945, në një anketë, *Gallup* i pyeti amerikanët: “*A e dini ç’është televizori?*”, ndërsa sot, dy të tretat e familjeve amerikane kanë më shumë se tre televizorë në shtëpi. Në shtëpitë e zakonshme televizori qëndron i hapur mesatarisht 7 orë në ditë dhe pjestarët e familjës shohin 4 orë në ditë secili.

Gratë shohin televizor më tepër se burrat, fëmijët e vegjël dhe pensionistët shohin më tepër se nxënësit dhe punëtorët, ata më pak të edukuar shohin më shumë se ata më shumë të edukuar. Në shumicën e rasteve këto tipare të amerikanëve karakterizojnë edhe evropianët, japonezët e australianët. Që prej 1994, Studimi Kombëtar mbi Dhunën e Televizionit (1997), ka analizuar rreth njëqind mijë programe nga të gjitha llojet e televizioneve amerikane.

Nga kjo analizë rezultoi se, gjashtë nga dhjetë programme, përmbajnë dhunë. Në fund të shkollës fillore, një fëmijë mesatarisht ka parë rreth 8000 vrasje dhe 100 000 akte të tjera dhune në televizion. Atëherë, më të drejtë, mund të shtrohen edhe pyetjet: A stimulohen sjellje kriminale prej skenave kriminale? Apo, ndoshta, këto skena përthajnë energjinë agresive, duke e konsumuar atë gjatë shikimit? Si ndikon dhuna televizive mbi mendimin dhe sjelljen e shikuesve?

A ndikon bota fantastike e televizionit në shtrembërimin e realitetit të botës? Xhorxh Gebner dhe kolegët e tij të Universitetit të Pensilvanisë, *supozojnë se pikërisht ky është ndikimi më i madh i televizionit. Anketat e tyre me adoleshentët dhe të rriturit tregojnë se ata që shohin më tepër televizion kanë prirje më të madhe se ata që shohin më pak, që të ekzagjerojnë me sasinë e dhunës në botën që i rrethon.*

Një anketë kombëtare, që përfshinte fëmijë amerikanë të moshave nga 7 deri 11 vjeç, zbuloi se *ata që shikonin shumë televizor kishin prirje më të madhe se ata që shikonin më pak televizor, për të pranuar frikën “se një person i keq mund t’u futej në shtëpi”, ose “kur të dilnin jashtë dikush mund t’i dëmtonte”. Ata që shohin shumë filmat dhe emisionet e tjera, ku shfaqet dhunë kriminale, e shohin Nju Jorkun si një vend të rrezikshëm. Ata mendojnë se edhe vetë qyteti i tyre ku jetojnë është një vend i rrezikshëm. Televizori, për çdo vit zëvendëson më shumë orë nga jeta aktive e njerëzve.*

Ndikimet e televizionit mbi sjelljen e njeriut dhe sidomos të të rinjve. A imitohen modelet e dhunshme nga shikuesit? Ka shumë shembuj që njerëzit imitojnë krimet televizive. *Në një anketë të 208 të dënuarve me burgim, 9 nga 10 persona pranuan se kishin mësuar stile të reja kriminale, duke parë skenat e ofruara nëpërmjet televizionit. Po ashtu, 4 nga 10 veta, pranuan se ishin përpjekur t'i vinin në jetë disa nga krimet specifike të para në televizion.*

Një teknikë, e përdorur gjërë me nxënësit, kërkon të dijë nëse e shton agresivitetin e tyre shikimi i televizionit. Në një farë mase kjo ndodh. Sa më e dhunshme është ajo që sheh fëmija, aq më agresiv bëhet edhe ai. Lidhja është e thjeshtë dhe naive në dukje, por një dukuri e tillë është vënë re në SHBA dhe Evropë.

Studiuesit pohojnë se kjo na çon në përfundimin, se një “dietë” me televizion të dhunshëm, është thjeshtë ushqim për agresionin. madje, shumë prej tyre kanë hedhur edhe tezën e kundërt, se fëmijët dhe personat e dhunshëm në përgjithësi, kanë prirje për të parë dhunë televizive. Ose një faktor i tretë, p.sh. zgjuarsia e ulët, bën që disa fëmijë të parapëlqejnë dhunën televizive dhe të sillen dhunshëm.

Kërkuesit kanë krijuar dy mënyra për t'i testuar këto dy shpjegime alternative. Ata testojnë shpjegimin e “faktorit të tretë të fshehur” duke nxjerrë në pah ndikimet e faktorëve të tjerë të mundshëm. Kërkuesi britanik Uiliam Belson studioi 1565 djem nga Londra. *Në krahasim me ata që shihnin pak dhunë në televizion, ata që shihnin shumë dhunë, pranonin se kishin kryer 50% më shumë akte të dhunshëm, në gjashtë muajt e mëparshëm. Ai ekzaminoi 22 faktorë të tjerë të tretë, si p.sh. përmasat e familjes. Por në fund Belson arriti në përfundimin, se njerëzit që shikonin më tepër televizion ishin më tepër të dhunshëm, në krahasim me ata që shikonin më pak.*

Në mënyrë të ngjashme, L. Eron dhe R. Hjusman(1980, 1985) zbuluan se shikimi i dhunës në television, nga ana e 875 fëmijëve 8-vjeçarë, lidhej me agresivitetin e tyre edhe kur shfaqeshin faktorë të tretë të mundshëm. Për më tepër, kur i studiuuan këta individë në moshën 19-vjeçare, ata zbuluan se shikimi i dhunës në moshën 8-vjeçare parashikonte në mënyrë modeste agresivitetin në moshën 19-vjeçare, por agresiviteti në moshën 8-vjeçare nuk parashikonte të parin e dhunës në televizion në moshën 19-vjeçare. Ata i vërtetuan zbulimet e tyre në një studim të mëvonshëm me 758 të rinj të Çikagos dhe 220 finlandezë. Për më tepër, kur Eron dhe Hjusman ekzaminuan dënimet për krime të individëve, që kishin studiuar në moshën 8-vjeçare, zbuluan se në moshën 30-vjeçare, ata të rritur, që në fëmijëri kishin parë më shumë programe televizive të dhunshme, kishin prirje më të madhe për t'u dënuar për krime të rënda.

Me përhapjen e programeve të dhunshme televizive shtohet edhe numri i vrasjeve. *Në Kanada dhe Shtetet e Bashkuara, niveli i vrasjeve është dyfishuar mes viteve 1954 dhe 1974, krahas me përhapjen e programeve të dhunshme televizive. Në rajone të caktuara, ku televizioni ka shkuar më vonë, edhe vrasjet janë rritur më vonë.* Përfundimi i arritur nga shumica e studiuesve është, se dhuna televizive dhe pornografia nuk janë shkaqet parësore të dhunës shoqërore, ashtu sikur ciklamatet nuk janë shkaku kryesor i kancerit, por dhuna e shfaqur në televizion është një shkaktar për t'u marrë në konsideratë.

Edhe pse vetëm një përbërës në recetën komplekse të dhunës, dhuna televizive duhet (dhe mund) të kontrollohet. Dhuna shoqërore prodhohet nga eksitimi që përftohet prej saj. Eksitimi përçohet. Një tip eksitimi u jep energji eksitimeve të tjera.

Kërkime të tjera tregojnë se shikimi i dhunës nuk të lejon të frenosh. Vëzhgimi i dhunës e nxit shikuesin që të kryejë sjellje të dhunshme, duke aktivizuar mendime që lidhen me dhunën.

Po ashtu, portretizimet në media evokojnë imitimin, i cili është një element kyç në ndikimin e pamjeve televizive tek fëmijët dhe të rinjtë, për të prodhuar dhunë. Industria televizive e reklamave synon që shikuesit të imitojnë atë që shohin. Në shumë raste, të dënuar për krime të rënda pohojnë se janë frymëzuar, apo kanë imituar me përpikmëri aktorët e tyre të preferuar, të cilët kanë bërë të njëjtën vepër në një film. Televizioni mëson sjellje destruktive e sidomos tek fëmijët, të cilët janë shumë të prekshëm nga kjo. Ata janë të gatshëm të imitojnë sjelljet e dhunshme të heronjve të tyre. *Krime, vrasje e vetëvrasje kryhen si pasojë e imitimit të pamjeve televizive.* I tillë është rasti i fëmijës nga një fshat i Lezhës, i cili vari veten në vitin 1996, duke dashur të imitonte të njëjtën sjellje që kishte parë në televizion.

Mënyra se si një individ i interpreton arsyet e veprimit agresiv pas vëzhgimit të tij, ka një efekt të madh në sjelljen agresive të mëvonshme. Kur agresioni paraqitet i justifikuar, ai sjell si pasojë më shumë sjellje të dhunshme në të ardhmen, se sa kur agresioni nuk është i justifikuar tekvëzhguesi. Kur ka një “dietë” të qëndrueshme *media-violence* shikuesi fiton një lloj desensibilizimi, si rrjedhim i të kuptuarit apo njohjes në detaje të një agresioni të tillë.

Mbrojtësit e televizionit pretendojnë shpesh se, nëpërmjet tij, fëmija edukohet dhe se emisionet, ndonse përmbajnë skena dhune, në thelb janë “prosociale”, pasi në të gjithat skenat e dhunshme televizive triumfon i miri, e apo e mira mbi të keqen. Në të vërtetë, fëmija nën 8 vjeç nuk e ndjek dot fabulën e ngjarjeve, që sheh në televizor, por ai tërhiqet vetëm nga skenat spektakolare dhe agresive.

Shpjegimi i efekteve negative të dhunës tek fëmijët ka mjaft rëndësi. Kur dhuna në televizion përfundon pa gjak, pa plagosje, pa dëmtime të mëdha, kur heroi merr plagë të lehta, shikuesi, sidomos fëmija, nuk i sheh pasojat e dhunës. Ndër njerëzit e paformuar, apo tek moshat e reja, pakkush përqendrohet në edukimin nëpërmjet të kundërtës, duke u thelluar në thelbin e filmit apo në triumfin e të mirës kundër të keqes. Niveli kulturor, formimi i varfër edukativ, e bën shikuesin madje të mos dallojnë filmin nga jeta. Vetë periudha e tejjzgatur kalimtare në Shqipëri, e bën më të mprehtë këtë problem, me specifikat e vendit tonë.

Gjetja e programeve të përshatshme është bërë më e thjeshtë, qëkur televizioni i fëmijëve në 1990, kërkoi transmetimin e programeve për fëmijë për rreth 3 orë në javë, ku publiciteti midis tyre ishte i kufizuar. Qëllimi është të udhëzohen prindërit të gjejnë programe të përshatshme për të parë bashkë me fëmijët – ato që nuk janë të dhunshme dhe të cilat forcojnë vlerat familjare.

- TV mund të ndihmojë parashkollorët të mësojnë alfabetin, nxënësit e rinj t'i informojë për botën e kafshëve, dhe prindërit me të rejtat më të fundit. Programet edukative mund të ndihmojnë fëmijët e të gjitha moshave për të zhvilluar aftësinë për të mësuar, ndërsa dokumentarët zhvillojnë mendimin kritik dhe ekspozimin ndaj kulturave të tjera

- Inkurajimi i prindërve për të parë së bashku me fëmijët edhe të ndajnë bashkë vlerat dhe përfitimet. Për shembull, kur një personazh keqtrajtohet ose diskriminohet, prindët mund të shfrytëzojnë mundësinë për t'i edukuar fëmijës rëndësinë e trajtimit të të gjithëve në mënyrë të barabartë.

▪ Mund të shfrytëzohet mundësia për t'u bërë pyetje provokative fëmijëve, duke u mësuar të pyesin edhe të mësojnë nga ajo që shikojnë në TV, nga fjalët që s'kuptojnë, apo kuptimin e tërthortët tyre.

Ata që përgatisin edicionin e lajmeve luftojnë vazhdimisht për të përcaktuar se çfarë ka nevojë dhe çfarë do audienca, si ta shpërndajnë këtë informacion në mënyrën dhe kohën më të mirë. Dëgjuesit dhe shikuesit presin raportime lajmesh të sakta dhe këtë gjë duhet të presin edhe gazetarët nga lajmi i tyre. Dëshira për saktësi duhet të bëhet pjesë e integritetit dhe përgjegjësisë së botës gazetareske.

Organet e shtypit janë bërë pasqyrë e zhvillimeve, duke ndikuar edhe në jetën gjuhësore të shqiptarëve. Por, duhet theksuar se ky ndikim ka pasoja pozitive dhe negative. Nëpërmjet njohjes së mirë të gjuhës shqipe dhe të gramatikës bazë të saj, një gazetar mund të bëhet më i mirë në profesionin e tij. Sistemet e televizionit dixhital e satelitor e kanë shpënë fjalën shqipe në çdo skaj të globit.

Qendrat urbane nuk mund të shihen më si pika përfaqësuese të një dialekti të caktuar. Tani nuk shihen më dallimet qytet-fshat. Gjuha e mediave ka ndikuar që shumica e njerëzve në situata të caktuara ta shmangin dialektin e tyre dhe të përdorin gjuhën letrare dhe kjo si pasojë e ndjekjes në masë të televizionit apo radios, leximit të revistave apo gazetave. *Shumë shqetësuese është gjuha që përdorin mediat ditët e sotme, sepse njerëzit e televizionit luajnë edhe rolin e mësuesit të gjuhës shqipe.*<sup>73</sup>

## II.10. Pasojat gjuhësore dhe shoqërore të reklamave mbi fëmijët

Shpeshherë prindërit e konsiderojnë televizorin si mjetin për të qetësuar dhe pushuar për vete dhe fëmijën, që ka lëvizur shumë gjatë gjithë ditës. Por studimet kanë treguar se kalimi i një kohe të gjatë përpara televizorit mund ta dëmtojë fëmijën. Televizori mund të ketë edhe efekte pozitive në zhvillimin social, emocional dhe mendor të fëmijës, por kur ai shikohet në masën e duhur nga fëmija. *Rekomandimet e specialistëve janë që fëmijët e moshave 2-3 vjeç duhet të shikojnë jo më shumë se 1-2 orë në ditë televizor*<sup>74</sup>.

Shikimi i televizorit pakëson kohën për të mësuar dhe zbuluar gjëra të reja.

Fëmija ka nevojë të ecë, të vrapojë nëpër shtëpi, të vizatojë, këndojë etj, për të zbuluar botën përreth tij. Gjithashtu fëmijët e vegjël kanë nevojë për kohë të lirë, që të mësojnë nëpërmjet lojës, duke zhvilluar imagjinatën e tyre. Nëse çdo moment i lirë do të kalohet përpara televizorit, fëmija nuk do të luajë më dhe nuk do të përparojë në zhvillimin e tij emocional, njohës social.

- *Televizori mëson fëmijët të arrijnë gjithçka në moment dhe pa u lodhur.*
- *Shikimi i televizorit pakëson kohën për lidhje sociale.*
- *Shikimi i televizorit mund të pakësojë veprimtarinë fizike të fëmijës.*

Përvojat e reja, natyrisht, sjellin në rend të ditës edhe domosdoshmëri të reja, qoftë edhe në pedagogjinë familjar, qoftë shkollorë, përderisa kemi mjete të tilla të pamënjanueshme si televizioni. Këshillat modrene janë që t'i jepet mundësi fëmijës të

<sup>73</sup> Shih: Shkurtaj, Gj. *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2009, f. 42 dhe Shkurtaj, Gj. *Kultura e Gjuhës*, Tiranë, 2006, f. 34

<sup>74</sup> Shih: Moisiu, R., Tushe, E. e të tjerë. *Arti i rritjes së fëmijëve sot*, 2005, f. 283.

shikojë programet, që janë për të gjithë familjen. Sigurohuni që fëmija juaj të mos shikojë programe, që shfaqin dhunë, seks dhe gjuhë fyese.

Fëmijët parashkollorë ndikohen më shpejt dhe më tepër nga dhuna e shfaqur në programet televizive, sesa fëmijët më të mëdhenj, sepse ata e kanë më të vështirë të dallojnë fantazinë, përrallën nga e vërteta. Për fat të keq, edhe në përrallat me kartona, të cilat pëlqehen nga fëmijët e vegjël, përsëri ka shumë skena të dhunshme. Prindërit shpesh mendojnë që fëmijët e kuptojnë vetë se përrallat me kartona nuk janë të vërteta. Por nga studimet që janë bërë është kuptuar se përrallat të fëmijët kanë po atë efekt, që kanë telenovelat tek të rriturit.

Po ashtu, këshilla moderne është që prindët t'i shikojnë programet e televizorit së bashku me fëmijën, duke mos lënë atë vetëm para një bote të madhe e që shpesh ka nevojë për shpjegime. *Mos e përdorni televizorin si një kujdestar për fëmijën që të keni mundësi të bëni ndonjë punë tjetër. Mos lejoni që fëmija juaj të shikojë televizor në dhomën e gjumit.*<sup>75</sup>

Shpeshherë krijohet ideja që filmat vizatimorë janë për fëmijët dhe kështu që nuk është aspak gabim lejimi i ndjekjes së tyre nga fëmijët. Por, shumë herë, më kanë bërë përshtypje disa fraza të fëmijëve drejtuar prindërve apo edhe të tjerëve, të marra nga filmat vizatimorë. P.sh. një vajzë e vogël 4-vjeçare, nga zemërimi, sepse e ëma nuk ia kishte plotësuar një dëshirë të saj, i thotë në mënyrë të revoltuar: “debile”. Ajo nuk e dinte kuptimin e saktë të fjalës, por një personazh i preferuar filmi vizatimor e kishte përdorur dhe ajo e përdorte shumë shpesh.

Apo: “Qepe gojën, se s'të duroj dot” etj.

Prandaj duhet të diskutojmë vlerën që jep programi i televizorit së bashku me fëmijën tonë. Të kërkojmë së bashku me fëmijën se çfarë mesazhi ka dhënë programi apo filmi. Duhet të lavdërojmë fëmijën kur ai bën zgjedhje pozitive, dhe ta nxisim atë që të bëjë kritika apo të analizojë atë që sheh në televizor.

Fëmijët e moshës parashkollorë, zakonisht i marrin mesazhet ereklamave që jepen në televizorashtu siç janë, sepse e kanë vështirë të kuptojnë të vërtetën. “Mastrimi” i reklamave televizivë në këto moshë, ndonjëherë mund të jetë i rrezikshëm. Një djalë 4vjeçar kaloi dy ditë në spital, pasikishte gëlltur dyzet copë vitamina; ai e kishte bërë këtë pasi kishte parë një reklamë televizive, e cila thoshte se po t'i përdornin fëmijët këto vitamina, do të bëheshin shumë shpejt të mëdhenj dhe të fortë.

Kjo gjë ndodh edhe te të rriturit. Një studente po më tregonte, se duke parë në reklamë që konsumimi i “Aktivia”, ndihmon në humbje të peshës dhe në një përmirësim të gjendjes fizike, e ëma kishte nisur të përdorte tri të tilla në ditë, me shpresë që kjo gjë të realizohej sa më shpejt.

Besimi “i verbër” i fëmijëve, (por në disa raste edhe i të rriturve), tekgjithçka që thonë reklamat, i bëjnë ata të kërkojnë dhe të duan pothuajse çdo gjë që shfaqet në to. Kërkesat e tyre i vënë në vështirësi prindërit. Ata s'dinë ç'të bëjnë: t'i kundërshtojnë kërkesat, apo t'i plotësojnë dhe të blejnë atë që uakërkojnë. Reklamat ndikojnë gjithashtu, në formimin dhe forcimin e stereotipeve të ndryshme sociale. (Përshembull, përgjithësisht fëmijët nëpër reklama janë djem biondë dhe vajzat zakonisht janë në rolepasive. Vajzat dalin në reklamave të për pamjen e tyre.)

<sup>75</sup> Shih: Moisiu, R., Tushe, E. e të tjerë. *Arti i rritjes së fëmijëve sot*, Tiranë, 2005, f. 283.

## II.11. Shprehitë e të folurit dhe televizori

Dikur kanë pasur rolin modeldhënës letërsia e shkruar për gjuhën e shkruar dhe teatri dramatik për gjuhën e folur. Letërsia dhe sot ka peshën e saj, por me kohë, në ndikimin gjuhësor kanë ardhur në fuqi mediat. Sot, në të gjithë botën është pranuar dhe theksuar katërcipërisht se gjuha e çdo kombi ndien kryesisht peshën e modelin që vjen:

a) për të shkruarit nga gjuha e gazetave dhe e revistave, si vlerë e shtuar ndaj letërsisë artistike;

b) për ligjërimin e folur, nga gjuha e mediave elektronike: nga radiot dhe televizionet, si dhe nga fjala publike në tubime e konferenca masive.

Gazetarët janë, njësoj si mësuesit e shqipes, madje edhe më ndikues e më të imitueshëm sesa mësuesit e gjuhës shqipe-thotë gjuhëtari Gj. Shkurtaç, duke shtuar se, *pa gazetari që të shkruajë e të flasë qartë, pastër e bukur, kurrë nuk do të kishim model të foluri të atillë që t'u shërbejë masave*. Natyrisht, edhe mjetet e sotme të teknikës së radiopërhapjes dhe përgjithësisht të mediave elektronike kanë prurë në skenë fjalën e folur e të shkruar që ndikon drejtpërdrejt dhe në kohë reale të njerëzimit, pa pasur nevojë për libra, revista etj.

Pra, jo duke i mënjanuar ato, por duke ua marrë krahun me shpejtësinë dhe hapësirat shumë herë më të mëdha që ofrojnë mjetet e sotme radiotelevizive, përgjithësisht pamore. Gjuhëtarët kanë përmendur disa herë mirë rolin e disa kanaleve tashmë të mirëpritura si Digit-Alb dhe emisionet e Bang-Bang, Çufu etj.

Fëmijët e sotëm i duan shumë ato emisione, përfitojnë mjaft prej tyre dhe, mund të themi, ata janë “gjyshërit” e “gjyshet” modernë të fëmijëve të sotëm. Kjo, natyrisht, kërkon të shtohet edhe më tej kujdesi për gjuhën e atyre emisioneve, për përkthime të bukura, po edhe për mishërimin sa më të mirë të fjals së folur nëpërmjet aktorëve.

*Shumëstudiuës shpjegojnë se televizori ndikon më shumë për keq, sesa për mirë te fëmijët. Ai iu “vjedh” atyre kohën e lojës, i bën ata më pak krijues, më pak shoqërorë dhe të varur. Sot është shumë e vështirë të gjesh familje, të cilat nuk kanë televizor në shtëpi. Por, një gjë është e sigurt, fëmijët, të cilët shohin e qëndrojnë për shumë kohë para televizorit, kanë më pak arritje në shkollë, sesa ata fëmijë që shohin më pak. Gjatë viteve të para të jetës, që fëmija të zhvillojë shprehitë e të folurit, ka shumë rëndësi komunikimi mes tij dhe prindërve (të rriturve). Vlerën e këtij komunikimi nuk mund ta zëvendësojë kurrë televizioni.*

*Gimi është një fëmijë normal, i lindur nga prindër të shurdhër. Prindërit e tij shpresojnë se ai do të mësojë të flasë, duke parë televizorin. Kështu, fëmija qëndronte me orë të tëra para ekranit, megjithatë ai filloi të flasë rreth moshës dy vjeç e gjysëm. Në moshën 3 vjeç e 9 muaj, gjuha e tij ishte jo normale për moshën e tij. Djalin e ndihmoi ta kapërcejë këtë gjendje trajtimi nga specialistët e të folurit.<sup>76</sup>*

Gjuha zhvillohet nga marrëdhëniet me të tjerët; prindërit, më të rriturit, moshatarët, kurse qëndrimi gjatë para televizorit e pengon, “e bllokton” mundësinë e zhvillimit të shoqërisë. Një fëmijë, i cili shkon në klasë të parë pa aftësitë e nevojshme

<sup>76</sup> Moisiu, R., Tushe, E. e të tjerë. *Arti i rritjes së fëmijëve sot*, Tiranë, 2005, f. 417.

bashkëpunuese, të cilat formohen nga loja me të tjerët, mund të mos jetë i zoti të vendosë marrëdhënie normale dhe të mësojë nga mësuesi apo nxënësit e tjerë.

Zhvillimi i teknologjisë së përparuar, mësimi i gjuhëve të huaja, përdorimi në masë i kompjuterit, televizionit, telefonisë celulare, postës elektronike, etj (pra, të gjitha “flukset e dukshme e të padukshme”), po ndikojnë drejtpërdrejtë në gjuhën tonë kombëtare.

Nëpërmjet njohjes së mirë të gjuhës shqipe dhe të gramatikës bazë të saj, një gazetar mund të bëhet më i mirë në profesionin e tij. Sistemet e televizionit dixhital e satelitor e kanë shpënë fjalën shqipe në çdo skaj të globit. Qendrat urbane nuk mund të shihen më si pika përfaqësuese të një dialekti të caktuar. Tani nuk shihen më dallimet qytet-fshat.

Mësimi i gjuhëve të huaja është në dobi të çdo shoqërie dhe tregon zhvillim dhe kulturë, por gjithnjë duke patur parasysh që gjuhët e huaja të mos ndërhyjnë në gjuhën tonë kombëtare dhe kjo gjë po vërtetohet më së miri ditët e sotme. Kjo është një dukuri e shëmtuar dhe e dëmshme.

Mjaft studiues shpjegojnë se televizori ndikon më shumë për keq, sesa për mirë te fëmijët. Gjatë viteve të para të jetës, që fëmija të zhvillojë shprehitë e të folurit, ka shumë rëndësi komunikimi mes tij dhe prindërve (të rriturve). Vlerën e këtij komunikimi nuk mund ta zëvendësojë kurrë televizori.

Gjuha zhvillohet nga marrëdhëniet me të tjerët; prindërit, më të rriturit, moshatarët, kurse qëndrimi gjatë para televizorit e pengon, “e bllokun” mundësinë e zhvillimit të shoqërisë. Është detyra e gjithsecilit prej nesh, që ta ruajmë, ta mbrojmë dhe ta duam thesarin më të çmuar që ka çdo komb, pra gjuhën.

Të gjitha zhvillimet që përmendëm më lart, e bëjnë të nevojshëm dhe të menjëhershëm mësimin e gjuhëve të huaja, për të qenë të informuar mirë dhe bashkëkohorë në çdo moment. Kompjuteri është gjithashtu një risi më shumë që nxit motivimin për të mësuar gjuhët e huaja. Kjo është në dobi të çdo shoqërie dhe tregon zhvillim dhe kulturë, por gjithnjë duke pasur parasysh që gjuhët e huaja të mos ndërhyjnë në gjuhën tonë kombëtare.

Fatkeqësisht, kjo gjë po ndodh rëndom, si në përkthimin e filmave, në emisionet të lajmeve e programeve të ndryshme televizive, në gjuhën e politikanëve etj. Madje në disa stacione televizive, titujt e disa programeve jepen në gjuhë të huaj, si p.sh. “Dancing with the stars”, “Albanian’s got talent”, “Big Brother”, “Deja vu” etj.

Siç vihet re edhe nga shembujt, gjuha angleze është ajo që dominon dhe shumë huazime janë marrë dhe përdoren dendur në gjuhën tonë.

Huazime të tilla, vijnë në shqipen në kuadrin e një dygjuhësie të çalë, d.m.th., nëpërmjet njerëzve që nuk e dinë mirë anglishten, por nuk kanë as ndershmërinë dhe as përgjegjësinë më të vogël, që para se të flasin e të shkruajnë shqip ato që kanë lexuar e dëgjuar në anglisht, t’i shohin sesi përkthehen në fjalorët anglisht-shqip.<sup>77</sup>

Kjo është një dukuri e shëmtuar dhe e dëmshme. E pse u dashka përdorur: *decisive* (vendimtare), *aparencë* (pamje e jashtme), *kredibilitet* (besueshmëri), *demonstron* (shfaq, tregon), *kualitet* (cilësi) etj, kur shqipja i ka fjalët gjegjëse përkatëse!?. Puna që bëhet në shkollë formon te brezi i ri vetëdijen gjuhësore, forcon dashurinë dhe kujdesin për gjuhën amtare dhe ka vlerën e gurit të themelit në ngrehinën e kulturës gjuhësore të çdo individi në veçanti dhe të krejt shoqërisë në përgjithësi.

<sup>77</sup> Shkurtaç, Gj. *Kundërime Gjuhësore*, Tiranë, 2006, f. 30

### KAPITULLI III

#### III.1. Huazimet ne shqipen si tregues te integritit te hershem e te sotem

Jashtë shoqërisë nuk ka gjuhë. Gjuha është e lidhur ngushtë me veprimtarinë prodhuese të njeriut. Gjuha e një populli pasqyron kulturën e tij, zakonet në zhvillimin e tyre historik. Prej këtej rrjedh edhe rëndësia e madhe e dëshimve gjuhësore, jo vetëm për gjuhësinë, por edhe për gati të gjitha shkencat e tjera albanologjike, si për etnografinë, folklorin dhe përgjithësisht për kulturën popullore, për historinë, por edhe për arkeologjinë etj.

Gjuha ruan vazhdimisht gjurmë nga kultura e vjetër e shoqërisë. Shumë fjalë ruajnë formën e vjetër të tyre, megjithëse me kohë ato kanë marrë përmbajtje tjetër, prandaj, prej kohësh, ka qenë dhe mbetet e qartë, se pa studimet ndërdisiplinare dhe, kur është e mundur, të përbashkëta të gjuhëtarëve dhe të etnografëve, folkloristëve, arkeologëve etj. nuk mund të zgjidhet drejt çështja e origjinës së popujve me mungesa të mëdha dokumetacioni historik, sikundër është populli shqiptar.

Një popull i lashtë, fqinj i përhershëm me grekët e me romakët, gjuha e të cilit qëndron midis greqishtes e latinishtes, ka pasur edhe ndikime leksikore prej tyre, por është gjuhë më vete, pa lidhje birërie me asnjërën prej dy gjuhëve më të vjetra të Evropës, që përmendëm, po edhe, për fat të keq, me dëshmi të mëkëta e gjithësi të pakëta të dokumentimit të pranishëm të tij si popull e të shqipes si gjuhë.

Prej një trualli bregdetar dhe me mundësi të shumta lidhjeje me Evropën nëpërmjet tokës e detit, Iliria e moçme si dhe Shqipëria e sotme, në fakt, kanë qenë kurdoherë brenda Evropës, madje mu në zemër të saj. Për këtë, ndër të tjera, na dëshmojnë edhe gjuha dhe onomastika shqiptare, veshjet dhe traditat kulturore, sa të moçme e interesante, aq edhe tërheqëse e dëshmitare të kohërave.

Gjuha shqipe sot flitet në Shqipëri dhe jashtë kufijve të saj në Kosovë, në territorin ndërmjet Shkupit, Gostivarit, Tetovës dhe Dibrës, në Preshevë, në Bujanovc dhe në Medvegjë, në Krajë, në Ulqin me rrethina deri në Tivar dhe në Çamëri. Shqipja, pra, flitet në viset perëndimore të Ballkanit, aty ku kryqëzohen rrugët që lidhin Lindjen me Perëndimin, pikërisht në atë rajon që ka qenë djepi i qytetërimit antik evropian. Gjithashtu, shqipja flitet edhe në diasporë (në Itali, në Greqi, në Bullgari, në Ukrainë), edhe në shumë vende të tjera të kontinentit tonë dhe më gjerë, në Amerikë, në Azi dhe në Australi nga shqiptarë të vendosur atje në kohë më të hershme ose më të vonshme.

Gjuha shqipe i përket familjes së gjuhëve indoevropiane. Rreth dy mijë fjalë të shqipes janë me origjinë indoevropiane: **kokë, ditë, natë, dimër, ujë, ha, pi, jam, kam, zog, dem, elb** etj. Shqipja formon një degë më vete në familjen e gjuhëve indoevropiane. Gjuha shqipe pra nuk ka lidhje birërie me asnjërën nga gjuhët e sotme indoevropiane. Territori shqiptar ka qenë i banuar që nga paleolitiku i mesëm (100.000– 40.000 vjet para erës sonë). Gjurmët e para të rëndësishme të qytetërimit i përkasin neolitit (6000-2000 vjet para erës sonë).

Në fillimet e kohës së bronzit fiset ilire shfaqen në një territor të gjerë që shtrihet nga gadishulli i Istrias në veri deri në gjirin e Artës në jug. Në lindje, kufiri i

tyre shtrihej afërsisht deri te lumenjtë Vardari e Morava. Popullsia ilire është formuar nga popullsi autoktone të epokës së neolitit, pas ardhjes së popullsive indoevropiane aty nga fundi i mijëvjeçarit të tretë para erës sonë.

Pra, Ilirët përbënin një popullsi shumë të vjetër të vendosur në perëndim të Ballkanit. Emrat e dy fiseve ilire, Pajonëve dhe Thesprotëve, i gjejmë tek "Iliada" dhe "Odiseja" e Homerit. Kjo popullsi del me këtë emër në shekullin e pestë para erës sonë. Në rrethinat e Durrachium-it (Durrësi i sotëm) u formua nyja e Shtetit të parë Ilir. Gjuha e kësaj popullsie ishte ilirishtja. Shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe gjuha shqipe pasardhëse e ilirishtes.

Nga kjo gjuhë nuk kanë mbetur veçse pak fjalë, të cilat mund të shpjegohen me gjuhën shqipe dhe konkretisht, *sika*= thika, *pele*= pleq, *aspetos*= i shpejtë. Edhe disa emra gjeografikë dhe emra personash ilirë mund të shpjegohen me fjalë të shqipes. Kështu p.sh. *Dardania* është shpjeguar me shqipen dardhë, *Dalmatia* me shqipen delme, dele; *Ulkin* me shqipen ulk, ujk, *Dimalum* me shqipen di mal, dy male; *Bardhulme* me shqipen i bardhë, *Dazme* me shqipen dash.

Në vitin 168 para erës sonë, Iliria u pushtua nga romakët. Filloi kështu një periudhë pushtimi që zgjati për më shumë se pesë shekuj. Në shekullin e VII Shqipëria u pushtua nga sllavët, kurse në shekullin XV nga turqit otomanë. Pushtimi otoman vazhdoi pesë shekuj deri më 28 nëntor 1912.

Në Mesjetë, popullsia e territoreve të populluara nga fiset ilire, quhej **Albanoi** dhe vendi **Albanon**, prej nga ka dalë forma popullore **Arbënesh** ose **Arbëresh**. Emrat e sotëm **Shqipëri**, **shqiptar**, shqip janë shfaqur në shekullin XVII. Gjatë kësaj periudhe të gjatë pushtimi, gjuha dhe kultura shqiptare kanë qenë nën ndikimin e gjuhës e të kulturës latine, greko-bizantine, sllave e turke. Gjenden në shqipe fjalë me origjinë nga greqishtja e vjetër, latinishtja, greqishtja bizantine, sllavishtja, turqishtja etj.

Nga greqishtja e vjetër kanë hyrë fjalë të tilla si: drapër, lakër, qershi, shpellë; nga latinishtja: arë, kalë, mbret, furkë, ungj; nga greqishtja bizantine: fis, ikonë, kollogjer, manastir; nga sllavishtja: gjobë, lopatë, pushkë, opingë, rob, si edhe toponime: **Berat** (bel+grad), **Dropull** (Drino+polje), **Konispol** (konis+polje), **Velipojë** (veliko+polje), **Zadrimë** (Za+Drin), **Zagori** (za+gor); nga turqishtja: **tepsi**, **pazar**, **cohë**, **bahçe**, **oxhak**, **sobë**, **jastëk**, **ilaç** etj.

Është e vërtetë që shqipja ka pësuar ndikime nga gjuhët e huaja, sidomos në leksik, po është po kaq e vërtetë që ajo ka shfaqur aftësi për t'i asimiluar dhe ndryshuar sipas modelit të vet huazimet, duke treguar forcën dhe gjallërinë e saj. Kështu fjalët e greqishtes së vjetër *drapanon*, *kerasia*, *spileon* në shqip dalin drapër, qershi, shpellë,- në latinisht *arvum*, *vicinium*, *impertorem*, në shqip arë, fqinj, mbret,- në sllavisht *glob*, *opanak*, *ravnica*; në shqip : gjobë, opingë, rrafshë. Gjithsesi, gjatë periudhës që vendi ynë, kultura jonë, gjuha jonë ishin nën ndikimin e kulturës e të gjuhës latine, greko-bizantine, sllave e turke, gjuha shqipe ka ruajtur origjinalitetin e saj si gjuhë indoevropiane me strukturë fonetike, gramatikore e leksikore të veçantë.

Me rëndësi janë shqyrtime të thelluara që ka bërë në këtë fushë studiesi i shquar, prof. Eqrem Çabej. Ndër çështjet teorike me rëndësi që trajtohen në veprën e tij është vendi që zë shqipja në mes gjuhëve të tjera indoevropiane, çështja e origjinës së saj

dhe fatet historike, që ka ndjekur. Shenja më e dukshme e kontaktit të shqipes me gjuhët e huaja, veçanërisht me vendet ku ndodhen arbëreshët a shqiptarët në botë janë huazimet leksikore, por edhe morfosintaksore.

Kështu, përmendim huazimet greke në të folmet e arvanitëve, italianizmat në të folmet e arbëreshëve të Italisë, bullgarizmat në të folmet e shqiptarëve të Mandricës, dalmatizmat në të folmen e arbëreshëve të Zarës, rusizmat në të folmen e shqiptarëve të Odesës.<sup>78</sup> Njohja dhe studimi i gjeobilinguizmit gjuhësor të shqipes ndihmon sot në sqarimin sa më të plotë të pozicionit të saj.

Gjendja e bilinguizmit ka çuar në ndikime më të mëdha, deri edhe në strukturën gramatikore të shqipes. Detyrat teorike të gjuhësisë shqiptare ai i shtron me qartësi shkencore dhe fisnikëri. Në mes tjerash nënvizon: "*Studimet albanologjike, përveç interesit thjesht shkencor, kanë medeomos edhe një anë praktike, pse gjuha shqipe për ne s'përbën vetëm një objekt studimi, por është edhe shprehja kryesore e jetës sonë nacionale.*"<sup>79</sup>

Fjalët e huaja kanë hyrë në gjuhën shqipe në rrjedhë të kohërave deri në ditët e sotme me veçoritë e tyre specifike në dy pjesë kryesore të leksikut: në leksikun e përgjithshëm dhe në atë terminologjik. Në leksikun e përgjithshëm ato janë përfshirë në kushtet e kontakteve qindravjeçare të drejtpërdrejta të shqipes me gjuhët e pushtuesve ose të fqinjëve, duke u përzier me leksikun vendës e duke formuar, sipas gjuhës hyrëse, shtresa të ndryshme leksikore, si, latinizmat (gjatë 500 vjet të pushtimit romak), greqizmat (nga fqinjësia e përhershme me popullsinë greke), sllavizmat tre shekuj (shekulli V deri në shekullin VIII dhe turqizmat (rreth 500 vjet të pushtimit turk).

Në leksikun terminologjik, në kushtet e kontakteve përgjithësisht jo të drejtpërdrejta e më rrallë të drejtpërdrejta me gjuhët e huaja janë formuar në kohët e vona (dy shekujt e fundit) në periferi të leksikut shtresime të tilla, si, italizmat, francesizmat, anglicizmat (anglicizmat) e më rrallë rusizmat e gjermanizmat.

Për shtresimet e huaja të leksikut të përgjithshëm ky proces ka vijuar për qindra a mijëra vjet deri në fundin e shekullit XIX, si rrjedhojë e të cilit pjesa më e madhe historikisht e huaj ndihet a perceptohet si shqipe (si, p.sh., edhe ato fjalë, të cilave nga forma mund t'u zbulohet origjina: *oxhak, xhëp, çarçaf, daulle* (turq.), *çekiç, çudit, vadit* (sllav.), kurse, për shtresimet e leksikut terminologjik procesi në fjalë është kryer për një kohë relativisht të shkurtër (rreth mbi njëqind vjet deri në ditët e sotme, çka lidhet me formimin e gjuhës së shkencës e të teknikës gjatë kësaj kohe. Kjo ka bërë që në to të ndihet (perceptohet) pak a shumë prejardhja e huaj dhe të mund të përcaktohet origjina e tyre: *bankë, karrocë* (it.), *byro, depo, dosje, bordero, meny* (fr.), *sport, basketboll, regbi, futboll* (angl.).

Në kohë afërsisht të barabarta, qysh nga fundi i shekullit XIX, sidomos nga fillimi i shekullit XX, procesi i hyrjes në shqipe kryesisht të fjalëve nga italishtja, frëngjishtja dhe anglishtja, të cilat kanë funksionuar si terma, ka përfshirë pothuajse plotësisht leksikun libror dhe, në mënyrë të veçantë, atë pjesë të tij që lidhej me terminologjitë e fushave të ndryshme të dijes, duke filluar qysh nga formimi në zanafillë i këtyre terminologjive ( në fushat bazë të tyre, si p.sh, matematika,

<sup>78</sup>Gj. Shkurtaj, "Sociolingustika", Tiranë, 1996, f. 158

<sup>79</sup>E. Çabej, "Studime gjuhësore", Vëllimi V, Prishtinë, 1975, f. 213.

gjeometria, gjeografia, etj.) e deri më sot, kur ato paraqiten të kristalizuara dhe të formësuara përfundimisht si sisteme të qëndrueshme e homogjene.

Në krahasim me huazimet e leksikut të përgjithshëm, tashmë të ngulitura në gjuhë dhe që bëjnë jetë të përbashkët me leksikun vendës, huazimet e terminologjive, si emërtime të gjuhës së shkencës dhe të teknikës, të grupuara në qindra fusha dije, vijnë të hyjnë në sasi të mëdha në gjuhë, sidomos sot, nën ndikimin e shfaqjes së pandërprerë të koncepteve, të lidhura me zhvillimin e shkencës dhe të teknologjive moderne, me përdorimin e objekteve të sofistikuara të industrive të reja ( të kompjuterit, të celularit e të çdo pajisjeje a makine tjetër elektronike).

Një pjesë e termave të huaj nguliten si të vetëm, si elemente të nevojshme të sistemeve terminologjike (sidomos sot: *harduer, softuer, tastierë, monitor*), një pjesë tjetër funksionon në kushtet e konkurrencës me termat barasvlerës shqip (krahas dimension edhe përmasë, krahas maus edhe mi), kurse një pjesë nuk gjen vend në këto sisteme, për shkak se lëvruarit e terminologjisë, specialistë a gjuhëtarë, kanë gjetur ose kanë formuar barasvlerës të përshtatshëm për ta (inf. :ruaj, përpunoj, kujtesë).

Kufizueshmëria e hyrjes së leksikut të huaj në leksikun e përgjithshëm, qysh nga fundi i shekullit XIX, dhe dendësimi i depërtimit të tij në leksikun terminologjik, pas kësaj periudhe e deri më sot, ka bërë që pesha specifike e huazimit të zhvendoset nga qendra në periferi të gjuhës, çka e ka shndërruar terminologjinë në portën kryesore të hyrjes së leksikut të huaj.

Kjo situatë problematike për terminologjinë është ndier fort qysh nga rilindësit, të cilët duke punuar për hartimin e teksteve shkollore, ndonëse të nivelit të ulët shkencor-teknik, janë ndeshur me termat e huaj, që shërbenin si shënues të koncepteve të fushave bazë të shkencës si: të matematikës (aritmetikës), të gjeometrisë të anatomisë (N. Frashëri), të gjuhësisë e të gjeografisë (S. Frashëri),.

Për kapërcimin e kësaj situatë ata gjithnjë, krahas futjes në tekstet mësimore të fjalorëve (termave) të huaj janë përpjekur që të krijojnë a të gjenin për ta mundësisht sa më shumë barasvlerës shqip, çka ndihmon për t'i kuptuar sa më lehtë dijenitë shkencore, në kushtet edhe të padijes që ekzistonte në atë kohë në vendin tonë. Më tej dijetarë të tjerë janë përballur me termat e huaj për nivelin e shkollës unike e të mesme, si *psikologji, pedagogji* (A. Xhuvani), *letërsi* (L. Gurakuqi), *teknikë* (M. Logoreci) etj.

Merita e rilindësve dhe e pasuesve të tyre është se ata, duke punuar për lëvrimin e terminologjive bazë u orientuan kaq shumë pas shqipërimit të termave të huaj, sa që krijuan edhe sisteme termash vetjakë shqip për fusha të caktuara, ndër të cilët mund të përmendim sidomos dijetarin arbëresh Dh. Kamarda për fushën e gjeografisë. Një pjesë e shqipërimeve që ata krijuan nuk i qëndruan kohës dhe u zëvendësuan përsëri nga termat e huaj (si *dheshkronjë* me gjeografi, *shkronjëto* me gramatikë).

Duhet nënvizuar në mënyrë të veçantë se në fushën e terminologjisë rilindësit dhanë shembullin se kundër termave të huaj duhet luftuar në mënyrë ballësore. Me punën që u bë më vonë në luftën kundër termave të huaj u arrit që terminologjia e shkencave bazë në shqipe të vihej mbi themele të shëndosha dhe t'u jepej vlerë elementeve autoktone të shqipes.

Me zhvillimin në gjerësi e në thellësi të shkencave dhe të teknologjisë në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar fushat e dijes u shtuan dhe u diferencuan kaq shumë, sa që plotësimi i tyre me terma mund të bëhet në radhë të parë përmes termave të huaj, të cilët vërshuan në masë të madhe sidomos në tekstet mësimore të shkollave të larta, si edhe në dokumentet shkencore e teknike, në doracakët e të gjitha llojeve e deri në thjeshtligjërime.

Megjithatë, mbështetja mbi një politikë gjuhësore të drejtë në fushën e terminologjisë në vendin tonë, duke zbatuar orientimin bazë të kësaj politike se ndërhyrja e shoqërisë në terminologji është e domosdoshme dhe e mundshme, çoi në krijimin e komisioneve e të organizmave përkatëse për ndjekjen e saj. *Kjo dha mundësi t'u vihej ledh një pjese të termave të huaj nëpërmjet termave shqip si zëvendësues të tyre, të cilët u pasqyruan në fjalorët e shumtë të llojeve të ndryshme, si shpjegues-gjuhësorë, terminologjike, mësimore e përkthimorë.*

Kjo situatë u mbars me një kontradiktë të thellë, që vihet re edhe në ditët tona, ndërmjet krijimit të një sasive të madhe termash shqip, të pasqyruar në fjalorët e përgatitur nga gjuhëtarë e specialistë, të hartuar mbi bazën e parimeve e kritereve të rrepta shkencore dhe përdorimit të kufizuar të tyre në tekste mësimore, dokumente teknike dhe në praktikën ligjërimore. Termat e huaj kanë mbizotëruar dhe mbizotërojnë edhe sot sidomos në tekstet mësimore të shkollave të larta.

Mund të vërehet gjithashtu, se në fushat themelore të dijes (*matematikë, gjeometri, fizikë, kimi*) mbizotërojnë termat me bazë shqipe, kurse në fushat speciale takohen me tepri termat e huaj. Ndërsa për italianizmat e francesizmat në fushën e terminologjisë mund të pohohet se janë arritur rezultate nëpërmjet shqipërimeve të mundshme, çka ka çuar në uljen relative të numrit të tyre, për anglicizmat terma mund të pranohet pa mëdyshje se ata po pushtojnë pothuajse të gjitha fushat e dijes, por edhe po futen thellë në gjuhë, duke depërtuar edhe në zonën librare (masmedia, publicistikë) e deri në thjeshtligjërime, ku dëgjohen në të folurit edhe të njerëzve të zakonshëm terma të përdorur si fjalë nga fusha e informatikës: *klikoj, tastierë, maus, monitor etj.*

Termat përdoren madje deri në kuptime figurative, siç mund të takohen si të tillë: *bunker*, *format*, *klon*, *pingpong*, në kontekste nga më të ndryshme, si: *bunker* (nga usht.) në: "Shqipja në bunker"(M.Elezi); *format* (nga inform.) dhe *i klonuar* (nga gjenet.) në "...formati me famë botërore Big Brother është klonuar pastaj në rreth 60 vende të botës" (Gazeta "Shqip"); *pingpong* në: "Një pingpong ndërmjet forcave politike" (TV).

Futja e termave të huaj, sidomos e termave me burim nga anglishtja, në qendër të gjuhës dhe aktivizimi i tyre në ligjërimin e zakonshëm *krijon një situatë problematike, sepse u jep atyre të drejtën për t'u përdorur në kushte të barabarta me fjalët shqipe, çka bën që të rrënjosen në gjuhë dhe të mund të mos dalin më prej andej.*<sup>80</sup>

<sup>80</sup>Shih: Agron Duro, *Fjalët e huaja dhe gjuha shqipe*, Gazeta "Shqip", 9 tetor, 2009.

### III.2. Huazimet nga greqishtja në shqipen

Gjuha greke dhe ajoshqipe bëjnë pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane, e gjuhëve gjenetike të afërta, të cilat qysh në kohërat e vjetra janë folur në trevat që nga India në Evropë. Kjo familje përfshin gjuhë të gjalla e të vdekura, të cilat kanë afri dhe bashkëpërkime (konkordanca) të shumta midis tyre. Sa më thellë të hyjmë në të kaluarën, aq më të dukshme janë afritë dhe bashkëpërkimet midis këtyre gjuhëve.

Kjo familje gjuhësore ndahet në shumë degë e nëndegë. Greqishtja dhe shqipja formojnë degë të veçanta dhe nuk kanë lidhje motërzimi me asnjë gjuhë tjetër. Gjuhët e kësaj familjeje, por edhe gjuhët e tjera hyjnë me njëra-tjetrën në marrëdhënie të ndryshme, të lidhura me faktorë historikë, gjeografikë, kulturorë etj.

Marrëdhëniet e shqipes me greqishten janë shumë komplekse dhe shtrihen në një periudhë shumë të gjatë kohore; ato kanë nisur ndoshta që në fazën paraetnike të këtyre gjuhëve në djepin parabolkanik të tyre dhe kanë vijuar pa ndërprerje në periudhën etnike deri në ditët tona. Nga ana tjetër këto marrëdhënie janë zhvilluar në rrethana historike dhe kulturore nga më të ndryshmet, duke filluar nga kontaktet e thjeshta të fqinjësisë deri te simbioza e përzierjet etnike në disa vise, si pasojë e shpërnguljeve dhe e shtegtimeve të popullsive.<sup>81</sup>

Gjuhëtari i madh, E. Çabej, një ndër përfaqësuesit më të shquar të gjuhësisë shqiptare, gjatë një gjysmë shekulli ka punuar si rrallëkush dhe duke shfaqur arritje të mëdha në fusha të ndryshme të albanologjisë dhe të ballkanologjisë<sup>82</sup>. Ai i kushtoi tërë jetën e tij shkencës, është dijetari që dha ndihmesë jashtëzakonisht të madhe për zhvillimin e shpejtë të shkencës së re shqiptare, sidomos në fushën e historisë së gjuhës, në fushën e etimologjisë, të fonetikës historike, të gramatikës historike, të dialektologjisë, pa lënë pa përmendur interesimin e tij për folklorin dhe letërsinë. Më së shumti ai u mor me studimet diakronike dhe veçanërisht me ato në fushën e studimeve rreth etimologjisë së gjuhës shqipe. Po ndalemi në ndihmesën që ka dhënë ky gjuhëtar në studimin e huazimeve të shqipes nga greqishtja, ndihmesë që lidhet me historinë e shqipes, me autoktoninë e shqiptarëve, si dhe me marrëdhëniet ndërmjet dy popujve e gjuhëve të tyre.

Me shumë rëndësi janë studimet e E. Çabejt për huazimet greke në shqipen, për të treguar jo vetëm veçoritë e periodizimit të tyre, por për të pohuar përsëri se ai është themelbër në teorinë e prejardhjes ilire të shqiptarëve dhe të shqipes nga ilirishtja jugore, duke iu përmbajtur argumentimit se shqiptarët, të ndriçuar edhe nga ky këndvështrim, janë vendas në trojet ku jetojnë sot.

Ky dijetar me përmasa evropiane shtron saktë shkencërisht se cilat nga këto huazime duhen bërë objekt studimi, gjë që përcaktohet nga numri i huazimeve, nga përhapja e tyre në shqipen, nga interesi i veçantë që ato paraqitin, madje dhe për shkakun se mund të jenë gjykuar gabim për burimin e tyre, duke u marrë për fjalë vendi etj<sup>83</sup>.

<sup>81</sup> Shih: S.Mansaku, *Probleme të historisë së gjuhës shqipe në dritën e marrëdhënieve të saj me greqishten*, në "Seminarin ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare", Prishtinë, 2004, 22/2, f. 109.

<sup>82</sup> Shih: Shaban Demiraj, *Eqrem Çabej - një jetë kushtuar shkencës*, 51, f. 52

<sup>83</sup> Shih: Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, f. 40

Çabej, gjatë një pune shumëvjeçare, duke u mbështetur në kritere të rrepta dhe të sigurta shkencore, bëri krahasimin e elementit të trashëguar me elementin e huazuar dhe arriti në përfundimin se elementi i trashëguar nga pikëpamja cilësore në historinë e shqipes pa dyshim zë kryet e vendit<sup>84</sup>.

Gjithashtu ai thekson se “*sasia e elementit të huazuar dhe sasia e elementit të vendit tregojnë më një anë shkallën e ndikimit të huaj mbi shqipen, dhe më anën tjetër shkallën e rezistencës së kësaj gjuhë*”<sup>85</sup>.

Prof. Çabej, së pari, u ndal në studimin e hollësishëm të marrëdhënieve historike të këtyre dy gjuhëve në kontakt, marrëdhënie që kanë filluar prej kohëve prehistorike e vazhdojnë deri në ditët e sotme. Atij i takon meriat se vuri në pah dhe saktësoi disa pika më kryesore të marrëdhënieve miidis dy gjuhëve e pikërisht:

1. Shqipja ka në leksikon e saj huazime që i ka trashëguar nga nëna e saj, ilirishtja, ku përfshihen kryesisht huazimet nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja. Këto huazime kanë depërtuar në mbarë shqipen, pra i gjejmë në toskërishte dhe në gegërishte p.sh., lakhanon (τολαχανον) = lakër, prason (τοπρασον) = presh, pepon (τοπεπονι) = pjepër, kerasia (ηκερασια) = qershi, mahana (μαχανα) = mokër, mokën; spileon (σπηλαιον) = shpellë, skapos (σκαπος) = shkop, etj. Nga latinishtja p.sh. bujk (bubulcus); tërfurk (trifurcus); mik (amicus); armik (inimicus); bekoj (benedicere); vullnet (voluntas) etj.

2. Gjithashtu shqipja ka huazuar drejtpërdrejt fjalë nga greqishtja e mesme dhe e re, shumica prej tyre janë bërë objekt interpretimi nga prof. Çabej dhe janë përfshirë në studimet e tij etimologjike. *Huazimet prej greqishtes së mesme dhe një pjesë e mirë e huazimeve prej greqishtes së re përkojnë me kohën e sundimit bizantin, sepse siç pohon vetë ai, Bizanti kishte bashkuar në vetvete në një tërësi të pandarë helenizimin me krishtërimin e me botën orientale, dhe ka ushtruar një ndikim të fuqishëm mbi popujt e Gadishullit Ballkanik në fushën sociale, ekonomike, kulturore e fetare*<sup>86</sup>.

Huazimet nga greqishtja e mesme dhe e re kanë depërtuar më shumë në të folmet jugore të shqipes. Por ato i gjejmë edhe në të folmet veriore. Të tilla huazime të rrafshit leksiko-semantik mund t’i përkasin sferës fetare, si, *manastir* te Budi, *munështir* te Bardhi; *kllogjer*, më e vjetër *kllogjën*, *kllogjër*; *potir* te Buzuku e te Bardhi *putir*. Përkthime nga greqishtja, ndikime të kishës lindore, janë shprehjet *Ujët e Bekuar*, *Java e Madhe*, që ka edhe sot veriu katolik etj.

Por tek huazimet e kësaj periudhe studiuesit gjejnë edhe fjalë të sferave të tjera që mund të jenë nga jeta shoqërore a shtëpiake, nga fusha e dokeve apo e zakoneve, nga kopshtaria apo nga gjuetia, mund të jenë fjalë që emërtojnë pjesë të trupit të njeriut etj.<sup>87</sup>

<sup>84</sup> Shih: Eqrem Cabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, f. 106

<sup>85</sup> Shih: Eqrem Cabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, f. 113

<sup>86</sup> Shih: Eqrem Cabej, *Studime gjuhësore*, Prishtinë, V, 1976, f. 48

<sup>87</sup> Shih: Eqrem Cabej, *Studime gjuhësore*, Prishtinë 1976, f. 48-49. Fjalë nga jeta shoqërore, gjini gjiri, gjeni gjëri (edhe te Buzuku, Budi e Bardhi e në kolonitë e Italisë), frati ‘bashkari, vëllazëri’ (te Buzuku e te Bardhi), qefali ‘kryetar, sundimtar’, permyqyr ‘kryeplak’, pronë, flamur, simahuer ‘ndihmës në një vrasje’, aspër ‘pare’, jeta shtëpiake: avlli, tagar ‘mangall’, gaforre, llukanik ‘suxhuk’, magjiri ‘kuzhinë’

Huazimet nga greqishtja e vjetër kanë pësuar shumë ndryshime strukturore, sepse u janë nënshtruar ligjeve fonetike të shqipes, ç'ka tregon jo vetëm hershmërinë e hyrjes së tyre në shqipë, por edhe vjetërsinë e shqipes (edhe pse ajo i ka trashëguar nga ilirishtja ato). Ndryshime fonetike kanë pësuar dhe huazimet nga greqishtja e mesme dhe e re edhe pse jo të përmasave të atyre nga greqishtja e vjetër.

Të tilla huazime janë bërë pjesë e brendshme, organike e shqipes, saqë është e vështirë të bësh dallimin e fjalëve të trashëguara nga ato të huazimeve të para të shqipes, p.sh., *jeremi* (ερημία) = murg që rron në vetmi; *naforë* (ναφορα) = kafshatë e bukës së meshës, *ajazëm* (αγιασμα) = ujët e bekuar, në këtë drejtim dëshmon dhe emri i lagjes Ajazëm në Shkodër; *Garentinë* = nga trajta e akuzativit (kallëzores) αρετην; *pezëm* (πεισμα) = kokëfortësi, inat, acarim; *piksidë* (πυξίδα) = kuti e meshës; *rogje* (ρογιον, ρογειον) = enë e vogël dhe e baltë për vaj.

Prof. Çabej, ka bërë dallimin e duhur midis huazimeve të mbarë gjuhës dhe atyre me përhapje të kufizuar (sidomos tek arbëreshët e Italisë dhe të Greqisë). Çabej mbajti qëndrim kritik ndaj disa përfundimeve të pasakta të nxjerra prej G. Meyer-it në fjalorin e tij etimologjik. Por, me këtë nuk duhet kuptuar që gjuhëtari ynë e ka nënvlerësuar ndikimin e huaj mbi leksikun e shqipes.<sup>88</sup>

Çabej është përpjekur t'i shikojë huazimet e shqipes në mënyrë sa më të plotë, duke vënë në dukje se edhe gjuhë të tjera, sidomos gjuhët ballkanike, diçka kanë marrë nga shqipja. Megjithëse e ka pranuar që për arsye të ndryshme historike, siç janë, ndër të tjera, pushtimet e gjata të Shqipërisë nga fuqi të huaja, shqipja më shumë ka marrë sesa ka dhënë<sup>89</sup>.

Shqipja në ditët e sotme i ka rritur shumë kontaktet me greqishten, kjo për shumë arsye, ndër të cilat do të veçonim se në Greqi punojnë si emigrantë ekonomikë rreth 700.000 shqiptarë. Ata ndodhen në një gjendje bilinguizmi, me shqipen si “gjuhë të zemrës” dhe me greqishten si “gjuhë të bukës”. Në leksikun e këtyre shqipfolësve gjejmë shumë greqizma si, *qinito*, *endaksi*, *signomi*, *efaristo*, *gjiro*, *psomi*, *nero*, *paidhaqe*, *buzuqi* etj., fjalë të cilat fatkeqësisht i gjejmë të përdorura dhe në Shqipëri ku nuk kemi situatë bilinguizmi.

Çabej në artikullin “Për pastërtinë e gjuhës”, pasi vë në dukje se “gjuha është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj” dhe se *shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është një tregues i nivelit të kësaj kulture*”, thekson: “Një nga detyrat kryesore të gjuhësisë shqiptare, krahas kërkimeve teorike, është dhe mbetet pasurimi i gjuhës me elemente të gurrave vetjake dhe spastrimi i saj prej masës së fjalëve të huaja, që kanë vërshuar së jashtmi dhe që po vazhdojnë edhe në ditët tona”<sup>90</sup>.

### III.3. Huazimet nga latinishtja në shqipen

Populli shqiptar ka një traditë të lashtë të fqinjësisë së mirë me popujt që ka pranë: qysh në mugëtirat e jetës njerëzore ia ka dashur puna të bashkëjetojë me fqinjët

<sup>88</sup> Shih: Sh. Demiraj, *Eqrem Çabej, Një jetë kushtuar shkencës*, Tiranë, 1986, f. 79-80

<sup>89</sup> Shih, po ai, po aty, f.81

<sup>90</sup> Artikull i botuar së pari në gazetën “Mësuesi” më 1979 dhe të ribotuar në revistën “Gjuha jonë”, 1, 1981.

Shih: Sh. Demiraj, *Eqrem Çabej, Një jetë kushtuar shkencës*, Tiranë, 1986, f. 133.

e vet, me grekët e latinët, pastaj edhe me të ardhurit nga larg, si sllavët e Jugut, duke dhënë e marrë me ta, ka përfituar prej dashamirësisë e përvojës së tyre, po edhe ua ka kthyer atyre të mirën me të mirë dhe, sidomos, me besën e pathyeshme e legjendare shqiptare.

Që nga lashtësia e deri në kohën e sotme dy brigjet tona, të Adriatikut e të Jonit, janë kapërxyer këmbyerazi, herë nga forca ushtarake, herë nga turma e grupe të mëdha popullore për të gjetur plang e shtëpi tek njëri-tjetri. Legjioneve romake që patën si pikëmbërritje Ilirinë e moçme, do t'u përgjigjeshin më vonë me shpatë në dorë forcat e njohura me emrin famëkq të *stradiotëve iliro-shqiptarë*, që përbëjnë edhe shtresën më të hershme të elementit etnik shqiptar në Itali.

Më vonë, në pasojë të fateve historike e të pësimeve nga hordhitë osmane, turma të mëdha arbëreshësh do të linin atdheun e tyre dhe do t'ia mësynin Greqisë ishullore dhe më pas, së andejmi, do të dilnin në brigjet e përtejme të Jonit në Kalabri e deri në Sicili. Ndërkaq, një masë tjetër arbëreshësh që u nisën nga Shkodra e Durrësi drejt brigjeve të Italisë qëndrore e veriore do të treteshin pa lënë gjurmë, përveç emrave etnikë të disa familjeve si: *Skutari, Spataro, Riolo, Scura, Masi* etj. që ndeshim edhe sot gjithandej metropoleve italiane.

Shtegtimi i emrave etnikë ka ndjekur dhe pasqyruar shtegtimin e popujve tanë. Nga Ballkani i lashtë drejt ishullit të Sicilisë janë përmendur shtegtime të personaliteteve më në zë të kulturës helenike. Diku në afërsi të Xhelës (it.Gella) prehen eshtrat e tragjedianit të madh grek, Eskilit, këtij vigani të mendimit të lashtë e të artit dramatik antik.

Në librin me ese "*Eskili ky humbës i madh*", Ismail Kadareja, ndër të tjera, shkruan se jeta e atij tragjediani të lashtë që e lidhur ngushtë me Sicilinë, ku edhe mbylli sytë si ushtar i thjeshtë. A nuk është një gjë për t'u habitur kjo? Më i madhi tragjedian i Greqisë së lashtë vdiste në Sicili dhe, për ironi të fatit, mbi varrin e tij nuk shënohet që ai të ketë qenë një krijues, por thjesht "*Eskili, bir i Euforomit*".

Prania e arbëreshëve në Greqi e në Italinë fqinje ka qenë dhe mbetet si një *urë miqësie*, si një shenjë afërie e lidhjesh shpirtërore e kulturore të popujve tanë. Në luftërat garibaldine për bashkimin e Italisë, sikundër dihet, prej mjediseve arbëreshe Garibaldi pati ushtarët më trima që përbënin "*ballin e luftës*" dhe që ai i lëvdoi, i nderoi dhe i shpërbleu për trimërinë e tyre.

Kohë më parë shkencëtarë e filozofë përdornin gjuhët e tyre amtare kur shkruanin veprat e tyre me një sintaksë transparente dhe leksik të fushës. Në të njëjtën kohë gjuha latine vazhdonte të ishte jo vetëm gjuhë e komunikimit ndërkombëtar midis shkencëtarëve dhe njerëzve të kulturës, por mbi të gjitha ishte valixhja e koncepteve të përbashkëta që pastaj do kalonin në gjuhët kombëtare.

Disa prej njerëzve të shquar fillojnë të shkëmbejnë gjuhën latine me gjuhën amë, duke mundësuar vënien në qarkullim të ideve për pasurimin e mjetit shprehës më të natyrshëm. Disa përdorin gjuhën amtare, por i përkthejnë veprat me vetëdijen se veprat e tyre mund të qarkullojnë veç duke i besuar gjuhës universale. Gjuha latine nuk ishte më gjuha e një populli të vetëm, e ushqyer nga folës të gjuhëve të ndryshme, ajo ishte gati t'u kthente atyre pasurinë që mbartte. Shkallë-shkallë pasuria në koncepte e mbledhur nga breza të tërë studiuesish në latinisht, dhe që u përkisnin

gjuhëve dhe kulturave të ndryshme, do zbrazet në gjuhët e Evropës, duke krijuar themelet e pasurisë së tyre.

Në kohën që po flasim gjendja duket me kahje të përmbysur, gjuha angleze duket e paracaktuar të thithë tërësinë e burimeve krijuese, duke i lënë gjuhët e tjera në anë të trungut kryesor. Gjithsesi të mos çorientohemi nga një gabim i perspektivës. Ashtu sikur në fillimin e shkencave modern, pasuria e shprehur në gjuhën sunduese ushqehet nga të gjitha kulturat, më një fjalë nga të gjitha traditat gjuhësore.

Gjuha angleze është kështu e pandashme nga multilinguizmi si lumi me degët e veta ushqyese. Sikur në të shkuarën edhe tani, kemi dy kanale që garantojnë qarkullimin e ideve dhe të leksikut të specialitetit nëpërmjet gjuhëve duke i mbajtur të gjitha të gjalla dhe vepruese. Kanali i parë është shkrimi shumëgjuhësh, i dyti përkthimi, i cili përbën dhe argumentin e këtij trajtimi.

Shkrimi shumëgjuhësh ngërthen përgjegjësinë e shkencëtarit në lidhje me gjuhën e vet. Për shembull, të shkruash në anglisht për çështjet e rëndësishme do të jetë gjithnjë e më e paevitueshme. Ajo që nuk është e paevitueshme është të lësh pas dore kultivimin e gjuhës amtare. Një studiues, i cili shkruan në anglisht hyn si protagonist në krijimin dhe qarkullimin e ideve. Nëse ky do të dojë të përkthejë në gjuhën shqip rezultatet e një pune më të gjërë, nuk i shkakton dështim por e ndihmon atë të qëndrojë në rrymën kryesore të krijimit duke e pasuruar gjuhën shqipe me leksik dhe tekste të tjera.

Në këtë pikë e ardhmja e gjuhëve evropiane natyrisht dhe e shqipes nuk është domosdoshmërisht në mëshirë të fatit, por varet nga zgjedhjet që do të bëjnë studiuesit. Për tëu lënë në trashëgim brezave të ardhshëm një gjuhë kulturore për të gjithë, Dante merrte nga burimi i përbashkët i latinishtes dhe njëkohësisht kontribuonte për ta ushqyer atë.<sup>91</sup>

#### III.4. Huazimet nga italishtja në shqipen

Takimi dhe bashkëjetesa shumëshekullore me gjuhën (përkatësisht dialektet) italiane të mjedisit ku u vendosën arbëreshët në Itali ka lënë gjurmë të thella edhe në të folmet e tyre. Për këtë na dëshmojnë huazimet e shumta dhe depërtimi i gjerë i italianizmave (përkatësisht i kalabrezizmave, sicilianizmave etj.) të cilave ua çelën shtigjet nevojat për komunikim dhe gjendja reale politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore e ngulimeve arbëreshe në Itali. Është fjala për huazime të kushtëzuara nga domosdoshmëria absolute që ndienin arbëreshët e Italisë për fjalë të reja nga dialektet italiane që i rrethojnë.

Ato fjalë shënonin realitete jo gjithmonë të reja në thelb, por të reja në shprehje. Më këtë lidhet edhe ai *përditësim fonik* që pësuan me atë rast mjaft nga fjalët që, (si italianizma e sidomos si latinizma të hershme të shqipes) arbëreshët i kishin pasur që para se të mërgoheshin nga Shqipëria si, p.sh.: *limun* "limon", *liun* "luan", *puc* "pus" etj. Ndikimi dhe depërtimi leksikor (por jo vetëm leksikor) që kanë ushtruar italishtja

<sup>91</sup>Shih: Artur Sula, *Mbi disaprobleme të përkthimit në gjuhën shqipe.*, në revista "Malësia", 5, Podgoricë, 2010, f.100-112.

dhe dialektet e ndryshme të saj mbi shqipen e ngulimeve arbëreshe përbëjnë një dukuri me interes të veçantë për kundrimin e takimit të këtyre dy gjuhëve.

Pleksen aty faktorë gjuhësorë të lidhur me dygjuhësinë apo me shumëgjuhësinë, si dukuri tipike për ishujt gjuhësorë, siç janë të folmet e ngulimeve arbëreshe në Itali; por ka aty edhe veprime të faktorëve jashtëgjuhësorë, si p. sh., domosdoshmëria e pasjes së fjalëve të reja për të shënuar realitete që mungonin në leksikonin shqip të atyre të folmeve. Mjedisi i ri ku u ngulën arbëreshët i vuri ata përpara nevojës për një leksik adekuat për realitetin e ri, në kushtet e një gjendjeje të re kulturore e shoqërore (të ndryshme nga ajo e Shqipërisë, prej së cilës ata tashmë ishin shkëputur përgjithmonë), e cila lehtëson dhe nxit procesin e huazimit.

Sigurisht, këtu është fjala për një shqyrtim të përditshëm të fjalëve dhe të termave që emërtojnë objekte apo gjendje e veprime konkrete, të cilat (për të përballuar jetesën) thithen e përjetohen ditë për ditë, krahas individëve apo grupeve të tjera joarbëreshe, që ushtrojnë të njëjtin lloj të punës së krahut në fshat. Identiteti në thelb i gjendjes midis popullsisë italiane (përkatësisht: kalabreze, molizane, siciliane etj.) dhe mërgimtarëve arbëreshë krijoi, me kohë, midis tyre, në mos solidaritetin, së paku domosdoshmërinë për të bashkëjetuar e për t' u kuptuar në fushat e jetës e të punës së përbashkët.

Nuk është fjala, pra, për ndeshjen me një trashëgimi gjuhësore, veçanërisht leksikore, më të pasur, më me prestigj dhe invaduese, por për një terminologji, si të themi, teknike, të përvetësuar gati me zor nga të ardhurit me qëllim që "të kuptojnë dhe të kuptohen" në mjedisin e ri në të cilin u takoi të vendoseshin. Ndërkaq, pikërisht për procesin e huazimit dhe të depërtimit leksikor të italishtes (përkatësisht të dialekteve italiane) mbi shqipen e ngulimeve arbëreshe nuk do lënë në harresë edhe shtimi i martesave të përziera.<sup>92</sup>

Krahas (dhe në ndërlikim) me huazimin e leksikut italian në të folmet arbëreshe ka qenë e vijueshme edhe bjerrja e shumë fjalëve anase (apo e huazimeve të hershme greke, latine etj.), çka u ka dhënë atyre të folmeve një fytyrë të veçantë, *i ka tjetërsuar ato mjaft leksikalisht në krahasim me shqipen e sotme*. Për t' u vënë re, në këtë mes, janë edhe një numër i madh izogramatizmesh a kalkesh strukturore që kanë hyrë në arbërisht nëpërmjet dialekteve të italishtes si, p.sh.: *rrini mir* "mirëmbeçi" (<it. dial. state bene); *rrinj ljug* "jam keq, nuk jam mirë" (< it. sto male); *bëri kanj* "ndërroi, këmbëu" (<it. dial. fece cagno); *ti a zë me mua* "ti kapesh me mua" (< it. dial. te la pigli con me); *bënj mjedhikun* "punoj si mjek" (<it. faccio il medico); *běj xapaturin* "punoj me shatë" (< it. faccio il zappatore) etj.

Kjo është aq e dukshme sa që mund të thuhet me siguri se *vështirësia për t' u kuptuar mirë një arbëresh me një shqiptar varet pikërisht nga ndryshimi i leksikut dhe shumë më pak nga ndryshimet fonetike e morfosintaksore midis të folmeve arbëreshe dhe shqipes së sotme*. Të kuptuarit e ndërsjellë mbështetet në një bazë të përbashkët të leksikut të të folmeve arbëreshe me shqipen e sotme, e cila (bazë), pavarësisht nga ndryshimet që vihen re nga një e folme arbëreshe tek tjetra, në një shifër të përafërt, rrok deri në 45% të fjalëve të sistemit leksikor të tyre, ndërsa 55 për qind e fjalëve të të folmeve arbëreshe paraqiten të ndryshme nga shqipja e sotme; ato e kanë gurrën

<sup>92</sup> Shih: L. Stassi, *La cultura siciliana nella parlata di piana degli Albanesi*, në "Etnia Albanese e Minoranze Etniche e Linguistiche in Italia", Atti del IX Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo, 1981, pp. 97.

kryesisht nga italishtja dhe, në një masë të kufizuar, nga greqishtja.<sup>93</sup> *Ka edhe raste kur të folmet arbëreshe (sigurisht jo të gjitha) ruajnë fjalë të vjetra shqipe që nuk përdoren më në shqipen dhe që atje kanë marrë edhekuptime të reja, për të cilat shqipja e sotme përdor huazimet romane.*

P.sh., në shumë nga të folmet arbëreshe të provincës së Kozencës *tirq-it* përdoret vetëm më kuptimin "pantallona", ndërsa në shqipen, siç dihet, kjo fjalë përdoret vetëm më kuptimin e saj të vjetër, si emërtim i veshjeve burrishte prej shajaku.<sup>94</sup> Po kështu, *ligj* tek arbëreshët përdoret vetëm në shprehjen e ngurosur: *ke ligj* "ke të drejtë", ndërsa me kuptimin e ligjit si term juridik përdoret *lexhe* o *lexhi* (nga it. *legge*).

Të shumta janë edhe rastet kur fjala si njësi fonetike në arbërishten dhe në shqipen e sotme del e njëjtë (ose me ndryshime të vogla fonike), por me kuptime të ndryshme. P.sh.: nga, në shumë të folme arbëreshe, ka kuptimin çdo, secili: *nga gjisht një unazë* "çdo gisht një unazë", *nga menat* "çdo mëngjes"; në të folmen e Shënkollit, të Garrahës etj. në anët e Katanxaros, përemri çdo / çëdo ka kuptimin "disa, ca": *çëdo vashaz* "disa vajza"; në mbarë të folmet arbëreshe të Kalabrisë e të Sicilisë folja *punoj* (*pinonj, punonj, pënoj* etj.) del vetëm me kuptimin "lëroj tokën, punoj me parmendë": *jam e punonj me llopët, jam e pënoj te dherat ahjimas*, ndërsa për kuptimet e sotme të foljes *punoj* të shqipes në arbërishten e Italisë përdoret shërbej (*zhbenj, shurbenj, shërbej*).

Folja qindroj në të folmen arbëreshe të Horës (Piana degli Albanesi) ka kuptimin "mbes, mbetem", ndërsa në Karfici të Katanxaros përdoret edhe me kuptimin vepror kalimtar "ndaloj dikë": *Ti m'u fruntarte e ure të qindrova*.<sup>95</sup> Ndryshime të tilla janë të shumta, por, duke qenë se ato nuk janë kudo njësoj në të folmet arbëreshe, kërkojnë një trajtim më të gjerë, të cilin do ta bëjmë në një krye të veçantë.

### III.5. Huazimet nga gjuhët orientale në shqipen

Fjalët e huazuara janë dëshmi të lidhjeve kulturore e historike ndërmjet popujve. Fati historik i ka bërë shqiptarët një popull ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes. Edhe kultura shqiptare është e mbrujtur me elemente të rëndësishme të të dyja anëve të këtij horizonti. Element themelor dhe shprehës i kulturë është gjuha.<sup>96</sup> Kur marrim në shqyrtim pikëtakimet, raportet dhe shkëmbimet e kulturave dhe gjuhëve të ndryshme, si në rastet kur është fjala për fqinjësi e mundësi ndërndikimesh nga afër, ashtu edhe në rastet e ndërndikimeve nga larg, gjithmonë mbetet në fuqi parimi i njohur i shkëmbimeve kulturore: e reja i pranëvitet (në mos edhe i mbivitet) së vjetrës, modernja ose, në mos tjetër, më e përparuara, ia merr vendin së prapambeturës, porse kjo kryhet gjithandej e gjithmonë në kushtet e një lufte të ekuilibrit e në një vijë luhatëse që ka si bosht konservacionin a ruajtjen, qoftë edhe të dëshpëruar, dhe inovacionin ose risimin, qoftë edhe me kushtin e etiketimit të ashpra nga pjesa jomoderne.

<sup>93</sup> Shih: I. C. Fortino, *Restaurime gjuhësore në fushën e arbërishtes*, "Gjuha jonë", 3, 1984.

<sup>94</sup> Shih: GA, *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 2000.

<sup>95</sup> Shih: "Fletore në arbërishten" - *Quaderno in albanese*", Raccolta fatta da Maria Delphina Rossano, Catanzaro, 1984, pp.14.

<sup>96</sup> Emil Lefe, *Persizmat në kuadrin e orientalizmeve të shqipes*. – *Perla* 4/1999, 1, 39–46.

Kjo ka ndodhur, pa dyshim, edhe në rastin e takimit dhe ndërndikimeve shumëshekullore të gjuhës, kulturës dhe prurjeve me burim osman (përkat. arabo-turk e më gjerë, pa tjetër edhe persian) në mjediset shqiptare. Ndeshja, qoftë edhe në kushte e për arsye të shtimit të hapësirave të vëna nën sundim, jo vetëm e Arbërisë së moçme, kryesisht analfabete dhe me zhvillim gjithsesi të mekët kulturor, me perandorinë më të regjur ushtarake të Mesjetës së vonët e që do të zgjaste deri në vitin 1912 të shek.XX, nuk mund të mbetet vetëm një atmosferë luftimesh, pavarësisht se ato, sikundër dihet, herë më ashpër e herë më mbyturazi, qoftë edhe në formën e kryengritjeve fshatare, nuk do të binin gati kurrë fashë, ka pasur kohë të gjatë e të mjaftueshme për të ushtruar edhe ndikime të forta gjuhësore.

Prapa këtyre trysnive kanë qenë elementet kulturore, gati gjithnjë edhe superiore ndaj asaj çfarë ndjente një hapësirë kryesisht fshatare dhe me urbanizim gati krejt të rrënuar e Shqipërisë, qysh nga koha kur quhej Arbëri (*Arbëni*) e deri në agimin e kohës së re, kur do të quhej Shqipëri (*Shqypni, Shqipni*) nga vetë shqiptarët dhe Albania, nga evropianët e përgjithësisht të huajt. Në këtë mes, sigurisht, nuk janë pa interes edhe etnonimet e ngjashme, kryesisht në mjediset osmane-sllave, si: *Arnaut, Arbanas, Arbënesh* etj.

Siç e kishte vënë re me kohë T. Dizdari, orientalizmat në përgjithësi, dhe gjithashtu persizmat si pjesë e tyre, kanë ardhur duke u rralluar në përdorim e duke u pakësuar. Megjithatë tërheq vëmendjen larmia e fushave kuptimore (rreth 20) që mbulojnë persizmat. Emërtimet nga fusha e kuzhinës dhe e gjellëtarisë, d.m.th. emërtime gatesash, ëmbëlsirash, pijesh, lëndësh ushqimore e përdorësesh të kuzhinës, zënë vendin e parë me rreth 40 fjalë.

Ndër to, prof. E.Lafe, studiuesi që është marrë gjerë më këtë fushë, ka përmendur: *burani, jahni, meze, paçe, pilaf, qofte, trahana, turshi; paluze, pelte, reçel, revani, sheqerpare, zerde; bozë, narden, pekmez; maja, nisështë, sheqer; çini, farfuri, hanxhar, havan, kuze, qepshe, rende,tas, tavë; majhosh, taze*. Shumica e këtyre fjalëve i përkasin leksikut aktiv, d.m.th. janë fjalë që përdoren gjerësisht, janë emërtime të vetme për sendet që shënojnë. Pa dyshim kjo lidhet me shkallën e lartë që kishte arritur prej kohësh arti i kuzhinës në Iran.<sup>97</sup>

Pas tyre renditen emërtimet që lidhen me banesën dhe me pajisjet e saj (23 fjalë), si *avdeshanë, baxhë, çerçive, gjerdek, kafaz, qoshe, reze, bohçe, çarçaf, destemel, divan, legen, paçavure, perde, peshqir, poste, postiqe, qilim* etj. Siç mund të vërehet, me modernizimin e jetës një pjesë e këtyre fjalëve po dalin nga përdorimi. Nga fusha e bimësisë (drurë frutorë e jofrutorë, perime, lule etj.) ka mbi 30 emërtime, si: *bajame, fëstëk, gonxhe, hurmë, idërshah, jargavan, jasemin, manushaqe, nerënxë, pambuk, panxhar, patëllxhan, razakishebojë, shefteli, zerdeli, zymbyl*. Shumica e tyre janë fjalë të leksikut aktiv, emërtime të vetme për drurët a bimët që shënojnë.

Nga fusha e almiseve dhe përdorëseve kemi gjithashtu rreth 20 fjalë, si: *bel, çark, çengel, çirak (kandil), gjergjef, llullë, masur, nargjile, nështë r, palldëm, perdah, pergjel, qase, qese, shishe, terezi, tezgjah, zemberek, zumpara*. Edhe këto në pjesën më të madhe janë fjalë të leksikut aktiv. Rreth 20 fjalë të tjera kanë të bëjnë me njeriun dhe me tiparet e tij fizike e morale; të tilla janë: *ferishte, naze, nazik,*

<sup>97</sup> Shih: Emil Lafe, *Persizmat në kuadrin e orientalizmave të shqipes*. – *Perla* 4/1999, 1, 39–46.

*neqez, nishan, paq, perçe, pishman, qel, qelan, qorr, sarhosh, serbes, shend, viran, xhadi, xhan, xhanan, xhymert, zor, zylyfe.* Një pjesë e mirë e tyre kanë fituar ngjyrimet stilistike<sup>98</sup>

Një fushë tjetër, përsëri me rreth 20 fjalë, është veshmbathja dhe lëndët që përdoren për të. Këtu hyjnë fjalë si: *anteri, çember, çarap, humai, ibërshim, meshin, pambuk, papuçe, perçe, qelepoçe, qyrk, shallvare, taç, tafta, tumane* etj. Me modernizimin e jetës edhe një pjesë e tyre tashmë kanë dalë nga përdorimi aktiv. Persizmat shtrihen edhe në një varg fushash të tjera semantike, si emërtimet e mjeshtërive (*çirak, çoban, usta, xhambaz*); tregtia dhe transporti (*badihava, dyqan, para, pazar, peshin, qar, deng, karvan* etj.); kozmetika dhe stolitë (*gjerdan, lajle, mazi, myshk, perishane, zile* etj.); pjesë të qytetit e të ndërtimeve në të (*çarshi, çezmë, gjiriz, han, mejhane, pazar, saraj, shatërvan*); emërtime fetare (*dervish, gjynah, gjynahqar, hoxhë, namaz e nevrüz* etj.).<sup>99</sup>

Fjalë me burim nga persishtja ka edhe në leksikon ushtarak (*çadër, dylbi*, ndërsa *kumbara, shishane, xhephane* janë bërë tashmë historizma). Nga fusha e muzikës kemi fjalët: *çapare-t, qemane, saze e zurna*, po ashtu *aheng*. Nga fusha e bujqësisë dhe e botës shtazore kemi pak fjalë, si *bahçe, bahçevan, bostan, hergjele, zarzavate; bilbil, çakall, fil, kumri, lejlek*.

Kjo dëshmon se ndikimi i persishtes lidhet kryesisht me jetën qytetare, me kulturën e jetesës. Persizmat kanë shërbyer jo rrallë edhe si tema fjalëformuese duke u bashkuar me prapashtesa ose me tema të tjera të shqipes. Kështu nga *behar* kemi *beharisht e beharor*, nga *qorr* kemi *qorroj, qorrohem, qorrim, qorras, qorrazi, qorrollis, qorrollisem, qorrollisje* etj.

### III.6. Huazimet nga turqishtja në shqipen

Siç dihet, gjuha shqipe hyn në gjuhët indoeuropiane, kurse turqishtja hyn në grupin e gjuhëve uralo-altajike; fonetika, morfologjia, dhe sintaksa janë krejtësisht të ndryshme; por, prapëseprapë fjalë të ardhura nga gjuha turke janë përshtatur ligjësisë tona fonetike, morfologjike e sintaksore. Duke qenë se pushtimi turk pati ndikim mjaft të madh në etno-kulturën tonë për 500 vjet, pati edhe një fluks mjaft të madh fjalësh turke në shqip. Këto fjalë u përdoren thuajse në të gjitha sferat e jetës, si në terminologjinë fetare, në etnografi, në ndërtime dhe kudo.

Duke qenë se ne i jemi larguar mjaft ndikimit turk, dalëngadalë edhe këto fjalë po e humbasin përdorimin e tyre të dikurshëm. Në fjalorin e administratës thuajse këto fjalë nuk ekzistojnë më. Dalëngadalë edhe nga fjalori ynë do të dalin përgjithmonë këto fjalë, sepse përdoruesi nuk e shikon më të arsyeshme t'i përdorë këto fjalë. Disa dhjetëra fjalë i kanë gjegjëset e tyre në shqip, disa janë krijuar më vonë dhe gjuha shqipe duke qenë se është një gjuhë mjaft dinamike është duke i zëvendësuar turqizmat. Të mos harrojmë se 500 vjet pushtim nuk ishin pak por, megjithatë, për hir të forcës ruajtëse të shqipes, si thotë Kadareja në një poemë "*kështjellat e sintaksës nuk i morën dot*".

<sup>98</sup>Emil Lafe, *Persizmat në kuadrin e orientalizmave të shqipes*. – *Perla* 4/1999, 1, 39–46.

<sup>99</sup>Emil Lafe, *Persizmat në kuadrin e orientalizmave të shqipes*. – *Perla* 4/1999, 1, 39–46.

Mbi këtë çështje të huazimeve nga turqishtja, gjuhëtarët mendojnë me të drejtë se "Fjalori i orientalizmeve në gjuhën shqipe", Tiranë 2005, i Tahir Dizdarit është një vepër cilësore dhe jep një ndihmesë të madhe. Autori shtjellon 4406 huazime të gjuhëve orientale në gjuhën shqipe, *hyrë thuajse të gjitha nëpërmjet turqishtes*. Fjalori i Dizdarit ka një numër jo të vogël fjalësh të pastra shqipe, që autori i përdor si sinonime, me dhanë kuptimin e orientalizmeve që i trajton. Duke qenë sinonime, *siç u tha dhe më sipër*, fjalët shqipe të Fjalorit shërbejnë me e çuar përpara zëvendësimin e fjalëve të huaja, në këtë rast me gurrë Lindore, me *fjalë të mirëfillta shqipe*, që përcjellin të njëjtin kuptim.

Turqizmat në shqipe hynë së bashku me kulturën osmane: kulturën materiale (jetesa e përditshme, mallra konsumi, zeje, veshje), kulturën shpirtërore (leksiku fetar), kulturën ekonomike dhe juridike, dhe kulturën shtetërore-administrative. Po, le të ndalemi në tipologjinë a grupimin e parë, natyrisht mjaft të përgjithshëm e pa mbidetajime, të ndikimeve dhe depërtimeit të leksematikës, frazeologjizmeve dhe përgjithësisht elementeve kulturore osmane në gjuhën shqipe dhe në hapësirat etnike të quajtura hershëm arbënore e më pas shqiptare:

*a. Ndikim nëpërmjet gjuhës se shkrimit*, që zë fill, me siguri, më së pari, kryesisht nëpërmjet administratës osmane të ushtrisë dhe personelit të saj që kryente ose ushtronte sundimin në vilajete, që lidhet me dyndjen ushtarake të tyre. Vetë fjala *vilajet,-i*, bashkë me *qitap* e *qatip*, pastaj me *zabit*, *nizam*, *xhelep*, do të hynin me shpejtësi si uji në arat e lëruara dhe do të vrujonin aty, madje edhe duke ua zënë vendin fjalëve shqipe, por sidomos duke plotësuar aty "poret" a gollet e terminologjisë, sidomos, ushtarake, po edhe përgjithësisht diturore, me fjalë, frazeologjizma e mënyra të thëni që, ndonëse vinin nga goja e pushtuesve, pa shkuar shumë kohë, do të lëshonin rënjë të thella në përdorimin në gojën e shqiptarëve,.

P.sh. *kala,-ja*, mund të thuhet se e mënjanoi krejt kështjellën, duke u futur edhe në frazeologjizma e deri në emërtime lojërash popullore, si *kaladibrance*, *bëjkala*, *marrkalanë* dhe, sidomos, në toponimi, duke u bërë gati gjithandëj zotëruese emërtimet që përmbajnë fjalën **kala**: *Kalaja e Gjirokastrës*, *Kalaja e Shkodrës*, e *Lezhës*, e *Petrelës*, e *Krujës*, e *Sfetigradit*, e *Elbasanit*, e *Durrësit* etj. Me kohë, në rrjedhë të moteve, do të shtrohej këmbëkryq në trevat shqiptare edhe terminologjia diturore, qoftë edhe në aq sa përfshinte hapësira, në krye të herës e ngushtë, por kurdoherë në zgjerim, e rrezatimit të ardhësve mbi vendasit, ku, përveç (dhe krahas) fjalëve: *qitap* (Kitap kitabi) e *qatip*, *rrah kitabin*, do të vinin pa shkuar gjatë edhe *mejtep,-i*, *tefter,-i* (Defter), dhe shumë fjalë të tjera si *xhevap*, *haber* (*marr haberin*, *çoj haberin*, *jap haberin*: *Veli Pasha çon haberin*, *tëtan Shqypnisë po m'ia lyp asqerin....*, *pushka habertare* etj.

*b. Elementi shqiptar në ushtrinë osmane dhe pasojat gjuhësore të atij takimi*. Vetë Gj. K. Skënderbeu, i marrë peng bashkë me të vëllezërit Stanisha e Reposhi, sikundër rrëfen historia, u rrit në oborrin e Sulltanit, atje u shkollua, u pagëzua me emrin ushtarak Iskander Bei dhe rrojti disa kohë në Turqi, ku, natyrisht, nuk ka qenë as vetëm, as i vetmi rast i bijve të feudalëve shqiptarë të nënshtruar. Nuk mund të mos hulumtohet me këtë rast, qoftë edhe përciptazi, onomastika osmane që dëshmon praninë e elementit me origjinë shqiptare në hapësirat e Turqisë së sotme e më gjerë. Stambolli dhe Ankaraja janë plot me shqiptarë, sidomos me shqiptarë të Kosovës, të shpërngulur në gjysmën e dytë të shek. XX, por edhe të tjerë, natyrisht më të hershëm, që u kanë përkritur figurave të dalluara e të larta në administratën osmane, si p.sh.

Pashko Vasa, i mbiquajtur Vaso Pasha Shkodrani, që qe deri në postin e guvernatorit të Bejrutit etj.

*c.Pykëzimi i enklavave osmane në viset e ndryshme të Ballkanit, si në qytetin e Prizrenit etj.*<sup>100</sup>

Së pari, po parqesim disa shqyrtime teorike dhe metodologjike lidhur me frazeologjizmat e huazuara sipas studimeve të prof. Akademik Jani Thomai:

a) Pjesa më e madhe e turqizmeve u përket fushave të lëvizëshrne, si fushës së marrëdhënies shoqërore, ekonomike, të administratës, të luftës, të urbanistikës, të veshjeve, të fesë, të kuzhinës, të zakoneve etj., prandaj ka qenë edhe e paqëndrueshme. Kështu, kanë dalë ose po dalin nga përdorimi shumë fjalë me burim nga turqishtja, që janë zëvendësuar me fjalë shqipe:

aksham-i me “mbrëmje”, ainan pasth. “të lutem”. penxhere-ja “dritare”. sabah-u in. “mëngjes” ..., ose fjalët që lidheshin me shoqërinë dhe me organizimin feudal: *kajmekam-i, vali-u, xhelep-i*, si edheshumë fjalë të tjera që janë vjetruar e janë bërë arkaizma.<sup>101</sup>

b) Shumë fjalë me burim nga turqishtja në shqipe kanë marrë ngjyrim emocionues e stilistik (kryesisht keqësues) dhe disa prej tyre përdoren si mjete stilistikisht funksionale, kryesisht për këtë ngjyrim: *baballëk, bejiexhi, dembel, derdimen, dyfek, dynja, matrapaz, matrapazllëk, mejhane, pazarllëk, serrat, topçi, yxhin...* Këto huazime përdoren në letërsinë artistike për karakterizimin e elementeve, të kohës së ngjarjeve (sidomos në shkrime satirike e humoristike), pra si mjete me vlerë stilistike. Si shembull po sjellim këtu disa vargje nga vjersha e Fan Nolit “*Kënga e Salep-Sulltanit*”:

*“Një mexhlis të madh na çeli / Pandeli Jano Vangjeli, / me sulltan - llokum na veli / si kofini pas të vjeli.*

*Koço Kota mjek hanxhari/ nis një valle palikari, / se me një ferman kusari / sadrazem u bë firari. /Se ç’u shporr xhumhurieti, /se ç’u rehatos mileti, /*

*se Sulltanin prapë e gjeti, / se, që kur e humbi, s’fjeti.*

Siç shihet, ndër 27 fjalë kryesore, 9 fjalë (1/3) janë turqizma.

c) Shumë fjalë me burim nga turqishtja në leksikon tonë nuk janë tema prodhuese për formimin e fjalëve të reja. Kjo karakteristikë është një shenjë tjetër që tregon se ato nuk kanë hyrë thellë në strukturën leksikore të shqipes.

ç) Disa fjalë të këtij burimi kanë qëndruar në leksikon tonë vetëm në shprehje të ngurosura; jashtë këtyre nuk përdoren: bëj *derman*, u bë*helaq*, s’bëhet *kabull*, s’kam *gajle*, s’kam *qeder*, më zuri *qederi*.

d) Shumë fjalë me burim nga turqishtja kanë mbetur në të folmë të veçuara (në

<sup>100</sup>Shih: *Historia e Shqipërisë*; Selami Pulaha, *Defteret osmane*. Shek 17-18

<sup>101</sup>Shih: J.Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f.254.

tëfolmet e Shqiperisësë mesme, në të folmet verilindore etj.) ose në rrafshin e ligjërimin të thjeshtë dhe nuk kanë hyre në leksikon e gjuhës standarde.

Huazimet turke duhen parë si pasqyrim i periudhës osmane në gjuhën shqipe. Në këtë kuadër do të trajtohet përshtatja fonetike dhe morfologjike e huazimeve turke në shqipen, duke shqyrtuar dukuri relativisht të hershme, siç janë problemi i theksit fundor të turqizimeve dhe trajtimi i tyre i diferencuar në arealin toskë e gegë<sup>102</sup> (i ashtuquajtur i rregullim mekanik i theksit, d.m.th.kalimi i theksit nga rrokja e fundit në atë të parafundit; tipi *káfe* për *kafé*, *tenxhére* për *tenxheré*, *bába* për *babá* etj.)<sup>103</sup>.

Së dyti, ka interes të trajtohen probleme të onomastikës shqiptare me leksema turke p.sh.: *tepe*, *Tepelenë*, *Kodrat* e *Tepes* (po ta përkthejmë fjalë për fjalë *Kodrat* e *Tepes* do të thotë *Kodrat* e *Kodrës*; është rast i pastër i dyfishimit administrativ të një emërtimi anas, siç e kemi edhe te *Guri* i *Kamjes*)<sup>104</sup>; *Kus Baba*<sup>105</sup> (që për humor shqipfolësit i kanë vënë përballë edhe një *Kus Lala* – njëri në Vlorë e tjetri në Lushnjë etj.).

Po ashtu vlen të trajtohet edhe problemi i vajtje-ardhjeve të emrave të përveçëm me origjinë turke, ku një vend të rëndësishëm zënë emrat e vendeve të shenjta ose të shenjtorëve myslimanë, si: *Muhamet*, *Ahmet*, *Hajrullah*, *Islam*, *Isamedin*, *Nuredin* etj. Tkurrja e elementit me origjinë turke si pasojë e trysnisë kombëtariste, materializuar kjo me emra nga brumi i shqipes, kryesisht në Kosovë e në trojet shqiptare, të cilat shquhen si vatra të “modës atdhetare” të emrave vetjakë.

Që nga Rilindja e këtij gjuha shqipe nuk u çlirua kurrë prej orientalizmeve, shumica e të cilave janë fjalë që emërtojnë sende të përdorimit të gjerë. Mund të themi madje se jo pak nga huazimet nga turqishtja, por edhe përgjithësisht orientalizmat me kohë nuk ndihen më si barbarizma, por thjesht si huazime ose si fjalë që, siç thoshte prof Çabej “janë bërë tashmë mishi e ashti i shqipes”<sup>106</sup>.

Për shembull fjalë si: *tepsi*, *zinxhir*, *bojë*, *raki*, *çorap*, *çarçaf*, *çizme*,  *pazar*, *berber*, *kasap*, *bajrak*, *kanun*, *xhelat*, *hoxhë*, *dervish*, *synet*, *bori*, *daulle*, *dyfek*, *fital*, *xhep*, *dyshek*, *jorgan*, ndihen shumë pak si të huaja.<sup>107</sup> Me fjalë të tjera edhe ky mjeshtëri i madh dhe njohës aq i mirë i pasurisë dhe vlerave të shqipes, i mbante disa prej orientalizmeve si të pazëvendësueshme, ose së paku si vështirësisht të zëvendësueshme.

Me shkëputjen e Shqipërisë prej sferës kulturore osmane, numri i turqizimeve në përdorim do të vinte duke u ulur natyrshëm. Teksa shoqëria shqiptare i kthente sytë nga Perëndimi, një numër i madh fjalësh që lidheshin me botën osmane do të dilnin vetvetiu nga përdorimi. Kush kishte më nevojë për *bimbash*, *sadrazem*, *kadi*, *vali*, *vezir*, *mytesarif* dhe *qatip*, në rrethanat kur këto figura profesionale u zhdukën nga qarkullimi?

<sup>102</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistikë shqipes*, Tiranë, 2009.

<sup>103</sup> Shih: J.Gjinari-Gj.Shkurtaj, *Dalektologjia*, SHBLU, Tiranë, 1997, f.197 dhe Rexhep Ismajli, *Për zhvillimet në fushën e gjuhës standarde*, Landskrona, Suedi, 2005.

<sup>104</sup> Shih: Gj.Shkurtaj, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, SHBLU, Tiranë,2001, f. 74-79.

<sup>105</sup> Këtë mikrotoponim Kadareja e përdor si emër të përveçëm për një nga personazhet e tij te “*Viti i mbrapshtë*”.

<sup>106</sup> Shih Gjovalin Shkurtaj, *Si të shkruajmë shqip*, Botimet Toena, Tiranë, 2008, f. 226.

<sup>107</sup> Shih Eqrem Çabej, *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*, SF 4, 1975.

Veç kësaj, një numër i madh turqizmesh kishin hyrë në shqipe pa nevojë; meqë shqipja i kishte fjalët përkatëse. Për shembull, kishin hyrë dhe përdorshin fjalë si *zaman* dhe *sene*, edhe pse shqipja i kishte fjalë si *kohë* dhe *vit*. Gjuha zakonisht nuk i duron dot sinonime të tilla absolute; dhe kur letërsia shqipe që po lëvrohej rishtas nisi të hedhë në qarkullim fjalë thjesht shqipe, atëherë barasvlerat e tyre në turqisht nisën të dalin nga përdorimi.

Në masë të madhe, një ligjërim shqip i mbytur nga turqizmat po kthehej në shenjë dalluese të *shtresës së mesme qytetare* të kultivuar nga Perandoria Osmane, e cila përçonte, nga qendra drejt periferive, vetë pushtetin osman. Jo rastësisht, kjo shtresë e mesme qytetare do të konsumonte jo vetëm marrëdhëniet ekonomike, tregtare, juridike, fetare dhe politike të kohës, por edhe disa aspekte kulturore tipike të periudhës, siç ishte letërsia shqipe me alfabet arab, ose e bejtexhinjve.

Përhapja sociale e turqizmave në shqipe nuk ndikohej aq nga ndarja në myslimanë e të krishterë, sesa nga ndarja qytet/fshat; mjaft të lexojmë disa poetë katolikë shkodranë të fillimit të shekullit XIX (Leonard De Martino, Pjetër Zarishi), për të parë se deri në ç' masë kishin depërtuar këto turqizma në shqipen "e kultivuar". Përkundrazi, fshati shqiptar kishte mbetur relativisht i paprekur prej tyre, sidomos sa i përket leksikut abstrakt dhe të kulturës. Sa më shumë që lëvruesit e gjuhës dhe të shkollës shqipe, të shumtë dhe të përkushtuar gjatë Rilindjes, nisën të vënë në dispozicion të folësve *fjalë shqiptetë mirëfillta*, aq më problematik do të bëhej statusi i turqizmave në shqipe, në fillim të folur, pastaj të shkruar.

Këtu duhet pasur parasysh edhe se turqizmat kishin hyrë relativisht vonë në shqipe dhe nuk ishin integruar dot mirë në sistem; p.sh. nuk ishin bërë produktive, duke u ofruar si tema për fjalë të tjera, por kishin mbetur relativisht si mish i huaj, leksikisht të izoluara. Veç kësaj, pjesa më e madhe e tyre ishin emra, ndërsa foljet ishin fare të pakta; çka e kufizonte edhe më aftësinë e tyre për të ndërvepruar në gjuhë – po të kihet parasysh, se nga foljet mund të kalohet lehtë në emra prejfoljorë abstraktë të veprimit dhe në gjithfarë mbiemrash prejpjesorë, etj. Të krahasohet, bie fjala, *defter* me *fletore* dhe të vihen re lidhjet horizontale të së dytës me *fletë*, *shfletoj*, etj.

Fati i turqizmave të shqipes u vendos nga një konvergjencë: vullneti i Rilindësve për ta pastruar gjuhën nga turqizmat konvergoi me vjetërimin e vetvetishëm të turqizmave, për arsye historike (shkëputja e Shqipërisë nga bota osmane). Praktikisht të gjithë shqiptarët mësuan të shkruajnë shqip me tekste të ndërtruara sipas parimeve gjuhësore të Rilindjes. Turqizmat që mbijetuan gjatë gjysmës së parë të shek. XX, mbijetuan në ligjërimin e folur, të shtresës kryesisht analfabete të popullatës.

Ndërkohë, për hir të mendësisë së Rilindjes dhe një zgjimi të përgjithshëm të krenarisë kombëtare, por edhe kthimit të vështrimit kulturor drejt Perëndimit, elitat në Tiranë, në Shkodër, në Korçë, në Elbasan dhe në Gjirokastër do t'i konsideronin turqizmat e shqipes si shenja të një mendësie orientale, anadollake, turkoshake, nga e cila do të distancoheshin me përkufizim, për të merituar statusin e tyre të ri si elita kombëtare të Shqipërisë. Brenda një shekulli, statusi i turqizmave në ligjërimin joletrar u përmbys: nga mishërimi i mendësisë urbane perandorake, në mishërim të

mendësisë së prapambetur, fshatarake, provinciale të shqiptarit të vjetër, që i kishte mbetur ora “në kohën e turkut.”

Ndërkohë, purizmi – që është gjithnjë i gabuar – kishte filluar të jepte efekte anësore të padëshiruara, duke *e varfëruar* shqipen letrare. Noli, që ishte ndoshta i pari shkrimtar shqiptar që ia pa shqipes së re mangësitë e mëdha, kur e ballafaqoi me gjuhë dhe shkrimtarë madhorë në punën e vet si shqipëruës, u detyrua... t’i kthejë disa turqizma në shqipen e vet poetike; dhe këtu s’e kam fjalën për poezi satirike, si Kënga e Salep Sulltanit, por edhe për poezi të stilit të lartë, si ato për Bajram Currin dhe Luigj Gurakuqin.

Me Nolin ndodhi kështu një tjetër ndërrim paradigmatic; që nga ajo kohë, turqizmat nuk është se u dëbuan nga gjuha në mënyrë të padiskriminuar, por vetëm u rivlerësuan nga pikëpamja stilistike ose e përdorimit. Kjo do të kërkonte, gjithsesi, shumë kohë për t’u realizuar.

Një koleg, në një koment të lënë në temën tjetër, shkruante – po parafrazoj – se pse qenka kaq e vështirë të ndërrohen toponimet e huaja, kur janë ndërruar “fjalët *tenxhere* dhe *penxhere*.” Në fakt, komenti është tipik për të ilustruar pështjellimin në mendjen e njerëzve, kur vjen puna për turqizmat e shqipes. *Tenxhere* dhe *penxhere* nuk janë ndërruar – të gjithë i dimë dhe i përdorim. Çfarë ka ndryshuar, është statusi i tyre – veçanërisht për *penxhere*, e cila është zëvendësuar, në tekste neutrale (p.sh. një manual i arkitekturës), nga *dritare*, që është neologjizëm (fjalë e krijuar në tavolinë). *Penxhere*, ndërkohë, është kufizuar disi në përdorim, duke fituar edhe ngjyrim stilistik.

Kjo u ka ndodhur tashmë shumë turqizmave: nuk janë larguar krejt nga gjuha, por vetëm janë “shenjuar” stilistikisht, nëpërmjet një procesi në thelb letrar, që e ka pasuruar gjuhën. Të krahasohet, p.sh. fjala *dynja* me fjalën *botë*; unë besoj se shqipja vetëm ka fituar, duke i mbajtur të dyja fjalët, sepse *dynja* jep disa nuanca specifike, të cilat *botë* nuk i jep dot.

Mund të thuhet, pa e tepruar, se sot turqizmat janë një pasuri e rrallë e shqipes, e cila gjen shprehje në regjistra të caktuar gjuhësorë, sidomos në letërsinë satirike, në teatër, dhe në përgjithësi në ligjërimin bisedor. Madje ligjërimi bisedor, si sistem i pavarur nga dialektet – ose diferencimi gjeografik i shqipes – nuk do të krijohet dot pa rehabilitimin stilistik të turqizmave.

Rilindësit vërtet u nisën të “pastrojnë” shqipen, sepse e tillë ishte koha. Njëllon si shqipja ishte pastruar më parë greqishtja (nga turqizmat) dhe rumanishtja (nga sllavizmat); më pas, të njëjtat “turqizma” (në fakt, orientalizma) që u dëbuan prej shqipes do të dëboheshin edhe prej *turqishtes moderne*, krahas me ndërrimin e alfabetit në atë gjuhë.

Megjithatë, pastrimi nuk është asnjëherë politikë gjuhësore e mirë. Një nga kritikantët që i kanë bërë Naimit, sidomos nga Shkodra, ka qenë se gjuha e tij tingëllon e sheshtë, për të mos thënë e varfër; dhe gjithsesi monotone. Në fakt, po të nxirret nga konteksti historik dhe letrar i kohës, gjuha e Naimit ashtu është: artificiale, e varfër në mjete leksikore, e sheshtë. Mirëpo kritika vetë është anakronike, sepse harron të marrë

parasysh sa eksperimental ishte Naimi; dhe sa *e re* do të ketë tingëlluar shqipja e tij, në veshët e shqiptarëve të kohës.

Gjithsesi, kjo është çështje tjetër. Çfarë dua të theksoj, është se purizmi, si politikë gjuhësore, nuk funksionoi – dhe nuk mund të funksiononte, me gjithë zellin me të cilin u zbatua ndonjëherë. Ndoshta shërbeu në fillim, kur duhej vendosmëri dhe sakrificë, për t’u shkëputur nga Perandoria Osmane dhe përqafimi i saj politik, ekonomik dhe kulturor; por kjo nuk ishte arsye për ta sanksionuar si politikë zyrtare në pavarësi nga rrethanat.

Përkundrazi, politikë e drejtë me turqizmat e shqipes do të rezultonte *disiplinimi* i tyre – i cili u arrit shkallë-shkallë, krahas me lëvrimin e shqipes si gjuhë polifunkionale, veçanërisht në sferat e letërsisë, të teatrit, të filmit, të televizionit. Sa më i artikuluar bëhej ligjërimi shqip, aq më shumë kishte nevojë për diferenca – të cilat do t’i përmbushte, ndër të tjera, edhe duke shfrytëzuar thesarin leksikor të turqizmeve, të cilin më kot ish përpjekur ta groposte krahu më radikal i Rilindjes.

Me turqizma do të kuptojmë ato njësi, fjalë a shprehje frazeologjike, të cilat kanë hyrë në shqipen drejtpërdrejt nga turqishtja dhe që, mbështetur në gjendjen e studimeve të derisotme, nuk dyshohet se kanë qenë huazuar në turqishten prej ndonjë gjuhë tjetër. Sigurisht, edhe ky përcaktim a kufizim nuk është gjithsesi i “imunizuar” prej problemeve interpretative. Kjo do të thotë që edhe nëse jemi të sigurtë se aksh fjalë ka ardhur drejtpërdrejt nga gjuha turke, nuk mund të jemi gjithaq të sigurtë se ajo nuk ka rrjedhur prej ndonjë entiteti tjetër gjuhësor, sepse një gjë e tillë do të kërkonte analiza etimologjike shumë më të thella se ato që mund të ofrojë një trajtesë e kësaj natyre.

Po ashtu, nuk kemi ndër mend të vëmë në pikëpyetje edhe ato pak gjëra të pranuar tashmë prej të studiuesve kompetentë lidhur me dallimet mes huazimeve të drejtpërdrejta e të tërthorta. Megjithatë jemi të vetëdijshëm që një problem i kësaj natyre do të na dalë përpara e që në njëfarë mase edhe fati i trajtesave të këtij lloji varet nga përgjigjja që marrin pyetje të ngjashme me ato që ne dëshirojmë t’u shmangemi jo pa qëllim qysh në krye. Le të kujtojmë se e ajo që përmbahet sot në togfjalëshin "gjuha turke" nuk ka qenë as në kohë dhe as në hapësirë një entitet i vetëm, unik e homogjen.

Që këtej nuk është e vështirë të kuptohet se, edhe në raport me shqipen, ajo nuk ka qenë dhe s’mund të ishte e tillë. Në këtë kuptim mund të dallonim edhe brenda turqishtes një **turqishte të vjetër** dhe një **turqishte të re**<sup>108</sup>; sipas së njëjtës logjike tani mbi bazën e kriterit diatopik mund të dallojmë një *turqishte të Turqisë* dhe një turqishte të të ashtuquajturave *republika turke*, si fjala vjen Azerbajxhani, Turkistani, Tataristani etj. Afërmendsh që shqipja ka pasur marrëdhënie të ngushta, në përdorimin e saj të folur e të shkruar, me të gjitha këto entitete, së paku gjatë periudhës së kontakteve më intensive mes "dy gjuhëve".

Për të dhënë një kufi qoftë edhe të përafërt kohor këtë pikëtakim a ndërndikim kulturor e gjuhësor do ta vendosnim mes viteve 1385 dhe 1912. Jashtë këtij kufiri, që

<sup>108</sup> Türk Dili Tariri f 437, cituar sipas A.Derjaj, *Rreth drejtshkrimit të turqizmeve dhe emrave vetjakë me origjinë turke*, kumtesë e mbajtur në konferencën kushtuar 40-vjetorit të Konsultës së Prishtinës, Konsulta gjuhsore e Prishtinës, Prishtinë, 2008, f. 259-266.

duket deri diku arbitrar, mbetet një datë e rëndësishme për historinë e gjuhës turke të Turqisë, 1928-a, viti i reformës qemaliste<sup>109</sup> në punë të gjuhës. Kjo datë, prej shumë gjuhëtarëve turq e të huaj mbahet edhe si "datëlindja" e turqishtes së re. Nga sa thamë, shpresojmë të jetë e qartë se termi *turqizëm* është jo pak problematik, madje ndonjëherë edhe spekulativ, për më tepër kur edhe ne u shmangemi me dashje prurjeve të tjera që janë pagëzuar me emrin e përbashkët *orientalizma*.

Megjithatë nuk është gjithmonë e lehtë t'u shmangesh orientalizmave, aq më tepër kur je i shtrengur që prej shqyrtimit në parim, t'i shtrohesh analizës rast pas rasti. E themi këtë ngaqë një pjesë e mirë e të ashtuquajturave orientalizma më parë se të hynin në shqipen kanë qenë pjesë e vetë turqishtes. Kjo është aq më shumë e vërtetë për një numër leksemash që në origjinë u takojnë gjuhëve të tjera, më së shumti arabishtes dhe persishtes.

Pa mëtuar të bëjmë këtu etimologjinë e njësive të tilla, mjafton të themi se një numër i mirë fjalësh (emra të përgjithshëm), si : *kalem, sulltan, padishah, qitap, musliman, kadi, melaqe (melaiqe) shejtan,, ezan, muezin, imam, mendile, vatan, kurban, insan, devlet (dovlet)*<sup>110</sup> ose emra të përveçëm, si: *Myzejen, Qerim, Ramazan, Shaban, Nazim e Nazmi, Sherif e Sheraf*, etj. e shpërfaqin problemin që përmendëm më lart ngaqë ato në thelb u takojnë gjuhëve si arabishtja e persishtja. Është e vërtetë se në shqipe ato kanë hyrë më së shumti prej turqishtes, por gjithsesi ky fakt nuk na duket i mjaftueshëm për t'i konsideruar thjesht turqizma.

Në gjuhën shqipe vijon të jetë një sasi e madhe orientalizmash shumë prej të cilave kanë një shtrirje dhe përdorim gati gjithpopullor. Mund të thuhet se me gjithë fushatat "purifikuese" ose gjuhëpastruese të ndërmarra në kohë të ndryshme, që nga Rilindja e këtej, gjuha shqipe nuk u çlirua kurrë prej orientalizmave, shumica e të cilave janë fjalë që emërtojnë sende të përdorimit të gjerë.

Mund të themi madje se huazimet nga turqishtja, por edhe përgjithësisht orientalizmat, me kohë nuk ndihen më si barbarizma por thjesht si huazime ose si fjalë që, siç thoshte prof Çabej "janë bërë tashmë mishi e ashti i shqipes"<sup>111</sup>. Për shembull fjalë si: *tepsi, zinxhir, bojë, raki, çarap, çarçaf, çizme, pazar, berber, kasap, bajrak, kanun, xhelat, hoxhë, dervish, synet, bori, daulle, dyfek, fitil, xhep, dyshek, jorgan*.<sup>112</sup> Me fjalë të tjera edhe ky mjeshtëri i madh dhe njohës aq i mirë i pasurisë dhe vlerave të shqipes, i mbante disa prej orientalizmave si të pazëvendësueshme, ose së paku si vështirësisht të zëvendësueshme.

Në mbetjen gjallë të orientalizmave duket se kanë ndikuar dy prirje të ndryshme për nga natyra, të cilat kanë shpënë tek i njëjti rezultat. Është një fakt i njohur tashmë se të paktën që pas Rilindjes, orientalizmat në përgjithësi dhe turqizmat në veçanti fituan një lloj ngjyrimi përkeqësues të cilin nuk e kishin pasur më parë. Ky ngjyrim me kalimin e kohës u dendësua aq shumë sa në më shumë se një rast e zhvendosi thuasjse krejt kuptimin fillestar. Një dukuri e tillë pas të gjitha gjasave ka lindur

<sup>109</sup> Kështu quhet gjithandë në Turqi reforma politike, ekonomike dhe kulturore e ndërmarrë aso kohe nga Mustafa Qemal Ataturku, i quajtur prandaj edhe "ati ose babai i Turqisë moderne".

<sup>110</sup> Është respektuar grafia e shqipes, pavarësisht prej formës me të cilën dalin në gjuhët nga vijnë.

<sup>111</sup> Shih: E. Çabej, *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*, Studime filologjike, 1975, No.4..

<sup>112</sup> Shih, E. Çabej, *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*, Studime filologjike, 1975, No.4.

fillimisht në meset e të shkolluarve e mandej është shtrirë edhe në përdoruesit e tjerë të gjuhës.

Pikërisht falë këtij ngjyrimi e kuptimi të ri, një pjesë e huazimeve orientale mundën të mbijetonin edhe pas dublimit të tyre me fjalë të burimit vendas. Fjalë si *qatip, defter, mehmur, pasha, bimbash, vezir, talim, zabit* etj mundën të mos dilnin nga përdorimi pikërisht për hir të atij ngjyrimi të ri përkeqësues, që fituan pas mesit të shek. XIX e që vazhdojnë ta kenë edhe sot.

Prirja e dytë lidhet me një tjetër rrethanë: huazimet orientale me kohë janë bërë pjesë e fondit të mbarë shqipes dhe ato nuk mund të shërbenin si elemente të dallimit dialektor. Është e vërtetë që në gegërishte hasim rregullimin mekanik të theksit,<sup>113</sup> që prek kryesisht fjalët e burimit oriental, por kjo dukuri nuk “e rrezikon” fjalën si njësi të leksikut. Dhe në këtë kuptim ato kanë shërbyer e shërbejnë si një faktor kohezioni. Fat që nuk e kanë huazimet nga gjuhë të tjera të kohëve të reja.

Siç mund të merret me mend, pas rikthimit të klimës së besimit fetar në Shqipëri, u rigjallëruan edhe huazimet orientale, kryesisht ato të sferës fetare, fjalë, si: *abdes-avdes, xhami, hallall, haram-harram, iftar-yftar, xhuma, bajram, kurban, mevlud*.

Përveç rigjallërimit këtyre fjalëve dhe formulave me përmbajtje fetare, vihet re edhe një prirje korrektimi të trajtave të tyre, pavarësisht prej traditës së ngulitur prej kohësh në shqipe. Kjo prirje diku tjetër është quajtur arabizim<sup>114</sup>. Na duket me vend të kujtojmë se, përkundër traditës në përdorime të tilla si: *Bajrami i Vogël, Bajrami i Madh*; ndeshen jo rrallë edhe trajta si: *FitërBajrami* dhe *KurbanBajrami*.

Në kuadrin e bilinguizmit dialektal, për një kohë relativisht të gjatë në shqipen do të vazhdojnë të përdoren krahas fjalëve të burimit oriental nga folës të paarsimuar, edhe fjalët e shqipes standarde, qofshin këto të huazuara nga gjuhët evropiane, të kalkuara ose të krijuara nga brumi i shqipes: si psh: *kala-kështjellë, allah-perëndi-zot, pejgamber-profet, dua-lutje, sabah-mëngjes, vatan-atdhe, rixha-kërkesë, aksham-mbrëmje, xhuma-e premtë, usta-mjeshtër, kodosh-rruffan, dyshman-armik, gjynahqar-mëkatar, para-monedhë, dyqan-shitore, berber-floktar, (berberhane-floktore-permanent), pazar-treg* etj.

Ky varg sot zgjerohet dhe me pykezimin e fjalëve moderne që vijnë nga anglishtja dhe gjuhë të tjera psh: *harem-aheng-muzikë, daulle-bateri, fans-tifoz-taraf, ezmer-brun-zijosh, resme-fotografi* etj

Në mënyrë të veçantë do të mbeten në shqipen një varg orientalizmesh të rrënjësura në shprehje frazeologjike, shpesh edhe me kuptim figurativ si psh: *bëj gajret, bëj rixha, bëj dua, bëj derman, e bëri hashha, mu bëfsh kurban, kam siklet-kasavet* etj.

Shprehje të tilla si: *hip këtu e shiko Stambollin* (sikur Stambolli të ishte me vite drite larg nga Shqipëria), *ju bë ferra Brahim, e humbi si Xhafferri simiten, gruaja e fut shejtanin në shishe, çfarë ka barku nxjerr bardhaku*.

<sup>113</sup> Shih: J. Gjinari – Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 46.

<sup>114</sup> Shih: Adriatik Derjaj, *Dukuri dhe probleme të huazimeve turke në shqipen*, në revista “Malësia”, Tiranë, 5, Podgoricë, 2010, f.137-142.

Shprehje frazeologjike të kalkuara drejtpërsëdrejti nga turqishtja, si psh: *ha binish mish* (ye kürküm ye, *Nasredin hoca*), *hane Shan hane Bagdat*, *fshati që duket s' do kallauz* (görünen köy kılavuz istemez).<sup>115</sup>

### III.7. Degëzimi tematik dhe kulturor i orientalizmeve në shqipen

**Fjalë që lidhen me banimin dhe paisjet shtëpiake:** *çardak, krevet* (lloj shtëpi), *minder, havllu, kilim-qylym, sixhade, tepih* (Kosova), *masha, nargjile-nargile, burrrnot* (duhan i imët që futet në hundë), *hamam- konak- jastik- sergjen, zahire-zahireja, pastërma, okllai, dudurma/dondurma, sofër-sofra*.

**Fjalë që lidhen me administratën:** *terxhymen-terxhymeni, kadi-kadiu, mühür, imza-ja, qehaja- qehajai, ortak - ortaku*.

**Fjalë që lidhen me administratën ushtarake:** *vexhi, celebi- celebia, vergi-vergjia, sancak-sancaku. sancakbey, bimbash, çaush, kasaba, tuxhar- tuxhari asker, jeniçer, bori-ja, efendi - efendilerët, aga- agai*.

Ku zënë vend të rëndësishëm edhe emrat e armëve si : *dýfek, allti- top- tupan-gjyle, cephane, fishek, qemer*.

**Pjesë të shtëpisë:** *taban, qoshe, divani, kolltuk, shandam sergji sergjen, oxhak, pencere, baca, filcan, kandil, pishtar, shilte, minder-minder-minderllëk*.

**Emra veshjesh për burra e gra:** *çorap, tirq, zinxhir, sixhim, barnavek, jelek, kemer-i ushkur, mendil, kolçik, tollume, kylaf*.

**Objekte e zbukurimit:** *bülüzük, sahat, qostek, gjerdan laxhuhere, tertil*.

**Emërtime që lidhen me kuzhinën, gjellët etj.** si p.sh.: *emra enësh: saç-i, demir-oxhak, syltjash, sini, tepsi, kusi, tav -tava- tavë, tabaka- tabake yani- yanja, taskebep, shishkebab, pilaf, kabuni, kofte,- pasha kofte, japrak, sucuk sucuku, tencere, cezve, ferece-ferceja, duvak-duvaku, helva,- hallvasi, hallma hasude, llokum, çorba, simit, samun, çay kafe, mangall etj.*

**Mjeshtritë dhe metale:***bakır-bakırcı, teneke- tenekeci, han, haxhi-u, nallban, marangoz, sharrxhi, kujunxhi, bixhi, samarxhi, sahatxhi, pacaxhi etj.*

Një problem tjetër me rëndësi në këtë kuadër të trajtimit të turqizimeve, përgjithësisht i orientalizmeve të shqipes, është edhe ai i të ashtuquajturave *huazime të dyfishta*. Është pikërisht rasti i *Ramazan* e *Ramadan* në shqipen. Njëra me prejardhje turke e tjetra me prejardhje arabe. Fjala ka hyrë si emër i përveçëm për vetat dhe për muajin e agjërimit. Është e vërtetë se *Ramazan* e gjen me të dyja kuptimet, ndërsa *Ramadan* vetëm me njërin. Ky lloj diferencimi kuptimor për nga rezultatet, por jo për nga origjina, duhet të jetë shkaku i ndjesisë së gjallë edhe sot ndër shqipfolësit se kemi të bëjmë me dy fjalë të ndryshme, edhe pse kjo nuk i përgjigjet së vërtetës.

Edhe më interesant bëhet rasti në fjalë kur konstatojmë se njësinë *Ramadan* e gjen vetëm në arabisht dhe jo në turqisht. Mjafton ky rast për të ngritur së paku dy

<sup>115</sup> Shih: A. Derjai, *Dukuri dhe probleme të huazimeve turke në shqipen*, në revista "Malësia", Tiranë, 5, Podgoricë, 2010, f.137-142.

pyetje: a) si është e mundur që Ramadan të ketë hyrë në shqip drejtpërdrejt nga arabishtja? b) pse forma e arabishtes përdoret ekskluzivisht si emër i përveçëm njerëzish të zakonshëm, kurse forma e turqishtes si emër i përveçëm i rritit fetar dhe emër i përveçëm njerëzish të seksit mashkull?

Përgjigjja ndaj këtyre pyetjeve, me siguri, do të kërkonte hulumtime të mëtejshme dhe sidomos njohje të fazave të hershme historike të shtegtimin të fjalëve dhe të shndërrimeve të kuptimeve të tyre, gjë që nuk ia dalim ta kryejmë në kohën tonë, pasi do të duheshin shqyrtime e kërkime të hollësishme, aq më tepër që ato mungojnë edhe në gjuhën zanafillëse.

Për sa i takon drejtshkrimin të emrave të përveçëm me prejardhje turko-arabopërse në gjuhën shqipe ka një traditë që s'mund të anashkalohej, e cila do të donte që emra të tillë si *Muhamet, Ahmet, Mehmet, Servet* të shkruhen me **-t** në fund (ashtu sikundër është udhëzuar në Rregullat e Drejtshkrimin) dhe jo me **-d**, duke respektuar edhe shqiptimin e gjuhës nga kanë hyrë në shqipen, gjë që përbën edhe një normë drejtshkrimore të gjuhës sonë në lidhje me emrat e përveçëm të huaj<sup>116</sup>. Vitet e fundit vërejmë një prirje për shkrimin me **-d** në fund të emrave si: *Muhamed, Ahmed, veçanërisht në rastet kur fjala është për profetin e myslimanëve.*<sup>117</sup>

Nuk është e vështirë të kuptohet se ku e ka zanafillën një prirje e tillë. Por ajo që na intereson më shumë lidhet me faktin se ajo po bëhet sunduese në përdorimin me shkrim të gjuhës edhe në regjistra të lartë. Arsyetimit të atyre që besojnë se ky këmbim bashkëtingëlloresh që shkon në kah të kundërt me prirjen e shqipes së shkruar dhe të asaj të folur, bëhet në emër të "saktësisimit" të trajtës së shkruar të emrit duke synuar t'i afrohet atë origjinës (amës) së vet, porse kësaj prirjeje ne do t'i përgjigjeshim duke thënë që nëse është kështu duhen shkruar me **-d** në fund edhe emrat e së njëjtës gjedhe, d.m.th *Ahmed, Mehmed, Behxhed, Served, Shefqed* etj.

Në pamje të parë duket se një qëndrim i tillë është më se normal kur në të vërtetë ndodh e kundërta. Këta emra shqipja i ka huazuar drejtpërdrejt nga turqishtja, gjuhë në të cilën shfaqen me **-t** dhe jo me **-d**. Por, edhe sikur ky argument të mos mjaftonte, në anën tonë qëndron një traditë e begatë, e denjë për t'u mbajtur gjallë edhe më tej.

Por jo gjithmonë drejtshkrimi i shqipes ka ndjekur me besnikëri shqiptimin e fjalëve të huazuara nga turqishtja. Në inventarin e fonemave të gjuhës turke mungon **q**-ja, megjithatë një numër të madh emrash që përmbajnë **k**- në pozicion nistor, në mes a në fund, në shqipen janë pasqyruar me **q**, kështu p.sh.: *Qemal* për Kemal, *Qamil* për Kamil, *Qani* për Kani, *Shefqet* për Shefket (ndonëse në ndonjë areale të gegërishtes mund ta gjejmë edhe me këtë trajtë). Nga ky "rregull" nuk kanë shpëtuar as zanoret, për shembull **y**-ja e turqishtes është pasqyruar në shqipe më së shumti me **u**, prandaj kemi *turk* për tyrk, *Turqi* për Tyrki (në gegërisht edhe *Turki*), *Ataturk* për Ataturk, por gjithsesi nuk mungojnë as përjashtimet e llojit *Hyrrjet*, fjalë e cila po t'i bindej "rregullit" të sapopërmendur të shqipes duhej shkruar me **u** dhe jo me **y**.

Ky fakt, sipas studiuesit dr. A. Derjaj, nuk ka të bëjë me rritjen e shkallës së njohjes së turqishtes nga ana e përdoruesve të shqipes dhe as me rritjen e kujdesit ndaj

<sup>116</sup> Shih. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f. 104 § 37.

<sup>117</sup> Shih: A. Derjaj, *Dukuri dhe probleme të huazimeve turke në shqipen*, në revista "Malësia", Tiranë, 5, Podgoricë, 2010, f.137-142.

huazimeve nga gjuhë të tjera, por duke qenë një fjalë që vinte prej gjuhës së shkruar, *Hyrrjet* e ka pasur më të lehtë të pasqyrohet drejt, duke u shpëtuar grackave të *identifikimit shpërdorues*.<sup>118</sup>

Një dëshmi tjetër të asaj prirjeje, që e përmendëm më lart dhe që ka të bëjë me një lloj "arabizimi" të fjalëformave me prejardhje turke në shqipen, e gjejmë edhe tek fjala *musliman*, e cila kohët e fundit, përkundër asaj që diktojnë rregullat e drejtshkrimit të shqipes, ka filluar të haset edhe në trajtën *musliman* gjë që nuk na duket korrekte as nga pikëpamja e normës dhe as nga pikëpamja e traditës. Lëkundje dhe gjendje plot luhatje, jo vetëm në ligjërimin e folur, por edhe në tratën e shkruar, vëmë re edhe në një varg emrash, si: *Muslim* e *Muslim*, *Myfit* e *Mufit*, *Myftiu* e *Muftiu*, *Myftar* e *Muftar*, *Mylazim* e *Mulazim*, *Mysheraf* e *Musheraf*, *Myrteza* e *Murteza* etj.<sup>119</sup>

Një gjë tjetër që do vënë në dukje ka të bëjë me faktin, se riaktivizimi i termave fetarë (*muslimanë*) ka sjellë edhe në regjistrat e lartë të shqipes së shkruar rigjallërimin e ndonjë trajte geqe. Tipike na duket emri *myftinia* si institucion fetar, që ka marrë tashmë përhapje gati mbarëkombëtare në të gjitha hapësirat ku ushtrohet feja muslimane në Shqipëri, pa dallim si në Veri ashtu edhe në Jug; por edhe ndonjë rast tjetër me denduri përdormi në etnografinë e të folurit të besimtarëve të fesë ilslame, si p.sh. formula: *Gëzuar muajin e madhnueshëm të Ramazanit*.

Kjo dukuri, ndoshta, pavarësisht se nuk ka gjasa të marrë përmasa të gjera, shkon krahas me rigjallërimin edhe të ndonjë fjale tjetër të vjetër, si p.sh. fjala *nalmadhni*, ku është fjala për mbretin dhe etnografinë e të folurit të atyre që i kanë përkur oborrit të mbretit.

Në lidhje me drejtshkrimin e emrave të përveçëm me origjinë orientale që kanë një traditë në shqipen, specialistët janë të mendimit se duhet respektuar ajo traditë pavarësisht nga problemet që mund të ketë edhe më tej kjo kategori emrash. Këtu, me siguri është rasti të tregojmë vëmendje më të madhe ndaj huazimeve të reja nga gjuha turke si : *Erdoan*, *Exhevit* etj. të cilët bëjmë mirë t'i shqiptojmë dhe t'i shkruajmë ashtu siç shqiptohen në gjuhën nga vijnë, duke shmangur kësisoj edhe huazimet grafike, si ai që shfaqet në rastin e emrit *Erdoan* që gabimisht në shqip del me trajtën *Erdogan*, kur dihet mirëfilli se *g*-ja ndërzanore (intervokalike) nuk shqiptohet në turqishten.<sup>120</sup>

Së fundi, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe sa lidhet me theksin një vargu huazimesh orientale në shqipen. Sikundër është vënë re edhe nga diektologët, disa fjalë me origjinë turke ndërsa në turqishten kanë qenë me theks fundor p.sh. *kafe*, *penxhere*, *tencere*, *baba*, *kafe* etj, në gjuhën shqipe standarde shkruhen pa shenjën e theksit, megjithëse dihet se në toskërishten dhe në standard kanë shqiptimin oksiton si në gjuhën prej nga janë huazuar. Ndërkaq, në gegërishten kjo kategori fjalësh kanë përfunduar kryesisht me theks parafundor.

<sup>118</sup> Shih: A. Derjai, *Dukuri dhe probleme të huazimeve turke në shqipen*, në revista "Malësia", Tiranë, 5, Podgoricë, 2010, f.137-142.

<sup>119</sup> Shih: A. Derjai, *Dukuri dhe probleme të huazimeve turke në shqipen*, në revista "Malësia", Tiranë, 5, Podgoricë, 2010, f.137-142.

<sup>120</sup> Shih: A. Derjai, *Dukuri dhe probleme të huazimeve turke në shqipen*, në revista "Malësia", Tiranë, 5, Podgoricë, 2010, f.137-142.

Kështu, sipas studimeve dialektologjike, p.sh. në *Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe*, del se kemi vargje të tëra turqizdash me theks fundor në toskërishten, që kanë kaluar në parafundore në gegërishten, si: *agá-agai* (tosk.) > *a:g-aga* (geg.), *dai-daiu* (tosk.) > *da:j-daja* (geg.), *babá-babai* (tosk.) > *ba:b-baba* (geg.); *xhaxhá-xhaxhai* (tosk.) > *a:xh-axha* (geg.), *teneqè-teneqèja* (tosk.) > *tenèqe-tenèqja* (geg.), *penxherè-penxherèja* (tosk.) > *penxhère-penxhèrja* (geg.), *kafè-kafèja* (tosk.) > *kafè-kafja* (geg.); *gajlè-gajlèja* (tosk.) > *gajle-gajlja* (geg.); *bahçè-bahçèja* (tosk.) > *ba(h)çe-ba(h)çja* (geg.), *dajrè-ja* (tosk.) > *dajre-dajrja* (geg.); *xhadè-ja* (tosk.) > *xhade-xhadja* (geg.); *qoshè-ja* (tosk.) > *qoshe-qoshja* (geg.); *bakllavá-ja* (tosk.) > *baklla:v-bakllava* (geg.); *pashá-pashai* (tosk.) > *pa:sh -pasha* (geg.), *shishè-shishèja* (tosk.) > *shishe-shishja* (geg.), *shamatá-shamatája* (tosk.) > *shamat-shamata* (geg.), *kaúrr-kaúrrri* (tosk.) > *káurr-káurri* (geg.) etj.<sup>121</sup>

Theksin në rrokjen e fundit në toskërishte e ruajnë edhe emrat vetjakë (antroponimet) me origjinë orientale, si *Fatimè-ja*, *Feridè-ja*, *Hatixhè-ja*, *Hanifè-ja*, *Hatifè-ja*, *Kadifè-ja* etj., ndërsa në gegërishten ata janë bërë paratheksorë: përkat. *Fatime-Fatimja*, *Feride-Feridja*, *Hatixhe-Hatixhja*, *Hanife-Hanifja*, *Hatife-Hatifja*, *Kadife-Kadifja*. Po ashtu edhe disa nga emërvendet (toponimet) e asaj gurre, si: *Qabè-Qabèja* (tosk.)-*Qábe-Qábja* (geg.); *Kadarè-Kadarèja* (tosk.)-*Kadàre-Kadárja* (geg.), p.sh. *Maja e Kadares* (toponim në Kastrat-Malësi e Madhe), *Tepè-Tepèja* (tosk.)-*Tèpe-Tèpja* (geg.), p.sh. *Kodrat e Tepes* (Shkodër).<sup>122</sup>

Vihet re se prirja për t'u bërë të tilla ( d.m.th parafundore) shfaqet edhe në standard dhe në ligjërimin e folësve të regjistrin të lartë. Tipike na duket shqiptimi *kafè* në vend të *kafë*, ku siç ka vënë në dukje edhe prof. Gj. Shkurtaj “*kohët e fundit në Tiranë e gjetkë vihet re se po parapëlqehen format me theks parafundor si p.sh. pimë një kafè, bleva kafè, pagova kafet, te Kafè Evropa, te Kafja e Madhe.*”<sup>123</sup>

Është një fakt i njohur tashmë se, të paktën që pas Rilindjes, orientalizmat në përgjithësi dhe turqizmat në veçanti fituan një lloj ngjyrimi përkeqësues, të cilin nuk e kishin pasur më parë. Ky ngjyrim me kalimin e kohës u dendësua aq shumë, sa që, në më shumë se një rast, e zhvendosi thujt krejt kuptimin fillestar. Një dukuri e tillë pas të gjitha gjasave ka lindur fillimisht në meset e të shkolluarve e mandej është shtrirë edhe në përdoruesit e tjerë të gjuhës.

Pikërisht për hir të këtij ngjyrimi e kuptimi të ri, një pjesë e huazimeve orientale mundën të mbijetonin edhe pas dyzimit (dublimit) të tyre me fjalë të burimit vendas. Fjalë si *qatip*, *qitap*, *defter*, *hyqymet*, *mehmur*, *kadi*, *allishverish*, *bakall*, *talim*, *efendi* etj. mundën të mos të dilnin nga përdorimi pikërisht për hir të atij ngjyrimi të ri përkeqësues që fituan pas mesit të shek. XIX e që vazhdojnë ta kenë edhe sot.

Për një tufë fjalësh të huajtura nga turqishtja vërehet edhe një dukuri tjetër, ajo e rehabilitimit. E kemi fjalën para së gjithash për njësi të tilla, si: *aga*, *bej*, *pasha*, *vezir*, *sultan* tek të cilat, deri para viteve '90, ngjyrimi përkeqësues, për arsye të njohura të rendit ideologjik ndihej fort; ndërsa sot, për të njëjtat arsye, ky lloj ngjyrimi ose ka humbur, ose është kthyer në të kundërtën e vet.

<sup>121</sup> Shih: GA, *Atlasin dialektologjik i gjuhës shqipe*, Vëllimi I, Napoli-Tiranë, 2007, harta nr. 65. a/1, f. 198, nr. 65. a/2, f. 199; nr. 65. a/3, f. 200; nr. 65. b/1, f. 201; nr. 65. b/2, f. 202.

<sup>122</sup> Po aty, f.202.

<sup>123</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, *Si të shkruajmë shqip, Nga drejtshkrimi te shkrimet profesionale*, Botimet TOENA, Tiranë, 2008, f. 226.

Prirja e dytë lidhet me një tjetër rrethanë: huazimet orientale me kohë janë bërë pjesë të fondit të mbarë shqipes dhe ato nuk mund të shërbenin si element i dallimit dialektor. Është e vërtetë që në gegërishten hasim rregullimin mekanik të theksit,<sup>124</sup> që prek kryesisht fjalët e burimit oriental, por kjo dukuri nuk “e rrezikon” fjalën si njësi të leksikut.<sup>125</sup>

### III.8. Ndërkombëtarizmat në shqipen e sotme

Huazimet nga gjuhët e huaja, ndryshe nga fjalët e huaja të panevojshme e të parrënjosura, e kanë gjetur tashmë vendin e tyre në gjuhë. Mbi këtë bazë mund të dallojmë:

a) Fjalë me burim të huaj që janë përvetuar nga shqipja, që janë bërë njësoj si fjalët e tjera të leksikut të shqipes. Hyjnë këtu huazimet e vjetra si: *qytet, shëndet, faqe, presh, xhep, mjeshtër, i pastër, kusi, karrocë, këndoj, rrugë* etj., dhe fjalët ndërkombëtare: *analizë, aritmetikë, demokraci, diktaturë, filozofi, filologji, histori, gjeografi, gjeologji, gramatikë, kongres, parti, klasë, socializëm, komunizëm, ideologji, imperializëm; roman, poemë, dramë, komedi, portret, peizazh, akualet, teatër, subjekt, personazh, skenë, balet, fabul* etj.

Si *fjalë ndërkombëtare* vështrohen ato fjalë që përdoren në shumicën e gjuhëve të botës (veçanërisht në gjuhët indoevropiane), por nuk do të quhen të tilla (ndërkombëtarizma) fjalët që përdoren vetëm në gjuhët neolatine (italisht, frëngjisht). Për këto fjalë do të bëhen përpjekje të zëvendësohen me fjalët shqipe, siç është bërë p.sh. me *solucion* që është zëvendësuar me *tretësirë*, *nuklear* me *bërthamor*, *neutral* me *asnjanës* etj.

Përbërja kuptimore e ndërkombëtarizmave në gjuhën shqipe ka marrë zhvillim origjinal, duke u gërshetuar me sistemin semantik të shqipes. Termat ndërkombëtarizma zënë vend të mirë në leksikun e gjuhës së sotme shqipe. Terminologjia shkencore dhe teknike shqipe, gjatë zhvillimit të saj, është pasuruar me ndërkombëtarizma dhe kjo e ka afruar gjuhën shqipe me gjuhët më të zhvilluara të Evropës, që kanë ndjekur pak a shumë këtë rrugë. Shtimi i termave ndërkombëtarizma në gjuhën shqipe është dukuri normale, që lidhet me zhvillimin e gjithanshëm të vendit tonë në fushat më të ndryshme, pra me faktorë jashtëgjuhësorë.

Ndërkombëtarizmat e shqipes letrare të kohës sonë vlerësohen si mjete e vlera të nevojshme që pasurojnë leksikun. Ata tashmë kanë depërtuar thellë në gjuhë, janë bërë pjesë e pandashme e shqipes, ashtu si edhe e një vargu gjuhësh të tjera. Zëvendësimi i tyre disa herë është i pamundshëm e disa herë i padobishëm, sepse mund të dëmtojë shprehjen e qartë të nocioneve përkatëse.

Lidhur me qëndrimin që duhet mbajtur ndaj fjalëve ndërkombëtarizma është shumë mësimdhënës vlerësim i njohur dhe i zbatueshëm pothuajse kudo në marrëdhëniet ndërmjet gjuhëve kombëtare dhe nevojave të shtimit të fondit të tyre me fjalë e sidomos terma të përbashkët e të njëjtë me shumë nga gjuhët e botës: *fjalët e huaja të*

<sup>124</sup> Shih: J. Gjinari-Gj.Shkurtaj, *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 1999, f.197.

<sup>125</sup> Shih: A.Derjai, *Dukuri dhe probleme të huazimeve turke në shqipen*, në revista “Malësia”, 5, Podgoricë, 2010, f.137-142.

*domosdoshme, të përfaqësuara në shumicën e rasteve nga terma shkencorë-teknikë të pranuar përgjithësisht, nuk do të ishin të domosdoshëm, sikur të mund të përktheheshin.*

Edhe historia e shqipes na jep shembuj të vlefshëm për të vërtetuar se “purizmi” i skajshëm nuk ka pasur fryte të mira. Mund të kuptojmë se disa përpjekje të veprimtarëve të Rilindjes sonë Kombëtare për pastrimin e gjuhës shqipe ishin të natyrshme e të kuptueshme për atë kohë, porse sprova për të shqipëruar edhe terma me shtrirje ndërkombëtare si: gjeografi, satelit, vullkan, me fjalët *dheshkronjë, pasës, mal që nxjerr zjarr*, ose termat: *astronomi, anatomi, gjeometri, zoologji*, me *qiellshkronjë, njeritregonjë, dhematje, kafshëtregonjë* etj., nuk gjetën jehonë në periudhën e mëpasme. Sidoqoftë edhe për qëndrimin ndaj ndërkombëtarizmave nuk mund të jepen “receta” të sakta. Ka mjaft raste kur, edhe për terma që kanë shtrirje ndërkombëtare, shqipja ka gjetur mundësinë për të krijuar fjalë të përshtatshme e të motivuara nga burimi i vet. Këto vitet e fundit kanë marrë përhapje të gjerë terma si: drejtshkrim, drejtshqiptim, gjuhësi, gjuhësor, gjuhëtar në vend të ndërkombëtarizmave përkatëse: *ortografi, ortoepi, linguistikë, linguistik,-e, linguist*; asnjësi për *neutralitet*; asnjësoj dhe asnjësim në vend të *neutralizoj, neutralizim*.

Nuk janë të paktë termat, që më parë dukeshin si ndërkombëtarizma të paprekshëm, mirëpo sot janë zëvendësuar me terma të shqipëruar, si p.sh.: *sensacion* (ndijim), *sensibël* (i ndjeshëm), *sensibilitet* (ndjeshmëri), *komplikacion* (ndërlikim), *nebulozë* (mjegullnajë), *iluminist* (ndriçimtar).

Por, ndërsa pranonte domosdoshmërinë e fjalëve të huazuara me karakter ndërkombëtar e më gjerë, kur ato janë të pamënjanueshme e të vlefshme për shqipen, mjeshtri i madh i shqipes, Eqrem Çabej, theksonte, se në shumë fusha të shkencës, të artit e të kulturës “*ka një mori fjalësh të vendit, që pa dëm kuptimor janë në gjendje t’ua zënë vendin fjalëve të huaja*” dhe shtonte se “*aty është me interes se fjalët e vendit kuptohen më mirë, rrokën e përvetësohen më mirë nga nxënësit e moshave të vogla, sepse u formojnë atyre shoqërime (asosacione) idesh; ato gjejnë analogjinë e vet në pasurinë leksikore që zotërojnë ata brenda sistemit të gjuhës amtare*”<sup>126</sup>.

a) Fjalë me burim të huaj, të cilat me kohë kanë dalë nga përdorimi i gjerë, për shkak se janë zhdukur vetë sendet a nocionet, që shprehin ato (*breshanë, xhandar, kumbara*), ose janë zëvendësuar me fjalë shqipe (*qatip, qitap, imza*).

Ndodh që brenda çerdhes së fjalëve të huazuara disa fjalë janë zëvendësuar me fjalë shqipe, kurse disa të tjera të së njëjtës çerdhe nuk janë zëvendësuar, p.sh.: *nacion, nacionalitet* dhe *intencional* janë zëvendësuar me fjalët shqipe *komb, kombësi, ndërkombëtar*, kurse *nacionalist, nacionalizëm, internacionalist, internacionalizëm* nuk janë zëvendësuar dhe, mesa duket, nuk kanë për t’u mënjanuar asnjëherë.

b) *Fjalë të huaja të panevojshme*, të cilat janë zëvendësuar e po zëvendësohen me fjalët shqipe ekzistuese ose të krijuara me brumin e shqipes sipas gjedheve të gjuhëve të tjera. Të tilla janë, p.sh.: *wikend* që po zëvendësohet me sukses me fjalën e krijuar sipas modelit të anglishtes, por me mjete të shqipes: *fundjavë*. Madje, ky model po rezulton i frytshëm dhe po shtrihet edhe në krijime të tjera, si: *fundvit, fundshekull*.

Në kohën tonë bëhet një punë e gjerë dhe e organizuar për të nxjerrë jashtë përdorimit fjalët e huaja, që kanë hyrë pa kriter, kryesisht nga italishtja, gjatë kohës së regjimit të Mbretërisë e gjatë viteve të pushtimit fashist. Kundër këtyre fjalëve

<sup>126</sup> Shih: E. Çabej, *Për pastërtinë e gjuhës*, në “Gjuha jonë”, 1, 1981.

është luftuar edhe në të kaluarën dhe një pjesë tashmë janë zëvendësuar ose krahas tyre përdoret edhe një fjalë shqipe në kuptimet themelore, p.sh. *ambient-mjedis, eksperiencë-përvojë, influencë-ndikim, koordinoj-bashkërendoj, respektiv-përkatës, reciprok-i ndërsjellë* etj.

Duhet bërë përpjekje për të zëvendësuar ose për t'ua ngushtuar më tej përdorimin një numri fjalësh të leksikut të përgjithshëm me burim nga gjuhët sllave, nga greqishtja e turqishtja, si: *akoma, nikoqirllëk, vadit, godinë* etj. Nuk u duhet bërë vend në përdorime letrare as fjalëve të huaja, që kanë hyrë nëpër të folmet e krahinave anësore, si p.sh: *goxha, mollois, kumbisem, potis, okllai, kum, plevicë, ulicë, nakatos* etj., kur nuk shërbejnë për tipizmin e personazheve.

Kundër fjalëve të tilla të huaja të panevojshme është drejtuar sot lufta e puna e "Komisionit të përhershëm për pastrimin e pasurimin e gjuhës shqipe", nën drejtimin e të cilit, prej disa kohësh, ka nisur të botohet te "Gjuha jonë" rubrika "Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj", si dhe libra të tjerë universitarë.<sup>127</sup> Edhe në epokën e sotme të evropianizimit dhe të botërorizimit të thellë kulturor dhe gjuhësor, pavarësisht nga domosdoshmëria për të mësuar sa më mirë e sa më gjerë anglishten dhe gjuhë të tjera të BE-së, do të mbetet kurdoherë hapësirë e gjerë dhe për gjuhët kombëtare të popujve të ndryshëm, pra edhe për shqipen e folur dhe të shkruar.

P.sh. gjuhëtarët kanë vlerësuar si gjë të mirë dukurinë që, viteve të fundit, në vend të fjalës angleze *wikend* po bën udhë kalku *fundjavë*, i cili, ndërkaq, edhe është modelësuar këndshëm, duke u ndjekur edhe nga formime të tjera të atij tipi, si *fundmuaj, fundvit, fundshekull*. Por, ka edhe kalke të panevojshme, madje të neveritshme në krahasim me sa ka shqipja në vend të tyre, si p.sh. *më ke munguar* (nga it. *mi sei mancato*), ndërsa kemi në shqipen shprehjen aq të bukur: *më ka marrë malli, më ka këputur malli, më dogji malli* etj.<sup>128</sup> Koncepti i drejtë për mbrojtjen e shqipes qenë dhe mbetet ky: *shqipja gjuhë e hapur, por edhe gjuhë në ruajtje, gjuhë e mbrojtur dhe e lëvruar me gjithë kujdesin e duhur*.

Nuk bëjnë aspak mirë disa njerëz që, të dhënë pas hireve dhe vlerave të mëdha të anglishtes e të gjuhëve të tjera të mëdha të Evropës, e kanë në majë të gjuhës ankesën se "shqipja na qenka një gjuhë e varfër" dhe për këtë arsye rruga e vetme e pasurimit të saj, sipas tyre, mbeten vetëm prurjet nga jashtë dhe huazimi pa asnjë fre.

Përgjigjen e gjejmë qysh në shkrimet e Ernest Koliqit, i cili theksonte: "Dikush ankohet për vobeksin' e gjuhës s'onë. Paragjykim, ky, qi duhet hjekë. Vërtetë qi shumë fjalë të jetës moderne e shumë skaje kulturore i mungojnë shqipes, po edhe gjuhët e hueja këto i kanë marrun prej njena-tjetrës ase i kanë krijue. Shqiptari asht bulk, asht blegtuer: e ke një pasuni të çudiçme fjalësh e frazash mbi bujqësi e mbi blegtori dhe mbi sende, veprime e ndiesi qi përfshin jeta bujqësore e blegtorale. Shqiptari asht burrë. Burrnija asht prodhim i një edukate historike qi ka për bazë urtin, për maje trimnin e për flamur të drejtën. E gjuha e jonë më duket e vetmja qi mundet me shpreh ndiesit tash të forta gadi deri n'egërsi, tash të buta deri n'amëlsi, të mbajtuna e të turrëshme, qi shpirti i shqiptarëve burra ushqen herë mbas here. Gjuha shqipe asht e bukur pse asht burrnore e prandej fisnike, zemërake dhe krenare."<sup>129</sup>

<sup>127</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, *Si të shkruajmë shqip-Baza të shkrimit akademik*, Morava, Tiranë, 2013, f.

<sup>128</sup> Shih: E. Hysa, *Përsëri për gjuhën e shtypit*, në "Kulturë gjuhë", 1, Prishtinë, 2003, f.33.

<sup>129</sup> Citohet sipas ribotimit tek revista "Rrezja jonë", 3, 1992, f.22-23.

**Koncepti i pastrimit të gjuhës lidhet me pasurimin e saj.** Pasurimim i gjuhës nuk do të thotë që të mundohemi të heqim çdo huazim, të kalojmë në anën tjetër dhe të tregohemi puritanë deri në marrëzi dhe çudira. Sipas Hock<sup>130</sup> (1986: 380), “termi ‘huazim’ i referohet „ marrjes së fjalëve të veçanta ose grupe fjalësh nga një gjuhë, ose dialekt tjetër. ”Fjalët e huazuara quhen huazime (Trask, 1996)<sup>131</sup>. Huazimet janë një proces në vazhdim për të gjitha gjuhët. Edhe gjuha angleze, e cila po jep më shumë fjalë sot në krahasim me gjuhët e tjera është zhvilluar duke huazuar nga gjuhët e tjera. Nuk ka gjuhë që mund të rrijë jashtë kësaj dukurie. Fjalët huazohen kur ju referohen koncepteve ose sendeve që nuk egzistojnë në gjuhën shqipedhe për të ruajtur saktësinë e kuptimit të kumtuar nga njësia leksikore e huaj.

Përdorimi i tyre në mënyrën e duhur e pasuron gjuhën. Detyra e mësuesve është të kontrollojnë si e kuptojnë atë fjalë dhe a e përdorin me kuptimin e saj për një situatë të dhënë, apo kanë marrë një kuptim të gabuar. Mësuesi duhet të nxitë diskutimet që në këtë rast plotësojnë dy qëllime, *së pari*, sqarohet njësia gjuhësore e huazuar dhe, *së dyti*, zhvillohen aftësitë komunikative të nxënësve për të diskutuar në gjuhën amtare për çështje gjuhësore. Kjo formë do rritë shumë vetëdijën e tyre për gjuhën që përdorin dhe për zgjidhjen drejt të stilit dhe fjalorit të tyre.

### III.9. Fjalët e huaja të panevojshme

Duke trajtuar këtë dukuri, d.m.th. të hyrjes së shfrenaur të fjalëve të huaja në shqipen e sotme, prof. Shkurtaç, një nga luftëtarët e shquar për pastrimin e shqipes ka parashtuar sa vijon:

1. *Shkaku dhe pasojat e vërshimit të përshtuar të fjalëve të huaja sot.* Periudha kalimtare e viteve 1991-2001 ose: nga socializmi real në demokraci, që, po ta kthejmë në terma sociolinguistike do të thotë: *kalimi nga një vlerësim shumë i lartë për gjuhën dhe kulturën e saj në një liri të plotë e në një qëndrim gati hapët të pakujdesshëm ndaj gjuhës së njësuar dhe kulturës së gjuhës në përgjithësi.*

Gjendja. Vrulli për të mësuar sa më shpejt e sa më mirë gjuhët e huaja, sidomos anglishten dhe italishten; kujdesi shumë i pakët e, ndonjëherë, edhe shpërfillja e gjuhës shqipe letrare. Diskutime e “qarje” prej krokodili për gjoja zgjidhjen e jo të duhur të variantit letrar mbi bazën e toskërishtes.

Pasojat: vërshim i përshtuar dhe i pafrenueshëm i fjalëve të huaja të panevojshme, shtim i termave të huaj në vend të termave shqip që përdroreshin normalisht dhe nuk ka pse të mënjanohen. Kjo, qysh nga Kuvendi i Shqipërisë, të cilin, vetë ata që e përbëjnë (deputetët dhe drejtuesit e tij) në mbi 9ë % të rasteve e quajnë “Parlament” dhe jo shqip siç e ka emërtesën zyrtare. Së këndejmi edhe *kryeparlamentar* (në vend të *kryetar i Kuvendit*).

Kanë hyrë e nuk pushojnë së hyri edhe jo pak mënyra të të thëni apo ndërtime sintaksore të papranueshme për shqipen, thjesht si ndikim nga gjuhët e huaja.

<sup>130</sup> Hock, Hans H. (1986) Principles of Historical Linguistics. Berlin : Mouton de Gruyter

<sup>131</sup> Trask, L.R. 1996. Historical Linguistics. Oxford University Press

*Politikanët dhe shtetarët janë ata që japin më së shumti shembullin e keq në përdorimin e fjalëve të huaja të pnevoshme<sup>132</sup>.*

### III.10. Huazimet nga anglishtja në shqipen

”Banka“ kryesore e huazimeve dhe e prurjeve të huaja në shqipen e sotme është anglishtja. Shqipja e sotme përballet me trysninë më të fuqishme në fushën e huazimeve leksikore pikërisht nga anglishtja, prandaj njohja e tyre dhe ndërmarrja e studimeve e shqyrtimeve shkencore për këto huazime shtrohen sot si një nga punët më të ngutshme dhe të vyera të gjuhësisë shqiptare.

Duke pasur parasysh masën e madhe të vërshimit të termave me burim nga anglishtja në shqipë, mund të thuhet se anglicizmat terma po e zgjerojnë nga dita në ditë portën e hyrjes së termave të huaj në gjuhën standarde në të gjitha nivelet e ligjëritimit. Meqë pjesa më e madhe e elementeve të huaja që hyjnë përmes kësaj porte janë pak a shumë të afërta nga forma dhe përbëjnë modele të përbashkëta nga përmbytja edhe për gjuhët e tjera (*kompjuter, monitor, display*), atëherë këto elemente shërbejnë si porta hyrjeje edhe për gjuhë të tjera.

Si një rrymë e përbashkët që kalojnë nëpër to, në mënyrë të veçantë termat anglezë, si ndërkombëtare në pjesën më të madhe të tyre, i shndërrojnë këto porta në enë komunikuese me masën e përbashkët qarkulluese (termat të huaj për secilën prej tyre). Terminologjia shqipe, duke u futur në këtë rrymë të përbashkët, duhet ta orientojë lëvizjen e kahun e rrjedhës së saj sipas kësaj rryme, të përbashkët edhe për gjuhët e tjera, sidomos atyre që shërbejnë në fushën e terminologjisë si gjedhe standardizimi e kodifikimi si anglishtja, frëngjishtja, italishtja, gjermanishtja, spanjishtja e rusishtja.

Në këtë rrjedhë duhet futur edhe terminologjia shqipe e përdorur në treva të tjera shqipfolëse, si në Kosovë dhe në Maqedoni. Kjo do të thotë se shumë probleme të terminologjisë shqipe duhen shtruar e zgjedhur në kuadrin e problematikës së përbashkët edhe të gjuhëve të tjera të botës, të vendeve të mëdha apo të vogla. Kjo i jep një orientim të ri vlerësimit e rivlerësimit të termave të huaj në shqipë, qëndrimit ndaj tyre, vendit të tyre në raport me termat e shqipëruar që konkurrojnë me to duke përshtatur ndaj tyre një politikë gjuhësore më të liberalizuar sa më parë.

Sigurisht, ndërmjet këtyre njësisive të shprehjes (të termave), termat e huaj, sidomos ato ndërkombëtare si fond i përbashkët gjuhësor-kulturor, do të jenë mishërimi i idesë së globalizimit kulturor në fushë të gjuhës. Vërshimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe është pasojë e globalizimit. Purizmi i gjuhës është me vend kur në rrezik është çështja kombëtare. Kjo çështje nuk shfaqet sot në rrezik tek shqiptarët.

Kur flasim për gjuhën nuk kemi të bëjmë thjesht me një problem teknik por me një çështje të rëndësishme kombëtare, kulturore dhe shoqërore. Shqipja, në radhë të parë shqipja standarde është një emërues i përbashkët kulturor i të gjithë shqiptarëve. Ajo e ka bërë dhe do ta bëjë kulturën kombëtare dhe botën shqiptare në tërësi më të integruar.

Pra dëshirojmë të themi se edhe atëherë kur flasim për një vërshim të madh fjalësh të huaja duhet të kemi parasysh se çfarë roli luajnë fjalët e huaja, ku përdoren ato në

<sup>132</sup>Shih: Gj.Shkurtaç, *Normëshlekësit duhet të përgjigjen për dëmin që i shkaktajnë gjuhës shqipe*, në “Akte të Konferencës shkencore 16 dhjetor, 2004, Pegi, Tiranë, 2004, f.9-26.

gjuhën shqipe d.m.th. në cilën fushë të gjuhës dhe pse përdoren ato. Duke u nisur nga ky këndvështrim mund të themi se vërshim të madh fjalësh të huaja sot kemi në shumë gjuhë. Kjo është pasojë e globalizimit, e zhvillimeve jetësore të kohës sonë. Së dyti: vërshimi i madh i fjalëve të huaja nuk karakterizon çdo fushë ose stil të shqipes, as të shqipes standarde, as të gjuhës së brezave të ndryshëm.

Dr. Gerd-Dieter Nehring, studiues gjerman, që merret me krahasimin e teksteve shkollore në vende të ndryshme shqipfolëse, thotë se bëhet fjalë për një projekt të Institutit Georg-Eckert me seli në Braunschweig dhe nuk ka përshtypjen se përdoren në masë të madhe fjalët e huaja. Nëse lëmë mënjanë varietetet speciale, fjalët e huaja përdoren më së shumti në gjuhën shqipe në masmedia, në mjetet e informimit, në reklamë, në modë, në gjuhën administrative etj. shpeshherë ato që nuk hynë në thesarin e përbashkët të shqipes, janë fjalë të modës dhe të kufizuara në përdorim.

Pra duhet të pyesim se sa kuptohen ato nga njerëzit dhe çfarë ngjyrosjeje stilistike kanë. Në vendet shqipfolëse kemi një përdorim të ndryshëm të fjalëve të huaja. Ndikimi i gjuhës gjermane me siguri duhet të jetë më i madh në Kosovë sesa në Shqipëri, ndërsa sa i përket ndikimit të gjuhëve romane kemi një raport të kundërt me këto dy vende.

*Purizmi ka qenë gjithmonë me vend kur në rrezik ka qenë çështja kombëtare. Kjo çështje nuk është sot në rrezik tek shqiptarët. D.m.th. nuk duhet të kemi një purizëm të tepruar.*

Zhvillimet dhe shndërrimet e mëdha në fushat politike, ekonomike, kulturore etj., në Shqipëri, të cilat kushtëzuan kalimin e shoqërisë shqiptare nga ekonomia e mbyllur dhe e përqendruar në ekonominë e tregut të lirë (të mirëfilltë kapitalist) hapën shtigje të mëdha edhe për marrëdhëniet me botën anglishtfolëse: drejtpërdrejt me SHBA-në, me Anglinë dhe me dokumentacionin e literaturën e BE-së, tashmë kryesisht në gjuhën angleze. Anglishtja tashmë është bërë jo vetëm gjuhë e dytë kryesore në shkollimin e shqiptarëve, por edhe mjeti më i pëlqyeshëm e më i ushtruar gati masivisht nga rinia edhe si mjet i shprehjes artistike, me përhapje të gjerë në këngët, në mediat etj.

Numri i anglicizmave, që kanë hyrë dhe që po hyjnë çdo ditë në shqipen është i madh dhe me prirje rritjeje, pikërisht nga arsyeja se *çdo tekst që shkruhet në administratën shtetërore dhe jo vetëm aty, shkruhet fillimisht në gjuhën angleze e pastaj përkthehet*. Parimi shkencor për paraqitjen e tyre në gjuhën shqipe duhet mbështetur, së pari, në natyrat e ndryshme të të dyja gjuhëve, në karakterin analitik të anglishtes dhe në karakterin sintetiko-analitik të gjuhës shqipe. Studiuesit theksojnë me të drejtë se *edhe vlerësimi i anglicizmave në përgjithësi duhet bërë në rrafshin e dy periudhave, për të cilat mund të kryhet një analizë më objektive nga të gjitha anët*:

a) Shtresimi i anglicizmave në leksikon e gjuhës shqipe **para vitit 1990** (periudhë e zhvillimit të shoqërisë së mbyllur në Shqipëri, me ekonomi të përqendruar), shfaqet si *periudha e kontakteve të kufizuara me gjuhët e mëdha të botës, veçanërisht me anglishten*.

b) Shtresimi i anglicizmave në leksikon e gjuhës shqipe **mbas vitit 1990** deri më sot (*periudha e zhvillimit të shoqërisë së hapur, me ekonomi të tregut të lirë*), veçohet si *periudha e kontakteve të pakufizuara me gjuhët e mëdha të botës, veçanërisht me anglishten si gjuhë edhe e komunikimit ndërkombëtar*.

Nën tryshinë e fuqishme të *globalizmit kulturor*, në të cilin është përfshirë thuajse gjithë bota e sotme, anglishtja përbën gjuhën parësore ndërmjet gjuhëve të tjera të mëdha në fushën e komunikimit ndërkombëtar, të botës moderne, kështu që edhe anglicizmat, të ngulitur e të përdorur në shumë gjuhë, në pjesën më të madhe mund të pranohen në çdo

gjuhë si fjalë *ndërkombëtare*, pra, si fond gjuhësor i kulturës botërore ( të tipit *bojkot, kompjuter* etj.), e po kështu mund të pranohen edhe për gjuhën shqipe.

Para vitit 1990, *anglicizmat kanë pasur vëllim, shtrirje e denduri përdorimi të ngushtë*, të kushtëzuar kryesisht nga rrethanat jashtëgjuhësore dhe nga politika gjuhësore e kohës në Shqipëri. *Prirja kryesore ishte mënjanimi i anglicizmave si emërtime të dukurive “të botës kapitaliste e të huaja”* për sistemin e shoqërisë së re socialiste të ndërtuar në Shqipëri. Përdorimi i fjalëve nga bota amerikane e angleze, sidomos në fushën e politikës, të ekonomisë, të së drejtës, të arsimit etj., ndodhte vetëm në raste të detyrueshme.

Kështu, më shumë anglicizma kanë hyrë në fusha të veçanta, disi “asnjanëse”, si p.sh.: në terminologjinë e sportit: *badmington, gol, golf, faull, bek, centër for, aut, korner, start, futboll, basketboll, volejball, ençe, refer, maç, trajner, kros, pas*; në tregti: *trust, licensë, klering, dollar, sterlinë, bum*; në bujqësi: *grejppfrut, kultivar, starking*; në teknikë, shkencë, ndërtim: *buldozer, transistor, raketë, balast, blister, napalm, kampion, xhaul, vat, laser, logaritëm, koks, stop, holl*; në terminologjinë ushtarake: *snajper, bunker*; etnografizmaose fjalë me karakter vendor të botës amerikano-angleze: *janki, sherif, bos, çartizëm, tredunion, lord, kauboj, jard, fut, paund, linç, hipi, tuist, rok, suing*.

Pas vitit 1990 u shtuan huazime të tjera në këto fusha dhe në fusha të reja, si: politikë, drejtësi, sociologji, art, administrim: *akses (kam akses), bekgraund, bodigard, dixhital / dixhitalizim / dixhitalizoj, hit / hit pareid, lider / lidershhip, menaxher / menaxhoj / menaxhim, performancë / performoj / performim, vip, killer, supervizor (supervajzër), videoklip, xhekpot, penalitete*; mjekësi: *aids (sida), bajpas, handikap / handikapat, skaner, kolaps*; produkte: *xhin, popkorn, korn fleks, fast fud, pepsi kola*.

Hyrja e anglicizmave në leksikon e përgjithshëm ishte në numër të kufizuar ose shumë të vogël. Si rrjedhim shtresa e përgjithshme e leksikut mbeti më e pastër se fusha e terminologjisë. Aftësia e kufizuar fjalëformuese sillte që edhe ata funksiononin kryesisht si fjalë të veçuara.

Para vitit 1990, anglicizmat kanë hyrë edhe në gjuhë “të mëdha” e të zhvilluara evropiane, si në italishte, frëngjishte, spanjishte, gjermanishtetj., kurse në gjuhë më “të vogla” ata nuk kanë qenë shumë të pranishëm. *Hyrja e tyre në gjuhën shqipe në Shqipëri, sikurse edhe në shumicën e vendeve të Evropës Lindore, përfshirë këtu edhe rusishten, kushtëzohej kryesisht nga shkaqe ideologjike e politike*, prandaj vetëm një pjesë shumë e vogël ka mundur të ngulitet në gjuhë, disa prej tyre me kohë edhe janë shqipëruar.

Periudha mbas vitit 1990 e deri në ditët e sotme *shënon hyrjen e menjëhershme, të vrullshme dhe të vazhdueshme të sasisë më të madhe të anglicizmave*, që gjallojnë sot në gjuhën shqipe në të gjitha rrafshet e saj. Faktorët ideologjikë, ekonomikë e kulturorë në Shqipëri pas vitit 1990, si kalimi i drejtpërdrejtë në ekonominë e tregut etj., ndikuan fuqishëm në drejtim të kundërt me faktorët pengues para vitit 1990. Edhe konteksti i ri ekonomik-shoqëror e kulturor në gjithë hapësirën shqiptare (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Luginë e Preshevës, Medvegjë e Bujanovc), iu shtrua kësaj gjendjeje.

*Faktorët ndikues jashtëgjuhësorë mbas vitit 1990 çuan në vërshimin e anglicizmave për shkaqe të shumta objektive të mirëfillta, por edhe subjektive*, që u ngritën ndonjëherë si shkaqe objektive. Disa nga shkaqet më të rëndësishme, që çuan në hyrjen e vrullshme të anglicizmave në gjuhën shqipe, lidhen me një varg veçorish të truallit gjuhësor:

Duke u futur në mënyrë të menjëhershme, ata e gjetën gjuhën të papërgatitur, pranoheshin nga folësi *à priori* dhe një pjesë përdorej madje duke zëvendësuar pa vend barasvlerësit e tyre të njohur në shqipe (si: *draft* për projekt ose projekt-ide a paraprojekt, *impakt* për ndikim, *resurs* për burim, *shopping* për treg, pazar).

Disa anglicizma, për shkak se shënonin koncepte të reja në fusha të ndryshme, pothuajse nga pak në të gjitha rrafshet e gjuhës, madje edhe në ligjërimin e rëndomtë, u futën bashkë me sendet, konceptet e mënyrën e re të jetesës, por, edhe pse afroheshin nga kuptimi me fjalë shqipe, ata gjithsesi mbetën “më specifike” (si: *disko*, *pab*, *seksi* / femër *seksi*, *okej*, *bajbaj*, *bodigard*). Disa anglicizma, sidomos terma, për emërtimin e koncepteve të teknikave të reja, e gjetën vendin të zbrazët dhe hynë menjëherë në përdorim (si: *kompjuter*, *hardisk*, *maus*, *monitor*, *lap-top*, *desk-top*).

Disa anglicizma u pranuan sipas kuptimeve të mëparshme, por u rivlerësuan nga ana ideologjike (si: *rokendroll*, *rep*, *reper*, *bos*, *kauboj*, *sherif*). Një pjesë e anglicizmave të këtyre fushave janë përfshirë edhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe 2006” (si: *kompjuter* / *kompjuterizoj* / *kompjuterizim*, *kompaktdisk*, *maus*, *tast*, *tastjerë*, *ekran*).

Si veçori kryesore mund të theksojmë edhe aktivizimin më të madh të fjalëve (sidomos të termave) të ngulitur, të futur qysh para vitit 1990, si edhe të një vargu fjalësh të tjera. Disa prej tyre, me vlerat “specifike”, kanë gjetur përdorim të gjerë, si:

**në politikë:** *lider*, *leadership*, *lob* me rrjedhojat (*loboj*, *lobim*); **në mjetet e komunikimit**, një pjesë si formime brenda shqipes: *andërgraund*, *bekgraund*, *bipartizan*, *fizibilitet*, *impakt*, *involvoj*, *killer*, *linçoj*, *panel*, *risk* / *risko* / *riskim*, *rekrutoj*, *samit*, *spiker* (i parlamentit), *target*, *trafik*, *vip*;

**në ekonomi, tregti, drejtësi:** *alokoj*, *akses*, *apdejtoj*, *audit* / *auditim*, *benefit*, *biznes* / *biznesmen*, *çek*, *çekin*, *dizajn* / *draft* / *draftoj*, *fulltajm*, *handikap*, *kesh*, *logo*, *market*, *marketing*, *menaxher* / *menaxhoj* / *menaxhim*, *monitoroj* / *monitorim*, *ombusmen*, *okej*, *parttajm*, *resurs*, *rixhid*, *spot*, *sponsor* / *sponsorizoj* / *sponsorizim*, *tender* / *tenderoj* / *tenderim*, *terminal*, *toplistë*;

**nga bota e artit, e spektaklit, e veshjeve:** *bluxhinz*, *disko*, *dixhej* / *dixheist*, *fans*, *hit* / *hitparejd*, *folkmen*, *folkfest*, *lajv*, *luk*, *kamping*, *mis*, *mister*, *muzikholl*, *plejboj*, *singëll*, *superstar*, *smoking*, *shou*, *topstori*, *topshou*, *trendi*; *tuist*, *xhaz*, *xhinz*;

**në fushën e sportit:** *derbi*, *regbi*, *golf*, *minigolf*, *relaks* / *relaksohem* / *relaksim*, *serf* / *serfoj*, *skuter*.

Pjesa më e madhe e huazimeve nga anglishtja i takon fushës së informatikës. Po përmendim termat më të njohur të kësaj fushe, duke shënuar në kllapa zëvendësuesin shqip (pak a shumë të ngulitur, por edhe si të mundshëm për ta zëvendësuar termin e huaj): *akses* (*hyrshmëri*), *autput* (*futje-t*), *bajt*, *bit*, *bold*, *dejtabejs* (*bazë të dhënash*), *desh*, *direktori*, *displej*, *dixhit* / *dixhital*, *emejl* (*postë elektronike*), *fajl* (*skedar*), *font*, *format* / *formatoj* / *formatim*, *gigabajt*, *harddisk*, *input* (*nxjerrje-t*), *interfejs* (*ndërfaqe*), *insertoj*, *karakter* (*shkronjë*), *kibord* (*tastjerë*), *klik*, *klikoj*, *kompaktdisk*, *kompjuter* / *kompjuterizoj* / *kompjuterizim*, *link* (*lidhëz*), *logo*, *fould* (*dosje*), *megabajt*, *memo*, *mikroçip*, *mikrokompjuter*, *mikroprocesor* (*mikropërpunues*), *laptop*, *monitor*, *on-lajn* (*në linjë*), *pasuërd* (*fjalëkalim*), *printer* / *printoj* / *printim*, *rëplej* (*përsëritje*), *selektoj* / *selektim*, *sejvoj* / *sejvim*, *tab*).

Një vend pothuajse krejtësisht të zbrazët kanë gjetur disa anglicizma në rrafshin e ligjërimin bisedor, një pjesë prej të cilëve vjen nga fusha të tjera, si nga bota e reklamës ose e artit. Këto fjalë shënojnë kryesisht koncepte të mënyrës së re të jetesës, të një botëkuptimi tjetër, ndonëse ato mund të gjenin barasvlerësit në shqipe (*çat* me rrjedhojat *çatoj* / *çatim* / *çatist*, që lidhen me marrëdhëniet intime, me kuptimin

“bisedë intime”, por edhe “bisedë me disa veta njëherësh”). Ndonjë gjen edhe barasvlerësin në shqip (*singëll* “beqar,-e, i pamartuar”, *shoping* “treg, pazar”).

Huazimi i fjalëve të tilla, sidomos i anglicizmave (qoftë të marra nga anglishtja e BE-së, qoftë nga anglo-amerikanishtja) vijnë në shqip në kuadrin e një *dygjuhësie të çalë*, d.m.th. nëpërmjet shqiptarëve, që nuk e dinë mirë anglishten dhe nuk kanë as përgjegjësinë më të vogël që, së paku, *para se të flasin e të shkruajnë shqip ato që i kanë lexuar a dëgjuar në anglisht, t’i shohin se si përkthehen në fjalorët anglisht-shqip*.

Lidhur me këtë mund të citojmë vlerësimin e prof. Gj. Shkurtajt, i cili thekson me nota të forta kritike:

“Kur dëgjon disa prej radiove private, si p.sh. “Top-Albania Radio” të duket se jemi të pushtuar nga ndonjë ushtri anglofone dhe shqipja nuk ngjan më si gjuha jonë, por si një përzierje a “hibride” e tipit të “franglais” (frënglishtes), kundër të cilës me aq zell e atdhetari luftojnë prej vitësh francezët. Edhe neve na kërcënon sot rreziku i një “shqipanglitalishteje”, prandaj, po ritheksojmë për të disatën herë: në qoftë se nuk duam që një shqipe e përçudnuar të përçudnojë edhe mendjen e shqiptarëve, duhet që shteti dhe krejt shoqëria e qytetëruar shqiptare të shkunden nga letargjia dhe të dalin nga mjegullnaja e kësaj shqipanglitalishteje që rrezikon të na kaplojë”<sup>133</sup>.

E para që duhet të bëhet, ashtu si edhe ndaj të gjitha huazimeve të tjera në shqipen, është ndarja e anglicizmave në të pazëvendësueshëm dhe të zëvendësueshëm. Kriteri për këtë ndarje do të ishte: si anglicizma të pranueshëm, sepse janë edhe të pazëvendësueshëm, duhet të pranohen ata, që, në asnjë kuptim të tyre, nuk do të mund të gjenin zëvendësim në aspektin e një lekseme të vetme përkatëse.

Normimin dhe standardizimin shumë të nevojshëm të terminologjisë me burim nga anglishtja duhet ta shoqërojë hartimi i fjalorit të anglicizmave terminologjikë në shqipen. Një fjalor i tillë do të ndihmonte edhe procesin e integrimit të kontrolluar të tyre në shqipen<sup>134</sup>.

### III.11. Disa ndikime të tjera nga anglishtja dhe gjuhët e tjera në drejtshkrim

Gjuha shqipe dhe gjuha angleze, i kanë të njëjta rregullat bazë të përdorimit të shkronjës së madhe, por ndryshojnë në disa raste specifike të cilat dëshmojnë për origjinalitetin dhe specifikën e secilës gjuhë:

1. Në emrat e përveçëm për t’i dalluar ata nga emrat e përgjithshëm. Megjithatë këtu kemi një dallim. Në shqip shkruhen me shkronjë të vogël mbiemrat e prejardhur nga emra të përveçëm gjeografikë, të popujve dhe të gjuhëve: *shqiptar, kinez, amerikan tiranës*. Në anglisht ky tip mbiemrash shkruhen detyrimisht me të madhe: *Can you speak English. He’s Italian* etj. Në fakt në gjuhën angleze, çdo mbiemër që vjen nga një emër i përveçëm, i cili nuk është detyrimisht një emër njeriu ose gjeografik, shkruhet me të madhe: *Elizabethan poets, Scotch whisky, the French language*.

<sup>133</sup>Shih, Gj. Shkurtajt, vep.cit.

<sup>134</sup>Shih: Gj. Shkurtajt, vep.cit.

2. Në emërtimet e funksioneve zyrtare e shoqërore më të larta, titujt e lartë të nderit dhe emërtimet e urdhrave e medaljeve shtetërore shkruhen me shkronjë të madhe (të gjitha fjalët që hyjnë në përbërje të tyre, me përjashtim të nyjave); po kështu veçohet edhe në rastet e ngjashme që tregojnë ente, shoqata, institucione, festa qytetare ose fetare: *Mësuesi i Popullit, Artist i Popullit, Mjeshtër i Madh, Hero i Popullit etj.* Emërtimet e titujve të tjerë të nderit shkruhen me shkronjë të madhe vetëm në fjalën e parë: *Mësuesi i merituar, Artisti i merituar, Mjeshtër i sportit etj.*

Në gjuhën angleze duhen shkruar me të madhe të gjitha fjalët e titullit, me përjashtim të nyjave, lidhëzave dhe parafjalëve. P.sh.; “*New Ways of Working in the Big Organizations, President, Chairman, Governor, Alderman, Elizabeth the Second, Alfred the Great etj.*”

3. Në letërkëmbimin me karakter formal, mund të shkruhen me të madhe dhe përemri vetor i vetës së dytë shumës (Ju), dhe përemrat pronorë (*Juaj, Suaj, Tuaj*) për personalitete të larta shtetërore ose shoqërore (E njëjta gjë ndodh edhe në gjuhën angleze kur përveç rasteve të mësipërme, shënohet gjithnjë me shkronjë të madhe përemri vetor *unë (I)*, por kjo nuk ka të bëjë me formalitetin. Në fakt nuk ka një shpjegim të sigurt mbi arsyet e këtij përdorimi. Mendohet se e ka origjinën te dokumentet ligjore, të cilat gdhendeshin nëpër gurë.

4. Duke qenë se ky përemër në gjuhën angleze ishte vetëm një shkronjë, e cila mund t’i bashkëngjitej lehtësisht një fjale tjetër, u pa e arsyeshme që të paraqitej me shkronjë të madhe në mënyrë që të shmangeshin keqkuptime dhe devijime të kuptimit të dokumentit ligjor. Gjithashtu, në gjuhën angleze shënohen me të madhe të gjitha përemrat që i referohen “zotit” p.sh.: “*They trusted in God that He would save His people*”

Në të dyja gjuhët në letërkëmbimin me karakter formal, mund të shkruhem me të madhe edhe emërimi i funksionit shtetëror e shoqëror:

*shqip: zoti Ministër, i nderuar zoti Kryetar etj.*

*anglisht: Dear Minister.*

5. Shkruhen me shkronjën e parë të madhe emërtimet gjeografike e territoriale-administrative:

*Adriatiku, Alpet, Ballkani, Buna, Dajti, Vjosa etj.* Por në gjuhën angleze shënohen me të madhe edhe emrat e përgjithshëm si *det, lum, mal etj.* kur vendosen pranë emrave të përveçëm: “*Mississippi River, North Sea, Alleghany Mountains,*” etc. Po ashtu katër pikat e horizontit *veri, jug, lindje dhe perëndim* kur përdoren për të dalluar një rajon të caktuar të një vendi shkruhen me shkronjë të madhe: “*The North fought against the South.*”

6. Shkruhen me shkronjë të madhe fjala e parë e titullit të librave, filmave ose veprave artistike kur janë në thonjëza: “*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*”, “*Kështjella*” etj. Po kështu edhe titujt e gazetave, revistave etj.: “*Zëri i popullit*”, “*Koha ditore*”, “*Studime filologjike*”, “*Gjuha jonë*”, “*Rilindja*” etj. në anglisht, siç u përmend edhe më lart, duhen shkruar me të madhe të gjitha fjalët e titullit, me përjashtim të nyjave, lidhëzave dhe parafjalëve. P.sh.; “*New Ways of Working in the Big Organizations*”.

7. Shkruhen me shkronjë të madhe pjesët përbërëse të emërtimit të festave kombëtare e ndërkombëtare:

*Shqip: 28 Nëntori, 8 Marsi, Viti i Ri etj*

*Anglisht: Independence Day, New Year’s Day*

Këtu vlen për tu përmendur një dallim tjetër që në gjuhën angleze emrat e muajve shënohen gjithnjë me të madhe, jo vetëm kur i referohen festave të caktuar sepse përfshihen te emrat e përveçëm.

8. Respekti në një gjuhë nuk shfaqet vetëm në leksik dhe drejtshkrim. Ai shfaqet edhe në gramatikë. Në gjuhën shqipe ai shfaqet në përdorimin e përemrit vetor të vetës së dytë shumë: *Ju* dhe në vendosjen e foljes në vetën e dytë shumë. Anglishtja nuk arrin ta shprehë respektin në këtë mënyrë sepse përemri vetor i vetës së dytë njëjës dhe ai vetës së dytë shumë janë njësoj. Megjithatë ajo përdor struktura gramatikore me folje modale, të cilat tregojnë respektin dhe shfaqen në një përshkallëzim të formalitetit. Duke kaluar nga më pak formalja deri te më formalja, në anglisht përdoren strukturat e mëposhtme për të bërë kërkesa:

1. Can I borrow your pencil?
2. Could you lend me your pencil?
3. Is it OK if I borrow your pencil?
4. Do you mind if I use your pencil?
5. Would it be OK if I used your pencil?
6. Would you mind if I borrowed your pencil?
7. Would you mind lending me your pencil?
8. I wonder if I could borrow your pencil?
9. I was wondering if you'd mind lending pencil

Siç vihet re nga më pak formalja deri te më formalja kemi edhe një ndryshim në kohën e foljes, duke kaluar nga e tashmja (can, lend, use) te e shkuara (could, would, used, borrowed, etj.)

Sot hapësirat shqiptare ballkanike kanë mbërritur një shkallë të re të përparimit e të kontaktit me anglishten e gjuhët e tjera me të cilat ka qenë në kontakt të drejtpërdrejtë, si p.sh. me maqedonishten në universitetet e Shkupit, të Tetovës etj. në Maqedoni, me serbokroatishten në universitetet e Kosovës e të Malit të Zi dhe, sidomos, me anglishten në të gjitha hapësirat e sotme universitare, duke qenë se anglishtja tashmë është gjuha e dytë kryesore në krejt formimin e shkollarëve, që ndjekin shkollat e mesme dhe studimet e larta universitare, dhe diplomimin në sistemin e masterit dhe në shkollat doktorale.

Përparësia që i është dhënë anglishtes, ndërkaq, shtron edhe më me forcë e ngut përmirësimin e statusit të shqipes si gjuhë e parë, si gjuhë e nënës dhe si “gjuhë e zemrës” në të gjitha hapësirat shqiptare e shqipfolëse të trojeve kompakte ballkanike, madje edhe në diasporën shqiptare, posaçërisht atje ku ka edhe katedra, institute a lektorate të shqipes, si p.sh. në Universitetin e Kozencës (Kalabri), të Palermos (Sicili), të Napolit dhe në “La Sapienza” të Romës.

Të nxënësit dhe përdorimi i gjerë i anglishtes dhe i gjuhëve të huaja të tjera, sidomos i italishtes, që përhapet shumë edhe nëpërmjet televizionit e radios, kanë sjellë dobi në përparimin e shkencës, të teknikës, po edhe në artin e në kulturën e intelektualëve shqiptarë, si në Shqipëri, ashtu edhe më gjerë; janë shtuar edhe përkthimet nga këto gjuhë dhe nga gjuhë të tjera, gjë që ka vënë në shërbim të shkollarëve e universitarëve shqiptarë ajkën e mbërritjeve të reja të shkencës e dijes botërore.

Ndërkaq, nga ana tjetër, kjo ka pasur edhe pasoja në nxënien, vlerësimin dhe kujdesin për gjuhën shqipe. Kudo ka rendje pas anglishtes, pëlqehen e blihen me ëndje librat dhe revistat në anglisht e në gjuhë të tjera të huaja, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për gjuhën shqipe. Përkundrazi, nuk mund (dhe s'ka pse) ta fshehim: ka pasur rënie të ndjeshme të kujdesit ndaj të nxënimit të shqipes dhe, sidomos, mungesë vullneti e dëshire për ta pastruar, pasuruar dhe mbrojtur shqipen.

Në radhë të parë është për t'u kritikuar rënia e disiplinës së shtetit e të institucioneve shtetërore e shoqërore të lejuara prej tij ndaj gjuhës shqipe. Nuk zbatohet drejtshkrimi i njësuar i shqipes, ka thyerje të rënda të normave të shkruarit edhe në fushën akademike, duke u theksuar prirja për të shkruar me të madhe çdo lloj emërtimi, pa asnjë kriter drejtshkrimor. Të gjitha rubrikat e reja të televizioneve shqiptare, ndërsa në Itali e gjetkë në Evropë, përkthehen nga anglishtja, si p.sh. *“Grande Fratello”*, *“Ballando con le stelle”* etj. tek ne, për fat të keq, përballem me zulmë e gëzim të pashpjegueshëm vetëm në anglisht: *“Dancing with the stars”*, *“Albanian’s got talent”*, *“Big Brother”*, *“Deja vu”* për të mos folur edhe për rubrika të tjera, të gjitha në anglisht e pa nevojë, si *“Gut Talent”*, *“INSID”*, *“Tunicht”* etj.

Problemi kryesor është, sikundër e thotë prof. Shkurtaj, *“të shkojmë drejt Evropës, të nxëmë anglishten dhe gjuhët e tjera, si mjete të domosdoshme e, madje, si shkallë të pamënjueshme të bilingualitetit e bilinguizmit të domosdoshëm, por edhe të mbetemi shqiptarë, të ruhem nga anomia sociale e nga teprimet në qasjen e së huajës”*.<sup>135</sup>

Pa gjuhë, asnjë popull nuk do të mund ta zhvillonte kulturën e vet. Gjuha e shkruar, e ngritur mbi bazën e ligjëritimit të folur dhe në bashkëvajtje e konkurrencë të natyrshme me të, gjatë shekujve ka ndihmuar në zhvillimin e përparimin e dijes, shkencës, teknologjisë dhe industrisë. Në kohët e reja, së shkruarës tradicionale, me anë të librave e botimeve të tjera, qysh nga gazetat e revistat deri te publiciteti me anë të fjalës së shkruar, përkthimet me shirit të shkruar (subtitrim) ose me dyzimin e të folurit me zë aktorësh në gjuhën kombëtare përkatëse, i janë shtuar tashmë edhe aq shumë mjete e forma të reja kumtimi e publikimi nëpërmjet atyre që në sociolinguistikën e sotme i quajmë “flukse të padukshme” ose postë elektronike (përkat. botime “on-line”), që si një hapësirë gjigande e nëndheshme i është veshur sot botës së komunikimit, duke e konkurruar dukshëm (e përditë e më masivisht) gjuhën e shkruar në letër.

Krahas ligjëritimit të shkruar e botimeve në faqe librash, gazetash a revistash, që natyrisht vazhdojnë e shtohen, kanë fituar rëndësi të madhe mediat e shkruara dhe të folura “on line”: radioja, televizioni, posta elektronike me internet si dhe gjithatë mundësi e forma të tjera të botimit a publikimit elektronik, që qarkullojnë në mënyrë të padukshme nga njëri vend në tjetrin, nga njëri kontinent në tjetrin dhe që, tashmë, bota dhe ecja përpara e saj as që mund të kuptoheshin pa përdorimin e tyre.

Mund të themi se sot, ndërsa ka pasur e ka jo shumë njerëz që kishin mundësi të blinin e të përdornin në shtëpinë vetë ndonjë fjalor të madh ose enciklopedi, me shtimin e internetit nëpër zyra, në qendra pune e biznesi dhe deri në shtëpi, kushdo, brenda disa sekondash mund të futet në sitet e enciklopedive “on-line” dhe të gjejë

<sup>135</sup>Shih: Gj. Shkurtaj, *Normëshkelësit duhet të përgjigjen për dëmin që i shkaktojnë gjuhës shqipe*, në “Akte të Konferencës Shkenore me temë “Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar”, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë, 2004, f.9-25..

informacionin që i duhet. Prandaj, mund të thuhet se edhe në komunikimin gjuhësor, sot, globalizimi vështrohet si dukuri që çon në rritjen marramendëse të ndikimit të anglishtes si gjuhë pune e informacioni me peshë aq të madhe në botë.

Përkundër këtij ndikimi të anglishtes, i cili bëhet kryesisht përmes mediave dhe internetit, risitë teknologjike janë duke krijuar hapësira të reja edhe për përdorimin e gjuhëve të tjera të botës. Hapja e Shqipërisë ndaj ekonomisë së tregut dhe futja e investimeve të huaja, si dhe zhvillimi i madh i teknologjisë së prodhimit, i mediave dhe i teknologjisë informative kanë krijuar hapësira për përparime cilësore në kuadër të bashkësisë shqiptare, e cila, ndonëse me ritme e veçanti të dallueshme nga Evropa, sidoqoftë, nuk mund të mos i nënshtrohej ndikimit të globalizimit.

Globalizimi është dukuri që ndikimin e tij e shtrin edhe në proceset gjuhësore dhe ky ndikim nuk mund të ngushtohet vetëm në ndikimin që anglishtja si gjuhë e sotme globale është duke ushtruar në gjuhët e tjera dhe as si ndikim në kuptimin e përhapjes së huazimeve prej saj në gjuhët e ndryshme të Botës. Ky kah (shumëkush do ta thoshte me termin anglisht *trend*) madhor i ecjes së sotme të njerëzimit në mbarë rruzullin tokësor nuk mund të shihet vetëm si dukuri që rrezikon t'i gërrryejë e t' i zhdukë dalëngadalë gjuhët kombëtare të popujve të vegjël. Aq më pak mund të shihet sot përhapja e gjerë dhe e shpejtë e internetit dhe e ndikimeve që vijnë me të si "armike" e përparimit dhe zhvillimit të kulturës e gjuhës kombëtare.

Mjetet e reja të komunikimit masiv kanë marrë shtrirje të gjerë. Shumica e brezave aktivë sot shërbehen jo vetëm nga telefonia fikse, por edhe nga telefonia e lëvizshme a celulare, "mbjellin e korrin" përherë e më shumë në hapësirat e internetit, qoftë me anë të E-mail-eve, sistemit të chatimeve me të shkruar, si dhe me ato pamore nëpërmjet "skypes". Këtu vlen të përmendim komunikimet e të rinjve me njeri-tjetrin me anë të mesazheve me internet dhe me celularë, duke u krijuar, madje, edhe një fushë e re e hulumtimit sociolinguistik të ligjërit rinor me anë të shkurtimeve e shkurtesave tejet të veçanta.

Mund të shohim aty, natyrisht, edhe ployën e ndikimeve të panevojshme në gjuhën shqipe, sidomos të pakujdesisë ndaj rregullave të gramatikës e të drejtshkrimit, duke u bindur se përveç avantazheve në lehtësinë e komunikimit, vihen re dhe shtrembërime (deformime) e dëmtime të rënda të kulturës së gjuhës shqipe, të cilat nuk ishin shfaqur dikur as në "flukset e dukshme" që kanë ekzistuar gjithmonë (letërsia artistike, teatri, filmi, shkollat, radio-televizioni publik), ku gjuha shqipe ishte e kujdesur dhe e respektuar dhe shfaqte origjinalitetin e saj.

Gjuha shqipe në internet ose në mesazhe me celular karakterizohet nga synimi për shkurti dhe shpejtësi kumtuese, çka është edhe e kuptueshme, le të themi edhe e pranueshme, por bashkë me këtë cilësi po shumohen në atë lloj ligjërit edhe elemente të "ligjërit të fshehur" e ku, krahas anonimatit e përdorimit të shtuar të pseudonimeve, po vërshojnë edhe shkruarje fjalësh mbrapsht, fjalë banale etj. karakteristike të zhargonit rinor.

Deri këtu, sidoqoftë, nuk do të ishte rasti për t'u shqetsuar, porse puna është se shprehjet e përdorura gjatë komunikimit në internet që krijohen për të kursyer kohë gjatë bisedave, si p.sh.: KLM –Kalofsh mirë! KLB -Kalofsh bukur! Flm-Faleminderit! Thnx- Thanks You! TKSHXH- të kam shumë xhan. TDF- Të dua fort. TDSH – të dua shumë. TPF- Të uth fort. Cpb—çfarë po bën?) etj<sup>1</sup>, kalojnë edhe në praktikën shkollore, duke mos i kushtuar kujdes aspak të folurit dhe të shkruarit

letrar, madje këto kthehen në shprehi, të cilat bartin me vete shumë ndikime negative tek nxënësit.

Përkthimet e letërsisë së huaj bashkëkohore dhe të filmave me anë të shiritave të shkruar janë mbushur me antieufemizma si p.sh. e padurueshmja dhe e stërpërdorura “palloj”. Duke shqyrtuar këtë lloj ligjërimi a zhargoni të të rinjve, një student pasuniversitare shkruan : ‘ *Nuk konsiderohesh komunikues i mirë nëse nuk përdor këtë lloj gjuhë, prandaj kjo formë e bisedave në mes njëri tjetrit te disa të rinjë bëhet edhe e imponuar, nëse nuk e praktikon nuk mund të jesh “modern”. Këto ndikime mund të vërehen edhe me rastin kur nxënësit pyeten apo vlerësohen nga profesorët*’.

Shpesh herë, në këto fjalë-kode dëgjohej të flitet me fjalë banale, me fjalë të huaja dhe kryesisht përdoren fjalë me nënkuptime që dinë t’i përkthejnë vetëm gjimnazistët. Një gjë është e sigurt, që nëse dëgjon një bisedë që zhvillohet mes adoleshentësh, asgjë nuk do të marrësh vesh dhe kurrë nuk do arrish të kuptosh atë çfarë ato thonë. Madje, do të duket sikur ata nuk e dinë mirë gjuhën shqipe që është dhe gjuha e tyre amtare. Do të duken biseda të pakuptimta, megjithëse ata kuptohen mjaft mirë me njëri-tjetrit. Një djalë 17-vjeçar (E.H.) tregon: *“Është e vërtetë që ne në mjedisin tonë shoqëror përdorim një sërë fjalësh, shprehjesh dhe kodesh që i dimë vetëm ne. Por me thënë të drejtën, ato tani janë bërë pjesë e fjalorit tonë dhe nuk i mënjanojmë dot.”*<sup>iii</sup>

**2.** Në rrafshin e gjerë të shqipes, dukuria e globalizimit ka ndikuar që shqipja t’i nënshtrohet një procesi të rishkallëzimit ose të ripërshtatjes në rrafshin global kombëtar dhe vendor (lokal). Ky proces është duke u shoqëruar dhe me ndryshimin e ligjëtimeve a stileve “diskurseve”, gjinive e llojeve “zhanreve” të kumtimit (komunikimit) të gjuhës shqipe. Rol shumë të fuqishëm po luan interneti, si sistem komunikimi e publikimi “on-line”, që erdhi krahas e i lidhur shumë ngusht me përhapjen e proceseve globalizuese.

Siç u tha më lart, përkundër faktit që interneti konsiderohet nga shumë autorë si mjete kryesor për përhapjen e anglishtes si gjuhë globale dhe për ndikimin e saj në gjuhët e tjera, megjithatë duhet të themi se ky mjet i komunikimit dhe i publikimit “on-line” ka krijuar edhe hapësira a fusha të reja për përdorimin e shqipes, që nuk njiheshin më parë. Shqipja sot është gjuhë e shumë siteve elektronike në gjuhën shqipe, e email-it, e forumeve dhe blog-eve të ndryshme në internet, në të cilat shqipja del në format e saj të shkruara: herë në formë standarde, herë në forma të varieteteve të tjera të shqipes dialektore ose, sidoqoftë, jostandarde.

Prandaj, duke e përmbyllur mendimin lidhur me këtë dukuri, duhet të vë

më në dukje, se ndikimi i globalizimit në shqipen nuk mund të shihet vetëm si ndikim i anglishtes dhe që shprehet nëpërmjet huazimeve e barbarizmave. Globalizimi dhe proceset integruese janë të lidhura fort edhe me aspektet e zhvillimeve të përgjithshme politike, ekonomike, kulturore, letarre dhe, pa dyshim, gjuhësore, që kanë ndikuar edhe në laryshinë apo llojshmërinë e ligjëtimeve a diskurseve të shqipes së sotme, duke i pasqyruar të gjitha këto procese ekonomike, politike dhe kulturore nëpër të cilat po kalon shoqëria shqiptare.

Në sfondin e ndikimit dhe zhvillimeve globalizuese edhe norma e sotme gramatikore e shqipes, por edhe ajo drejtshkrimore, po ndeshet me trysinë e fortë e gërryerëse të gjuhëve të huaja, sidomos të gjuhëve që dallohen shumë nga natyra eptimore e shqipes, si anglishtja, gjuhë kryesisht idiomatike që nuk ka as lakim emrash as zgjedhim foljesh etj. Ndikimi i shqiptimit të gjuhëve të huaja, pa përmendur vërshimin e fjalëve dhe termave të huazuar, po ia marrin frymën shqipes, duke dëmtuar sidomos atë që quhet etnografi e të folurit shqiptarisht. Deri edhe pasthirmat shqiptare po pakësohen duke na u servirur në vend të tyre pasthirmat të gjuhëve të huaja, a thua se televizionet tona i shohin dhe i mbajnë gjallë të huajtë e jo forca blerëse e kontribuesve dhe e shikuesve shqiptarë.

Një problem grafik jo pa rëndësi, që vjen nga prurjet e reja, është edhe shtimi i fjalëve dhe emrave të huaj, kryesisht anglo-amerikanë që përmbajnë shkronjën **w** apo sikundër po e shqiptojnë modernët “dabëll ju”. Kohëve të fundit, nga ndikimi përherë e më i fuqishëm i gjuhëve të huaja, kanë hyrë e po zënë vend në shqipen edhe disa fjalë, kryesisht emra të përveçëm, po edhe fjalë të artit e të politikës, që shkruhen si në gjuhët huazuese (*Show, Show-Biz, News, News-24, Euro-News*). Kemi shtënë në përdorim kompjuterin dhe aty, ndër të tjera, kemi edhe programet e tilla, kryesore, si *Word, Word-Perfeckt, Window* etj. Këto fjalë tashmë janë shtruar dukshëm në veprimtarinë shkrimore dhe në ligjërimitin e folur të njerëzve me shkollë. Pyetja që shtrohet është edhe këtu: si do të shkruhen fjalë të tilla?

Mesa shihet, shtimi i fjalëve dhe emrave të huaj të tillë po sjell edhe domosdoshmërinë e përfilljes së shkronjës **w** në shqipen. Rregullat e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, duke u nisur nga situata e kohës kur me atë shkronjë dilnin vetëm disa emra personalitetesh të shkencës e të letrave, si *Wat, Wiliam, Wilson* etj. dhe të disa emërvendeve (toponimeve) gjithashtu të arealit anglo-amerikan, kishte parashikuar që në shqipen emra të tillë të jepen me **U**, si p.sh.: *Uat, Uashington, Uells, Uljam, Nju- Jork, Nju- Delhi, Nju- Orleans* (Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, *Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 1973).

Prirja është e dukshme dhe anon nga forma e huaj. Edhe ndaj kësaj dukurie normativistët nuk mund të vijojnë më tej me “lojën e strucit”. Prurjet gjithmonë në shtim të fjalëve të tilla dhe përdorimi i gjerë që kanë disa prej tyre në mediat e sotme, natyrisht, nuk mund të kalohen vetëm me qesëndisje a shpotitje ironizuese. Ditë për ditë dëgjojmë të jepen reklamat duke shënuar edhe adresën e faqeve të internetit, të cilat, duam apo nuk duam, fillojnë patjetër me tri dopio-v njëjërën pas tjetërës.

Edhe këtu, sigurisht, mund të kishim zgjidhje të ndryshme, duke përfutur edhe nga sa kanë bërë fqinjët tanë, p.sh. italianët, e shkruajnë **w** si në gjuhën dhënëse, por e shqiptojnë sipas traditës italiane: **vu-vu-vu**, prej nga edhe ne mund të merrnim gjedhen pozitive të thoshim : **vë-vë, vë-vë, vë-vë**, porse ka edhe prej atyre që e thonë *dabëll a dabëllju*, si p.sh. kur i referohen Bushit: *Georges W. Bush* (shqiptohet *Xhorxh Dabëll Bush*).

Çfarë të bëjmë? Natyrisht atë që e kanë pohuar gjithmonë gjuhëtarët: *të mos përulemi para së huajës, të mbrojmë tonën, sidomos atë pjesë që dihet se e kemi të mirë, të bukur e të pavidirë: strukturën morfologjike të shqipes*<sup>136</sup>.

<sup>136</sup> Shih: Gj.Shkurtaç, *Kultura e gjuhës*, SHBLU, 2006..

### III.12. Ndikimet evropianizuese në drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj në shqipen

Fjalët dhe emrat e përveçëm të huaj, si pjesë e trysnisë dhe e ndikimit gjuhësor të huaj, si rregull, kur hyjnë në shqipen (ashtu si në çdo gjuhë tjetër) shkaktajnë edhe probleme shqiptimore, sidomos të vendit të theksit, si dhe drejtshkrimore e morfologjike.

Le ta nisim nga rasti më i thjeshtë: një i huaj që vjen në Shqipëri dhe paraqitet tek nëpunësi i doganës për të kryer formalitetet e nevojshme: regjistrim e pajisje me vizë, kontroll i bagazheve etj, si do ta shkruajmë emrin e tij? Ashtu si e ka në pasaportën e tij? Kjo do të ishte (dhe teorikisht mbetet) mënyra më e drejtë dhe më e saktë. P.sh, *Michel Jakson, George W. Bush, Silvio Berlusconi*.

Mirëpo puna është se emra të tillë ndryshe shkruhen dhe ndryshe shqiptohen. (Përkat: *Majkëll Xhekson, Xhorxh Dabëllju Bush, Silvyo Berluskoni*). Komisioni hartues i Rregullave të drejtshkrimit të shqipes, duke pasur të qartë se sa e vështirë do të ishte për ne shqiptarët që të mësonim si shkruhen e si shqiptohen të gjithë emrat e përveçëm të huaj, pavarësisht nga mendimet jo të pakta që kishin anuar edhe më parë nga të shkruarit si në gjuhën prej nga vijnë (ashtu si sot ata që nuk i zbatojnë rregullat) ka tumiruar që emrat dhe fjalët e huaja që hyjnë në shqipen do të shkruhen ashtu si shqiptohen në gjuhën prej nga vijnë, por sipas rregullave të drejtshkrimit të shqipes. Pra, *Gëte* (e jo Goethe), *Viljam Shekspir* (dhe jo Wiliam Shekespeare), *Bajron* (dhe jo Buron) etj.

Ky rregull për disa vjet, deri në dhjetëvjeçarin e fundit, është zbatuar gati pa mëdyshje, porse ajo e ka pasur dhe e ka një ngërç (ata që kanë prirje të flasin me terma e fjalë të huaja, me siguri do të thoshin "një handicap"). Në shumë vende të Evropës (Itali, Francë, Gjermani etj.) emrat e autorëve dhe të personaliteteve të ndryshme politike, shkencore, shoqërore, të artistëve etj. shkruhen zakonisht ashtu si i kanë në vendin e gjuhën përkatëse. P.sh. italianët nuk e kanë fonemën **th** dhe as që mund ta shqiptojnë edhe po të donin, prandaj ata shkruajnë sipas drejtshkrimit të anglishtes *Margaret Thatcher, Tony Blair* etj. pa u bërë shumë merak për shqiptimin e tyre.

Të shkruarit sipas rregullave të shqipes, siç e thamë, është një mënyrë që e lehtëson mjaft punën kur dihet se si shqiptohet një emër i huaj, aq më tepër edhe për hir të pasurisë së madhe të shqipes me fonema bashkëtingëllore, të cilat plotësojnë pothuajse mjaftueshëm të gjitha nevojat për shqiptimin (pra edhe për shkrimin) e emrave të krejt rruzullit tokësor. Mirëpo lehtësi jo gjithmonë do të thotë edhe zgjidhje e qëlluar. Ja përse, siç po e shikojmë në këto dekadat e fundit, kahas formave normative e në përputhje me rregullat e drejtshkrimit, kanë filluar të shtohen rastet e thyerjeve të ndërgjegjshme të rregullave dhe, si pasojë, emrat e autorëve të ndryshëm të huaj që përkthehen e botohen në gjuhën shqipe, shkruhen sipas mënyrës së shkrimit në origjinalin përkatës. (*Jahn Paul Sartre, Albert Camus, Charles Dickens* etj.).

Si duhet vepruar më tej?

*Ashtu si për çdo rregull e ligj tjetër kur ka shtet ligjor, derisa të ndryshohen rregullat në fuqi, duhet të vijojë zbatimi me përpikmëri i të shkruarit sipas rregullës që përmendëm. Megjithatë, situata është e tillë që thyerjet e normës në këtë kategori emrash janë të shumta, ndoshta më të shumta sesa rastet e zbatimit të saj, prandaj nuk mund të rrimë pa shprehur edhe ndonjë vlerësim të mëtejshëm, qoftë edhe si mendim personal. Zbatimi i kësaj rregulle, sipas meje, ka pasur dhe ka një të mirë të madhe: lehtëson punën e të shkruarit të emrave të huaj, porse edhe e çënon mjaft dhe e dëmton saktësinë dhe rreptësinë e pasqyrimin, si edhe çënon mjaft keqas vërtetësinë*

*anagrafike e vlerat zyrtare burokratike të emrit të personit.* Ka edhe probleme të tjera jo të lehta për t'u zgjidhur, si p. sh. hartimi i bibliografive letrare e shkencore. Si do të veprohet me katalogizimin dhe vendosjen e veprave të të njëjtit autor të huaj kur janë të botuara në origjinalin përkatës e me emrin e atjeshëm të autorit dhe kur janë të përkthyer në shqip e ku emri i autorit, i shkruar sipas normave të shqipes, nuk përputhet grafikisht.

*Pra, të shkruarit sipas origjinalit përkatës ka të mirën se mban të patjetërsuar emrin e autorit dhe mbron vlerat anagrafike të emrit, porse, nga ana tjetër, shkakton edhe një përshtjellim të vërtetë në shqiptimin e emrave të huaj.* Për t'u bindur për këtë, si dhe për të treguar pse do të isha më i anësuar që të mbetet shkrimi ashtu siç e kanë parashikuar Rregullat në fuqi, po sjell vetëm ndonjë shembull vërtetë bindës. Për gati tridhjetë vjet radhazi, disa makina franceze të tipit "Renault" kanë punuar në Shkodër e në qytete të tjera. Askush nuk i shqiptonte sipas shqiptimit të gjuhës frënge (*Rëno*), por sipas shkronjave përkatëse (*renault-i*).

Por, mund të sjellim edhe një shembull të kohëve më të reja. Veturat e pakëta të tipit "Peugeot" të viteve '80. Shumëkush, madje deri edhe titullarë të ministrive që i kishin në dispozicion, nuk dinin ta shqiptonin "pëzho" si në frëngjisht, por duke e deshifruar shkronjë për shkronjë "peugeot". Tashti, sigurisht, gjendja ka ndryshuar shumë. Janë shtuar njerëzit që flasin e shkruajnë mirë anglishten dhe gjuhë të tjera të huaja, ka marrë përhapje të gjerë leximi dhe komunikimi nëpërmjet internetit etj. dhe, sigurisht, mund të thuhet se janë përherë e më të paktë ata që mund të bëjnë aso leximesh si në shembujt që u përmendëm.

Megjithatë, si në qoftë se do ta ndërrojmë rregullën, si në qoftë se do ta mbajmë ashtu siç e kemi, në të dy rastet një "haraç" do ta paguajmë. Me fjalë të tjera, o do t'i shkruajmë sipas origjinalit dhe do të përpiqemi pastaj për të kapur edhe drejtshqiptimin e tyre deri ku të arrijmë, o do të kënaqemi me një shqiptim gjithsesi më të sigurtë që na e jep mënyra e shkrimit që kemi ende në fuqi, porse duke cënuar jo pak rreptësinë grafike dhe anagrafike të emrave të huaj.

Pra, o do të shkruajmë *Shrëder, Bler, Shalekashvili* dhe do të bëjmë figurë të mirë me shqiptimin si në gjermanisht apo në anglisht, ose, përkundrazi, do ta shkruajmë *Schroder, Blear, Chalechashevill* dhe do të presim "kusuret" shqiptimore të pamënjanueshme.

Ana tjetër e medaljes pse shihet (dhe është) më e përshtatshme mënyra e të shkruarit sipas shqiptimit që kanë në gjuhën prej nga merren dhe duke zbatuar drejtshkrimin tonë ka të bëjë me ruajtjen (përkatësisht prishjen) e strukturës morfologjike të shqipes. Le ta shkoqisim më mirë këtë dukuri. Të shkruarit sipas grafisë që emrat e huaj kanë në gjuhët prej nga i marrim, po sjell (dhe do të sjellë përherë e më dukshëm) prirjen që emrat e huaj të mos marrin më as trajtën e shquarësisë formale.

Gjuha shqipe, siç dihet, ka trajtën e pashquar dhe të shquar të emrave dhe këtë e shtrin normalisht edhe në emrat e përveçëm shqiptarë apo të huazuar e të huaj. Shqip thuhet (dhe duhet të thuhet gjithnjë): *Dritero-Driteroi, Fatos-Fatosi, Pjetër-Pjetri, Ismail-Ismaili, Zija-Zijai, Pushkin-Pushkini, Gëte-Gëtja, Hajne-Hajneja* etj. Pra, lexova një vjershë të *Diteroit, të Fatosit, të Pjetrit, të Ismailit, të Zijait, të Pushkinit, të Gëtes, të Hajnes, të Bajronit* etj.

Mirëpo shihni dhe dëgjoni se çfarë po ndodh: ditë për ditë lexojmë në gazeta e dëgjojmë nga goja e folësve të Radio-Televizionit Shqiptar dhe të mediave të folura private: *ai i tha Bush* (në vend: *i tha Bushit*), *gjqyqi i Millosheviq* (në vend të: *-i Millosheviqit*), *vizita e Bler* (në vend të: *vizita e Blerit*), *takimi me Nikolas Geixh* (në vend të: *takimi me Nikolas Geixhin*) etj.

**Probleme të shqiptimit të emrave të përveçëm të huaj.** Koha e sotme, sidomos në këta vjet të shndërrimeve të mëdha edhe në superstrukturën shtetërore e në krejt jetën e marrëdhëniet politiko-shoqërore e kulturore të vendit, ka prurë në skenë figura dhe personalitete që ndikuan me fjalën e tyre të folur e të shkruar, porse shpesh pa e pasur as përgatitjen e nevojshme gjuhësore, as shkallën e lakmueshme arsimore e kulturore. Po ashtu, ka pasur e vijon edhe mjaft përfryrje e snobizëm, sidomos dëshira për të treguar dijet "e thella" të gjuhëve të huaja etj.

Dhe, nga të gjitha këto rrjedha, kanë vërshuar në mediat e folura e të shkruara, po edhe në dokumentacionin e partive politike e deri të administratës shtetërore, aq shumë fjalë e terma të huaj të panevojshëm, sidomos anglo-amerikanizma: *drafti, stafi, involvim, implementim, rurale, lider, lidershhip, spiker, konsensus, konsensual* etj. e deri te krijimi sa hibrid e i kotë aq edhe i përçudshëm : *komisioni bipartizan*, me të cilin këto kohët e fundit kanë rënë në dashuri gati të gjithë politikanët e analistët. As që u shkon në mendje se shqip do të thuhej më mirë e më thjeshtë: *komisioni dypalësh, i dy partive* ose *dypartiak* apo *dypartior* apo *prej dy partish*.

Kot të lodhemi. *Pa shëruar trurin e disa prej atyre që kanë sot në dorë shtetin, politikën, partitë, radiot, televizionet dhe krejt jetën e vendit, nuk ka vlerë asnjë këshillë a kritikë dashamirëse e gjuhëtarëve.* Është thënë disa herë në studime dhe në artikujt e botuar: deri deputetët e nderuar të Kuvendit, nuk kënaqen me termin shqip "Kuvendi i Shqipërisë", por rendin pas fjalës së huaj: *Parlamenti, parlamentar, kryeparlamentar* etj.

Muaj e vite me radhë kemi dëgjuar se si ngatërroheshin të mjerët duke shqiptuar shatra-patra anglicizma të panevojshme, po edhe pa ua ditur mirë kuptimin: *konsensus* (herë me theksin mbi **e**-në, herë mbi **u**-në), *lider* (herë me theksin mbi **i**-në, herë mbi **e**-në). Të njëjtën gjë po heqin prej vitesh edhe punonjësit e radiotelevizioneve me fjalën *spiker-i* ( herë me theksin mbi **e**-në, herë mbi **i**-në), porse "picirin" po heqin sidomos me fjalët "anonçoj" dhe "anonçim".

Disa nga këto mëdyshje që unë do t'i quaja "hamletiane" mund të shmangeshin shumë lehtë në qoftë se njerëzit do të fillonin të mendonin shqip, më parë shqip sesa në gjuhë të huaja, ta nisin fjalën, fjalimin a diskutimin ashtu siç duhet nisur kur dëshiron të të kuptojnë dhe të të ndjekin dëgjuesit, pra, duke mos u përfryrë e duke mos shitur dengla me sllogane e terma të huaj të nxënë përciptas.

Vihet re me shqetësim se gjithandej në rrethet e politikanëve, të analistave dhe të masës së gjerë të shkruarve ka një "ethe" për të përdorur fjalë të huaja të reja, po edhe për t'u rikthyer në fjalë të huaja të vjetra, të cilat tashmë ishin zëvendësuar me mjaft sukses. Kështu, krahas *kombëtar*, po rishfaqet dendur *nacional*, madje edhe *nacion* për *komb-i*, në vend të *ndërkombëtar-e* po rikthehet *internacional-e* etj. Ka edhe disa persona që shkojnë deri në fjalime aq të "holla" sa që në vend të thonë "kjo çështje ka (ose nuk ka) zgjidhje" thonë "ka (ose nuk ka) solucion".

## KAPITULLI IV

## SHTRIRJA E SHQIPES NE HAPESIRAT SHQIPTARE BALLKANIKE

Ashtu si në çdo gjuhë tjetër, edhe në gjuhën shqipe, prej ndryshimeve që ka pësuar ajo kohë pas kohe në krahina të ndryshme, ka arritur të ketë sot një degëzim me dy dialekte, secili dialekt me dy nëndialekte dhe me grupe të folmesh të shkallëve të ndryshme.

Shqipja me variantet e saj territoriale shtrihet sot në truallin e Republikës së Shqipërisë, në tokat që kanë vijimësi matanë kufijve: toskërishtja vijon në Greqi, në krahinën e Çamërisë, deri në gjirin e Prevezës dhe në Maqedoni, në anët e Prespës deri nga Manastiri, kurse gegërishtja në Mal të Zi, në anët e Ulqinit, Krajës, Vranjës, Tuzit, Malësisë së Podgoricës, Plavës, në gjithë krahinën e Kosovës, në Jabllanicë, në anët e Preshevës e të Bujanovcit, në anët e Pështerit afër Novi Pazarit dhe në Maqedoni, në anët e Strugës, Ohrit, Dibrës, Kërçovës, Prilepit, Tetovës, Gostivarit, Shkupit e Kumanovës.

Veç të folmeve të këtyre trojeve me vijimësi, që përmendëm, shqipja ka edhe disa të folme të tjera të shpërndara nëpër ngulimet e shqiptarëve larg Shqipërisë. Kështu në Italinë e Jugut dhe në Sicili janë të folmet e arbëreshëve të Italisë, në disa ishuj të Egjeut, në rrethinat e Athinës në Peloponez janë të folmet e arbëreshëve të Greqisë, në Bullgari e folmja e Mandricës, në Ukrainë, në brigjet e Azovit, është e folmja e disa fshatrave shqiptare dhe, së fundi, në bregdetin e Dalmacisë është e folmja e Arbëneshit të Zarës<sup>137</sup>.

Prej këtyre të folmeve të ngulimeve shqiptare larg atdheut vetëm ajo e Zarës ka dalë nga treva të dialektit verior (nga anët e Krajës), kurse të gjitha të tjerat janë të folme të toskërishtes, sidomos të toskërishtes jugore. Gjuha shqipe flitet edhe në vende të tjera, si në Turqi, në SHBA, Argjentinë, Australi etj., por folësit e saj në këto vende janë shpërngulur vonë, nga fillimi i këtij shekulli e këtej prandaj edhe gjuha e tyre nuk paraqet shumë interes për historinë e dialekteve.<sup>138</sup>

## IV.1. Statusi i shqipes në diasporë.

Një pamje të përgjithshme për të folmet e arvanitëve të Greqisë dhe të arbëreshëve të Italisë, si dhe të mbarë të folmeve të diasporës shqiptare, kanë dhënë prof. Gjinari e Shkurtaç në librin "Dialektologjia"<sup>139</sup>. *Aty është përcaktuar se ngulimet arbërore të Greqisë janë themeluar qysh para shumë shekujsh, pjesa më e madhe e tyre duhet të jenë vendosur atje në periudhën në mes të shekullit XI dhe XV. Ato janë të shpërndara gati në të gjithë Greqinë ishullore e më gjerë dhe, prej kohësh, kanë tërhequr edhe vëmendjen e albanologëve të huaj, të historianëve dhe, më vonë, të shumë studiuesve arbëreshë e shqiptarë.*

Shpërngulja e shqiptarëve është forcuar sidomos gjatë sundimit të Stefan Dushanit. Asokohe, grupe të mëdha shqiptarësh ia mësynë Greqisë, duke populluar kryesisht pjesë të pabanuara të saj. *"Dyndjet e malësorëve që kishin filluar në shekujt*

<sup>137</sup> Shih: GA, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe* (ADGJSH), Napoli-Tiranë, vëll.I, 2007, vëll.II, 2008.

<sup>138</sup> Shih: J. Gjinari-Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 1997, f.331-347

<sup>139</sup> Shih: J. Gjinari-Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 1997, f.331-347.

*e mëparshëm, morën përpjesëtime të mëdha gjatë sundimit të Stefan Dushanit*<sup>140</sup>, i cili i lejoi dhe i nxiti të vendoseshin në tokat e shpopulluara të Greqisë. Malësorët shpërnguleshin nga vendbanimet e tyre në mënyrë individuale dhe kërkonin punë nëpër qytete.

Një shumicë e madhe malësorësh, me gjithë kundërshtimet e guvernatorëve, zbritën nëpër fusha. Ata, bashkë me bagëtitë e tyre, u shtrinë në Veri deri në dyert e Raguzës e në bërrylin e Danubit, kurse në Jug u vendosën deri në Epirin e Jugut e në Thesali. Dalëngadalë ata arritën deri në Atikë e More, duke u hedhur edhe në disa ishuj të detit Egje, si në Eube, Hydra, Specia, Poros etj.

Pjesa më e madhe e tyre u vendos në tokat e feudalëve grekë e frëngj. Popullsitë arbëreshe mbushën tokat e shkretuara të Greqisë dhe ndihmuan në ngritjen e ekonomisë së rrënuar të vendit. Qysh nga shek. XIV ata ende vazhdojnë të banojnë në ato vende, por, nën trysninë e gjatë të helenizimit, shumica e tyre e ka humbur gjuhën shqipe.

Arbëreshët e Greqisë quhen më dendur *arvanitë*, por Antonio Belushi ka shënuar, se nëpër ngulimet shqipfolëse përdoret dendur edhe *arbëror*. Sipas Belushit, arvanit dhe arvanidh është një fjalë që përdoret më tepër nga grekët për të shënuar arbëreshin, kurse vetë popullsia arbëreshe e Greqisë përdor arbëror: "*Neve thuhemi arbërorë*". Ashtu si arbëreshët e Italisë veten e quajnë arbëreshë, kurse italianët i quajnë ata "gjegji". Belushi shkruan dhe dëshmon se gjatë udhëtimeve të tij në Greqi, duke shkuar katund më katund e gati derë më derë, ka gjetur edhe një numër të mirë librash monografikë rreth historisë së ngulimeve arbërore. Ai shënon se atje, edhe sot e gjithë ditën, janë edhe një një numër shumë i madh visesh arbëreshe si dhe qindra mijëra shqipfolës, për të cilët dihet pak ose asgjë. "*Arbëreshët*, përfundon Belushi, *krahas maqedonëve, turqve, hebrenjve dhe vllahëve janë pakica gjuhësore më e konsiderueshme në Greqi*".<sup>141</sup>

Në kreun e parë të librit Antonio Belushi jep të dhëna për numrin e banorëve arvanitë duke shënuar se "janë mbi 400 ngulime arbëreshe në Greqi". Ato janë të shpërndara në Atikë, rreth 73 ngulime dhe ku, deri më 1961, pa përfshirë ata të Athinës, arbëreshët arrinin në 15.000 veta; në Beoti ku përmenden rreth 108 ngulime arbëreshe shqipfolëse; në Eube, ku janë rreth 49 ngulime të ndara në katër grupe sipas krahinave përkatëse: 15 në bashkinë e Karistias (Kavantoros), 17 në bashkinë e Stiros, 14 në bashkinë e Tamineonit (Aliverin) dhe 3 në Avlons; në Peloponez, të cilë

t përfshijnë zonën e gjerë të Moresë ku janë rreth 92 ngulime shqipfolëse.

Në të gjitha këto ngulime Belushi ka regjistruar emrat e katundeve, toponiminë shqipe dhe shumëçka nga folklori dhe e folmja e tyre, biseda të zakonshme, këngë, tregime, fjalë të urta, mendime të ndryshme rreth jetës e shpirtit arbëror të tyre, citime nga autorë të sotëm arbëreshë të Greqisë etj. Nëpërmjet tyre studiuesit fitojnë një pamje pak a shumë të gjerë për gjendjen gjuhësore dhe etnokulturore të atyre ngulimeve, duke nxjerrë edhe disa nga dukuritë më tipike të të folmeve arvanite. Mund të thuhet se ato kanë mjaft dukuri të përbashkëta me të folmet arbëreshe të

<sup>140</sup>Shkë lzen Raça: "Shtegtimet dhe ngulmimet e shqiptarëve në Greqi" Prishtinë 2004, fq. 18-19

<sup>141</sup>Antonio Bellusci: "Ricerche e studi tra gli arberori dell'Ellade" Cosenza-Itali; 1993, fq. 26

Italisë dhe me disa prej të folmeve të skajit jugor të shqipes, sidomos me çamërishten e me labërishten.

Nga fusha e leksikut, të folmet e arbëreshëve të Greqisë, sigurisht, dallohen prej të folmeve të shqipes nga numri më i madh i huazimeve nga greqishtja. Ka aty mjaft huazime të vjetra (disa prej të cilave i ndeshim edhe në të folmet arbëreshe të Italisë), si: *psonis* (blej, bëj pazar), *zograftis* (pikturoj), *dhjovas* (lexoj), *dhaskal* (mësues), *proftas* (mbërrij), *dhidhaks* (jap mësim, mësoj), *konaqi* (konak, shtëpi), *horë* (vend, qytet), *parkales* (lutem), *jatro* (mjek), *qaramidhe* (tjegull), *argali* (vek, avlëmend), *mollois* (flas, kuvendoj), *vasiliko* (borzilok), *thagmë* (mrekulli, çudi), *mandile* (shami), *gajdhur* (gomar), *sinor* (kufi), *karfos* (gozhdoj, mbërthej).

Po ka edhe një shtresë më të re greqizmesh që kanë hyrë e po hyjnë në të folmet arbëreshe të Greqisë, të cilat nuk i gjejmë ndokund as në të folmet arbëreshe të Italisë, as në shqipen këtej kufirit, si: *evharisto* (faleminderit), *amartia* (gjynah), *dhaso* (pyll), *dhikastiro* (gjq), *ligo* (pak), *gnomi* (mendje) etj.

Sidoqoftë, deri më sot, atje ruhet ende një pasuri e madhe edhe në fushën e leksikut e të frazeologjisë shqipe. Një pamje të hapët e me mundësi të mëdha për njohjen e leksikut e të frazeologjisë shqipe të arbëreshëve të Greqisë na ka dhënë Antonio Belushi në librin e tij "*Kërkime dhe studime ndër arbërorët e Helladhës*", si dhe në shumë shkrime të tjera të tij. Ajo pasuri e madhe shpirtërore dhe kulturore që kanë ruajtur arbërorët e Helladhës e që na paraqitet me aq gjerësi nga Belushi dhe studiues të tjerë, në radhë të parë, është pasuri që i përket Greqisë, vendit ku ata ndodhen tashmë prej shumë shekujsh.

Por kultura shqiptare, qoftë e diasporës më të moçme të Greqisë e të Italisë, qoftë e diasporës më të re nëpër metropolet e Evropës e të Amerikës, është një element konstituiv i bashkësive të sotme plurikulturore dhe nuk mund të mos i shfaqë edhe gjurmët e veta shqiptare, duke dalë kështu, si ndihmesë e diasporës shqiptare në pasurimin kulturor e shpirtëror të vendeve e popujve në gji të të cilëve janë integruar arbëreshët apo shqiptarët.

Këta dhjetëvjeçarët e fundit kanë dalë, gjithashtu, një numër botimesh të reja, që japin njohuri e materiale të shumta përmbi arbëreshët e Greqisë, për historinë dhe traditat e tyre, për gjuhën dhe folklorin dhe, përgjithësisht, për atë diasporë. Vendin më të gjerë e zënë aty shkrimet e studiuesve arbëreshë të Greqisë të botuara në revistat "*Dialogoi*"<sup>142</sup> dhe "*Besa*"<sup>143</sup>, si dhe një numër përmbledhjesh folklorike etj. si ato të Georgio K. Mihas për Martinon, të Gjona Mike Paidousit për Vilian e Beotisë, të Vangjel Lapit për dasmën arvanite kunduriote, të G. K. Kollias me thënie idiomatike nga Leontari (Çaçkavelli), të G. P. Gjikes<sup>144</sup>, K. Birit<sup>145</sup>, T. Johalasis<sup>146</sup> etj.

<sup>142</sup> *Dialogoi, Politiki epitheorisi*, Nikaia-Atene-Grecia, drejtor Jorgo Marugas.

<sup>143</sup> *Besa, Istorja laografia Logoteknika*, Atene - Grecia, drejtor Aristide P. Kollias.

<sup>144</sup> Gjika Gj. P., *Arvanitika tragudhia tu kavo d' Oro*, Athina, 1962, 27 faqe.

<sup>145</sup> Biri K. I., *Arvanites i Dhoris tu neoteru ellinismu. Istorja ton Ellinon arvaniton*, Athinë, 1960, 377 faqe.

<sup>146</sup> Jochalas Titos P., *Considerazioni sull' onomastica albanese in Grecia-Offtprintfrom "Balkan Studies"*, 17, 2, Thesaloniki, 1977; *Über die Einwanderung der Albaner in Griechenland*, Sonderdruck "Dissertationes Albanicae", XIII Band, Munchen 1971.

## IV.2. Statusi zyrtar i shqipes në Greqi

Statusi gjuhësor i shqipes në Greqi, qoftë në atë pjesë ku shqiptarët janë në trojet e veta e në vijim të atdheut të vet, Shqipërisë, në Çamëri, qoftë në diasporën arvanite, është kudo i njëjtë: *injorim e mohim i plotë i pranisë së albanofonisë në Republikën e Greqisë*. Pra, si në Çamëri, ashtu edhe në diasporën arvanite, shqipja është vetëm gjuhë e zemrës, gjuhë amtare e papërfillur dhe e panjohur zyrtarisht. Mbi të, për të gjithë shqipfolësit e Greqisë, qofshin shqiptarë në trojet e veta në Çamëri, qofshin arvanitë në diasporën e atjeshme, qëndron greqishtja e folur dhe e shkruar, të cilën çdonjëri duhet ta mësojë dhe ta ushtrojë në shkollë, në administratë e kudo.

Më 1975-n, studiuesi amerikan Pitër Tradgil, bashkë me një arbëresh të Greqisë, të quajtur Zavaras (Tzavaras) kanë ndërmarrë një studim sociolinguistik në fshatrat arbëreshe të Greqisë, ku flitet shqipja dhe kanë hulumtuar konkretisht natyrën dhe shkallën e ruajtjes së gjuhës shqipe, ndikimin (interferencën) e gjuhës greke mbi arbërishten dhe "transferimin gjuhësor të gjuhës arbëreshe të Greqisë".

Një prej rezultateve të qarta që del nga ai studim është se "*arbërishtja e Greqisë me shumë gjasa është gjuhë në zhdukje e sipër*". Ata japin edhe një pasqyrë të përgjigjeve të dhëna në një pyetësor të zbatuar në pothuaj të gjitha fshatrat e rëndësishme të Atikës dhe të Beocisë, ku tregohet qartë shkalla deri ku është zvogëluar aftësia për t'u kuptuar në arbërishte në këtë bashkësi. "*Këta shqiptarë të Greqisë ka një kohë të gjatë që i përkasin qartë një identiteti etnik të veçantë, por ky identitet etnik gradualisht po pëson gërryerje. Sot ata nuk e njohin veten si shqiptarë, por si arvanitë, ndërsa gjuhën që flasin nuk e quajnë më shqipe, por arvanite. Ata bëjnë përpjekje për t'u shpjeguar të huajve se jo vetëm që janë arbëreshë të Greqisë, por edhe grekë. Rezultat i këtij zhvillimi është se karakteristika kryesore, ndoshta e vetme, e identifikimit të shqiptarëve të Greqisë tashti është gjuha e tyre*"<sup>147</sup>.

Dygjuhësia greqisht-arbërisht tashti është normë për të gjitha grupet sipas moshës, por ka shumë situata kur folësit e vjetër përdorin arbërishten, ndërsa folësit e rinj greqishten. Duket sikur arbëreshët më të vjetër përdorin arbërishten për shumicën e qëllimeve, përveç për ato më formalet (dhe për të komunikuar me joarbëreshët). Folësit e moshës mesatare dhe të rriturit e rinj favorizojnë bukur shumë transferimin e kodit varësisht nga faktorë, si formaliteti, vendi, objekti, prania e jövendësve dhe aftësia gjuhësore e bashkëbiseduesve.

Shumë të rritur e të rinj, megjithatë, përdorin shpesh arbërishten vetëm nëse situata është posaçërisht intime ose joformale, ose nëse flasin me njerëz të vjetër që ata i njohin. Burimi tjetër i informacionit mbi këtë temë rrjedh nga përgjigjet e dhëna në pyetësor, ku pyetja më e rëndësishme është: cila gjuhë ju duket më e saktë për t'u shprehur? Përgjigjet në këtë pyetje nga ana e arbëreshëve sipas grup-moshave tregojnë bindshëm, se arbërishtja e Greqisë është objekt i kufizimit gjithnjë e më të madh të përdorimit të saj"<sup>148</sup>.

Forma më kryesore e kufizimit të një gjuhë është zhdukja apo varfërimi i leksikut. Tradgili dhe studiues të tjerë kanë vënë re se shumë njësi leksikore të shqipes nuk hasen më në arbërishten e Greqisë. Gjithashtu, reduktimi i arbërishtes

<sup>147</sup> Shih: Piter Tradgil, *Kontakti gjuhësor në Greqi, Reduktimi dhe thjeshtimi në të folmet e shqipes në Atkë dhe në Beoti*, në librin e Vesel Nuhiut, *Ndikimet ndërgjuhësore*, Prishtinë, 1990, f. 275.

<sup>148</sup> Po ai, po aty, f. 283-284.

është i lidhur me nevojën që kanë atje folësit për të përvetësuar e përdorur leksikun grek. Kështu, shumë fjalë të greqishtes së re tashti janë bërë pjesë integrale e të folmeve arbëreshe të Greqisë.

Me fjalë të tjera, leksiku i arbërishtes është fusha më kryesore ku ka vepruar ndikimi i greqishtes dhe kufizimi apo reduktimi gjuhësor. Reduktim më të ndjeshëm ka pësuar leksiku i arbërishtes që flasin më të rinjtë. Aty mund të shihet se shpesh parafjalë apo forma të tjera të shqipes janë zëvendësuar me format përkatëse të greqishtes.

Së fundi, lidhur me situatën gjuhësore ndër arbëreshët e Greqisë mund të thuhet, se gjendja e kësaj gjuhë është në vdekje e sipër, megjithatë, ajo dallohet nga gjuhët që karakterizohen si pixhine. Kufizimi i arbërishtes vihet re, por ai nuk është aq i ashpër. Folësit e rinj, edhe pse mund ta mësojnë gjuhën "jo në mënyrë të përsosur", mbeten në kontakt të plotë me folës që flasin rrjedhshëm arbërisht. Për këtë arsye reduktimi në arbërishten e Greqisë është shumë më pak drastik se ai që bëhet gjatë pixhinizimit<sup>149</sup>.

### IV.3. Gjendja socio-dhe etnolinguistike e arbëreshëve të Italisë

Studimi i të folmeve arbëreshe të Italisë në gjendjen e tyre të sotme nuk mund të jetë i plotë dhe, për më tepër, i saktë e i qartë, pa kundruar edhe marrëdhëniet e tyre si gjuhë në kontakt me italishten, çka, natyrisht, shtron nevojën e një njohjeje të thelluar të proceseve të dygjuhësisë, të tregjuhësisë dhe të shumëgjuhësisë, si dhe shumë anë e dukuri të tjera etnokulturore dhe antropologjiko-shoqërore të diasporave në përgjithësi e të asaj arbëreshe në Itali në veçanti.

Arbërishtja (apo të folmet arbëreshe të Italisë) është *gjuhë e folur dhe e shkruar*. Si gjuhë e folur, ajo na shfaqet në formën e ligjërimeve që, për nga ana tipologjike, u takon të përfshihen në dialektin jugor të shqipes, si një nëndialekt i tij, krahas toskërishtes veriore, labërishtes e çamërishtes dhe arbërishtes së Greqisë.<sup>150</sup> Si gjuhë e shkruar, arbërishtja e Italisë, na del në funksionin e gjuhës së katekizmave dhe të librave të meshës dhe si gjuhë e letërsisë artistike arbëreshe të traditës dhe të asaj të sotme, si dhe në botime të folklorit arbëresh.

Deri vonë, në shumë nga ngulimet arbëreshe, pjesa më e madhe e banorëve nuk dinin gjuhë tjetër përveç arbërishtes, kurse në kohët më të reja, sidomos në këta dhjetëvjeçarët e fundit, shkollimi në italisht, mjetet e komunikimit masiv ("mass-media"), si dhe lëvizjet e popullsisë e nevojat e jetesës i kanë çelur shtigje të gjera përdorimit të italishtes nga arbëreshët. Përmasat e kësaj dukurie janë aq të gjera dhe të dukshme, sa që ka edhe studiues që thonë, se tashmë nuk kanë mbetur më njëgjuhës vetëm arbërishtfolës në Itali. Megjithatë, ne theksojmë se njëgjuhës vetëm arbërishtfolës ka, por në shtresat dhe moshat që qëndrojnë jashtë qerthullit të veprimit të faktorëve të mësipërm. Mund të përcaktohen si njëgjuhës (arbërishtfolës) këto shtresa e grupe arbëreshësh:

<sup>149</sup> Shih: J.Gjinari.Gj. Shkurta, *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 1997.

<sup>150</sup> Shih: S. Salvi, *Le lingue tagliate*, Milano, 1975, pp. 97; E. Çabej, *vep. cit.*, në "St. fil.", 2, 1975, f. 52 etj.

1) *Analfabetët e moshuar*, sidomos në ngulimet malore e të vetmuara, ku, në kushtet e një jetese pa shumë lidhje me qendrat e mëdha urbane apo me katundet italiane përreth, si bujq e blegtorë në punë të vet, i kanë shpëtuar deri diku ndikimit të italishtes. Edhe në këtë shtresë, duhet të themi, kanë qenë gratë ato që nuk kishin kontakte me italishten, prandaj mbeten më gjatë si njëgjuhëse vetëm arbërishtfolëse. Kudo nëpër katundet arbëreshe, edhe midis analfabe-tëve, përçindja e grave albanofone është më e madhe se ajo e burrave. Kështu, në Marçeduzë, katund arbëresh në anët e Katanxaros, ku shqipja po zhduket, të fundmet arbërishtfolëse ishin dy gra të moshuara, por edhe ato qaheshin se në shtëpitë dhe mjediset e tyre njerëzit "*ngë di:n të fëlasinë*".<sup>151</sup>

2) *Njëgjuhës*, vetëm arbërishtfolës, janë edhe një pjesë e mirë e fëmijëve nën moshën 7 vjeç, në ngulimet arbëreshe më pak të zhvilluara e ku nuk ka pasur deri tashiti struktura të arsimit parashkollor. Deri në moshën shkollore fëmijët rriten në shtëpi, zakonisht nën kujdesin e më të moshuarve, të cilët, në një pjesë të mirë të rasteve, kanë qenë analfabetë dhe vetëm arbërishtfolës, por, ndërkaq, është e nevojshme të shtojmë se, këto vitet e fundit, edhe nëpër ngulimet arbëreshe, sidomos në ato më të mëdhatë, janë bërë hapa drejt arsimimit parashkollor me programe të caktuara, ku, si kudo, zotëron gjuha letrare zyrtare: italishtja.

Kjo do të bëjë që, nga dita në ditë, *kontigjenti i njëgjuhësve arbëreshë (vetëm arbërishtfolës) të pakësohet edhe më tej*. Po realizohet tashmë profecia e De Radës, poetit të madh arbëresh nga Maqi, i cili deri edhe në çastin e fundit ishte i shqetësuar e me merak se "*gjaku arbëresh është e birret*".

3) *Pjesa më e madhe e popullsisë arbëreshe të ngulimeve arbërishtfolëse përbëhet nga dy-, tre- ose shumëgjuhës*. Të gjithë arbëreshët që kanë kryer shkolla (të cikleve të ndryshme) dinë, përveç arbërishtes së katundit të vet, edhe italishten letrare, pra janë dygjuhës. Shumë prej tyre, përveç italishtes letrare, dinë edhe dialektin italian të krahinës përkatëse, duke na u paraqitur kështu me kompetencë gjuhësore të trefishtë.

Nga ana tjetër, një pjesë e intelektualëve arbëreshë që janë me arsim të lartë filologjik e që, ndonjëherë, kanë ndjekur edhe kurse përditësimi të gjuhës letrare shqipe (pranë katedrave të gjuhës shqipe në universitetet italiane të Kozencës, Palermos, Barit, Romës, Napolit etj. apo edhe në Shqipëri e në Kosovë) njohin relativisht mirë edhe gjuhën shqipe, të cilën e ushtrojnë në shkrimet e tyre, disa edhe në të folur. Këta, duke ditur edhe italishten letrare edhe dialektet përkatëse të krahinave, na shfaqen me një kompetencë gjuhësore më të plotë e më të shumanshme, ata janë plurilingë.

4) Në raste të tjera, tek arbëreshët e shpërngulur në kohët e reja jashtë Italisë (për punë të përkohshme në vise të ndryshme, si në Gjermani, SHBA, Argjentinë etj.), gjendja gjuhësore është si vijon:

Krahas arbërishtes që vijon të mbetet edhe në "*diasporën e diasporës*" si gjuhë e parë (L 1) apo "gjuhë e zemrës" ("*lingua del cuore*"), mësojnë edhe gjuhën e vendit ku punësohen, duke u bërë dygjuhës: arbërisht-gjermanisht (përkatësisht: arbërisht-anglisht, arbërisht-spanjisht etj.). Në rastet e qëndrimeve të zgjatura në udhët e

<sup>151</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Disa shënime për të folmen arbëreshe të Marçeduzës*, në "Studime për nder të A. Xhuvanit", Tiranë, 1986, f. 513.

emigrimit është vënë re, se arbëreshët në Amerikë, Gjermani etj. mund të harrojnë krejtësisht italishten letrare apo dialektin vendor italian që dinin më parë krahas arbërishtes, sepse atje përdorin dendur "gjuhën e bukës" ("*lingua del pane*"), por kurdoherë e kudo shqipja (=dialekti i tyre amtari) mbetet gjithnjë gjuhë e parë, gjuhë e shpirtit të tyre.

E megjithatë vetëm kaq nuk mjafton. Duam apo nuk duam, shqipja sot, si në diasporën arbëreshe tradicionale (në Itali të Jugut e në Sicili), ashtu edhe në "diasporën e diasporës" të rikrijuar në Amerikë e gjetkë me arbëreshë të shpërngulur nga Italia, është kudo një *gjuhë që po birret*.

#### IV.4. Gjuha shqipe në shkollat arbëreshe të Kalabrisë e të Sicilisë

Arbëreshët, siç e kemi thënë edhe më lart, nga ana sociolinguistike përjetojnë një situatë diglosie apo, sikundër e quajnë disa "dygjuhësi e çalë". Aty, ndarja e kodeve është e kufizuar, prandaj qëndron akoma i hapur diskutimi rreth problemit se çfarë gjuhe përdoret në katundet arbëreshe në krahasim me italishten standard.

Në fakt, qysh nga dekreti i vitit 1979, kur për herë të parë u njoh me ligj mësimdhënia në shkollat e mesme të gjuhëve dhe kulturave minoritare të Italisë, ka pasur edhe mëdyshje midis arbëreshëve, se cilën gjuhë duhet të mësojnë në shkollë: të folmen arbëreshe vendore të secilit katund, apo shqipen e njësuar standarde.

Qëndrimet që u mbajtën prej veprimtarëve kulturorë arbëreshë ishin të ndryshme: nga njëra anë janë ata që e mbështesin idenë e G. Gangales për koinetë vendore të secilit ngulim, duke përjashtuar çdo llojkontakti me shqipen e sotme; nga ana tjetër, ishte propozimi i prof. F. Solanos, i cili arsyetonte metë drejtë, se e vetmja gjuhë që mund të mësohet në shkollat e katundeve arbëreshe është shqipja.

Pra, rreth kësaj dukurie u shprehën tri qëndrime të ndryshme: nga njëra anë, qëndrimi i arbëreshëve të Sicilisë, të cilët kanë si pikënisje të folmet arbëreshe vendore, duke iuafruar shqipes standard nëpërmjet përqasjes e gjatë procesit të të nxënit. Atje, janë botuar librat "Udhëtimi" (2000), "Udha e mbarë" (2001) etj.

Të njëjëtën pikëpamje e pikënisje kanë edhe arbëreshët e Krotones me "Gjuha jonë e bukur" (2006). Qëndrimi i tekstit "Alfabetizzazione arbëreshe" (2001) dhe i shoqatës AIADI (Shoqata e mësuesve arbëreshë), propozon krijimin e një standardi arbëresh. Së fundi, është edhe qëndrimi i teksteve "Libri imi parë" (2003) dhe "Zëmi e xëmi" (2005), të cilët mbështeten mbi të folmen arbëreshe të katundit Shën-Sofi në krahinën e Kozencës.<sup>152</sup>

#### IV.5. Arbëreshët e Zarës dhe gjuha e tyre

Arbëreshët e Zarës janë një pjesë e diasporës shqiptare jashtë atdheut. Ata ndodhen në fshatin Arbëresh në afërsi të Zarës në Dalmaci dhe janë shpërngulur para rreth 250 vjetësh nga Malësia e Shkodrës apo anët veriperëndimore të Shqipërisë së

<sup>152</sup>Shih: Orjeta Hashorva, *Gjuha shqipe në shkollat arbëreshe të Kalabrisë e të Sicilisë*, në "Studime Albanologjike", II, Tiranë, 2011, f. 339-340.

moçme, që, siç dihet, përfshinin edhe anët e Krajës, Tivarit e Ulqinit, që, qysh nga vitit 1913 e këtej, do të mbeteshin jashtë kufijve të shtetit shqiptar, në Mal të Zi.

Nga ana historike, shtegtimi dhe përjetimet e ndryshme të arbneshëve të Zarës janë studiuar e paraqitur relativisht gjerë nga një numër studiuesisht të huaj e shqiptarë, kryesisht mbi të dhënat e Arkivit të Zarës. Përmendim veçanërisht kundrimet e thukëta historike të historianit Zija Shkodra<sup>153</sup>, i cili na ka dhënë një kuadër të plotë rreth kohës, motiveve dhe gjendjes së shtegtimin të shqiptarëve nga anët e Shqipërisë etnike veriperëndimore drejt brendësisë së trojeve sllave të Dalmacisë.

Ngulimi i shqiptarëve në fshatin Arbnesht të Zarës u bë në fillim të shek. XVIII, në një situatë kur në sanxhakun e Shkodrës zotëronte një gjendje pasigurie dhe kur Perandoria Osmane ndodhej në një rënie të ndjeshme. Ishin vitet 1723-1726, kur në Shkodër sundonte pashallëkun Asllan Bushatlliu.

Për të folmen e arbneshëve të Zarës janë interesuar qysh herët albanologë të huaj, pastaj edhe gjuhtarë shqiptarë. Një studim të thukët dhe me akribi shkencore për të folmen e arbneshëve të Zarës ka bërë studiuesi i njohur kosovar, Idriz Ajeti, në studimin "*Istorijski rasvitak gegijskog govore kod Zadra*", Sarajevo, 1961. Ajeti, duke shqyrtuar në mënyrë kritike gjithë sa ishte shkruar për të folmen e Arbneshtit, mblodhi materiale të gjera nga burime të besueshme dhe bëri një paraqitje shumë të plotë e të saktë të tipareve dhe vlerave të së folmes arbneshëve të Zarës.

Pas Idriz Ajetit, rreth së folmes së arbneshëve të Zarës ka shkruar edhe albanologia ruse Agnia Desnickaja në librin e saj përgjithësues "*Allbanskij jazyk i iego dialektii*" (=Gjuha shqipe dhe dialektet e saj), si dhe Budimir Peroviqi në një shkrim botuar te revista "Jeta e re" (e përkohshme kulturore-shkencore që dilte deri vonë në Titograd) dhe, së fundi, një studim i Kruno Krstiqit rreth së folmes dhe leksikut të arbneshëve të Zarës.<sup>154</sup>

Krahas studimeve të mirëfillta gjuhësore, për njohjen e së folmes së arbneshëve të Zarës, me vlerë të madhe faktuese e dokumentuese janë edhe një varg veprash letrare të shkruara në atë të folme. Përmendim, sidomos, dramën e Josif Relës dhe poezitë e Shime Deshpalit. Veprat e këtyre dy autorëve shqiptarë nga Arbneshti, duke u shkruar në një gjuhë nëndialektore e me fytyrë ruajtëse (konservative dhe arkaike) mjaft të dallueshme nga gjuha shqipe e sotme, natyrisht, e kanë tepër të kufizuar lëmin e komunikimit me lexuesin e sotëm shqiptar.

Tashmë të mësuar kryesisht me botimet në gjuhën letrare standarde, ato janë të mirëseardhura e të vlefshme për gjuhëtarët, sidomos për ata që nuk kanë pasur kurrë mundësi të shkojnë vetë në atë ngulim për kërkime gjuhësore në terren. Pa dyshim, ndonëse në një formë sadokudo të letrarizuar, gjuha e veprave të Relës e të Deshpalit meriton të përfillet e të kundrohët edhe nga dialektologët shqiptarë dhe nga të gjithë ata që duan të dinë diçka më shumë se ato që përmbahen në studimet dialektologjike të autorëve që u përmendën.

Me studimin e historikut të arbneshëve të Zarës, si dhe përgjithësisht me kulturën, gjuhën e letërsinë e tyre janë marrë një numër i mirë studiuesish shqiptarë, kosovarë dhe albanologë të huaj, si dhe disa albanologë arbneshë. Pas G. Vajgandit e

<sup>153</sup> Zija Shkodra, *Kontribut për njohjen e diasporës shqiptare*, në "St. hist.", 3, 1971, f. 93-109.

<sup>154</sup> Kruno Krstiq, *Reçnik govora Zadarskih Arbanasa*, Zadar, 1987..

I. Ajetit, punë të vlefshme na kanë lënë historianët Hasan Kaleshi, Muhamet Tërnavë e Zija Shkodra, si dhe Akademik Rexhep Qose e Prof. Isak Shema.

*Statusi gjuhësor*, natyrisht, është ai i shumicës së diasporës shqiptare: shqipja, si *gjuhë e zemrës*, por me përdorime kryesisht në familje, kurse sllavishtja (më saktë kroatishtja) si *gjuhë pune*, si *gjuhë buke* dhe me përdorime në të gjitha funksionet kryesore. Kruno Krstiqi, në hyrje të veprës së tij "Rječnik govora Zadarskih Arbanasa" (1987), shënon se "në shtëpi si dhe në bisedat me të afërmit "sluzhe svi stariji Arbanasi" (=shërben shqipja e moçme), por të rinjtë flasin edhe kroatisht dhe, shumë syresh, edhe italisht. Pra, kemi një gjuhë shqipe në takim me stokavishten apo dialektin sllav të Malit të Zi të anëve të Kotorrit qysh para se të mërgonin në Zarë, pastaj me kroatishten dhe me italishten që fliten në qytetin e Zarës.<sup>155</sup>

#### IV.6. Gjuha shqipe në Mal të Zi

Shqiptarët e Malit të Zi jetojnë në një trevë të gjerë e ku gjuha malazeze është bërë prej dhjetëvjeçarësh gjuhë e përbashkët për të gjithë hapësirat e asaj Republike. Por, krahas saj, e dyta për nga përdorimi, qëndron shqipja, e cila flitet prej rreth 7 për qind të banorëve. Edhe pse shqipja është gjuhë pakice, ajo flitet dhe gëzon njohje nga Kushtetuta e RSF e vitit 1974. Në Malin e Zi, gjuha zyrtare është serbokroatishtja, por garantohet edhe përdorimi zyrtar i barabartë i shqipes në vendet ku flitet kjo e fundit<sup>156</sup>.

Në lidhje me shtrirjen dhe ndikimin e gjuhës shqipe në territoret e Malit të Zi, prof. Tomor Osmani thekson: "Një eement që mund të lozë ndonjë rol në të ardhshmen për zhvillimin sado pak të shqipes në zonat me popullsi shqiptare dhe për të përballuar sfidat e kohës që janë shumë të fuqishme, është hapja e një dege të gjuhës shqipe për përgatitjen e mësuesve të shkollës fillore pranë Universitetit të Podgoricës, 5-6 vjet më parë. Këta studentë, mësues të ardhshëm, duke u përgatitur me kulturën e nevojshme në gjuhën shqipe pasi ligjëruesit janë pedagogë nga Shqipëria do të jenë mbrojtës dhe përkrahës të kësaj gjuhe".<sup>157</sup>

Pra, siç thotë edhe akademiku Rexhep Ismajli: "Shqipja është gjuhë vetëm e një kombi, edhe pse flitet në shtete të ndryshme".<sup>158</sup> Gjuha shqipe e njësuar është tashmë në proces të pandalshëm dhe tipar përbashkues i kombit shqiptar. Ajo ka filluar të zbatohet gjerë edhe në trevat shqiptare të malit të Zi, në Malësinë e Hotit e të Grudës, në qytetin e Ulqinit me rrethinë etj. Gjendja është afërsisht ashtu si në Maqedoni, gjë që do të thotë se realiteti i sotëm e vë gjuhën shqipe të mediave në ato treva në radhën e institucioneve që duhet të përçojnë modelin e të shkruarit dhe të folurit.

Gjuha zhvillohet, evoluon nën ndikimin e nevojave që kanë njerëzit për të realizuar komunikimin mes tyre dhe media i pasqyron menjëherë këto ndikime. Për situatën gjuhësore të Malit të Zi, kohët e fundit ka shkruar edhe gazetari Ardian Hoti, i cili thotë se ka zgjedhur Malin e Zi, Ulqinin, nisur nga vetë karakteristikat

<sup>155</sup> Shih: Gjinari-Shkurtaj, *Dialektologjia*, f. 381-385

<sup>156</sup> Shih: Zamira Shkreli, *Pasqyrimi i kontakteve të shqipes në tekstet shkollore*, në "Studime Albanologjike", II, Tiranë, 2011, f.358.

<sup>157</sup> Shih: T. Osmani, *Shqipja e Malit të Zi në sfidat e kohës*, kumtesë e mbajtur në Seminarin e Prishtinës, Prishtinë, gusht, 2010. (Citohet sipas artikullit të Z. Shkrelit, art. cit. f.364).1

<sup>158</sup> Shih: R. Ismajli, *Gjuhë dhe etni*, Prishtinë, 1991, f.337.

gjeopolitike të zonës. Ai thotë se në Ulqin, gjuha shqipe flitet, po edhe ka shkolla në gjuhën shqipe, ndërkohë që shihen qartë ndikimet gjeopolitike në gjuhë.<sup>159</sup>

Në gjuhën shqipe botohet edhe gazeta “Elif”, në dy gjuhë: shqip e në gjuhën malazeze, “*Zani i Shna-Ndout*”. Titujt e gazetave dhe të revistave në gjuhën shqipe kanë nisur të reduktohen. Vite më parë ka pasur më shumë tituj, si : revista “*Koha*”, “*Kronika*”, “*Fati për fëmijë*”, “*Zana*”, “*Kraja*”, “*Shpresa*”, “*Malësia e re*”. Media e shkruar shqipe në Mal të Zi është realitet gjuhësor. Në zonat shqipfolëse flitet një shqipe dialektore me shumë ndikime slave, si në rrafshin leksikor, ashtu edhe në rrafshin morfosintaksor.

Në shumë raste edhe vetë shqiptarët përdorin gjuhën malazeze në komunikim. Ndërsa mediat shqiptare në Mal të Zi kanë një realitet tjetër. Aty shihet qartë prirja për ta përdorur me korektësi shqipne standarde.<sup>160</sup>

#### IV.7. Shqiptarët e Bullgarisë dhe gjuha e tyre

Katundi Mandrica ndodhet në krahinën e Ivajllogradit, në rrethinat e Karaxhalit në Bullgari. Ai është i vetmi ngulim shqiptar në Bullgari që ka ruajtur gjuhën shqipe dhe etnokulturën shqiptare. Për këtë të folme, që paraqet interes të posaçëm si për dialektologjinë ashtu edhe më gjerë në kuadrin e shqipes si gjuhë në kontakt, kanë shkruar, së pari, Dh. S. Shuteriqi<sup>161</sup> dhe M. Domi e Baki Ymeri<sup>162</sup>, pastaj edhe albanologë të tjerë.

Mandrica gjendet në këndin juglindor të Bullgarisë, tamam në kufirin bullgaro-turko-grek. Të gjithë mandricarët, me ndonjë përjashtim të rrallë, flasin edhe bullgarisht.

Shqipja në Mandricë, sipas Bojka Sokolovës, ruan një numër të madh veçorish të moçme dhe ka një fytyrë mjaft arkaike (konservative), por edhe ndikimi nga mjedisi i huaj i ka dhënë asaj disa karakteristika, që nuk i përkasin gjuhës shqipe të trevave prej nga janë shpërngulur mandricarët. Me fjalë të tjera, pas shkëputjes nga dheu-mëmë dhe vendosjes në Bullgari, shqipja e mandricarëve ka pasqyruar mjaft ndikimin e gjuhëve të huaja dhe për një numër dukurish nuk ka ndjekur atë rrugë që kanë marrë të folmet shqipe në Shqipëri.

E folmja e Mandricës, sipas studimeve të M. Domit e Dh. S. Shuteriqit, me veçoritë e saj fonetike e morfologjike, sidomos me mjaft dukuri ruajtëse (konservative) që ka, paraqet interes të veçantë për dialektologjinë shqiptare. Në mënyrë të veçantë ajo jep dëshmi e të dhëna me vlerë për dialektologjinë historike, po edhe përgjithësisht për historinë e gjuhës shqipe.

E folmja e Mandricës ndodhet në një farë mase edhe nën ndikimin e gjuhës greke. Për këtë kanë ndihmuar një fqinjësi e zgjatur me grekët, martesat e përziera dhe

<sup>159</sup>Shih: Ardi Hoti, *Ndikim i mediave shqip në Mal të Zi në mësimin e gjuhës shqipe*, në “Studime Albanologjike”, II, Tiranë, 2011, f.369-375.

<sup>160</sup>Shih: Ardi Hoti, *Ndikim i mediave shqip në Mal të Zi në mësimin e gjuhës shqipe*, në “Studime Albanologjike”, II, Tiranë, 2011, f.369-375.

<sup>161</sup>Shih: Dh. Shuteriqi, *Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica, studim dhe tekste*, në “St. fil.”, 1, 1965, f. 103-141.

<sup>162</sup>*Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, në “St. fil.”, 1965, nr.2.

veprimtaritë ekonomike dhe tregtare me grekët, panairot ku merrnin pjesë edhe banorët të Mandricës. Greqishtja ka ndikuar mbi shqipen e Mandricës edhe për faktin se, deri më 1912 shkolla e fshatit ishte në gjuhën greke. Po ashtu, jo pa rëndësi ka qenë edhe fakti, se të rinj nga Mandrica studionin në shkollat e mesme dhe në universitetet greke. Megjithatë, ndikimi i greqishtes mbi shqipen e Mandricës ka ardhur gjithnjë duke u pakësuar. Kjo gjuhë, gjithashtu, ishte pothuajse e panjohur nga pjesa femërore e banorëve të Mandricës. Pra, greqishtja ishte gjuhë që nuk përdorej në familjet shqiptare.

Në katundin shqiptar të Mandricës, pjesa mashkullore e popullsisë është katërfish poliglote, në përputhje me kushtet e veçanta të krijuara për banorët e kësaj qendre. Burrat, në një farë mënyre, mund të lexonin e të shkruanin në bullgarisht, në greqisht dhe në turqisht. Natyrisht, banorët e Mandricës dinin më mirë bullgarishten. Nuk mund të thuhet me siguri se deri në çfarë shkalle i njihnin ata greqishten dhe turqishten. Sot askush nuk flet më në këto gjuhë në Mandricë, me përjashtim të ndonjë plaku, që i flet me vështirësi.

Kjo dëshmon se, së paku qysh më 1912 e këtej, në vend të një katërgjuhësie, edhe popullsia mashkullore e Mandricës ka kaluar në dygjuhësi: bullgarisht-shqip. Kjo situatë është sot gjendje reale e të gjithë popullsisë së katundit Mandricë. Sidoqoftë, është vendi të theksohet, se dygjuhësia shqip-bullgarisht dhe ruajtja me forcë e shqipes në atë katund i takon sidomos pjesës femërore. Gratë shqiptare në Mandricë, ashtu si edhe gjetkë në diasporën shqiptare e arbëreshe, kanë shfaqur kurdoherë një shpirt të theksuar ruajtës të gjuhës amtare dhe të tipareve të tjera etnokulturore të mëmëdheut të lënë.

Kemi të bëjmë, kështu, me një dukuri që gjen shpjegim edhe me rrethanën që, në të kaluarën, ato nuk shkonin në shkollë, nuk e linin katundin për kohë të gjatë dhe nuk hynin në marrëdhënie me bullgarët apo me persona që u përkitnin kombësive të tjera. Për këto arsye, sipas Sokolovës, *deri në ditët tona, në Mandricë mund të gjesh gra të moshuara që pothuajse nuk e dinë bullgarishten dhe që flasinnjë shqipe mjaft të pastër*. Pa dyshim, në të shkuarën, numri i tyre do të ketë qenë shumë më i madh.

Ndikimi i gjuhëve bullgare, greke dhe turke mbi shqipen në Mandricë nuk ka arritur, megjithatë, ta shndërrojë atë të folme në një konglomerat. Ajo as nuk është zhdukur, as nuk i ka bjerrë tiparet e saj kryesore; ka ruajtur deri më sot fizionominë dhe strukturën e saj. Edhe sot, pavarësisht nga shenjat e mënjanimimit nga kodi (angl. *cods switching*) dhe të përzierjes së kodeve (angl. *cods mixing*), pas shumë shekujsh të ekzistencës së saj të izoluar, larg Shqipërisë e larg gjuhës shqipe amë, banorët e Mandricës e kanë ruajtur gjuhën e tyre, që është një formë e vjetër, e gjallë dhe relativisht mjaft e pasur e gjuhës shqipe.<sup>163</sup>

Kohët e fundit ka të dhëna se në Bullgari, përveç Mandricës, shqipja ruhet edhe gjetkë, po edhe sprova e përpjekje për ta shkruar, për ta mbajtur gjallë, sidomos në anët e Veliko Tërnovës.<sup>164</sup> Në kohën e lëvizjes së madhe të popullit shqiptar për pavarësi, shumë veprimtarë shqiptarë të kulturës, poetë e shkrimtarët Rilindjes Kombëtare Shqiptare kanë jetuar dhe punuar në Bullgari. Sofja që kthyer në një nga qendrat më të rëndësishme të kohës për botimin e librave, gazetave në gjuhën shqipe.

<sup>163</sup>Shih: Gjinari-Shkurtaj, *Dialektologjia*, f.390-391; f.398-400

<sup>164</sup>Shih: Raqi Bello, *Mësimi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Bullgari dhe në veçanti në Universitetin e Veliko Tërnovës*, në "Studime albanologjike", II, Tiranë, 2011, f.331-338.

Edhe në kohën tonë Bullgaria po shfaqet përsëri sin jë qendër e rëndësishme për albanologjinë, por tashmë për këtë po tregojnë kujdes vetë bullgarët. Për t'u përmendur është gjuhëtarja Bojka Sokollova, e cila i ka kushtuar një studim të gjerë së folmes shqipe të Mandricës. Më 1962, me nismën e gjuhëtarit të njohur bullgar Vladimir Georgiev u propozua që gjuha shqipe të mësohet në Universitetin "Sveti Kliment Ohridski" të Sofjes.

Si mësimdhënës qe caktuar Thoma Kacorri. Kurset e gjuhës shqipe filluan t'i ndiqnin mjaft bullgarë, kryesisht pedagogë dhe të huaj, që studionin në Universitetin e Sofjes.

Radio "Bullgaria" ka qenë dhe është, gjithashtu, një tribunë tjetër, ku është ushtruar gjuha shqipe nga mjaft profesionistë bullgarë.

Gjuha shqipe është mësuar edhe në Universitetin "Neofit Rilski" të Bllagoevgradit, një qytet në jug të Sofjes. Në vitin 1994-95 u fut gjuha shqipe si kurs i detyrueshëm dhe ai program vazhdoi deri më 2001.

Në vitin 1998, nën kujdesin dhe me këmbënguljen e prof. Petja Asenovës, në Universitetin "Sv, Sv. Kiril i Metodi" të Veliko Tërnovës u hapdega e ballkanistikës dhe atje pedagog i rregullt i letërsisë dhe i gjuhës shqipe u caktua Raqi Bello.

Më 2008 Fakulteti Filologjik i Universitetit të Veliko Tërnovës mori vendimin që gjuhës shqipe t'i jepet statusii gjuhës së parë, ashtu si dy gjuhët e tjera: greqishtja e rumanshtja, me numër të barabartë orësh.

Çdo vit orët e gjuhës shqipe ndiqen nga mjaft studentë të huaj, që vijnë në Universitetin e Veliko Tërnovës, sipas programeve të ndryshme.<sup>165</sup>

#### **IV.8. Shqiptarët e Ukrainës dhe gjuha e tyre**

Një ngulim shqiptarësh të shpërngulur relativisht herët është edhe ai i Ukrainës, në 4 katunde: Zhovetnjevoje (Karakurt), Devnjenskoe (Taz), Gamovka (Gjandran) dhe Georgievka (Qushki). Fshati më i madh është Zhovetnjevoje, që më parë quhej edhe thjesht Karakurt, që ndodhet në rrethinat e Odesës, nja 10 km larg qytetit Bollgrad. Tri katundet e tjera që përmendëm janë shumë afër njëri-tjetrit dhe gjenden në zonën e bregdetit Azov, në rrethin e Priazovjes në qarkun e Zaporozhjes, afërsisht nja 1ë km larg nga qyteti Melitopol.

Vendi ku ndodhen katundet shqiptare në Ukrainë është një trevë stepore, me klimë kontinentale dhe të përshtatshme për bujqësi, për kultivim frutash e perimesh.

Përbërja etnike e popullsisë është heterogjene: aty, krahas shqiptarëve që përbëjnë shumicën, ka edhe bullgarë, ukrainas dhe rusë, kurse në Zhovetnjevoje jetojnë edhe gagauzë. Sipas regjistrimit të popullsisë, të bërë në vitin 1970, numri i shqiptarëve që jetojnë në Ukrainë është 4402. Në regjistrimin e mëparshëm (të vitit 1959) kishte 5258 veta, gjë që tregon se numri i popullsisë me origjinë shqiptare në Ukrainë ka ardhur duke u pakësuar.

<sup>165</sup>Raqi Bello, *Mësimi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Bullgari dhe në veçanti në Universitetin e Veliko Tërnovës*, në "Studime albanologjike", II, Tiranë, 2011, f.334.

Shqiptarët që jetojnë në Ukrainë e quajnë veten arnautë dhe gjuhën që flasin arnautçe. Emrat e vjetër etnikë *arbër*, *arbëresh*, si dhe të mëvonshmin *shqiptar*, ata nuk i përdorin. Në të folmen e arnautëve të Ukrainës nuk përdoret as folja flas, në vend të së cilës thuhet zallahit: *zallahit arnautçe* "flas shqip". Përveç së folmes së tyre amtare (arnautçe) të gjithë shqiptarët e Ukrainës zotërojnë edhe rusishten. Shumë prej tyre dinë edhe gjuhën ukrainase, ndërsa në fshatin Zhovetnjevoje flitet edhe bullgarisht ("bullgarçe") dhe gagaisht ("turkishta").

Akademiku rus N. Derzhavin, që është nga të parët që u mor me studimin e së folmes dhe etnografisë së arnautëve të Ukrainës, mendonte se në tre dhjetëvjeçarët e parë të shekullit tonë një përhapje të madhe në fshatrat shqiptare ka pasur edhe turqishtja. Sot, sipas studimeve më të reja të Voroninës etj., shqiptarët e fshatrave në bregdetin Azov nuk e flasin më turqishten, kurse në Zhovetnjevoje, sidomos brezi i vjetër, e zotërojnë atë. Madje, aty, edhe sot ekziston një lagje në të cilën banojnë gagauzë.

E folmja shqipe ndër shqiptarët e Ukrainës, sidoqoftë, sot ka një status e përdorim të kufizuar: ajo është si mjet i komunikimit të përditshëm për një numër pak a shumë të kufizuar syresh. Ajo flitet kryesisht në familje dhe në mjedisin fshatar vetëm shqiptar, por aty nuk ka pasur ndonjëherë shkollë shqipe dhe askush nuk ka ditur e nuk di të lexojë e të shkruajë në të folmen e vet amtare. Mësimi në shkollë bëhet vetëm në gjuhën ruse.

Kohët e fundit, në përshtatje me ndryshimet politiko-shoqërore dhe shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, studiuesit kanë vënë re një farë rizgjimi të vetëdijes kombëtare ndër shqiptarët e Ukrainës dhe, për pasojë, ka një farë ringjalljeje të interesimit për gjuhën shqipe dhe për traditat e tyre shqiptare. Kështu, në Zhovetnjevoje nga mësues të shkollës së mesme të atjeshme po punohet për themelimin e një muzeu etnografik krahinor.

Në këtë punë ndihmojnë jo vetëm banorët e fshatit, po edhe studentë e pedagogë të Universitetit të San-Peterburgut, duke dërguar atje libra mësuesorë e materiale të ndryshme. Madje, në prill të vitit 1995, ka nisur të dalë edhe një gazetë shqiptare me titullin "*Rilindja*", e cila botohet në gjuhën shqipe të shkruar me alfabetin e rusishtes. Redaksia e asaj gazete mëton, kështu, të punojë për mëkëmbjen e ringjalljen e traditave shqiptare, t'i njohë të rinjtë me gjuhën dhe letërsinë shqiptare në përgjithësi dhe të bëjë të njohura kudo historinë, kulturën dhe jetën e shqiptarëve të Ukrainës.

Disa përgjithësime rreth *situatës gjuhësore* dhe *pasurisë leksikore* të së folmes së shqiptarëve të Ukrainës: Leksiku i së folmes së shqiptarëve të Ukrainës është pasqyrë e një historie të gjatë të shtegimit tyre. Aty janë pasqyruar rezultatet e takimeve ndëretnike dhe situatat e ndryshme shoqërore e gjuhësore në të cilën kanë qenë shqiptarët pas mërgimit nga Shqipëria, së pari, në Bullgari e, pastaj, në rrethinat e Ukrainës ku gjenden sot.

Para së gjithash bie në sy aty një numër i madh huazimesh nga bullgarishtja, nga turqishtja dhe nga gagauzishtja, pra nga gjuhë të sllavëve lindorë, takimet me të cilët erdhën përherë duke u bërë më të ngjeshura në rrugën e tyre prej Ballkanit deri në brigjet e detit Azov ku gjenden tashti. Gjuha bullgare do të mbetej përherë ndër shqiptarët e Ukrainës si gjuhë e dytë ose e tretë, madje, shpesh, edhe për komunikim brenda familjes (sidomos në rastet e familjeve të përziera shqiptaro-bullgare).

Megjithatë, studiuesit kanë vënë re se, me gjithë huazimet e shumta leksikore nga bullgarishtja, rusishtja, turqishtja etj., deri më sot e folmja shqipe mbetet zotëruese dhe si gjuhë e parë, si gjuhë amtare (L1) për pjesën dërrmuese të tyre. Edhe fondi kryesor i fjalëve të kësaj së folmeje përbëhet nga fjalë burimore shqipe ose të shqiptarizuara e të hyra në shqipen nga gjuhë të tjera (greke, romane, sllave dhe turke) para se të shpërnguleshin shqiptarët për në Bullgari e në Ukrainë. Grupet kryesore tematike që janë prekur më dukshëm nga ndikimi i gjuhëve sllave janë zanatet, jeta shoqërore e fetare, ushqimi. Shumë sllavizma ka edhe në terminologjinë e punëve në arë dhe në kopshtari, në nocionet abstrakte etj.<sup>166</sup>

---

<sup>166</sup>Shih: Gjinari-Shkurtaç, *Dialektologjia*, f. 401-403

## KAPITULLI V

## PROBLEME DHE PERSPEKTIVA TE ZHVILLIMIT TE SHQIPES NE MJEDISET EVROPIANE

## V.1. Zhvillimet e shqipes në vitet e fundit, probleme aktuale dhe perspektiva

Ashtu si e parasheh edhe titulli i kësaj pjesë të studimit do të trajtojmë gjendjen dhe zhvillimet e gjuhës shqipe në Shqipëri, në trojet kompakte ballkanike, po edhe të shqiptarisë e gjuhës shqipe në dhe të huaj. Ato që do të përpiqemi të sjellim në hulumtimin tonë, lidhen me një dukuri të hershme e të pandërprerë: emigracionin e shqiptarëve në dhe të huaj.

Është kjo një shpërngulje etnike e gjuhësore, që ka nisur qysh në mugëtirën e shekujve me stratiotët: luftarë arbër të paguar, që shkonin “*dietro la sciabolla*” (mbas shpatës e zulumës) në Italinë fqinje e gjetkë në Evropë, por që do të vijonte ndër shekuj me mërgatat e mëdha të arbërve drejt Greqisë, ku do të bëheshin “arvanitas”, pastaj drejt Italisë, ku shumë syresh u tretën, por edhe një sasi e madhe mbetën në Italinë e Jugut e në Sicili, si “arbëreshë”.

Kështu edhe mërgime të tjera, herë më masive, herë më të vogla, si arbneshët në Zare të Dalmacisë, “arnautët” në Mandricë e gjetkë në hapësira të Bullgarisë, deri në Velikotërnovo, “arnautët” a shqiptarët e Ukrainës dhe aq shumë arnautë të tjerë në Turqi e gjetkë, si në Misir, Konstancë etj. deri te eksodet masive të shqiptarëve në vitet '90 të shekullit XX, të cilat do t'i shtoheshin si një shtresë e re diasporës së hershme arbëreshe e arbërore në krejt Evropën, po edhe në Amerikë, Kanada, Australi etj.

Në disa shkrime dhe sidomos në librat e prof. Gj.Shkurtajt ”**Ligjërimet arbëreshe**” dhe “**Sociolingustikë e shqipes**”, “**Kundrime gjuhësore**”, autori ka dhënë një pamje të hapësirave tashmë tepër të shtrira të mërgatës së hershme e të re shqiptare në Botë, duke shtruar pyetjen: “*Ku janë sot shqiptarët?*” dhe jepet, si fillim, një përgjigje me pyetjen retorike: “*Ku nuk janë sot shqiptarët?!*”. Kjo do të thotë se, edhe gjuha shqipe e kultura shqiptare, janë gërshtuar e përzier shumë me gjuhët e botës, janë përfshirë ose tretur në mozaikun e madh evropian e botëror.

Në shumë prej vendeve ku rrojnë sot shqiptarë në shtete të Evropës si në Zvicër, Suedi e gjetkë, po edhe në Amerikë e në Australi, në grupime të mëdha a të vogla, kanë filluar të veprojnë shoqata shqiptare të arsimtarëve dhe dashamirëve të shqipes. Në mjediset e Italisë së Jugut nëpërmjet reformave shkollore e të ligjeve që mbështesin e përkrahin nismat për mësimin e shqipes si gjuhë e dytë në mjediset arbëreshe shqipfolëse, ka kohë që po organizohen kurse të gjuhës shqipe.

Gjithandej në diasporën shqiptare ka përpjekje e sprova për ta mbajtur gjallë shqipen e kulturën shqiptare. Megjithatë, janë më të shumtë ata që nuk kanë kushte e mundësi për t'i ndjekur kurset a shkollat shqipe në dhe të huaj. Por, të gjithë sa janë, ashtu sikundër e kanë të pashuar dëshirën për të qenë edhe më tej shqiptarë, kanë dëshirë për të folur e shkruar shqip dhe, nëpërmjet gjuhës shqipe, të mbeten përjetësisht të lidhur me kombin e vet, me Shqipërinë dhe shqiptarët.

Disa përdorin abetaret e shkollave shqipe të Shqipërisë ose të Kosovës. Porse, gjithandej, në diasporën e hershme e në ngulimet më të reja, nuk kanë munguar edhe

sprovat e dashamirësve e arsimtarëve të ndryshëm për të hartuar abetare a libra mësimi për gjuhën shqipe.

Ndërkaq, pikërisht në vitet e fundit të shek. XX dhe në fillim të mijëvjeçarit të ri, të dhënat rreth përhapjes, shtrirjes dhe situatës së shqiptarëve e të gjuhës shqipe në Evropë e në mbarë Botën, janë shtuar dukshëm me prurje të reja, deri vonë të panjohura, por edhe sot, ende të atilla që meritojnë të hetohen e të hulumtohen më tej. *Në qoftë se, këtu e 12 vjet më parë, ishte një befasi e këndshme që një studim doktore i kushtojë diasporës shqiptare në Zvicër dhe gjendejs së gjuhës shqipe e kontaktit të saj me gjermanishten në kantonet e Zvicrës gjermanofone, për hir të një ndihese aq të thelluar të paraqitur nga dr. Basil Schader, kur mbrojti doktoraturën në Universitetin e Tiranës, si dhe njohja me veprimtarinë e LAPSH-së “Naim Frashëri”, tashmë duhet të themi se kjo lloj përnjohjeje nuk është më aq befasi, as e rrallë.*<sup>167</sup>

Prej botimeve të kohëve të fundit, si në letër, ashtu edhe të librave e publikimeve “on-line”, del se Evropa dhe Bota, kanë edhe LAPSH-a të tjera, si p.sh. në viset nordike, prej nga, pikërisht këto ditë, lexuam me kënaqësi të dhëna mjaft interesante për shqiptarët e Suedisë. Në librin e Ramadan Rushitit, me titull “Shkolla shqipe në Suedi”, thuhet se atje: “Edhe pse tash për tash nuk ka të dhëna të sakta për numrin e shqiptarëve, asociacionet e organizuara shqiptare këtu, vlerësojnë se në Suedi aktualisht janë të vendosur rreth 45.000 shqiptarë. Ata janë kryesisht nga Kosova”.

Në fillim të viteve 90 të shekullit XX, kur, për shkak të represionit shtetëror serb, po bëhej shpërngulja masive e shqiptarëve nga Kosova, nëpër strehimoret e refugjatëve, që ishin hapur në shumë mjedise të Suedisë, numri i shqiptarëve llogaritej të ishte midis 60 –70 mijë. Aty, flitet edhe për gjendjen e kësaj diaspore shqiptrae në Suedi, po edhe për përpjekjet e ndihmesat e realizuara për mbajtjen gjallë të gjuhës shqipe. Për të kërkuar strehim këtu kishin ardhur familje të tëra, prandaj normalisht se pjesa më e madhe e refugjatëve nga Kosova ishin të moshës së re, kryesisht nxënës që kishin ndërprerë shkollimin. *“Meqenëse në mesin e këtyre refugjatëve kishte edhe punëtorë të arsimit, pothuajse në të gjitha strehimoret e refugjatëve, natyrisht me pëlqimin e organeve vendore, u organizua mësimi plotësues në gjuhën amtare”.* Më vonë, këto nisma u përkrahën dhe u ndihmuan nga veprimtarët e LDK-së, kurse ndihmesë profesionale dha Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë “Naim Frashëri”, dega në Suedi, bashkë me asociacionet e organizuara të shqiptarëve.

Sipas të dhënave të verifikuara, midis viteve 1992 -1995, mësimi plotësues në gjuhën shqipe në Suedi ishte i organizuar në 250 vendbanime.<sup>168</sup>

Të dhëna me interes, qoftë edhe pse jo mirëfilli me karakter studimor e sociolinguistik, sjellin edhe botime të tjera, ndër të cilat, mund të përmendet libri i dr. Gj.Gjeloshit “**Afër dhe larg**”, ku, në disa krerë e sytha të tij, sjell edhe jo pak të dhëna të freskëta, që vijnë edhe nga disa vise prej të cilave, jo se nuk e dinim që ka shqiptarë, por nuk kishim pasur asnjë rast të hulumtonin drejtpërdrejt atje, si p.sh. në Bosnjë e Herzegovinë, dhe, pikërisht ashtu si e kërkon një gazetari e kohës, ai shtron pyetjen: “*A ka shqiptarë në këtë shtet multi-etnik?*” Pastaj jep një përgjigje mjaft interesante, sigurisht edhe të dhimbshme, si p.sh., kur pohon se “*të vjetrit më tepër e mbajnë veten për boshnjakë se sa shqiptarë. As që bëhet fjalë për shkrim e lexim në shqip. Ata pothuajse janë asimiluar. Disa djem që ne i takuam e që luanin edhe rolin e përkthyesit, as që bëhej fjalë të dinin ndonjë gjë nga historia e Shqipërisë. Vërtet shqipen e flasin, por çalët. Disi më mirë fliste shqip ndonjë person që mban lidhjet*

<sup>167</sup> Shih: Gj.Shkurtaç, kumtesë e mbajtur në Universitetin e Zyrhut, 7 qershor, 2003.

<sup>168</sup> Shih: R. Rushitit “Shkolla shqipe në Suedi” (faqe në internet)

me Kosovën, që kanë atje edhe rreth familjar. Asimilimi i tyre duket edhe nga emrat.”<sup>169</sup>

Shumë interesant është, sidomos, kreu me titull “Atdheu i dytë i shqiptarëve”, kushtuar diasporës shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (f.60-77), ku autori sjell, së pari, një pamje të përhapjes së shqiptarëve në Amerikë. “Në Waterbury të shtetit të Connecticutit mund të ketë deri në 20 mijë shqiptarë. Po kështu edhe në Hartford e Bridgeport ka shqiptarë, sidomos nga Shkodra....Shqiptarë ka edhe në Alaskën e largët, në vendin që kufizohet me Rusinë nga faqja tjetër e globit, duke u nisur nga Europa. Në këtë vend, që është mbi një milion kilometër katrorë, thuhet se jetojnë vetëm mbi një milion njerëz, 300 mijë prej të cilëve jetojnë në qytetin Ankoerejxh. Aty mund të gjenden rreth 300 shqiptarë.” (f.60).

Më tej thuhet: “Megjithëse shqiptarët e Amerikës janë të përqëndruar në disa shtete të veçanta, fakt ky i njohur edhe në Shqipëri, ata janë të shpërndarë pothuajse në të 5 shtetet e Shteteve të Bashkuara. Ndër to spikatin qendrat më të mëdha të shqiptarëve: Shteti i Michiganit, kryesisht qyteti i Detroitit me rrethinat e tij. Nju Jorku, me Bronzin kryesisht dhe Bostoni. Në anën e Atlantikut, kufiri i shpërndarjes së shqiptarëve shtrihet deri në Florida. Në anën tjetër të Oqeanit Paqësor, është Kalifornia. Shumë shqiptarë, kryesisht nga Korça e Pogradeci gjenden në Filadelfia, shteti i Pensilvanisë. Nuk dihet numri i saktë, por “që janë shumë” duken me rastin e festës së flamurit, që shqiptarët e festojnë me gëzim. Në këtë ditë, të gjitha lokalet mbushen plot prej shqiptarëve. Por ata nuk mungojnë as në Dakotën e Veriut e të Jugut, në dy Karolinat, në Çikago e San-Francisko. Në Kolorado e Atlanta. Nga Shtetet e Bashkuara thuhet se kanë kaluar shumë shqiptarë në shtetin fqinj të Kanadasë. Kohët e fundit, numri i familjeve që shkojnë atje është shtuar edhe për arsye se në SHBA, po shtohen vështirësitë e pengesat për të marrë lejen e qëndrimit të përhershëm...” (f.61)

Autori, madje, në këtë syth shtron edhe pyetjet e rëndësishme: A ka evidenca për këtë problem? Ku janë të shpërndarë shqiptarët? dhe përmbyll duke verësuar se këto pyetje nuk vlejnë vetëm për numrin e shqiptarëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por për të gjithë globin. Krejt faqet 61 e 62 janë me trajtime dhe vlerësime rreth shtrirjes, sasisë dhe situatës së shqiptarëve në krejt rruzullin, duke bashkuar me shumë domethënie, situatën e sotme, me sa shkruhej po për këtë dukuri (të shqiptarëve në botë) qysh më 29 prill të vitit 1940, nga Lazër Shantoja në gazetën “Tomori”, të cilin e citon dhe është me të vërtetë një shënim mësimdhënës.

Por, pjesa ku autori i trajton më së miri problematikat me interes sociolinguistik është ajo vijuese dhe që e ka nxjerrë si syth më vete me titullin: “Fati i gjuhës shqipe”. Aty, me një aftësi depërtuese shumë të lëvdueshme, autori na jep pamjen e saktë të gërryerjes dhe bjerrjes së pamënjatueshme të shqipes në dhe të huaj, në kushtet e sotme të domosdoshmërisë së përshtajës e njohjes së gjuhës së vendit si gjuhë pune, punësimi e përparimi. Po, le ta japim këtë me fjalët e vetë autorit, që e jep në gojën e njërt prej shqiptarëve të Amerikës:

“Përfundimi: meraku i integritit sa më të shpejtë nëpërmjet gjuhës së huaj na shpie në humbjen e gjuhës sonë. Kur të kujtohem që ta mësojnë fëmijët, do të jetë tepër vonë.”(f.66).

Natyrisht, duke sjellë edhe aspekte të tjera nga shqiptarë të Amerikës, që, sidoqoftë, përpiqen edhe për mbajtjen gjallë të shqipes, faqet e kësaj prashtrëse kushtuar shqipes, pleksen edhe me ndonjë rreze sado të mekët drite e shprese, si p.sh., kur përshkruhet ndonjë përvojë konkrete: “ Mësimi i shqipes në shtëpi nuk është aspak pengesë për

<sup>169</sup> Shih: Gj.Gjeloshi, “Afër dhe larg”, Tiranë, 2010, f. 66.

*mësimin e anglishtes në shkollë apo në shoqëri. Në Shtetet e Bashkuara, fatmirësisht gjen me dhjetra raste ku bëhen përpjekje të përbashkëta e të organizuara për mësimin e gjuhës shqipe”*(f. 66)

Dhe fatin e gjuhës shqipe në mërgatat shqiptare, ai e ndjek me shqetësim e me të dhëna të sakta, kudo që ka shtegtuar. Flet për lagjen “Bajram Pasha’ apo”Berat Pasha” në Stamboll dhe pyetjet e gazetarit tonë shkojnë drejt e te gjuha shqipe dhe gjendja e saj. Aty mësojmë se Turqia nuk i përkrah nacionalizmat. “*Shteti nuk i ka qejf tubimet apo organizimet me bazë kombësie.ke njëpasaporët turke, je shtetas turk. Kjo shkon deri te gjuha. Nuk përkrahen, por edhe pak ka iniciativa për të organizuar mësimin e gjuhës shqipe. Po të vësh re sot, ndër shqiptarët që jetojnë këtu prej kohësh, vetëm një nmër tëmoshuarish e flasin gjuhën shqipe. Shumë pak fëmijët dhe aspak nipërit.”* (f.321).

Nga mesi i shekullit XIX, për disa dhjetëvjeçarë, kombi shqiptar ishte duke u përlindur dhe iluminizmi e romantizmi ishin boshti politik e poetik i kohës, ndaj kemi aq shumë shkolla shqipe gjatë Rilindjes dhe disa vjersha himnizuese kushtuar gjuhës shqipe, nga Naimi, Mjeda, Fishta, Lasgushi etj. Por sot, pas njëqind vjetësh të shtetit shqiptar, është e udhës të pyesësh, jo vetëm sa shqiptarë flasin në gjuhë të huaj, por dhe sa të huaj e kanë mësuar shqipen nëpër botë? Sa gjuha jonë u është dashur atyre? A botohen libra dhe gazeta shqip në vende të tjera?

Çdo shqiptar do të lakmonte e uronte që gjuha e tij amtare të shkruhej e flitej në mediumet e qytetërimit bashkëkohor. Ashtu siç qe shkruar shqip qysh me 1555 në Europë “*Meshari*” i Buzukut, apo “*Kuvendi i Arbnit*” me 1703. “*Flamuri i Arbërit*” i De Radës e “*Albania*” e Konicës një shekull më vonë. “*Dielli*” e “*Vatra*” e Bostonit. E sa stacione të tjera historike kësisoj të shqipfoljes e shqipshkrimi nëpër botë. Derisa të mbërrihet te “margaritari i kurorës”, botimi vite më parë, nga “Fayard” -Francë, i veprës së Kadaresë në shqip e frëngjisht, si një lartësi e gjuhës shqipe në kohë moderne.

Por ndoshta, krahas lavdisë së mosbjerrjes së shqipes në shekuj, do të trishtohemi pak në ditët e sotme, pasi ka shqiptarë në tokë të huaj që disi e kanë “harruar” shqipen, duke u ndjerë mbase më shumë evropianë, amerikanë, australianë etj. Ndërkohë që kombe dhe qeveri të huaja përpiqen ta shtrijnë sa më shumë hartën e të folurit së tyre nëpër botë, ku jo rastësisht ka mbretërim të anglishtes, ditë të frankofonisë, ngarendje të spanjishtes, nxitim të kinezishtes etj.

Jemi padyshim për t’u bërë pjesë e qytetërimit të botës, por duke shkuar andej me të dyja këmbët, autoktonen dhe gjuhësoren. Do të ishte bukur nëse do të mund të thoshim me krenari se sa përpara e kemi çuar ëndrrën rilindase për këtë gjuhë të perëndisë, siç e quante Fishta. Mes të tjerësh, sa frytdhënëse i kemi shkollat shqipe në Greqi, Belgjikë, Itali, Zvicër, Angli, Amerikë për fëmijët e emigrantëve? Sa efikase kanë qënë në këto mote katedrat e gjuhës shqipe në: Palermo, Kozencë, Napoli, Vjenë, Mynih, Shën Peterburg, Bukuresht, Pekin etj, në gjurmë të albanologëve të mëdhenj europiane të dy-tre shekujve të fundit. Apo vetëm dy-tre sosh ndihen, kurse të tjerat janë shuar, kanë mbetur si kujtime e natyrisht dhe si arkiv?

Kemi një model unik të ruajtjes së shqipes, atë të arbëreshëve të Italisë, në pesëqind vjet, ku dhe sot e kësaj dite vazhdon të gjallojë arbërishtja e tyre e pabjerrë. Ata sa herë i merrte malli dhe sa herë iu kërcënohej gjuha dhe identiteti kthenin kryet këndeje nga Arbëria që iu kujtonte se “na të huej jemi te ky dhé”. S’bëhet fjalë për paralele, pasi rrojmë në tjetër epokë dhe në kohë integrimesh të gjithëmbarshme, ama

nuk mjaftojnë krenimet familjare a komunitare të emigrantëve me flamurin kombëtar dhe pak fjalë shqipe me fëmijët pas punës, ashtu si në vrap, për ta mbajtur gjallë e kultivuar shqipen në emigracion.

Vetëm pesëdhjetë vjet duhen që dikush me prindër shqiptarë, i trojeve shqiptare, ta quajë veten turk, amerikan, kinez dhe shqipen e prindërve të tij ta ketë si gjuhë të dytë. Kjo do të ishte një shqipberrje e ngadaltë, e frikshme, që nuk do të na falte i pari Gjon Buzuku. Ta themi sot këtë merak. Vetes po ia themi, që ta kemi vëth në vesh, mbrojtjen e shqipes tonë nga të gjitha tallazitjet e fillim-mijëvjeçarit të tretë. Ndaj dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka hartuar një strategji për mbrothësinë e shqipes në emigracion, me programe digjitale të posaçme, tekste në gjuhën shqipe për fëmijët e emigrantëve etj.

Për më tepër “*në çastin kur vendet ku jetojnë emigrantët tanë do të lejojnë futjen e gjuhës shqipe si lëndë me zgjedhje në kurrikul, atëherë qasja jonë do të jetë tjetër*”, është thënë nga ministria e Arsimit dhe Shkencës, duke shtuar se “*tashmë një praktikë e tillë zbatohet për emigrantët italianë në Gjermani dhe në shumë vende të tjera.*” Teksa është miratuar abetarja mbarëkombëtare dhe plani mësimor për fëmijët e diasporës, botimi i librave për ta, shpërndarja e tyre etj.

Problemi i shqipes së emigracionit është i dyfishtë, si për fëmijët që vazhdojnë të mësojnë atje, ashtu dhe për ata që tashmë janë kthyer. Duke qenë se në vitin 2012 janë regjistruar mbi 2700 fëmijë, të cilët kanë rinisur mësimet në shkollat shqiptare, organet e arsimit kanë hartuar një plan kombëtar veprimi, për t’u ardhur në ndihmë atyre, që të aftësohen në shqipen e folur e në drejtshkrim, përmes kurseve verore etj. Por mosberrja e shqipes në emigracion është një sipërmarrje më e gjerë se ajo shtetërore, jemi të gjithë që mund të luajmë një rol në këtë mes.

Ashtu siç “Top Channel” i kushton vëmendje herëpashere kësaj problematike, përfshirë dhe njërin nga emisionet e mëngjesit. Apo dy prindër të rinj, që e kishin sjellë te të afërmit në Shqipëri djalin e tyre (të lindur në Itali), një vit përpara se të fillonte klasën e parë, që të përshtatej me shqipen që në kopsht dhe të mos kishte vështirësi kur të niste abetaren.

Bjerrja e shqipes së emigracionit shpesh i ka “rrënjët” këndeje, kur të rinj shqiptarë analfabetë nga zonat malore mbërrijnë deri në Suedi, Belgjikë e Angli për të kërkuar azil prej “gjakmarrjes”, por që nuk dinë të flasin e shkruajnë gjuhën e tyre. Ata kërkojnë të integrohen në Europë si individë, por dhe një shoqëri e tërë siç jemi ne, e kemi të vështirë integrimin qoftë dhe prej analfabetizmit, që vërtet nuk është kronik si ai i viteve ’30 të shekullit të kaluar, por jo për t’u shpërfillur, pasi sot më shumë se kurrë ballafaqohemi me botën, teknologjinë, qytetërimin evropian.

*Gjuha pëson “krisje” dhe për një presje e për një shkronjë të keqpërdorur, siç ngrinte zërin këto ditë gjuhëtari i njohur, Akademik Gjovalin Shkurtaj, ku dhe fjala nënë në emërtimin e QSUT “Nënë Tereza” ishte shkruar gabim, me e në vend të ë-së. Ka vite që gjuhëtarët tanë “bërtasin” për mirëpërdorimin e gjuhës e ne nuk i dëgjojmë, si të jenë duke folur për një “gjuhë të vdekur”<sup>170</sup>.*

<sup>170</sup> Shih: Ndue Dedaj, *Shqipja e bjerrë e emigracionit*, në “Shqip”, 21 mars 2013.

## V.2. Hapësira të shqipes në botë. Pjesë plotësuese e thelluese për integrimet e shqipes në mjediset evropiane

Në Zvicrën gjermanishtfolëse jeton një numër i madh mërgimtarësh shqiptarë të ardhur në periudha të ndryshme nga të gjitha trojet shqiptare<sup>171</sup>. Ngulitja këtu e këtyre mërgimtarëve ka shtruar para tyre nevojën për të mësuar në rend të parë gjuhën e vendit, kurse ruajtja e gjuhës amtare ka qenë diçka që e kanë menduar se mbetet vetvetiu tek ata. Me ndryshimin e strukturës së mërgimtarëve, e ndikuar para së gjithash nga bashkimi i tërë familjes, është krijuar një situatë e re, e cila ka shtruar nevojën për ruajtjen e gjuhës shqipe të gjenerata e dytë dhe e tretë.

Kjo situatë e re ka kërkuar edhe veprime të reja, të cilat për fat të keq nuk janë realizuar ashtu siç është menduar për shkaqe nga më të ndryshmet. Gjuha shqipe duke u ndodhur përballë gjermanishtes letrare e dialektit të gjermanishtes zvicerane që në fillim ka zënë një vend inferior në Zvicrën gjermanishtfolëse si gjuhë e një pakice me ndikim të parëndësishëm në jetën shoqërore e politike. Në periudha të caktuara dhe nga grupe të caktuara bile është fshehur njohja e kësaj gjuhë shkaku i frikës dhe barrierave të ndryshme.

Në një situatë të tillë është e natyrshme që kërkohen përpjekje të mëdha për ta ruajtur dhe zhvilluar më tutje një gjuhë. Dhe kur këto përpjekje nuk bëhen nga dora e shtetit, atëherë rreziku i dobësisht dhe zhbërjes së një gjuhe është më se real.

Për t'i dalë ballë këtij rreziku historia e mbijetesës së gjuhës shqipe është e përshkuar me aktivitete nga më të ndryshmet. Në vazhden e këtyre përpjekjeve është edhe puna e LAPSH „N. Frashëri“ në Zvicër. Më se dy dekada ky institucion i rëndësishëm bën përpjekje për t'ua mësuar fëmijëve shqiptarë gjuhën shqipe. Në këtë kuadër punonjë që më se 20 vjet mjaft mësues me nxënës shqiptarë në Kantonin e Cyrihut. Njeri prej tyre Nexhat Maloku shkruan :

Gjatë kësaj kohe tek unë kanë ndjekur mësimin plotësues me qindra e qindra nxënës të grupmohave të ndryshme. Disa prej tyre, tashmë të rritur, i takoj herë pas here në vende të ndryshme dhe gati të gjithë më thonë se atëherë nuk e dinin shumë rëndësinë e mësimit shqip, por tash e kuptojnë se sa me vlerë ka qenë për ta ky mësim. Një pjesë e tyre tashmë i sjellin fëmijët e tyre në mësimin plotësues, pra fëmijë të gjeneratës së tretë të mërgimtarëve shqiptarë.

Fatkeqësia më e madhe është tek ata fëmijë që nuk e vijnë fare këtë mësim, e që fatkeqësisht janë shumica dërmuese. Në Kantonin e Cyrihut, i cili ka numrin më të madh të nxënësve, në tërë Zvicrën, që e ndjekin mësimin plotësues, përqindja e pjesëmarrjes së nxënësve është mes 8-10 %.

Nuk do të ndalem në shkaqet e kësaj gjendjeje sepse besoj për ne këtu janë të ditura këto, por mund të nxjerr një konkludim fillestar se mërgata shqiptare në Zvicrën gjermanishtfolëse është mjaft larg përmbushjes së detyrës për ta kultivuar tek fëmijët e tyre gjuhën shqipe. Kjo nënkupton që një pjesë e konsiderueshme e prindërve shqiptarë vetëm në mënyrë afektive e përkrah zgjerimin e aftësive gjuhësore tek fëmijët e tyre.

Në mësimin plotësues, duke u bazuar në përvojën time, mund të bëj kushtimisht një ndarje në dy kategori të nxënësve shqiptarë:

Kategoria e parë janë nxënësit të cilët vijnë për një kohë të shkurtër apo një ose më se shumti tri vjet në mësimin plotësues, dhe;

<sup>171</sup>Shih: Nexhat Maloku, *Përvoja dhe udhëzime në lidhje me ruajtjen e aftësive gjuhësore të shqipes në Zvicrën gjermanishtfolëse*, kumtesë e mbajtur në 7 qershor 2013 në Cyrih.

Kategoria e dytë janë ata nxënës, të cilët e vijnë deri në përfundim të klasës së tetë, respektivisht të klasës së 9 mësimit plotësues.

Kategoria e parë është e tillë për shumë arsye. Ndër to mund të përmendim kontributin që duhet të paguajnë prindërit në mënyrë që fëmija të ndjek mësimin plotësues, angazhimet në aktivitete të tjera të lira, sidomos në futboll (djemtë), mosinteresimin e duhur të prindërve për t'i përkrahur fëmijët e tyre në vijimin e rregullt të mësimit, koha e papërshtatshme mësimore, rëndësia minore e notës së mësimit plotësues në dëftesën e shkollës publike, e natyrisht një rol me rëndësi këtu luan edhe përgatitja profesionale e mësimeve.

Pra në mosvijimin e rregullt dhe ndërprerjen e mësimit plotësues luajnë rol shumë faktorë që ndikojnë që këta fëmijë të marrin vetëm njohuritë fillestare në gjuhën shqipe.

Kategoria e dytë janë nxënësit të cilët vijnë rregullisht në mësimin plotësues që nga fillimi dhe janë të përkushtuar që të mësojnë sa më shumë. Në bazë të përvojës shumëvjeçare të përfituar, mund të themi se shumica e këtyre nxënësve arrijnë një nivel të kënaqshëm të zgjerimit të aftësive gjuhësore në gjuhën shqipe. Pra mund të them që nxënësit dhe nxënëset nuk zgjerojnë në gjuhën shqipe vetëm shkathtësitë bazë komunikuese, të cilat i përdorin në përditshmëri, të ashtuquajturat *Basic Interpersonal Communicative Skills (Aftësitë bazale të komunikimit ndërveprues)(BICS)*. Ata fitojnë në mënyrë plotësuese edhe kompetencat gjuhësore, të cilat janë vendimtare për të mësuarit kognitiv në shkollë: *the Cognitive Academic Language Proficiency (Aftësitë kognitive akademike për përdorimin e gjuhës)(CALP)*.

“Janë këto kompetenca CALP, të cilat ua lejojnë atyre që të kuptojnë gjendje faktike komplekse dhe të kuptojnë abstrakten, të njohin marrëdhëniet shkakore ose të strukturojnë një tekst. Prandaj mësimi i GJKA e përkrah hapin nga regjistrat BICS tek regjistrat CALP. Ai e forcon vetëdijen e nxënësve dhe nxënëseve për dallimet mes regjistrave të fjalëve dhe i mëson ata se si mund t'i përdorin ato”. (Plani mësimor kornizë).<sup>172</sup>

Nxënësit shqiptarë në Zvicrën gjermanishtfolëse që në fillim ndeshen me gjuhën gjermane, dialektin e gjermanishtes zvicerane, me gjuhën standarde shqipe dhe me dialektin e gegërishtes. Kjo situatë ua vështirëson atyre arritjen e suksesit të kënaqshëm shkollor në përgjithësi. Ata e mësojnë dialektin e gjermanishtes zvicerane në njërin anë dhe nga shtëpia prindërore fitojnë një leksik të kufizuar të së folmes dialektore të gegërishtes. Vetëm të mësuarit e vazhdueshëm i përcjellur me aktivitete të larmishme ua mundëson këtyre nxënësve të çajnë barrierën dialektore dhe të mund të përdorin me kompetencë gjuhën standarde.

Gjatë veprimtarive të ndryshme mësimore nxënësit përdorin shumë shpesh shprehje dialektore ose kur nuk gjejnë fjalë as në dialekt atëherë “huazojnë” fjalë nga gjuha që e njohin më mirë, pra nga gjermanishtja, ku vjen në shprehje kod suiçingu, fenomen të cilin studiuesi i njohur Basil Schader e ka trajtuar me gjerësi në punimin e tij të doktoratës. Edhe pse gjuhën shqipe e kanë gjuhë amtare, shumica e nxënësve në mësimin plotësues, me kalimin e kohës e njohin gjuhën gjermane më mirë, pra gjermanishtja kalon në rendin e parë e pastaj vjen gjuha shqipe.

E folmja dialektore, e cila fitohet që në hapat e parë në shtëpinë prindërore, përpos ndikimit pozitiv që luan para së gjithash në drejtim të sqarimit të dallimeve

<sup>172</sup>N.Maloku, kumtesë e cituar.

mes dialektit dhe gjuhës standarde apo kuptimit të fjalëve në gjuhën letrare, nëse me kohë e hap pas hapi nuk plotësohet me gjuhën letrare, bëhet pengesë për nxënësit në fitimin e kompetencave gjuhësore në shqipen standarde.

Kjo punë natyrisht se është shumë sfiduese duke pasur parasysh në njërin anë fondin prej dy orësh mësimi në javë në GJKA (Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut) e në anën tjetër përdorimin e vazhdueshëm të dialektit gegë në shtëpinë prindërore apo në kontaktet me bashkëmoshatarët. Por qëllim i rëndësishëm i mësimit plotësues është kalimi suksesiv nga dialekti në gjuhën standarde.

Në një orë mësimore një nxënës i klasës së tretë (i cili ka filluar që disa muaj të ndjek mësimin shqip) vjen tek unë dhe më pyet: “Mësues, a ki një Spitzer me furfullat Bleistift-in”.

Formimi i një fjalie të tillë është shumë i veçantë. Ky nxënës, i cili vjen nga trevat shqiptare në Maqedoni, ka përdorur kod-suiçingun duke futur fjalët *Spitzer* dhe *Bleistift*. Derisa fjalën e parë edhe mund të mos e ketë ditur në gjuhën shqipe, pra “mprehësen”, fjalën e dytë *Bleistift* (lapsin) sigurisht që e ka pasur të njohur, por këtu vjen shpesh në shprehje komoditeti i fëmijëve për të përdorur fjalë, të cilat i gjejnë më lehtë. Të bën përshtypje në këtë fjali shprehja *furfullat*, të cilën nuk e kemi dëgjuar më parë nga ndonjë nxënës. Në fjalorin e gjuhës shqipe është një sqarim i dytë (sqarimi i parë Furfula – erë e ftohtë që fryn në dimër me rrëmbim) për fjalën *furfullatë* – ashkla që dalin gjatë zdrugimit! Pra ai ka përdorur një fjalë që në mënyrë simbolike shpreh aktivitetin që ka synuar të bëjë.<sup>173</sup>

Një fenomen i rëndësishëm në mësimin plotësues është ndikimi i ndërsjellë mes shqipes dhe gjermanishtes. Duke qenë se gjermanishtja është gjuhë kryesore e komunikimit në jetën e nxënësve, shumë shpesh, gjatë të folurit apo të shkruarit, fjalë të gjermanishtes futen në strukturën e fjalisë së shqipes. Kjo vërehet në shumë situata gjuhësore, si tek përdorimi i mbiemrave, ngase në gjermanisht parimisht mbiemri është përpara emrit, kurse në shqip pas emrit. Kur e pyet një nxënës shqiptar se në cilën klasë shkon, në shumicën e rasteve ai/a jo përgjigjet “Unë shkoj në t’pestën klasë” e që në të shprehur të rëndomtë do të duhej të thoshte se: “Unë shkoj në klasën e pestë”, por siç shihet kjo strukturë e fjalëve bartet nga gjermanishtja dhe në shqip pastaj zë një vend të gabuar.

Dallimet tek emrat, mbiemrat, përemrat, foljet pastaj tek parafjalët janë mjaft të shumta dhe këto dallime çojnë tek gabimet e ndryshme që i bëjnë nxënësit më shumë në shqip e më pak në gjermanisht. Duke pasur parasysh se shpesh këto kod-suiçinge janë në vend të gabuar, para mësuesve shtrohet një detyrë shumë e rëndësishme që t’i sqarojnë mirë këto fenomene gjuhësore dhe të punojnë më nxënësit në mënyrë të vazhdueshme për mënjanimin e tyre. Por parakusht për ta bërë këtë është njohja e mirë e të dy gjuhëve që për fat të keq ne mësuesve të mësimit plotësues mjaft shpesh na mungon.

Një vështirësi tjetër në mësimin plotësues është pjesëmarrja e nxënësve nga familje të përziera. Në klasat e mësimit plotësues puna me grupmosha të ndryshme, me aftësi gjuhësore të ndryshme, është e rëndomtë dhe ky grup i vogël i nxënësve nga familje të tilla është një sfidë plotësuese në këtë mësim. Se sa të vështirë e kanë fëmijët e këtij grupi tregon ky shembull, që jep N.Maloku, *ku në një ushtrim me shkrim nga një vajzë e po të njëjtit nivel, që shkruan për një kohë prej 10 min më shumë se gjysmë faqe, nxënësja e prindërve të përzier mezi arrin të formulojë tri fjali!*

<sup>173</sup> Po ai, po aty.

Një dallim tjetër për t'u theksuar është mosha kur fillojnë fëmijët të ndjekin mësimin plotësues. Në rrethin shkollor të Limmattal-it në qytetin e Cyrihut, fëmijët fillojnë me mësimin plotësues që nga kopshti parashkollor dhe kur vijnë në klasën e parë tashmë janë më të përgatitur se ata nxënës, të cilët në klasën e parë apo të dytë fillojnë me mësimin plotësues. Është e njohur se gjuha amtare mësohet më së shumti që me lindjen e deri me hyrjen në klasën e parë dhe një përkrahje, e drejtuar, sa më e hershme është tepër e rëndësishme për fëmijët mërgimtarë.

Në këtë drejtim, herë pas here, realizohen projekte me qëllim animimin e prindërve për t'i përkrahur fëmijët e tyre, por për fat të keq përfshihen një numër i vogël i prindërve. Andaj ndjekja e mësimin plotësues që nga kopshti parashkollor, dhe edhe më herët me të ashtuquajturat grupet e lojës, do të ishte një ndihmesë e mirë për fëmijët mërgimtarë këtu.

Në disa punime shkencore është theksuar se për të mësuar një gjuhë të dytë, përpos elementeve të tjera, me rëndësi primare është njohja e gjuhës amtare. Kam parasysh këtu të dhënat që kanë dalë nga studimet e bëra si ato të B. Schader, E. Kaprec, U. Moser etj.

Një fenomen i ri, i cili vërehet në kohën e fundit është se një numër i vogël i këtyre të rinjve, duke qenë të vetëdijshëm për mangësitë, që kanë në gjuhën shqipe, kanë filluar të ndjekin kurset për të rritur. Në shkollën e lartë të udhëtimeve në më shumë se 10 vjet shkojnë herë pas here të rinj të tillë. Një vështirësi i hollësishëm i gjendjes së tyre gjuhësore na jep informacione interesante se ku kanë më shumë vështirësi në përdorimin e gjuhës shqipe. Disa nga këta të rinj vijnë në këtë kurs edhe të udhëzuar nga punëdhënësit, ngase në vendet ku punojnë është e nevojshme njohja e gjuhës shqipe (spitale, shtëpi mallërash etj).

### **V.3. Kurset e gjuhës shqipe për të huaj dhe katedrat e shqipes në Itali, Greqi, Rusi etj.**

Kurset e gjuhës shqipe për të huaj janë të hershme në Universitetin e Tiranës, ato kanë filluar qysh kur në këtë institucion ende të ri nisën të vinin studentë të huaj, së pari, nga vendet e ish-kampit socialist, si BS, Polonia, Bullgaria, Rumania, Kina, Vietnami, Koreja etj. Madje, në vitet '60 ka pasur edhe disa studentë nga Mongolia. Në mesin e viteve '60, ka pasur pedagogë kinezë, koreanë e vietnamezë që janë diplomuar në Universitetin e Tiranës dhe pastaj kanë zënë vende të rëndësishme në fushën e diplomacisë, deri në nivel ambasadorësh.

Më vonë, në vitet '70, kurseve të mëparshme të shqipes për studentë të huaj, që ishin zakonisht njëvjeçare, sikundër janë edhe sot për të huajt që vijnë nga larg dhe nuk dinë gjuhën shqipe, iu shtuan edhe kurset njëmuajore gjatë verës, në të cilat përfshiheshin më shumë studentë arbëreshë nga Italia, së pari, nga Universiteti i Kalabrisë, ku sapo ishte çelur edhe katedra e gjuhës shqipe nën drejtimin e të ndjerit dhe të nderuarit prof. Francesco Solano, pastaj edhe nga Universiteti i Palermos, më vonë edhe nga Instituti i Gjuhëve Orientale të Napolit dhe nga Universiteti i Romës.

Por, në ato vite, kanë ardhur gjithashtu grupe studentësh nga Franca, sidomos nga INALCO, qendër me të cilën Shqipëria ka pasur dhe ka edhe sot një marrëveshje

për shkëmbime mësimore dhe ka dërguar atje lektorë të shqipes për periudha të gjata kohore.<sup>174</sup>

Një punë e ngjashme në organizimin e kurseve të shqipes për të huaj kishte filluar në vitet '70 edhe në Prishtinë, ku mësimi i shqipes u gërshetua edhe me seminare e sesione shkencore albanologjike, duke u mëkëmbur kështu një institucion i ri siç është tashmë Seminari i Kulturës Shqiptare për të Huaj, që organizohet çdo vit nga 15 deri 30 gusht në Prishtinë. Data e fillimit të Seminarit të Prishtinës është gushti i vitit 1974 dhe, qysh atëherë, ka vijuar rregullisht të mbahet, qoftë edhe me ndonjë ndërprerje ose zhvendosje e vendit të organizimit, sidomos gjatë kohëve të vështira politike kur për disa vjet Seminari që transferuar në Tiranë, duke u organizuar në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shkencave.

Edhe në Prishtinë shkonin arbëreshë, ndonjëherë madje të njëjtët që merrnin pjesë atje, vinin edhe te ne, në kurset verore të shqipes për të huaj, porse në Prishtinë, duke qenë se Shqipëria i kishte prerë krejt marrëdhëniet me vendet e Lindjes, shkonin më shumë studentë rusë, polakë, bullgarë etj. të cilët nuk mund të shkelnin më në Tiranë për shkak të mbylljes sonë politike.

Në vitet '90, kur u bënë shndërrimet demokratike në Shqipëri, për disa vjet, gjatë periudhës kalimtare dhe të turbullirave që kaloi vendi ynë, ardhja e studentëve të huaj, qoftë edhe arbëreshëve, u mek aq sa, për disa vjet, vinte vetëm ndonjë person ose grup i vogël. Rikthimi i kurseve verore, si dhe përgjithësisht i kurseve të shqipes për të huaj në Universitetin tonë u bë mbas viteve 1999-2000, kur rifilluan të vijnë grupe studentësh nga Rusia, si dhe individë të ndryshëm nga Polonia, Bullgaria, Gjermania, Franca, Italia, Amerika etj. Janë shtuar tashmë edhe studentët nga Kina, kryesisht në kurset vjetore, si dhe për specializime.

Këto vitet e fundit, gjithashtu, ka filluar të dërgoj studentë në kurset e shqipes edhe Hungaria, sidomos me kujdesin e z. Istvan Schutz, njohës i dalluar i gjuhës shqipe, albanolog dhe përkthyes i njohur. Gjithashtu, viteve të fundit, janë shtuar e po shtohen edhe lektoratet ose qendrat universitare ku jepet gjuha shqipe, si p.sh. në IMH të Selanikut, ku mund të përmendim se krahas rusishtes, rumanishtes, serbishtes etj. mësohet edhe shqipja dhe, atje, vit për vit, japin provimin e gjuhës shqipe dhjetëra studentë e profesionistë që ua do puna të dinë shqipen. Vlen të përmendet aty puna e kujdeshme e dr. Stavri Dajos dhe e znj. Nadia Qirinxhi, veprimtaria dhe puna e kujdeshme e të cilëve ka kontribuar që të shtohet shumë interesimi dhe numri i grekëve që duan të nxënë gjuhën shqipe.<sup>175</sup>

Kohët e fundit, gjithashtu, janë dërguar lektorë të shqipes në Turqi, ku është çelur dega e shqipes në Universitetin Trakia të Edirnesë. Pra, sot Shqipëria ka këto lektorate të shqipes me lektorë shqiptarë (të dërguar nga departamenti i Fakultetit të Historisë dhe filologjisë, nga ndonjë universitet tjetër, ose të përzgjedhur vetë nga forcat intelektuale të diasporës shqiptare), në Kozencë, në Palermo, në Leçe, në Romë, në Napoli, në Paris, në Vjenë.

Këto vitet e fundit, gjithashtu, ka pasur edhe marrëveshje me Universitetin e Arizonës, ku është dërguar një lektor i shqipes për periudha të caktuara, si dhe kanë

<sup>174</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Kundërime gjuhësore*, Tiranë, 2006, f. 216-220.

<sup>175</sup> Gj. Shkurtaç, *Kundërime gjuhësore*, Tiranë, 2006, f. 216-220.

ardhur studentë të atij universiteti për të thelluar dijet e tyre të shqipes në Universitetin e Tiranës.

Ka të dhëna se një katedër e re e shqipes është çelur edhe në Grac të Austrisë, duke iu shtuar kështu qendrave ekzistuese albanologjike të Bonit, ku është Bardhyl Demiraj, të Mynihut (München) ku vijojnë nxënësit e Martin Camajt<sup>176</sup>.

Dega e albanologjisë në Universitetin Ludwig-Maximilian të Mynihut, e themeluar nga Martin Camaj, dega e albanologjisë është pjesë përbërëse e Institutit të Gjuhësisë Krahasuese-Indoevropiane, si edhe e Albanologjisë në LMU. Ajo përgatit, diplomon dhe doktoron albanologë të rinj, duke plotësuar formimin universitar dhe pasuniversitar të atyre studentëve që e përzgjedhin albanologjinë si degë plotësuese. E përfshirë në matriksin e sistemit universitar tradicional gjerman. Kjo e bën këtë degë të jetë unike në gjithë atë pjesë të arealit shkencor albanologjik që shtrihet jashtë hapësirës kompakte shqipfolëse në Ballkan, sipas Prof. Demirajt, drejtuesit të saj.

Duke qenë degë e vetme në Evropën Perëndimore, ajo ka shërbyer edhe si një pikë, e cila ka thithur shumë studentë, bursistë dhe studiues (deri sot nga 15 vende të ndryshme të Evropës) për t'u specializuar pranë saj. Në bashkëpunimin e saj me qendrat e tjera albanologjike në Itali (Cosenza, Palermo, Napoli), Kosovë (Prishtinë), Shqipëri (Shkodër, Tiranë, Elbasan), Rusi (St. Petersburg), Maqedoni (Tetovë), Bullgari (Sofie) etj., ajo ka dhënë frytet e veta në botimet cilësore, tubimet kulturore-shkencore dhe shkëmbimet e studiuesve.

#### **V.4. Shkolla shqipe në Zvicër - Mësimi plotësues ose ruajtja e shqipes përmeshkrimit**

Për sa i përket nivelit të ruajtjes së gjuhës për aktivitetin e tyre kulturor dhe shoqëror, në të cilin pasqyrohet e gjithë vetëdija kombëtare, për ruajtjen e shqipes përmes shkrimit, një vend të veçantë në diasporën shqiptare në Zvicër zë organizimi i mësimit plotësues të gjuhës shqipe. Shqiptarët e Kosovës në mërgim me gjithë fatkeqësinë e atdheut, të robëruar, u përpoqën që krahas integritit në shoqërinë zvicerane të ndërtojnë imazhin e mirë të kombit nëpërmjet gjuhës shqipe, kulturës, historisë dhe vlerave të pasura tradicionale. Me gjithë “pësimet” ata arritën të krijojnë shkollat e mësimit plotësues të gjuhës shqipe<sup>177</sup>.

Arsimi shqip është pjesë e arsimit të përgjithshëm, një institucion shoqëror mjaft i rëndësishëm, i cili luan rol vendimtar në përmirësimin e të folmeve të shqipes në përgjithësi dhe afrimin me normën e standarde. Pavarësisht nga mosha, përkatësia gjinore etj, apo dhe nga elemente të tjera të rëndësishme jashtëgjuhësore, ky është një kriter i padiskutueshëm, mjaft i rëndësishëm në krijimin e diferencave të sjelljes gjuhësore të individit. Për shembull, diferencat në ligjërimin e një folësi që ka ndjekur mësimin shqip dhe atij që shqipen e ka mësuar vetëm në gjirin familjar, si dhe prej miqve e shokëve janë të dukshme.

<sup>176</sup>Shih: Gj.Shkurtaj: *Kurset e gjuhës shqipe për të huaj dhe katedrat e shqipes në Itali, Greqi,Rusi etj.*,në “Kundrime gjuhësore”, Pegi,Tiranë, 2006, f.216.

<sup>177</sup> NexhmijeThaçi Mehmetaj, *Përvoja dhe njohuri në lidhje me ruajtjen humbjen e kompetencave gjuhësore të shqipes në Zvicrën frëngjishtfolëse*, kumtesë e mbajtur në 7 qershor 2013 në Cyrih.

Folësit që kanë ndjekur mësimin në shqip e që zhvillojnë kompetencat e tyre në të folur dhe të shkruar, do ta pasurojnë fjalorin e tyre gjithashtu kanë prirje të rregullojnë format e parregullta të dialektit të tyre. Ata përmirësojnë formën që përkon me standardin, përvetësojnë të folmen e tyre sipas normave të shqipes së përgjithshme. Pasuron më tepër fjalorin, komunikon lirshëm, aftësohet të flas rrjedhshëm dhe të jetë i kuptueshëm si në familje dhe nga shokët e shoqet e tij. Roli i mësimin shqip është i pashmangshëm edhe në të folmen e adoleshentëve shqipfolës. Tek ata fëmijë që nuk vijnë në mësimin vërehen shumë dukuri që i përkasin të folmes së frëngjishtes, ndërsa adoleshentët e arsimuar në shqip janë zbatues më të mirë të normës letrare.

Ata fëmijë që nuk vijnë në mësimin shqip, por që e flasin ashtu si e flasin shqipen, kanë të meta në shqiptim të disa tingujve të shqipes : sh, q, rr, c, ç, xh etj dhe të fjalëve tri e katër rrokëshe, shmangie nga norma letrare, dhe në fund të fundit, ata janë imitues qoftë edhe të disa formave të parregullta të dialektit që mësojnë në shtëpi ose prej shokëve e miqve.

Le të shtojmë edhe një fakt, në një vështrim më të thelluar, ruajtja e gjuhës shqipe, është ngushtësisht e lidhur me pasjen e kulturës shqiptare, vlerën e çmuar që ka ajo sot, e jo vetëm atë historik, të së shkuarës, por ende të vlefshme edhe në këtë botë të globalizuar që kërkon të fshijë pamëshirshëm, atë që nuk sjellë leverdi ekonomike. Ruajtja e gjuhës shqipe me fjalë të tjera qëndron te mirëqenia e tij e brendshme, kultura e tij e pasur.

Nuk ka asnjë dyshim se gjuha shqipe mundësitë më të mëdha të ruajtjes dhe pasurimit i gjen pikërisht në shkollën e mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kjo duke u ndihmuar nga familja. Një rol të rëndësishëm kanë gjithashtu lidhjet me atdheun, shtypin, mediat elektronike, internetin, qendrat kulturore, shoqatat, veprimtaritë artistike e kulturore, të cilat do të sigurojnë një prani gjithnjë e më të gjerë në vendet ku jetojnë shqiptarët jashtë atdheut.

Aktualisht mësimdhënia e gjuhës shqipe ka një traditë dhe vazhdon të luaj rolin e saj në Zvicrën frëngjisht folëse në këto qendra: Gjenevë, Vaud, Jura, Valis, Neoshatel, Bern, Friburg. Por nëse karahasojmë numrin e nxënësve në vite shkollore në 1995/ 96 kanë qenë 6.295 mijë nxënës, ndërsa aktualisht janë 2500 në nivel shteti, shihet qartë numri i nxënësve është dukshëm në rënie.

Fëmijët që vijnë për të mësuar gjuhën shqipe, shumica janë folës burimor të shqipes të lindur në Zvicër, një gjuhësh me dy prindër shqiptarë, por që rriten në kushtet e dygjuhësisë së mërgimit duke u shndërruar gjuha shqipe në mjetin e përdorur vetëm në familje si një vlerë e dorës së dytë, ndërsa frëngjishtja gjuhë e shkollës dhe më vonë e punës apo e bukës.

Marrëdhëniet martesore midis shqiptarëve dhe grupeve të tjera etnike vinë duke u shtuar. Për të mësuar shqipen vijnë edhe nxënës me familje dygjuhëshe fëmijët shqiptaro-zvicranë, ose siç e quajnë vetën “cinquante - cinquante” /pesëdhjetë – pesëdhjetë/ fëmijë me familje të përziera, me baballarë shqiptarë dhe nëna zvicerane në të shumtën e rasteve ndonjëherë italiane, apo turke. Kohëve të fundit, nxënës me baballarë të bashkësisë pritëse dhe nëna shqiptare.

Ata janë nga anë të ndryshme të Kosovës dhe trojeve të tjera shqiptare. Shtrirja gjeografike e të folmeve të nxënësve në Kantonin Jura përfshinë të folmet e hapsirës gjeografike të Rrafshit të Kosovës, në veçanti të folmet e Anamoraves. E folmja e Moravicës, Preshevës dhe Medvegjës, të folmet e Rrafshit të Dukagjinit me të folmen e Deçanit dhe Pejës. Një numër i nxënësve flasin të folmen e Tetovës.

Ndonëse të folmet e gegërishtes nuk kanë dallime të mëdha ndërmjet tyre, megjithatë

ato dallohen me disa karakteristika. Vërejmë një përzirje ndërdialektore në kontakt, por njëkohësisht shqipja do të ballafaqohet edhe nga ndikimi i frëngjishtes por me orientimin nga gjuha standarde. Mendojmë, se ruajtja është një tipar, i cili kryekëput i bashkon në një emërues të përbashkët të gjitha këto të folme.

### V.5. Hapësira të reja të shqipes në mjediset greke

Kohët e fundit, në kuadër të shtimit të pranisë numerike të shqiptarëve në Greqinë fqinje, krahas nismave të tjera të bashkëpunimit ndërshtetëror në lëmin e kulturës, të shkencës e të artit, ka pasur edhe shtim të interesit dhe të hapësirave për gjuhën shqipe në universitetet greke dhe në institutet e gjuhëve të huaja në Greqi.

Tashmë në Greqi ka disa katedra dhe lektorate të gjuhës shqipe, si në Janinë, në Follorinë, në Selanik etj. Një punë të vijueshme ka bërë sidomos Instituti i Gjuhëve Ballkanike (*Institut for Balkan Studies*) në Selanik, me drejtor Jannis Murelos dhe president dr. Vasilios Kondis. Instituti është krijuar më 1963 dhe, qysh atëherë, aty janë shtuar gjuhët ballkanike që studiohen e ndiqen nga shumë njerëz të interesuar. Aty mësohen serbishtja, bullgarishtja, rusishtja, rumanishtja dhe, tashti së fundi, edhe shqipja.

Për herë të parë në vitin akademik 2003-2004 u realizua edhe marrëveshja zyrtare midis atij Instituti dhe Universitetit të Tiranës (Departamenti i Gjuhës Shqipe i Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë), sipas së cilës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë dhe Shkolla e Gjuhëve Ballkanike e IMHA-së, bashkëpunojnë në mësimdhënien e gjuhës shqipe, si gjuhë e huaj dhe të gjuhës greke për studentët shqiptarë, duke ndihmuar në mënyrë të ndërsjellë me tekste, mjete didaktike dhe udhëzime metodike.

Të dy palët do të bashkëpunojnë për organizimin e studimeve shkencore, në krijimin e programeve të përbashkëta kërkimore dhe shkencore dhe në shkëmbimin e pedagogëve, studiuesve dhe studentëve. Në një nga nenet e marrëveshjes parashihen edhe masat konkrete për organizimin e provimeve sipas niveleve përkatëse të studentëve që ndjekin mësimin e gjuhës shqipe në kurse të rregullta vjetore që organizon IMHA-ja. Provimet (me shkrim dhe me gojë) kryhen nga një komision i përzier, në të cilin marrin pjesë pedagogë nga të dyja palët.

Departamenti i Gjuhës Shqipe i Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, sipas marrëveshjes në fjalë, përgatit edhe dëshminë përkatëse dhe ua dërgon fituesve brenda një periudhe trijavore pas dhënies së provimit. Lektorë të shqipes në IMHA janë Dr. Stavri Dajo dhe zonja Nadia Qirinxhi, të cilët, me punën e tyre të përkushtuar, kanë bërë të mblidhet një numër përherë e më i madh studentësh grekë që dëshirojnë të mësojnë gjuhën shqipe. Në vitin 2014 u zgjerua dhe tani në Universitetin e Selanikut është hapur një katedër e shqipes dhe është dërguar nga Universiteti i Tiranës një pedagoge e gjuhës shqipe.

Në vitin 2014, kjo hapësirë u zgjerua dhe tani në Universitetin e Selanikut është hapur edhe një katedër për mësimin e gjuhës shqipe dhe është dërguar edhe një pedagoge e gjuhës shqipe nga Universiteti i Tiranës, e cila ka filluar nga puna.

Një hapësirë tjetër e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve tona të lartpërmendura do të jetë edhe pjesëmarrja e studentëve grekë në kurset verore të gjuhës shqipe, që organizohen çdo vit në muajin shtator për të huajt që vijnë nga vise të ndryshme të botës. Po ashtu, një numër i mirë studentësh shqiptarë ndjekin në Tiranë degën e filologjisë dhe të gjuhës greke të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, duke e shtuar dukshëm numrin e njohësve të asaj gjuhë dhe, natyrisht, ata do të jenë nga më të

dëshiruarit për të shkuar në Greqi për kurse specializimi në kuadrin e marrëveshjeve dypalëshe që ekzistojnë dhe që mund të zgjerohen më tej.

Prania e shqiptarëve në Greqi është tashmë një realitet me të cilin, *least but not least*, grekët tashmë janë mësuar dhe përditë e më shumë po e pranojnë atë si një pjesë të jetës e të realitetit të sotëm jetësor e kulturor të tyre. Aq shumë shqiptarë ka sot në Greqi, saqë edhe bankat, kohët e fundit, janë detyruar të “flasin” edhe shqip. Në sportelet e shërbimit bankar me kartë krediti, të bën përshtypje se tashti, krahas pyetjeve në greqisht dhe anglisht të shfaqet edhe pyetja në gjuhën shqipe. (Ja disa nga fjalët dhe shprehjet shqip që përdoren në pikat e shkëmbimeve automatike me kartë krediti të Bankës Kombëtare të Greqisë:

çgjuha] –*Shqip / Eliniká*

*Llogari rrjedhëse / Llogari arke*

Lutemi formoni PIN tuaj

*Në rast gabimi shtypni Dhióρθosi – Clear*

---

*Doni koha? çsic] Po / Anullim*

---

*Lutemi zgjidhni shkëmbimin që dëshironi.*

Prania e konsiderueshme e emigrantëve, që u ka ndezur ylli i biznesit dhe kanë fituar emër të mirë në mjediset e sipërmarrësve të atjeshëm, ka bërë që tashmë edhe në mediat elektronike dhe në shtypin e shkruar grek të ketë hapësira përherë e më të gjera publiciteti (reklamat) në gjuhën shqipe. Kjo është një dukuri e re që tregon se forca imponuese e punës së ndershme, dalëngadalë, triumfon mbi paragjykimet dhe qëndrimet e vjetëruara antishqiptare. Po ashtu edhe në lëmin e artit. Ka pasur edhe filma me tematikë nga jeta e shqiptarëve në Greqi, po edhe të prodhuara nga producentë shqiptarë dhe grekë.<sup>178</sup>

---

<sup>178</sup> Po ai, po aty,

## PËRFUNDIME

1. Këtë temë “Gjuha dhe identiteti i shqiptarëve në integrimin evropian” e zgjodhëm për arsye, se larmia e gjuhës dhe zhvillimi i saj në rrjedhë të kohës, po edhe në varësi nga kushtet historiko-shoqërore dhe faktorët e tjerë jashtëgjuhësorë, paraqesin interes dhe vlera njohëse. Gjithashtu, aktualiteti që paraqet trajtimi i temave të tilla bashkëkohore e të lidhura aq ngushtë me kahet e zhvillimet e sotme të shqiptarëve dhe të kulturës së tyre, rrjedhimisht edhe të gjuhës e ligjërimit të shkruar e të folur në hapësirat shqiptare, është një tjetër arsye e përzgjedhjes sonë.

Ideja e globalizimit është e lidhur me zgjerimin e hapësirave të komunikimit midis njerëzve, duke shpërfillur e tejkaluar ndarjet e moçme gjeopolitike, etnike dhe kulturore. Globalizmi është term, kuptimi i të cilit nuk është i qartë aq sa duhet, prandaj edhe ekzistojnë dallime të mëdha mes autorëve reth përkufizimit të tij. Disa e shohin si një proces, i cili çon drejt bashkimit të njerëzve, shteteve dhe kulturave të ndryshme, si një proces, i cili synon ta shndërrojë botën në një “fshat global”, fshat të vogël, ku të gjithë do të jetonin në marrëdhënie shumë të mira ndërshtetërore. Në qoftë se do të kishte ekzistuar një kuptim i vetëm për globalizimin, atëherë ai do të ishte “integrim në nivel botëror”.<sup>179</sup>

Autorë të tjerë, e shohin si proces që mundëson lidhjen e njerëzve nga mbarë bota dhe krijimin e përfitimeve për të gjithë, ndërsa disa të tjerë që janë më tepër kundër globalizimit, e shohin si proces që individëve dhe shteteve të pasura ju mundëson të pasurohen edhe më tepër në kurizim e të varfërve. Në një farë mënyre, globalizimi i kulturës do të thotë universalizim dhe, së këndejmi, edhe sinkretizim e madje unifikim ose uniformizim.<sup>180</sup>

Kjo është arsyeja që, në shumë vende të botës, ka pasur e vijon të ketë dy rrjedha; njëra, që e dëshiron, e përkrah dhe e mbështet fuqishëm globalizimin në shkallë botërore (sikundër na e thotë edhe vetë termi që përmban rrënjën “glob” (rruzull, univers), duke vlerësuar të mirat që sjell një jetë ekonomiko-shoqërore dhe kulturore e përfshirë nga kahet e reja dhe modernizimi i sotëm; kurse tjetra, që e kundërshton me forcë globalizimin, duke parë tek ai një armik të etnive dhe të kulturave të popujve të vegjël.

Së këndejmi vijnë me denduri edhe fjalë e terma të përdorshme në Bashkimin Evropian e më gjerë, ku shquajnë, sidomos, fjalë që fillojnë me parashtesat *-inter*, *anti-*, *super-*, *multi-*, *pluri-* etj, si: *interkultural*, *interetnik*, *internacional*; *antidemokratik*, *antinjerëzor*, *antitank*, *antiamerikan*, *antishqiptar*; *supernjeri*, *superfuqi*, *supermiliarder*; *multietnik*, *multilinguizëm*, *multifunksional*, *multivitamin* etj; *pluralitet*, *pluralizëm*, *pluridimensional*; *sporti multietnik*, *hoteli multietnik*, *shtet multietnik*, *fshat multietnik* etj.

2. Mund të themi se globalizmi ngjan me udhët e mëdha të tipit të autostradave, që presin drejt e shpien larg, që nuk pyesin për asnjë pengesë dhe ngrenë ura apo çelin tunele madhështore për të mos e penguar mbërritjen e shpejtë në desitacion nga një vend në tjetrin, duke pasur si motiv themelor pragmatizmin dhe lehtësitë që krijohen nga bashkimi i hapësirave aq të mëdha në të njëjtin qëllim. Përkundrazi,

<sup>179</sup> Shih: Etem Aziri, “Sociologjia”, f. 425

<sup>180</sup> Shih: Etem Aziri, “Sociologjia”, f. 425

antiglobalistët janë për të mbetur edhe më tej në ndarjen dhe kufijtë tradicionalë të hapësirave gjeopolitike, kërkojnë të ruhen tiparet dalluese të çdo etnie e kombi, nuk e shohin për mbarë as uniformizimin, as njësimin e konformizimin, që synohet në një botë të re, pa kufijtë e ndarjet e vjetra, e projektuar duke pasur si synim një jetë më të mirë për të gjithë globin e për ta konsiderar njeriun si qytetar të botës, si qenie që i jepen mundësi dhe hapësira të njëjta kudo që të shkojë, pavarësisht nga kombësia apo etniciteti i origjinës. Duhet të themi se një ide e globalizmit ka qenë shprehur qysh në kohët e lashta në maksimën " *Ubi bene, ubi patria*" (Aty ku është mirë, aty është atdheu), porse ajo ka pasur edhe shumë kundërshtime nga pikëpamja e atdhetarizimit. E kundërt me të ka qenë fjala e urtë: " *Guri i rëndë në vend të vet*".

3. Globalizimi prek, në radhë të parë, fushat që janë më të afërta me politikën, si: ekonominë, marrëdhëniet publike dhe marrëdhëniet me jashtë, krejt sistemin e komunikimeve me shkrim e me gojë dhe, në këtë kuadër të gjerë, më shumë ndikon edhe në procesin e marrëdhënieve ndërgjuhësore, të cilat, në qoftë se deri vonë ndiqnin kryesisht sistemin e kalimeve binare (ose të ndikimeve të ndërsjella nga një kulturë në tjetrën, përkatësisht nga një gjuhë në tjetrën), tani, krahas kësaj udhe që mbetet edhe më tej, prirjen të ndjekin edhe udhën e ndërkëmbimeve të shumëfishta.

Është e qartë, pra, se po del në plan të parë procesi i globalizimit, të cilin ndoshta për ta pasur më të qartë mund ta thoshim me një fjalë tjetër shqipe, procesi i botërorizimit, që kalon së pari nëpërmjet procesit tashmë të njohur të evropianizimit. Ne synojmë me shumë zell "të hyjmë në Evropë", porse kjo duhet kuptuar si hapi i parë drejt hyrjes në Botë, duke e kuptuar këtë si hyrje a përbashkim me mbarë rruzullin a globin.

4. Evropianizimi dhe botërorizimi i kulturës shfaqet dukshëm edhe në gjuhë, në stilin e të shkruarit dhe të folurit, në etnografinë e sjelljes dhe në etnografinë e komunikimit, pra, edhe në gjuhën e shkruar e të folur.

Njohja dhe studimi i thelluar i gjuhës shqipe, në takim me gjuhët e huaja fqinje dhe me gjuhët e Evropës, sidomos me anglishten, po edhe në hapësirat e diasporave të hershme e të sotme arvanite (në Greqi), arbëreshe (në Itali), arnaute (në Turqi, Bullgari, Ukrainë) dhe në qytetet e mëdha të Evropës e deri në Amerikë, qoftë për vlerat e ditura si shqipe e shkëputur herët nga trangu amtar, qoftë për ndikimin që kanë pësuar prej pesë shekujve nga gjuhët e huaja të vendeve përkatëse ku janë shpërngulur (nga greqishtja, italishtja, turqishtja, bullgarishtja, ukrainishtja; në shekujt e fundit edhe nga anglishtja në diasporën shqiptare të Amerikës etj.), pastaj edhe nga rrjedhat e zhvillimeve të sotme, kanë rëndësi shkencore të shënueshme.

5. Globalizmi është një dukuri, që prek në thellësi edhe proceset gjuhësore. Shpesh, duke përmendur këtë koncept, mendja na shkon tek "hegjemonia" e anglishtes e cila, në kuadrin e një "lingua franca" po shtrihet shumë shpejt në botë, duke ndikuar ndjeshëm mbi gjuhët vendase në Evropë e më gjerë, në mbarë Botën. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për shqipen, ku huazimet nga anglishtja duket se po perceptohen si një normalitet për shkak të fluksit të dendur e të papërbalueshëm të tyre. Megjithatë, globalizmi nuk mund të reduktohet thjesht në fjalë e struktura të huazuara nga anglishtja; ai depërton më thellë në psikikën e popujve, prek marrëdhëniet e tyre, të cilat, sigurisht, reflektohen edhe në gjuhë.

Konteksti global dhe proceset integruese po mishërohen në sistemin e shqipes, po orientojnë modelet e komunikimit të shqiptarëve, prandaj edhe pasojat e tyre në gjuhën shqipe janë të dukshme.

Së pari, ndryshime vihen re në ligjërimin publik (si në formë, edhe në përmbajtje), në zhanret dhe stilet e përdorura, ku ndihet bindshëm ndikimi i gjuhëve të huaja, kryesisht i anglishtes. Ky ndikim reflektohet në fjalor, në struktura gjuhësore të huazuara, në modelet e ndjekura për hartimin e raporteve, kërkesave, projekteve të shkruara, kjo për arsye të bashkëpunimit me organizata, institucione dhe partnerë të huaj. Madje, jo të rralla janë rastet kur edhe vetë komunikimi / dialogimi kryhet tërësisht në anglisht. Mjaft të përdorshme në këtë lloj kontesti janë huazime leksikore e strukturore si: *implementim projekti, ndërtim i kapaciteteve, resurse humane / natyrore; partnership; investime publike, workshop-e* etj.

6. Studimi ynë synon të jetë hulumtues, rreth gjuhës së shkruar dhe ligjërimeve të folura të shqipes në hapësirat shqiptare ballkanike dhe në diasporë, duke kundruar si është përdorur ajo në kontekste të ndryshme, sa më të larmishme dhe me mundësi për të parë në rrafsh të ndryshme, se si shkallëzohet pragmatikisht gjuha e shkruar dhe e folur nën gjykimin e bindjes, duke u pykëzuar në fusha të komunikimit, duke pasur si objekt dhe synim kryesor të studimit: “Gjuha e zemrës” dhe “gjuha e bukës” sipas studimeve të reja të sociolinguistikës së sotme.

7. Studimi ynë vjen si thellim e mbështetje e fushës “Qytetërimi në simbiozë e gjuhë në kontakt” dhe, në vijim të shtjellimeve që janë bërë në boshtin “përplasja e qytetërimeve” të formuluar prej Hantingtonit, si dhe të sociologëve të tjerë në fundshekullin XX, në mijëvjeçarin e ri kërkojnë edhe hetime konkrete në aspektin sociolinguistik të proceseve të lidhura me emigrimin dhe imigrimin.

Mbi bazën e mundësive të sotme për hulumtime, do të ndiqen dy drejtime vëzhgimesh e analizash gjuhësore: të shqiptarëve që ua do puna t’i mësojnë gjuhët e huaja, duke emigruar në Evropë (Itali, Greqi, Zvicër, Gjermani, Angli etj.), por edhe të evropianëve që, qoftë edhe në sasi më të vogla, jetojnë në Shqipëri e janë në kushte simbioze.

Një shqyrtim i tillë në aspektin sociolinguistik dhe etnolinguistik mendojmë se mund të japë rezultate të rëndësishme për njohjen e ecurisë dhe shkallëzimit që ndjek sot procesi i dygjuhësisë dhe i shumëkulturalizmit shqiptaro-evropian.

8. Emigrantët shqiptarë në diasporat e hershme arvanite, arbëreshe dhe shqiptare të fundshekullit XX dhe të dekadave të para të mijëvjeçarit të ri, përbëjnë një network të konsiderueshëm dhe një aspekt interesant të njohjes së simbiozës së qytetërimeve të pranëvëna dhe gjuhëve në kontakt, kurdoherë nëpërmjet depërtimit në proceset e kalimit, prej sociolekteve një gjuhëshe arbëreshe e shqiptare, në sociolekte dygjuhëshe, së pari, vetëm me dygjuhë si ose nxënie gjuhe “nga jashtë”, pastaj në diglosi e dygjuhësi të realizuar e të mbështetur në dykulturorësi e në ndërthurjen e qytetërimeve në simbiozë.

Bashkësitë njëgjuhëshe po pakësohen dhe, kudo në Evropë, po edhe më gjerë në botë, përzierjet etnike janë shtuar dukshëm dhe problemet e tyre nuk mund të zgjidhen vetëm me domosdoshmërinë që ndjenë ata për të nxënë gjuhën e mjedisit.

Në kuadrin e simbiozës me vendasit dhe me ardhës prej etnish të ndryshme, një gjuhësia do të plekset gjithmonë e më shumë me dygjuhësinë e diglosinë, nëpërmjet dykulturorësisë e qasjes së qytetërimeve në takim. Jo vetëm në fillimet e emigracionit,

por edhe për shumë vjet më vonë, ndoshta edhe për dekada të tëra, emigrantët do të jenë nën dy trysni a kahe emocionale dhe gjuhësore: midis “gjuhës së bukës” dhe “gjuhës së zemrës”.

**9.** Në kushtet kur shoqëritë po bëhen gjithmonë e më të hapura, pikëtakimet e shpeshta mes njerëzve që u përkasin etnive, besimeve fetare, klasave shoqërore të ndryshme kanë lindur nevojën për të studiuar elementet-çelës të komunikimit, për të arritur mënyrë më efektive të të folurit dhe të dëgjuarit, kuptim më të qartë të partnerit, zgjidhje më të shpejtë të konflikteve, përmirësim të komunikimit prindër-fëmijë.

Me shumë rëndësi janë sot situata e ligjërit në rastet e fëmijëve të emigranteve shqiptare, të martuara me qytetarë evropianë: italianë, gjermanë, zviceranë, belgë, francezë, anglezë etj. (dhe anasjelltas: të meshkujve shqiptarë të martuar me joshqiptare).

**10.** Ky studim do t’u vijë në ndihmë jo vetëm studiuesve dhe studentëve, për t’u ofruar atyre një bazë të mirë teorike dhe praktike në lidhje me dygjuhësinë dhe dykulturorësinë e shqiptarëve, por edhe sociologëve e politologëve, duke qenë se në kohën tonë, kudo në Evropë, po bëhen përpjekje të vazhdueshme për të vënë në jetë politika integruese të atilla që, nëpërmjet dygjuhësisë dhe dykulturorësisë, të realizohet sa më mirë simbioza e popullsive etnikisht të ndryshme, të pranëvëna në mjedise të përbashkëta.

Në këtë botë të re, ku shihet qartë se shoqëritë joperëndimore gjithnjë e më tepër ngulitin vlerat e tyre kulturore dhe hedhin poshtë ato të imponuara nga Perëndimi, vihet re një risi që politologët e përkufizojnë duke u nisur nga dy polet e politikës së sotme botërore, politika vendore (lokale) dhe rruzullimore (globale), ose lokalizmi dhe globalizmi; le ta themi këtë me fjalët e një politologu të famshëm: “...në këtë botë të re, politika lokale është politikë e etnicitetit, politika globale është politikë e qytetërimeve. Rivaliteti ndërmjet superfuqive është zëvendësuar nga përplasia e qytetërimeve”<sup>181</sup>.

Diplomatët, biznesmenët, shkencëtarët, turistët dhe shërbimet që bëhen për ta, pilotët e linjave ajrore e kontrollorët e qarkullimit kanë nevojë për një mjet komunikimi të frytshëm me njëri-tjetrin. Sot për këtë shërben kryesisht anglishtja, pra, në një farë mënyre, jemi në atë raport që ishte *latinishtja* në periudhën klasike dhe mesjetare, *frëngjishtja* për disa shekuj në Perëndim, *swahili* në shumë pjesë të Afrikës. Këtë rol të një *lingua franca* e ka marrë anglishtja në gjysmën e dytë të shek XX dhe, siç po duket, do të vijojë me hapa e ritme më të shpejta në mijëvjeçarin që sapo ka filluar.

**11.** Evropianizimi dhe botërorizimi i kulturës shfaqet dukshëm edhe në gjuhë, në stilin e të shkruarit dhe të të folurit, në etnografinë e sjelljes dhe në etnografinë e komunikimit, pra edhe në gjuhën e shkruar e të folur. Njohja dhe studimi i thelluar i gjuhës së brezit të ri a më saktë të fëmijëve të emigrantëve shqiptarë në Itali, qoftë për vlerat e ditura si shqipe e shkëputur nga trangu amtar, qoftë për ndikimin që po pësojnë nga italishtja, ka rëndësi shkencore.

Shpesh, duke përmendur këtë koncept, mendja të shkon tek “hegjemonia” e anglishtes, e cila, në kuadrin e një ‘lingua franca’ po shtrihet shumë shpejt nëpër botë,

<sup>181</sup>S.P Huntington, *Përplasia e qytetërimeve*, Përkthyer nga anglishtja, Logos-A 2004, f, 22

duke ndikuar ndjeshë mbi gjuhët vendase. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për shqipen, ku huazimet nga anglishtja duket se po përceptohen si një normalitet për shkak të fluksit të dendur e të papërbalueshëm të tyre.

**12.** Shoqëria shqiptare, gjatë dekadave të fundit, është gjendur para ndryshimesh të shumta politike, shoqërore, kulturore, demografike etj. Në qendrat më të mëdha qytetare (urbane) vërehet shtim dhe përqëndrim mjaft i madh i popullsisë. Përkatësia e origjinës së tyre gjeografike nuk përputhet më plotësisht me karakterizimin gjuhësor të para 20 viteve. Shndërrimet e mëdha shoqërore dhe ekonomike, si edhe marrëdhëniet e afërta me kulturat dhe gjuhët e popujve të tjerë kanë sjellë ndryshime të dukshme edhe në sjelljen gjuhësore të shqiptarëve në mbarë hapësirat e Republikës, po edhe më gjerë, sidomos në hapësirat kombëtare shqiptare, në trojet kompakte ballkanike, madje, deri në diasporat e hershme historike ende shqipfolëse (përkat. arvanite /arbërore, arbëreshe, arbneshë, arnaute etj.).

Hapja e Shqipërisë dhe e hapësirave të tjera etnike shqiptare ndaj botës dhe, sidomos, ndaj Evropës, shtimi i pakufizuar tashmë i shtegtimin fizik dhe virtual të njerëzve dhe të informacioneve e botimeve, kuptuar kjo: e fjalës së shkruar dhe të folur, e gjuhëve dhe e kulturave të ndryshme në shkallë evropiane e, me kohë, edhe ndërplanetare, edhe pse i shumëpritur e i mirëseardhur jo vetëm politikisht, po edhe kulturalisht, nuk mund të mos sillte me vete, krejt natyrshëm, edhe trysinë e sistemeve të ndryshme nga ai i shqipes, mbi shqipen e shkruar, po edhe mbi formën e saj të folur.

Edhe në Shqipëri po ndihet ndikimi i globalizimit dhe kjo në radhë të parë shprehet me animin e fortë nga anglishtja, anim që të kujton pemët e larta që epohen e shkojnë andej nga fryn era; por procesi i globalizimit duhet kuptuar jo vetëm si arë e mbjellë që e zë breshri dhe bën kërdrinë mbi të, por edhe si përpjekje për ta ruajtur gjuhën nga asimilimi dhe për ta rreshtuar shqipen me dinjtet krahas gjuhëve të tjera evropiane.

**13.** Ne, si popull, sikundër është theksuar edhe nga korifejtë më të mëdhenj të albanologjisë, si A. Buda, E. Çabej etj. jemi pjesë e familjes evropiane, por të jesh pjesë e kësaj familjeje të madhe nuk do të thotë harrim i vetvetes, nënshtrim ndaj ndonjë gjuhë tjetër, qoftë ajo edhe anglishtja, që shumëkush e quan sot “gjuha e botës”.

Në këtë bashkësi qytetërimesh ne duhet të futemi, në radhë të parë, me identitetin tonë kulturor e kombëtar. Gjuha është pjesë themelore dhe shprehësja më e dukshme e këtij identiteti, tipari dallues më kryesor i mbijetesës sonë si komb.

**14.** Gjuhët e Bashkimit Evropian janë gjuhë që përdoren nga njerëz brenda shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Ato përfshijnë 23 gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian. BE-ja pohon se ajo është në favor të larmisë gjuhësore dhe aktualisht ka një Komisioner Evropian për shumëgjuhësinë, Leonard Orban.

Në Bashkimin Evropian, politika gjuhësore është përgjegjësi e shteteve anëtare. BE nuk ka një politikë të përbashkët për gjuhën, institucionet e Bashkimit Evropian luajnë rol mbështetës në këtë fushë, të bazuar në parimin "e subsidiaritetit". Roli i tyre është për të nxitur bashkëpunimin në mes të shteteve anëtare dhe për promovimin e dimensionit evropian në vendet anëtare të politikave gjuhësore. BE-ja inkurajon të

gjithë qytetarët e saj të flasin në shumë gjuhë, veçanërisht, inkurajon ata të jenë në gjendje të flasin dy gjuhë përveç gjuhës së tyre amtare.

**15. Statusi i shqipes në Republikën e Shqipërisë dhe në hapësirat shqiptare në Ballkan e më gjerë.** Sot shqipja flitet në Shqipëri, në Kosovë, në Luginën e Preshëvës, në trojet shqiptare në Mal të Zi, në Maqedoninë Perëndimore, në Çamëri dhe në hapësirat veriore të Greqisë rreth Kosturit. Flitet shqipja edhe në diasporat e moçme arbëreshe në Greqi (*arvanitika*): si në Atikë, në Eube, në Pelepones dhe në ishujt Andros, Specë, Salaminë, Hidra, Poros, Luca etj.; në Itali shqipja, e quajtur *arbëresh* ose *arbërisht*, flitet në Kalabri, në rreth njëzet ngulime kryesisht rreth qendrave të Kozencës, Katanzaros e Krotones; në krahinën e Abruzzos (rreth Peskarës), në krahinën e Bazilikatës (me qendër Potencën), në krahinën e Kampanias (me qendër Avellinon); në Molize (rreth Kampobasos), në Pulia (rrethet e Foxhës, Tarantos) dhe në Sicili (krahina e Palermos). Shqipja ruhet dhe flitet edhe në Arbënesh të Zarës (Dalmaci), në Bullgari (katundi Mandricë), në Ukrainë (disa ngulime rreth Odesës). Shqiptarë ka edhe në Turqi, në Siri, në Egjipt, në Belgjikë dhe në tërë Evropën Perëndimore, Gjermani, në Belgjikë, në Zvicër, në Rumani, në Suedi, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada, në Australi etj., pa përmendur ngulime ose grupe të vogla arbëreshësh e shqiptarësh edhe në shumë vende të tjera të botës, pothuajse në krejt rruzullin tokësor.

Kudo që është ruajtur gjuha e tyre e hershme, arvanitët a arbërorët, arbëreshët (ose arbëneshët), arnautët, arbanasit flasin shqip, natyrisht në forma dialektore të dallueshme nga shqipja e Shqipërisë së sotme dhe e trojeve shqiptare kompakte ballkanike, por në thelbin e vet të njëjtë dhe etnikisht e kombëtarisht të cilësuar si të tillë: *arvanit, arbëresh, arbnesh, arbanas, arnaut*.

**16.** Gjuha shqipe është gjuhë indoevropiane që flitet në Shqipëri, Kosovë, Republikën e Maqedonisë, Serbinë jugore dhe nga shqiptarët etnikë në pjesë të tjera të Ballkanit jugor. Gjuha shqipe flitet gjithashtu edhe përgjatë bregdetit lindor të Italisë dhe në Sicili, në jug të Greqisë si dhe në Gjermani, Suedi, Shtetet e Bashkuara, Kanada, Ukrainë dhe Belgjikë Shqipja është një ndër gjuhët moderne që përfaqëson një degë më vete në familjen e gjuhëve indoevropiane.

Shqipja flitet sot nga më se gjashtë milionë vetë në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë, në viset shqiptare të Maqedonisë, të Malit të Zi, të Serbisë jugore, si dhe në viset e Çamërisë në Greqi. Shqipja flitet gjithashtu, në ngulimet shqiptare në Itali, në Greqi, në Bullgari, në Ukrainë, si dhe në shqiptarë të mërguar në viset e ndryshme të botës para Luftës së Dytë Botërore dhe në këtë dhjetëvjeçar in e fundit.

**17. Gjuhët kombëtare dhe gjuhët zyrtare në Bashkimin Evropian.** Sot jetojmë në një kohë kur ka një lëvizje të madhe të njerëzve nga një vend në tjerin për arsye ekonomike, kulturore ose politike dhe kur këto lëvizje, si dhe shkëmbimet kulturore kërkojnë aftësi të mira komunikimi, të cilat realizohen nëpërmjet gjuhës. Ne jetojmë në një botë ku po kapërcehen kufijtë e ndarjeve të ngushta shtetërore, etnike dhe kombëtare, duke synuar të bëhemi pjesë e Bashkimit Evropian, i cili është themeluar mbi idenë e bukur të bashkimit të të ndryshmeve, që do të thotë: nëpërmjet politikave të reja të shkohet drejt hapje së kufijve shtetërorë dhe njerëzit të e mbarë Evropës, ndonëse me prejardhje, gjuhë, kultura, zakone dhe besime të ndryshme të vihen në kushte të reja dhe të atilla që të mund të bashkëveprojnë e të bashkëjetojnë.

18. Qysh nga formimi i BE-së gjuha më e përdorshme e punës ka qenë frëngjishtja, qoftë për pozicionin e Francës midis shteteve themeluese, qoftë për një traditë të gjatë të përdorimit të frëngjishtes në diplomaci dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Përfshirja në BE e Anglisë (apo siç quhet ndryshe e Mbretërisë së Bashkuar) i dha shtysë të re përdorimit të anglishtes si gjuhë e komunikimit ndërkombëtar, përderisa **sot anglishtja është e para në hierarkinë e dobishmërisë** në fushën ekonomike dhe në atë teknologjiko-shkencore; ky pozicion e bën anglishten mjaft të kërkuar si gjuhë të huaj përkrah gjuhës së vet amtare të çdo vendi anëtar të BE-së. Anglishtja në kuadrin e BE-së, aspekte politiko-shoqërore dhe gjuhësore. Një nga problemet e para që duhet të përballojë BE-ja sot është edhe ai i komunikimit zyrtar midis shteteve anëtare, duke qenë se, qysh në fillimet e sajimit të saj, kjo njësi mbishtetërore (ende në hapat e parë, por me perspektivë të sigurtë që të forcohet e të fuqizohet më tej) është karakterizuar nga një larmi e madhe gjuhësh kombëtare. Një zgjidhje e parë është gjetur me deklarinimin si gjuhë zyrtare të BE-së gjuhën letrare kombëtare të çdo shteti anëtar, për një tërësi prej nëntë gjuhësh; *çdo komunikim duhet të përkthehet në këto gjuhë.*

*Integrimi evropian në një “bashkësi gjuhësore” të njëjtë (unike) është i papërfytyrueshëm, edhe pse kjo gjë do të parakuptonte një autoritet politik mbikombëtar të pajisur me institucione që të ishin në gjendje t’i impononin njohjen e gjithmbarshme (universale) të një gjuhë zotëruese. Në mungesë të një gjuhe zyrtare të vetme (unike) mbeten për t’u realizuar mundësitë e ndërkuptimit dhe të shkëmbimeve mbi një bazë të re. Zgjedhja politike që po shkon duke u përvijuar është ajo e plurilinguizmit të përhapur, porse, në planin praktik, është parë tashmë pohimi progresiv i dy gjuhëve: i frëngjishtes dhe i anglishtes.*

19. *Gjuha e globalizmit është anglishtja*<sup>182</sup>. Kjo bën që edhe në Shqipëri, po t’u referohemi disa zhvillime kulturore, duhet të pranojmë se anglishtja po bëhet një gjuhë e dytë, në mos për të gjithë njerëzit, së paku për brezin e ri të qyteteve të mëdha e sidomos të qendrave me përqendrim të madh të institucioneve dhe marrëdhënieve me jashtë, siç janë sot, jo vetëm Tirana e Prishtina, si dy kryeqendrat me kah nga zmadhimi e metropolitanizimi, po edhe të tjera, si Shkupi e Tetova, pjesërisht edhe Durrësi, Shkodra, Vlora etj.<sup>183</sup>

Po përmendim, ndër të tjera, rrethanën që në një qendër shqiptare si Tetova, sot ka edhe një universitet ku mësimet zhvillohen që të gjitha në gjuhën angleze dhe programat mësimore janë të njëjta me ato të Amerikës. Edhe në Tiranë ka disa vjet që është çelur Universiteti i Nju-Jorkut, ku, gjithashtu mësimet zhvillohen në anglisht dhe planet e programet e lëndëve janë të njëjta me ato të Amerikës.

20. Zhvillimi i medias dhe tregtimi i një sasive të konsiderueshme organesh të shtypit, si: gazeta, revista, guida, buletine etj. ka realizuar mundësinë që lajmi dhe informacioni të përcillen në mënyrë të shpejtë, por jo gjithnjë cilësore. Duket se, megjithë kalimin e viteve, nuk është fituar sa duhet profesionalizmi, etika dhe përgjegjshmëria që duhet të karakterizojë një grup drejtues serioz, i cili ka në dorë një nga mjetet më të shpejta dhe më të efektshme të shpërndarjes së lajmit: shtypin.

<sup>182</sup> Shih: Gabriela del Lungo Camiciotti, *L'inglese nell'ambito della Comunità Europea*, vep.cit., f. 29-46.

<sup>183</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, vep.cit.

Po aq të rëndësishme në këtë rol janë dhe mediat elektronike që shtohen në sasi, por jo gjithmonë në cilësi. Shpesh ato përdorin fjalë të mëdha dhe komente të përfryra, që ndikojnë në mënyra të ndryshme në perceptimin e masës apo grupeve sociale që i ndjekin. Ata që flasin me më shumë njerëz njëherësh, siç janë gazetarët dhe analistët, jo gjithmonë shfaqin elokuencë dhe më e keqja nuk i përmbahen një kodi të caktuar etik, shkelja e të cilit rrezikon seriozisht komunikimin e qëndrueshëm me publikun, kësisoj dhe marrëdhëniet sociale.

*Është fakt i njohur e shumë domethënës që në mjetet tona të informimit masiv ka shkrime, ligjërime e kumtime mjaft të mira edhe në punë të gjuhës e veçanërisht, të zgjedhjes së fjalës. Por ka edhe shkrime, ligjërime e kumtime, ku përdoren shumë fjalë të huaja të panevojshme, sidomos anglicizma, ose formime nga fjalë të huaja, gjithashtu, të panevojshme, për të thënë gjëra fare të zakonshme e kur shqipja i ka mjetet e saj të shprehjes. Kësisoj, duken edhe të habitshme.*

**21.** *Gjuha e reklamës eklipsoi fjalët e bukura dhe u zëvendësua me fjalë të huaja.* Hap televizorin dhe përballësh me një shqipe, që nga dita në ditë po shndërrohet në një gjuhë të mbushur me shumë fjalë të huaja e gjithnjë e më pak fjalë shqipe. Televizionet të duket se janë vënë në garë kush e kush të zëvendesojë fjalë të bukura shqipe me fjalë të huaja, madje edhe të vështira në shqiptim (aq sa shpesh herë edhe shqiptohen gabim). Shqiptari i shqetësuar del në rrugë e menjëherë perballët me emra lokalesh e reklamash, ne pjesën dërmuese në gjuhë të huaja, aq sa të krijohet ndjesia se ndodhesh në të njëjtën kohë në shumë vende të huaja.

Kjo duket qysh nga emrat e televizioneve kryesore private, si Top-Channel Tv, Top Neuws Tv, Channel one tv, Top-Albania Radio, Neuws-24, Agon-Channel, Explorer Shkence Tv, Explorer Nature Tv, Digitgold ppv. Tv, Tring Super, Tring Lifer, Tring 3 plus, Tring Fantasy, Tring Living, Tring Planet, BBF Musik, ABC Neus, ABC TV, A1Report Tv, Ora News Tv, Superfolk Tv, News Tv Kosova, Albanian Screen etj. Po ashtu edhe rubrikat e televizioneve, si Big Brother, Dancing With the Stares, Show Biz, Sport-Live, Inside, Tuniht-Elva Tare, Top Select dhe aq shumë emisione që nisin pikërisht me Top.

**22.** Politikanët janë po aq përgjegjës sa edhe gazetarët për praninë shqetësuese të huazimeve të tipit: *pacifik, infiltrim, purifikim, proporcional, asocim - stabilizim, impakt, intervenim* etj. Madje, sikundër ka vënë re prof. Gj. Shkurtaç, *viteve të fundit, sikur të mos mjaftonin fjalët e huaja që kanë vërshuar rishtazi, ka pasur edhe një kthim mbrapa, duke u përdorur fjalët e huaja në vend të një sasive të madhe fjalësh shqipe, që ishin bërë pothuajse të përgjithësuara në gjuhën e shkruar.*

**23.** Deri vonë, disa hapësira e treva shqiptare, sidomos ato më qendrore, kanë qenë pak ose aspak të përziera, pra edhe pa dukuri të përzierjeve etnike në familje. Vetëm në një periudhë të caktuar, që nuk pati as jetë të gjatë as shtrirje të madhe si dukuri shoqërore, një numër personash, kryesisht studentë e kuadro që qenë dërguar në Rusi dhe në vendet e “Kampit Socialist”, qenë martuar me gra të huaja. Tek-tuk si dukuri, martesat etnikisht të përziera ndër shqiptarë kishin qenë edhe më parë, sidomos nga djem shqiptarë që kishin studiuar në Perëndim dhe, qoftë edhe pse tejet të ralla, disa prej tyre edhe kanë funksionuar.

Dy gjuhësia e emigracionit karakterizohet nga fakti se fëmija duhet të përballojë jashtë mjedisit familjar, përgjithësisht njëgjuhës (monoling), një gjuhë të ndryshme, që nuk e flasin medoemos prindërit e tij ose që e flasin keq. Ky tip i dygjuhësisë ka prirje të zhvillohet e të përhapet shumë aktualisht në vendet e pasura, si pasojë e

dyndjes së punëtorëve të krahut nga vise të huaja. Me interes do të jetë, në studimet sociolinguistike, shqyrtimi e studimi sa më konkret i situatës dhe i shfaqjeve konkrete të dygjuhësisë së emigracionit arvanit, arbëresh dhe i emigracioneve më të reja shqiptare në dhe të huaj si në Bullgari (fshati Mandrica e ndonjë tjetër), në Zari (Dalmaci), në Ukrainë (Rusi), në Gjermani, Suedi, në SHBA, në Kanada, në Australi etj.

Rritja dhe shkollimi në mjedis shoqëror dygjuhësh (bilingual) nënkupton edhe të qenit dygjuhësh të fëmijës. Sigurisht, pozita e një numri jo të vogël të fëmijëve e të rinjve të larguar në mërgim (përmendim rastet e panumërta të studentëve që shkollohen jashtë) është tipike dygjuhëshe, madje mund të themi edhe trigjuhëshe. Ata, natyrisht, kalojnë nëpër të gjitha shkallët e sistemit arsimor, përkatësisht edhe me kontaktet me gjuhën e vendit pritës në jetën publike (çerdhe, kopshte, shkolla, shoqëri, media, koha e lirë dhe loja), kështu që përdorimi i gjuhës së vendit pritës është pothuajse i natyreshëm.

Në literaturën shkencore kushtuar dygjuhësisë, shpesh diskutohet për dygjuhësi të hershme dhe për pasojat e saj mbi zhvillimin e përgjithshëm dhe intelektual të fëmijës. Duhet theksuar që shumica e studiuesve psikologë e pedagogë flasin për një ndikim pozitiv të bilinguizmit të hershëm, duke dëshmuar se zhvillimi dygjuhësh jo vetëm që nuk vonon zhvillimin dhe mundësitë njohëse tek fëmijët, por, përkundrazi, e zgjeron ndjeshëm atë.

Shumë familje gjenden në situata ku njëri ose të dy prindërit flasin një gjuhë të parë përveç një gjuhe tjetër. Për këtë arsye, pyetjet më të zakonshme që ata bëjnë janë: “Si duhet t’u flasim fëmijëve?”. Zakonisht dy janë këshillat që u jepen prindërve në këto raste: së pari, prindërit duhet të komunikojnë me fëmijën në mënyre sa më natyrale; dhe e dyta, prindërit të jenë të qëndrueshem dhe këmbëngulës në mënyrën si do t’ua paraqitin fëmijëve të tyre të dyja gjuhët.

**24.** *“Flukset e padukshme” si përçuese të së resë në ligjërim.* Media ka aq ndikim të madh në jetën e njeriut në ditët e sotme saqë kufiri midis realitetit dhe virtualitetit po prishet, madje nganjëherë edhe nuk mund të dallohet. Vetë termat “flukse të dukshme” e “të padukshme” duket se janë në një dinamizëm, ecuri e ndryshueshmëri të vazhdueshme, pasi, me kohë, vetë shoqëritë njerëzore ndryshojnë, ndryshojnë kushtet në të cilat ato ndërveprojnë, rrethanat etj, e kësaj ndryshon dhe gjuha bashkë me to. Ende midis tyre mund të përdorim një lloj kufiri për sa i përket vendeve ku ato zhvillohen e gjallërohen. Tek “flukset e dukshme”, sipas prof. Shkurtajt, klasifikohen pazaret, shkollat e bibliotekat, teatrot, kinematë, diskotekat etj e gjuha që haset në to ndërsa në flukset e padukshme klasifikohen radioja, teleksi, televizioni, faksi, e-maili, internet, gazetatat, revistat, librat etj.<sup>184</sup>

Te “flukset e dukshme”, natyrisht, rolin kryesor e ka pasur dhe e ka shkolla. Shkolla, që do të thotë aty, në radhë të parë, të nxëniet e gjuhës shqipe si lënda kryesore e formimit të shkollarëve deri në fund të maturës shtetërore. “Gjuha shqipe nuk ka nevojë t’i zërë diellin asnjë lëndë tjetër, po edhe as të jetë nën hijen e ndonjë lëndë tjetër, qoftë edhe të letërsisë. Gjuha shqipe i duhet letërsisë, sepse letërsi të bukur pa gjuhë të mirë, të pasur e të kujdesur nuk ka e nuk mund të ketë. Porse gjuha shqipe u duhet edhe njerëzve që nuk merren me letërsi, prandaj lidhja me letërsinë nuk është dhe nuk ka pse të jetë e kushtëzuar. Ka pasur e ka shumë njerëz që nuk merren me

<sup>184</sup> Shih: Gj. Shkurtajt, *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2009.

letërsi, por shkruajnë e flasin shumë bukur, sikundër ka, për fat të keq, edhe aq shumë njerëz që merren me letërsi dhe që shkruajnë aq keq, me fjalor të varfër e me mangësi të mëdha të formimit gjuhësor”-thotë Gj. Shkurtaç, duke argumentuar se *ka pasur një rendje të natyrshme pas gjuhëve të huaja. Kjo është punë shumë e mirë. Hyrja në Evropë nuk bëhet pa njohur gjuhët e mëdha të komunikimit, sidomos anglishten, frëngjishten etj. Mirëpo, të mësosh dhe të vlerësosh gjuhët e huaja, nuk do të thotë aspak të mos vlerësosh (e aq më pak të nënvlerësosh) gjuhën tënde?! Tashti kemi shumë njerëz që i dinë mirë, (ndoshta edhe sa s’ka ku të vejë më mirë), gjuhët e huaja. Kjo duhet vetëm të na gëzojë. Por, kemi pak, shumë shumë pak njerëz që e dinë mirë gjuhën shqipe, që mund ta shkruajnë e ta flasin bukur e pa gabime.*

*Shikoni si flasin e shkruajnë sot pushtetarët, zyrtarët dhe gazetarët tanë! Plot fjalë të huaja të panevojshme, plot shtampa gjuhësh të huaja e kundër natyrës së shqipes, me dukuri që tregojnë mosnjohje të plotë jo vetëm të gjuhës së njësuar (standard), po edhe me elemente të çoroditjes së sintaksës. Pra, nuk dimë të flasim e të shkruajmë shqipen, gjuhën tonë amtare, ndërsa mëtojmë (dhe arrijmë përherë e më shumë) të flasim dhe të shkruajmë jo pak gjuhë të tjera.<sup>185</sup>*

**25. Gjuha është pasqyrë e edukatës, e koncepteve dhe e moralit të një shoqërie, të një mjedisi të saj, por edhe të çdo individi të veçantë që e përdor gjuhën kombëtare.**

Shoqëria njerëzore po zhvillohet me hapa të shpejtë. Dita-ditës jemi dëshmitarë të ndryshimeve, që po pëson shoqëria jo vetëm në mendësi, nga ana kulturore, kulturore, ekonomiko-shoqërore, por këto ndryshime po pasqyrohen dukshëm edhe në përdorimin e gjuhës sonë.

Gjithnjë njeriu ka ndjerë nevojën për të jetuar në bashkësi, prandaj, për të komunikuar, për të shprehur mendimet e tij, ndjenjat, opinionet, pikëpamjet etj., përdor gjuhën. Por, duhet thënë që zhvillimet teknologjike kanë bërë të mundur finalizimin e komunikimit në largësi, që e motivoi njeriun të zbulojë sisteme komunikimi të ndryshme nga i tij dhe që sot janë pjesë e rëndësishme e çdo shoqërie të organizuar e moderne.

Zhvillimi i teknologjisë së përparuar, mësimi i gjuhëve të huaja, përdorimi në masë i kompjuterit, televizionit, telefonisë celulare, postës elektronike etj (pra, të gjitha “flukset e dukshme e të padukshme”), po ndikojnë drejtpërdrejt në pasurimin dhe, në të njëjtën kohë, në “shtrembërimin” e gjuhës sonë kombëtare.

**26. Ndikimi i internetit dhe i rrjeteve sociale në gjuhën shqipe.** Duke qenë mjeti ndoshta me i sofistikuar për mbartjen e shpejtë të informacionit dhe korrespondencës, interneti është bërë mjet i pashmangshëm i veprimtarisë së njerëzve të sotëm, ndërsa përhapja dhe shtrirja e tij në rrafshin global ka ndikuar në integrimin e hapësirave komunikuese botërore dhe, si rrjedhim, ka bërë që kontaktet mes gjuhëve të shtohen. Gjuha shqipe është bërë pjesë e kësaj dukurie. Krahas revolucionit që ka shkaktuar në informim, interneti ka nxitur edhe ndryshime domethënëse strukturore në gjuhë, duke krijuar një hapësirë të re virtuale, në të cilën është reflektuar gjithë variacioni gjuhësor i botës reale. “Ky ndikim shkon edhe më tej në krijimin e formave të reja të komunikimeve, të cilat nuk janë të pranishme në botën reale,” - shprehet Shkumbin Munishi në artikullin “Gjuha shqipe dhe interneti”.

**27. Radio-televizioni dhe organet e shtypit si shtypa integruese.** Gjatë Luftës së Dytë Botërore radioja bëhet një mjet i pëlqyer dhe i përparuar propagande, po aq sa

<sup>185</sup>Shih: Gj. Shkurtaç, *Si të shkruajmë shqip-baza të shkrimit akademik*, Tiranë, 2012.

edhe një mjet i përhapjes së lajmeve. Pas Luftës së Dytë Botërore, televizori u bë një mjet i rëndësishëm dhe njerëzit menduan se “radioja vdiq”. Ajo u shndërrua në një tjetër mjet komunikimi. Nga një mjet primar, në plan të parë, të cilën njerëzit e dëgjonin në shtëpi, radioja u shndërrua në një shoqëruese të lëvizshme. Radioja zhvilloi muzikën dhe formatet e lajmeve. Gjithashtu, ajo zhvilloi programe të specializuara për një grup të ngushtë njerëzish dhe, në vend të një audience të përgjithshme masive, kaloi tashmë në një mjet të përzgjedhur e të pamungueshëm sidomos në kushte e udhëtimeve të gjata me tren apo edhe me mjete të tjera. P.sh. stacione që i drejtohen vetëm adoleshentëve, programe që transmetojnë muzikën më të ndjekur sot, etj.

Televizioni e radioja nëpërmjet një gjuhë të përpunuar synojnë të arrijnë objektivat e tyre duke u shfaqur konkurruese midis njëra tjetrës e duke afirmuar sukseset e tyre në anën publicitare nëpërmjet reklamave.

Por nga ana tjetër, nga një vend në një tjetër, dhe ndikimet e tyre janë nga më të ndryshmet. Çfarë mund të thuhet sot në mjediset shqiptare mediatike? Në garën për të qenë të parat ato shpesh përdorin shumë fjalë të huaja si shenjë e inovacionit, futjes të së resë, modernes, asaj që përbën bashkëkohoren. Por në secilin rast të tillë ato sjellin përveç synimit për të pasuruar ato sjellin dhe shtrembërime dhe çorientim gjuhësor, pasi ndjekësit e tyre jo rrallëherë e gjejnë veten mes dilemash dhe pakuptueshmërisë.

**28. Huazimet në shqipen si tregues të integritit të hershëm e të sotëm.** Jashtë shoqërisë nuk ka gjuhë. Gjuha është e lidhur ngushtë me veprimtarinë prodhuese të njeriut. Gjuha e një populli pasqyron kulturën e tij, zakonet në zhvillimin e tyre historik. Prej këtej rrjedh edhe rëndësia e madhe e dëshimve gjuhësore, jo vetëm për gjuhësinë, por edhe për gati të gjitha shkencat e tjera albanologjike, si për etnografinë, folklorin dhe përgjithësisht për kulturë popullore, për historinë, por edhe për arkeologjinë etj.

Gjuha ruan shumë gjurmë nga kultura e vjetër e shoqërisë. Shumë fjalë ruajnë formën e vjetër të tyre, megjithëse me kohë ato kanë marrë përmbajtje tjetër, prandaj, prej shumë kohësh, ka qenë dhe mbetet e qartë, se pa studimet ndërdisiplinare dhe, kur është e mundur, të përbashkëta të gjuhëtarëve dhe të etnografëve, folkloristëve, arkeologëve etj. nuk mund të zgjidhet drejt çështja e origjinës së popujve me mungesa të mëdha dokumnetacioni historik, sikundër është populli shqiptar.

Një popull i lashtë, fqinj i përhershëm më grekët e me romakët, gjuha e të cilit qëndron midis greqishtes e latinishtes, ka pasur edhe ndikime leksikore prej tyre, por është gjuhë më vete, pa lidhje birërie me asnjërën prej dy gjuhëve më të vjetra të Evropës, që përmendëm, po edhe, për fat të keq, me dëshmi të mekëta e gjithësesi të pakëta të dokumentimit të pranishëm së tij si popull e të shqipes si gjuhë.

Fjalët e huaja kanë hyrë në gjuhën shqipe në rrjedhë të kohërave deri në ditët e sotme me veçoritë e tyre specifike në dy pjesë kryesore të leksikut: *në leksikun e përgjithshëm dhe në atë terminologjik*. Në leksikun e përgjithshëm ato janë futur në kushtet e kontakteve qindravjeçare të drejtpërdrejta të shqipes me gjuhët e pushtuesve ose të fqinjëve, duke u përzier me leksikun vendës e duke formuar, sipas gjuhës hyrëse, shtresa të ndryshme leksikore, si, latinizmat (gjatë 500 vjet të pushtimit romak), greqizmat (nga fqinjësia e përhershme me popullsinë greke), sllavizmat tre shekuj (shekulli V deri në shekullin VIII dhe turqizmat (rreth 500 vjet të pushtimit turk).

Në leksikon terminologjik, në kushtet e kontakteve përgjithësisht jo të drejtpërdrejta e më rrallë të drejtpërdrejta me gjuhët e huaja janë formuar në kohët e vona (dy shekujt e fundit) në periferi të leksikut shtresime të tilla, si, italizmat, francesizmat, anglicizmat (anglicizmat) e më rrallë rusizmat e gjermanizmat.

**29.** *Ndërkombëtarizmat në shqipen e sotme.* Huazimet nga gjuhët e huaja, ndryshe nga fjalët e huaja të panevojshme e të parrënjosura në gjuhë, e kanë gjetur tashmë vendin e tyre në gjuhë. Mbi këtë bazë mund të dallojmë:

a) Fjalë me burim të huaj që janë përvetuar nga shqipja, që janë bërë njësoj si fjalët e tjera të leksikut të shqipes. Hyjnë këtu huazimet e vjetra si: *qytet, shëndet, faqe, presh, xhep, mjeshtër, i pastër, kusi, karrocë, këndoj, rrugë* etj., dhe fjalët ndërkombëtare: *analizë, aritmetikë, demokraci, diktaturë, filozofi, filologji, histori, gjeografi, gjeologji, gramatikë, kongres, parti, klasë, socializëm, komunizëm, ideologji, imperializëm; roman, poemë, dramë, komedi, portret, peizazh, akuarel, teatër, subjekt, personazh, skenë, balet, fabul* etj.

Si *fjalë ndërkombëtare* vështrohen ato fjalë që përdoren në shumicën e gjuhëve të botës (veçanërisht në gjuhët indoevropiane), por nuk do të quhen të tilla (ndërkombëtarizma) fjalët që përdoren vetëm në gjuhët neolatine (italisht, frëngjisht). Për këto fjalë do të bëhen përpjekje të zëvendësohen me fjalët shqipe, siç është bërë p.sh. me *solucion* që është zëvendësuar me *tretësirë*, *nuklear* me *bërthamor*, *neutral* me *asnjanës* etj.

Përbërja kuptimore e ndërkombëtarizmave në gjuhën shqipe ka marrë zhvillim origjinal, duke u gërrshetur me sistemin semantik të shqipes. Termit ndërkombëtarizma zënë vend të mirë në leksikon e gjuhës së sotme shqipe. Terminologjia shkencore dhe teknike shqipe, gjatë zhvillimit të saj, është pasuruar me ndërkombëtarizma dhe kjo e ka afruar gjuhën shqipe me gjuhët më të zhvilluara të Evropës, që kanë ndjekur pak a shumë këtë rrugë. Shtimi i termave ndërkombëtarizma në gjuhën shqipe është dukuri normale, që lidhet me zhvillimin e gjithanshëm të vendit tonë në fushat më të ndryshme, pra me faktorë jashtëgjuhësorë.

**30.** *Koncepti i pastrimit të gjuhës lidhet me pasurimin e saj.* Pasurimim i gjuhës nuk do të thotë që të mudohejmë të heqim çdo huazim, të kalojmë në anën tjetër dhe të tregohemi puritanë deri në marrëzi dhe çudira. Sipas Hock<sup>186</sup> (1986: 380), “termi ‘huazim’ i referohet „ marrjes së fjalëve të veçanta ose grupe fjalësh nga një gjuhë, ose dialekt tjetër. ”Fjalët e huazuara quhen huazime (Trask, 1996)<sup>187</sup>. Huazimet janë një proces në vazhdim për të gjitha gjuhët. Edhe gjuha angleze, e cila po jep më shumë fjalë sot në krahasim me gjuhët e tjera është zhvilluar duke huazuar nga gjuhët e tjera. Nuk ka gjuhë që mund të rrijë jashtë kësaj dukurie. Fjalët huazohen kur ju referohen koncepteve ose sendeve që nuk egzistojnë në gjuhën shqipe dhe për të ruajtur saktësinë e kuptimit të kumtuar nga njësia leksikore e huaj.

**31.** Huazimet nga anglishtja në shqipen. ”Banka“ kryesore e huazimeve dhe e prurjeve të huaja në shqipen e sotme është anglishtja. Shqipja e sotme përballet me trysinë më të fuqishme në fushën e huazimeve leksikore pikërisht nga anglishtja, prandaj njohja e tyre dhe ndërmarrja e studimeve e shqyrtimeve shkencore për këto

<sup>186</sup> Hock, Hans H. ( 1986 ) Principles of Historical Linguistics. Berlin : Mouton de Gruyter

<sup>187</sup> Trask, L.R. 1996. Historical Linguistics. Oxford University Press

huazime shtrohen sot si një nga punët më të ngutshme dhe të vyera të gjuhësisë shqiptare.

Duke pasur parasysh masën e madhe të vërshimit të termave me burim nga anglishtja në shqipe, mund të thuhet se anglicizmat terma po e zgjerojnë nga dita në ditë portën e hyrjes së termave të huaj në gjuhën standarde në të gjitha nivelet e ligjëritimit. Meqë pjesa më e madhe e elementeve të huaja që hyjnë përmes kësaj porte janë pak a shumë të afërta nga forma dhe përbëjnë modele të përbashkëta nga përmbajtja edhe për gjuhët e tjera (*kompjuter, monitor, display*), atëherë këto elemente shërbejnë si porta hyrjeje edhe për gjuhë të tjera.

Si një rrymë e përbashkët që kalojnë nëpër to, në mënyrë të veçantë termat anglezë, si ndërkombëtare në pjesën më të madhe të tyre, i shndërrojnë këto porta në enë komunikuese me masën e përbashkët qarkulluese (termat të huaj për secilën prej tyre). Terminologjia shqipe, duke u futur në këtë rrymë të përbashkët, duhet ta orientojë lëvizjen e kahun e rrjedhës së saj sipas kësaj rryme, të përbashkët edhe për gjuhët e tjera, sidomos atyre që shërbejnë në fushën e terminologjisë si gjedhe standardizimi e kodifikimi si anglishtja, frëngjishtja, italishtja, gjermanishtja, spanjishtja e rusishtja.

Në këtë rrjedhë duhet futur edhe terminologjia shqipe e përdorur në treva të tjera shqipfolëse, si në Kosovë dhe në Maqedoni. Kjo do të thotë se shumë probleme të terminologjisë shqipe duhen shtruar e zgjedhur në kuadrin e problematikës së përbashkët edhe të gjuhëve të tjera të botës, të vendeve të mëdha apo të vogla. Kjo i jep një orientim të ri vlerësimit e rivlerësimit të termave të huaj në shqipe, qëndrimit ndaj tyre, vendit të tyre në raport me termat e shqipëruar që konkurrojnë me to duke përshtatur ndaj tyre një politikë gjuhësore më të liberalizuar sa më parë.

Ky orientim i ri i politikës gjuhësore për terminologjinë e huaj në shqipe lidhet edhe me realizimin e qëllimit të afërt të futjes së Shqipërisë në BE, ku gjuha shqipe në këtë rast do të luajë rolin që i takon me ngritjen e saj në nivelin e marrjes së statusit të një gjuhë të BE-së. Një ndër shtytësit e rëndësishëm të ngritjes së shqipes standarde në nivelin e gjuhëve të tjera të BE-së do të jetë edhe terminologjia e saj, e cila me njësitë e përbashkëta (ndërkombëtare) të përmbajtjes (të koncepteve shkencore-teknike) dhe vetjake (kombëtare) të shprehjes, të termave do ta sjell më afër shqipen me gjuhët e tjera të Europës.

Sigurisht, ndërmjet këtyre njësitëve të shprehjes (të termave), termat e huaj, sidomos ato ndërkombëtare si fond i përbashkët gjuhësor-kulturor, do të jenë mishërimi i idesë së globalizimit kulturor në fushë të gjuhës.

Vërshimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe është pasojë e globalizimit. Purizmi i gjuhës është me vend kur në rrezik është çështja kombëtare. Kjo çështje nuk është sot në rrezik tek shqiptarët.

### **32. Rekomandime:**

Ndikimet europeanizuese në drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj në shqipen. Fjalët dhe emrat e përveçëm të huaj, si pjesë e trysnisë dhe e ndikimit gjuhësor të huaj, si rregull, kur hyjnë në shqipen (ashtu si në çdo gjuhë tjetër) shkaktajnë edhe probleme shqiptimore, sidomos të vendit të theksit, si dhe drejtshkrimore e morfologjike. Një i huaj që vjen në Shqipëri dhe paraqitet tek

nëpunësi i doganës për të kryer formalitetet e nevojshme: regjistrim e pajisje me vizë, kontroll i bagazheve etj. Si do ta shkruajmë emrin e tij? Ashtu si e ka në pasaportën e tij? Kjo do të ishte (dhe teorikisht mbetet) mënyra më e drejtë dhe më e saktë. P.sh, *Michel Jakson, George W. Bush, Silvio Berlusconi*.

Mirëpo puna është se emra të tillë ndryshe shkruhen dhe ndryshe shqiptohen. (Përkat. *Majkëll Xhekson, Xhorxh Dabëllju Bush, Silvyo Berluskoni*). Komisioni hartues i Rregullave të drejtshkrimit të shqipes, duke pasur të qartë se sa e vështirë do të ishte për ne shqiptarët që të mësonim si shkruhen e si shqiptohen të gjithë emrat e përveçëm të huaj, pavarësisht nga mendimet jo të pakta që kishin anuar edhe më parë nga të shkruarit si në gjuhën prej nga vijnë (ashtu si sot ata që nuk i zbatojnë rregullat) ka tumiruar që emrat dhe fjalët e huaja që hyjnë në shqipen do të shkruhen ashtu si shqiptohen në gjuhën prej nga vijnë, por sipas rregullave të drejtshkrimit të shqipes. Pra, *Gëte* (e jo Goethe), *Viljam Shekspir* (dhe jo Wiliam Shekespeare), *Bajron* (dhe jo Buron) etj.

Rekomandimi ynë, pra, i drejtohet punës së mëtejshme të Këshillit Ndërkademiç të Gjuhës Shqipe, i cili, do të ishte mirë që, në kuadrin e ndonjë përmirësimit të vogël që iduhet bërë Drejtshkrimit, ta shohë me përparësi sidomos drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj.

## BIBLIOGRAFIA

### A. Literaturë teorike e përgjithshme

- ✚ ASPECTS OF BILINGUAL APHASIA / edited by Michel Paradis. - [Oxford] : Pergamon, 1995.
- ✚ AVAMPOSTI DELLA PSICOLINGUISTICA APPLICATA : v. 2 : apprendimento delle lingue e psicolinguistica differenziale / [scritti di] R. Titone... [et al.] ; a cura di Renzo Titone. - Roma : A. Armando, 1981.
- ✚ Avdullai Isa, *Antiglobalizmi*, Shkup, 2009.
- ✚ BILINGUALISM, MULTICULTURALISM, AND SECOND LANGUAGE LEARNING : The McGill conference in Honour of Wallace E. Lambert / Edited by Allan G. Reynolds. - Hillsdale /etc./ : Lawrence Erlbaum Associates, c1991.
- ✚ Bozeman, *Strategic intelligence and stratecraft competencies and qualifications*, Brussel; European Commission, 2003.
- ✚ CHILDHOOD BILINGUALISM : aspect of linguistic cognitive and social development / edited by Peter Homel, Michael Palij, Doris Aaronson. Hillsdale /etc./ : Lawrence Erlbaum Associates, 1987.
- ✚ CHILDREN'S LANGUAGE : vol. 8 / edited by Keith E. Nelson, Zita Reger. Hillsdale ; Hove : Lawrence Erlbaum Associates, 1995.
- ✚ CHINI, Marina, *Genere grammaticale e acquisizione : aspetti della morfologia nominale in italiano L2* / Marina Chini. - Milano : Franco Angeli, c1995.
- ✚ COGNITIVE PROCESSING IN BILINGUALS / Edited by Richard Jackson Harris. - Amsterdam /etc./ : North Holland, 1992.
- ✚ Comon European Principles for Teacher Competencies and Qualifications, Brussel: European Commission, 2003.
- ✚ Council Resolution of 21 Novembre 2008 on a European Strategy for multilingualism, Official Journal.C, 320, 16.12.2008, p.001-0003.
- ✚ CULTURAL AND LANGUAGE DIVERSITY AND THE DEAF EXPERIENCE / Editor, Ila Parasnis. - Cambridge : Cambridge University Press, 1996.
- ✚ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973,
- ✚ DULAY, Heidi *La Seconda lingua* / Heidi Dulay, Marina Burt, Stephen Krashen. Bologna : Il Mulino, c1985. - Tit. orig. : Language two.

- ✚ FABBRO, Franco Il cervello bilingue : neurolinguistica e poliglossia / Franco Fabbro. - Roma : Astrolabio, 1996.
- ✚ *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë, 2008, vëll.II
- ✚ GA, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe (ADGJSH)*, Napoli-Tiranë, vëll.I,2007, vëll.II, 2008.
- ✚ GASS, Susan M. Second language acquisition : an introductory course / Susan M. Gass, Larry Selinker. - Hillsdale çetc.] : L. Erlbaum Associates, 1994.
- ✚ HAMERS, Josiane F.ilingualité et bilingualisme / Josiane F. Hamers, Michel H. A. Blanc. Liege : Pierre Margada, c1989.
- ✚ Hock Hans H., *Principles of Historical Linguistics*, Berlin, 1986.
- ✚ L' APPRENDIMENTO SPONTANEO DI UNA SECONDA LINGUA / a cura di Anna Giacalone Ramat. - Bologna : il Mulino, c1986.
- ✚ L' ITALIANO TRA LE ALTRE LINGUE : strategie di acquisizione / A cura di Anna Giacalone Ramat. - Bologna : il Mulino, 1988.
- ✚ La PERSONALITÀ BILINGUE : *caratteristiche psicodinamiche* / Testi di B. Bain... çet al.] ; a cura di Renzo Titone. - Milano : Bompiani, 1996.
- ✚ LANGUAGE PROCESSING IN BILINGUALS: psycholinguistic and neuropsychological perspectives / Edited by Jyotsna Vaid. - Hillsdale ; London : Lawrence Erlbaum Associates, 1986.
- ✚ Mejdani R., Integrimi evropian u shërben qytetarëve, “Ese rreth temës së integritimit evropian të Shqipërisë”, faqe në internet.
- ✚ ODLIN, Terence, *Language transfert : cross-linguistic influence in language learning* / Terence Odlin. - Cambridge : Cambridge University Press, c1989.
- ✚ OLLER, John W. *Language and bilingualism: more tests of tests* / John W. Oller, with the assistance of Steve Chesarek, Robert Scott. - Lewisburg : Bucknell University Press, c1991.
- ✚ O'MALLEY, J.Michael, *Learning strategies in second language acquisition* / J. Michael O'Malley, Anna Uhl Chamot. - Cambridge : Cambridge University Press, c199ë.
- ✚ Rama Edi, *Fjala e Kryeministrit Edi rama në Forumin e Liderëve Botërorë në Universitetin e Kolumbias*, në Shtete e Bashkuara të Amerikës, faqe interenti.
- ✚ ROMAINE, Suzanne, *Bilingualism* / Suzanne Romaine. - 2nd ed. - Oxford ; Cambridge : Blackwell, c1995.
- ✚ ROMAINE, Suzanne, *Bilingualism* / Suzanne Romaine. - Oxford : Basil Blackwell, 1989, ristamp. 1991.

- ✚ S.P Huntington, *Përplasja e qytetërimeve*, Logos-A 2004.
- ✚ SIGUAN, Miguel, *L'Europe des langues* / Miguel Siguan. - Sprimont : Pierre Margada, c1996.
- ✚ SKEHAN, Peter, *Individual differences in second-language learning* / Peter Skehan. London : E. Arnold, 1989.
- ✚ SOCIAL INTERACTION, SOCIAL CONTEXT AND LANGUAGE : essays in honor of Susan Ervin-Tripp / Edited by Dan Isaac Slobin... çet al.]. - Mahwah : Lawrence Erlbaum Associates, 1996.
- ✚ The BILINGUAL LEXICON / edited by Robert Schreuder, Bert Weltens. Amsterdam ; Philadelphia : John Benjamins Publishing Comp., 1993.
- ✚ The CONSTRUCT OF LANGUAGE PROFICIENCY : applications of psychological models to language assessment / edited by Ludo Verhoeven, John H.A.L.de Jong. - Amsterdam ; Philadelphia : John Benjamins Publishing Co., 1992.
- ✚ The MULTILINGUAL COMMUNITY: bilingualism: a special issue of "The european Journal of Cognitive Psychology " / edited by A. M. B. de Groot, C. Barry. - Hove ; Hillsdale : Lawrence Erlbaum Associates, c1992.
- ✚ TITONE, Renzo, *Studies in the psychology of second language learning* / Renzo Titone. Zurich : Pas-Verlag, 1964.
- ✚ Trask L.R., *Historikal Linguistics*. Ocsford University Press, 1996.
- ✚ TUTORIALS IN BIBLINGUALISM : psycholinguistic Perspectives / Edited by Annette M. B. de Groot, Judith F. Kroll. - Mahwah : Lawrence Erlbaun Associates, 1997.

**B. Literaturë e veçantë:**

- ✚ Abazi, Genciana, *Për klasifikimin e turqizimeve në gjuhën shqipe*. – në: “Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët”. Simpozium ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë më 15, 16, 17 tetor 1992. Prishtinë, 1995, f. 345–349.
- ✚ Ajeti, I. *Mjetet e informimit për ngritjen e kulturës gjuhësore*, në “Çështje të kulturës së gjuhës”, Prishtinë, 1980, f.15.
- ✚ Alpan, Nexhip: *Bashkëpërkime leksikore midis shqipes dhe turqishtes*. – në: *Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare. Përmbledhje e ligjëratave, referimeve, kumtesave dhe e diskutimeve. Tiranë, 16–31 gusht 1995*. – Akademia e Shkencave – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë – Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë. Eurorilindja, Tiranë 1995, 189–199.
- ✚ Alpan, Nexhip: *Ndikime e gjuhës dhe të letërsisë turke në gjuhën dhe letërsinë shqipe*. – në: “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike me rastin e 5ëhë-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit–Skënderbeut”. Tiranë, 12–18 janar 1968. III. Materiale të seksionit të shkencave filologjike. Tiranë, 1970, f. 81–88.
- ✚ Altimari, F. (1983) *Comportamento linguistico e condizionamenti socioculturali nella situazione plurilingua di un' area albanofona della Calabria*, in "Studi linguistici arbëreshe", "Quaderni di Zjarri", 1988, pp.5-29.
- ✚ Altimari, F. (1985) *Lingua ed emigrazione nella comunità albanese di Calabria*, in "Minoranze etniche e linguistiche", Palermo-Piana degli Albanesi, pp.121-142.
- ✚ Altimari, F. *Comportamento linguistico e condizionamenti socioculturali nella situazione plurilingua di un' area albanofona della Calabria*, në "Atti del IX Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo 1981, p. 57.
- ✚ Asenova P., *Gruaja monolingue në Ballkanin biling*, në “Studime albanologjike”, Tiranë, 1996, nr.2, f. 86.
- ✚ Aziri Etem, *Sociologjia*, Shkup, ???
- ✚ Baja O., *Rreth orientizimeve të përdorura në kryeveprën e Fishtës*, në “Malësia”, 7, Podgoricë, 2012, f.253-262.
- ✚ Ballhysa a.-Lala M., *Shqiptarët dhe plurilinguizmi në Europën plurikulturore*, në “Studime Albanologjike”, II, Tiranë, 2011, f.382-393.
- ✚ Bello R., Mësimi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Bullgari dhe në veçanti në Universitetin e Veliko Ternovës, në në “Studime albanologjike”, Tiranë, 1996, nr.2, f.331-338.

- ✚ Bergamin A., *Mirësjellja gjuhësore dhe format e shprehjes së saj në shqipen e në italishten*, në “Malësia”, 7, Podgoricë, 2012, f. 275-282.
- ✚ Berruto G., *Fondamenti di sociolinguistica*, Editore Laterza, 2006.
- ✚ Bolognari, M. *Alcuni problemi culturali di una legislazione sulle minoranze linguistiche*, në "Atti dell IX Congresso Internazionale di Studi Albanesi", Palermo, 1981, p. 4.
- ✚ Brown, B. B. “The peer Group and Peer Cultures”, Cambridge, 1990.
- ✚ Çabej, E. 1. *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe 2. Fonetika historike*, Tiranë, 1975, f. 111-132.
- ✚ Çabej, E. *Italo-Albanische Studien*, Universitat Wien, 1933 (doktorat), si dhe studime të tjera të tija, sidomos *Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre*, në Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 197ë, f. 1ë7-115.
- ✚ Çabej, E. *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, në “Gjuha jonë”, 1,1981, f.36-47.
- ✚ Çabej, E., *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*, SF, 4, 1975.
- ✚ Çabej, E., *Studime gjuhësore*, Vëll.V, Prishtinë, 1976.
- ✚ Callari Galli 1977) *Bilinguismo instabile nelle comunità arbëresh dellaprovincia della Cosenza*, in AA. VV. *Aspetti sociolinguistici dell’Italia contemporanea*, SLI, Bulzoni, Roma.
- ✚ Camaj M. (1974) *Il bilinguismo nelle oasi linguistiche albanesi dell’Italiameridionale*, in "Bilinguismo e diglossia in Italia", 1, A cura del
- ✚ Camiciotti G. De Lungo, *L’inglese nell’ambito della comunità’ europea*, në “Quaderni del Dipartimento di Linguistica”, Firenze,3, 1992, pp.29-46.
- ✚ Carakausi G. (1986) *Lingue in contatto nell’ estremo Mezzogiorno d’ Italia*,Influssi e conflitti fonetici.
- ✚ Cardona G. Raimondi (1989) *Dizionario di linguistica*, Armando Editore.
- ✚ Çeliku M., *Për pastërtinë e shqipes nga fjalkët e huaja në përdorim*, në “Akte të Konferencës Shkenore me temë “Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar”, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë, 2004, f.9-25..Shkurtaj Gj., *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë, 2006, f.94-116.
- ✚ Coco Francesco, *Introduzione allo studio della dialettologia italiana*, Patron Editore, Bologna, 1977
- ✚ Çomo Bekim, *Psikologji Komunikimi*, Tiranë 2001.

- ✚ Conforti E., Approccio grafico e impostazione teorica dell' insegnamento della lingua di minoranza nelle comunita' italo-albanesi, në “Studime Albanologjike”, II, Tiranë, 2011, f.345-350.
- ✚ Consiglio delle Ricerche, Centro Studi per la Dialettologia Italiana, Padova, pp. 5-13.
- ✚ De Mauro T., *Europa delle lingue*, Roma, 2000.
- ✚ De Mauro T., *Storia linguistica dell'Italia unita*, Laterza, Bari, 1963.
- ✚ De Padova, C., *Ndikimi roman në të folmen arbëreshe të San Marcanos*, në "Dialektologjia shqiptare", V.
- ✚ Dedaj Ndue, *Shqipja e bjerrë e emigracionit*, “Shqip”, 21 mars 2013.
- ✚ Delia Shpresa., EPOSTL “ Portofoli European për studentët e mësuesisë”-njësimi me Europën, në “Studime Albanologjike”, II, Tiranë, 2011, f.393-398.
- ✚ Demiraj, Sh., *Eqrem Çabej- një jetë kushtuar shkencës*, Tiranë,1982.
- ✚ Demiraj, Shaban: *Rreth huazimeve prej burimit turk, arab dhe persian në gjuhën shqipe. – Univers 2001, 1, 15–30.*
- ✚ Demiraj, Shaban: *Rreth huazimeve të shqipes prej burimi persian. – Perla 11/2006, 1, 29–36.*
- ✚ Derjaj Adriatik, *Dukuri dhe problem të huazimeve turke në shqipen*, në “Malësia”, 5, Podgoricë, 2010, f. 137-142.
- ✚ Derjaj Adriatik, *Rreth drejtshkrimit të turqizmave dhe emrave vetjakë me origjinë turke*, në IAP, Konsulta gjuhësore e Prishtinës (1968), Prishtinë, 2008, f.259-266.
- ✚ Desnickaja, A. V.: *Mbi funksionin stilistik të turqizmave në poezinë shqipe. – Perla 11/2006, 4, 126–134 (përkthim nga rusishtja).*
- ✚ Di Sparti Antonio, *Diaspora nel televisivo: lingue minoritarie e mass-media*, në "Atti del IX Congresso Internazionale di Studii Albanesi", Palermo, 1981, pp.177-258.
- ✚ Dibra Klodeta, *Kultura e të shkruarit në gazeta*, në “Akte të Konferencës Shkencore, 16 dhjetor 2004, Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, Tiranë, 2004, f. 129-136.
- ✚ Dizdari, Nasuf T.: *Rreth dorëshkrimit “Orientalizmat në gjuhën shqipe” të Tahir Dizdarit. – në: Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët. Simpozium ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë më 15, 16, 17 tetor 1992. Prishtinë, 1995, f. 331–336.*

- ✚ Dizdari, Tahir: *Disa vëzhgime mbi turqizmat në shqipe*. – në: Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike Tiranë, 15–21 Nëntor 1962. Universiteti Shtetëror i Tiranës Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë, 1965, f. 407–408.
- ✚ DuroAgron, *Fjalët e huaja dhe gjuha shqipe*, Gazeta “Shqip”, 9 tetor, 2009.
- ✚ Elezi Gladiola, *Politikat gjuhësore jashtë Shqipërisë dhe gjuha shqipe*, në “Studime Albanologjike”, II, Tiranë, 2011, f.398-405.
- ✚ Famiglietti M. (1979) *Educazione e cultura in Arbëria*, Bulzoni, Roma.
- ✚ Famiglietti, M. *Sociopsicologia dell' educazione e lingua*, Bulzoni Editore, Roma, 1976.
- ✚ Ferguson CH. (1959) *Diglossia*, in "Word", 1962, 15, nr.2
- ✚ Ferguson CH. (1971) *La diglossia*, in "Linguaggio e Società", Bologna.
- ✚ Fishman, Joshua A. "The impact of nationalism on language planning" 1971.
- ✚ Fistani Irena, Ndikimet leksikologjike të gjuhëve me bazëlatine në gjuhën shqipe, në “Malësia”, 7, Podgoricë, 2012, f.229-236.
- ✚ Francescato G. (1970) *Il linguaggio infantile, strutturazione e apprendimento*, Piccola Biblioteca Einaudi.
- ✚ Francescato G. (1981) *Il bilinguismo isolato: studi sul bilinguismo infantile*, Minerva Italica, Bergamo.
- ✚ Gabriela del Lungo Camiciotti, *L'inglese nell'ambito della Comunità Europea*, në “Quaderni del Dipartimento di Linguistica” di Firenze, 3, 1992, pp.29-46.
- ✚ Gambarara, D. *Parlare albanese nell'Italia Unita*, në "Zjarri", 27, 1981, p.59.
- ✚ Gecaj Murat, *Me zemër në vendlindje*, Tiranë, 2013.
- ✚ Giglioli, P. – *Linguaggio e società*, Bologna, Il Mulino, 1983
- ✚ Gjinari J.- Shkurtaç, Gj. *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 2003 e ribotime.
- ✚ Gjokutaj Mimoza, *Mësim i gjuhës shqipe përballë braktisjes së fshehtë*, OTKA, 27 tetor, 2006.
- ✚ Haloçi Andromaqi, *Probleme të kulturës gjuhësore në tekste shkollore*, në “Akte të Konferencës Shkenore me temë “Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar”, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë, 2004, f.9-25.. Shkurtaç Gj., *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë, 2006, f.65-73.

- ✚ Hartup, W.W. "Peer Relations." *In handbook of child psychology, socialization, and social development*, edited by E.M. Hetherington. New York: Wiley & Sons, 1983.
- ✚ Hashorva O., *Gjuha shqipe në shkollat arbëreshe të Kalabrisë dhe Sicilisë*, në "Studime Albanologjike", II, Tiranë, 2011, f.345-350.
- ✚ Heidrich, D.. *Grammar and Punctuation, Grade 6*. Evan-Moor press, 2002.
- ✚ Helfrich Heinz (1964) *L' enseignement bilingue dans tout ses états*, in "Etudes de Linguistique Appliquée", nr. 96, Octobre- Décembre, pp. 9-31.
- ✚ Hoti Ardian, *Ndikimi i mediave shqip në Mal të Zi në mësimin e gjuhës shqipe*, në "Studime Albanologjike", II, Tiranë, 2011, f.369.
- ✚ Huntington P.Samuel, *Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror*, Logos, 2004.
- ✚ Hysa Enver, *Mbi ligjërimin e reklamës*, në "Akte të Konferencës Shkencore, 16 dhjetor 2004, Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, Tiranë, 2004, f. 82-88.
- ✚ Hysa Enver, *Përsëri për gjuhën e shtypit*, në "Kulturë gjuhsore",1,Prishtinë, 2003.
- ✚ Isa Avdullai, "Antiglobalizimi", Shkup, 2009.
- ✚ Islamaj Shefkije, *Anglishtja dhe latinizimi i ri i shqipes*, në "Akte të Konferencës Shkencore, 16 dhjetor 2004, Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, Tiranë, 2004, f.56-62.
- ✚ *Journal of Sociolinguistics*, Volume 7, Issue 3, pages 392–397, August 2003 Eckert 2003.
- ✚ Kandreva- C. Stamile, *C.Sperimentazione didattica in un ambiente bilingue arbëresh*, Corigliano Stazione, 1979.
- ✚ Kastrati, Jup, *Një studiuë i fjalëve iraniste (persishte) në gjuhën shqipe*. – *Perla* 1/1996, 2, 3–15.
- ✚ Kastrati, Jup, *Për historinë e marrëdhënieve gjuhësore shqiptaro-persiane*. – *Perla* 4/1999, 1, 24–31.
- ✚ Koleci Flora, *Mbi mësimdhëien e gjuhës shqipe si gjuhë e dytë*, në "Studime Albanologjike", II, Tiranë, 2011, f. 350-357.
- ✚ Kostallari, A., *Diskutim rreth kumtesës së N. Alpanit* "Ndikime e gjuhës dhe të letërsisë turke në gjuhën dhe letërsinë shqipe". – në: Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit–Skënderbeut. Tiranë, 12–18 janar 1968. III. Materiale të seksionit të shkencave filologjike. Tiranë, 1970, f. 311–315.

- ✚ Kostallari, A., *Rreth depërtimit të turqizmeve në gjuhën shqipe*, gjatë shekujve XVII-XVIII, në “Gjurmime albanologjike”, SSHF, Prishtinë, 1978.
- ✚ Krajni, Anton: *Hymja e turqizmeve në shqipen dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre*. – në: *Studime filologjike*, 1965, nr. 1, f. 144–151; *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe. II*. Universiteti Shtetëror i Tiranës Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1972, 279–286; përkthim frëngjisht: *Bref aperçu des emprunts turis en albanais*. – në: *Studia albanica*, 1966, nr. 2, f. 85–96.
- ✚ Kruno Krstiq, *Recnik govora Zadarskih Arbanasa*, Zadar, 1987.
- ✚ Labov W. (1977) *L'influenza relativa della famiglia e dei compagni sull' apprendimento del linguaggio*, SLI, Bulzoni editore, Roma.
- ✚ Labov W. (1973) *Lo studio del linguaggio nel suo contesto sociale*, in "Linguaggio e Società", Bologna.
- ✚ Lafe, Emil, *Një gjykim i Norbert Joklit lidhur me qëndrimin ndaj turqizmeve*. - *Perla* 10/2005, 3, 127–129.
- ✚ Lafe, Emil, *Persizmat në kuadrin e orientalizmeve të shqipes*. – *Perla* 4/1999, 1, 39–46.
- ✚ Lambertz, M. *Albanische Mundarten in Italien* (1915) dhe *Italo-Albanische Dialektstudien*, në KZ, 51 (1923), 52 (1924), 53 (1925).
- ✚ Larson, R. W., & Verma, S. (1999). *How children and adolescents spend time across the world: Work, play, and developmental opportunities*. *Psychological Bulletin*, 125, 701-736.
- ✚ Lilo Raul, *Çështje të normës leksikore në shtyp*, në “Akte të Konferencës Shkenore me temë “Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar”, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë, 2004, f.9-25..Shkurtaj Gj., *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë, 2006.
- ✚ Lloshi Xh., *Shqipja standarde në rrethanat e dygjuhësisë,*” St.fil.”, 2001, nr.3-4, f. 50.
- ✚ Luarasi, I. *Lajmet e transmetuara*. Shkrim dhe raportim. Shtëpia Botuese OMBRA GVG, Tiranë, 2000, f. 22- 50.
- ✚ Luka, David, *Ndihmesa e Tahir Dizdarit për historinë e gjuhës shqipe*. – *Phoenix* 3/1999, 3–4, 286–292; *Studime gjuhësore VII*. Shkodër, 2002, f. 202–207.
- ✚ M. Bolognari, *Il silenzio dellatradizione*, Roma, 1978.
- ✚ Maloku Nexhat, *Përvoja dhe udhëzime në lidhje me ruajtjen e aftësive gjuhësore të shqipes në Zvicrën gjermanishtfolëse*, kumtesë e mbajtur në Universitetin e Zyrihut, më 7 qershor, 2013, (faqe interenti).

- ✚ Mansaku Seit, *Probleme të historisë së gjuhës shqipe në dritën e marrëdhënieve të saj me greqishten*, në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2004, f.109.
- ✚ Mari, Denis. *Shtigje ndërkulturore: komunikimi virtual, si hapësirë e shndërrimeve socio-kulturore*, në “OPTIME”, nr.1, janar 2013, f.79-83.
- ✚ Marinesku. A. *Kodi i sjelljeve të pëlqyeshme sot*. Botimet “OMSCA-1”, 2000. f. 7.
- ✚ Mehdiu, Feti, *Ngulitja e disa persizmave dhe evoluimi i tyre semantik në gjuhën shqipe. – Perla 4/1999, 1, 47–56.*
- ✚ Mehdiu, Feti, *Orientalizmat: hyrja dhe përdorimi i tyre në gjuhën shqipe. “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”*.III. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1989, f. 407–411.
- ✚ Mehmetaj Nexhmije, *Përvoja dhe njohuri në lidhje me ruajtjen/ humbjen e kompetencave gjuhësore në Zvicrën gjermanishtfolëse*, kumtesë e mbajtur në Universitetin e Zyrihut, më 7 qershor, 2013, (faqe interenti).
- ✚ Meillet A. (1933) *Sur le bilinguisme*, Traduzione italiana "Sul bilinguismo" in AA.VV. *Il linguaggio*, Bari, 1976.
- ✚ Memushaj R., *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002.
- ✚ Memushaj R., *Vështrim mbi dygjuhësinë në Shqipëri*, “Studime albanologjike”, 1997, 2, f.101.
- ✚ Memushi Luan, *Shkolla dhe shoqëria përballë zbatimit të kulturës gjuhësore*, në “Akte të Konferencës Shkencore, 16 dhjetor 2004, Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, Tiranë, 2004, f. 5-9.
- ✚ Meyer, G. Lybke, Meyer W., *Die lateinischen Elemente im Albanischen*, Auflage 1888.
- ✚ Mihaescu, H. *I prestiti italiani nell' albanese*, në "Zjarri", XI, 1979, nr. 26, f. 17.
- ✚ Milo Paskal, *Bashkimi Evropian, ideja, integrimi, e ardhmja*, Tiranë, 2002.
- ✚ Moisiu, R., Tushe, E., Naqi, D., Ceka, N. dhe Spahiu L. *Arti i rritjes së fëmijëve*. Shtëpia Botuese dhe Shtypshkronja Pegi, Tiranë, 2005. f. 283-286; f. 415-418.
- ✚ Morina, Irfan, *Turqizmat si terminologji ushtarake në poemën epike shqiptare. – Univers 2006, 8, 173–180.*
- ✚ Muka Arben, *Depërtim në media*, Tiranë, 2003.

- ✚ Murati Q., *Shqipja përballë gjuhëve të tjera evropiane e rajonale-huazime leksikore dhe strukturore*, në “Akte të Konferencës Shkencore, 16 dhjetor 2004, Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, Tiranë, 2004, f. 26-36.
- ✚ Murphy, R. *English Grammar in Use. 2000*. Cambridge University Press, f. 152-155.
- ✚ Philips, G.M. and Vood J.T. – *Communication and Human Relationships*. New York: Macmillian, 1983
- ✚ Pizzorusso A. (1975) *Il pluralismo linguistico tra stato nazionale e autonomieregionali*, Pacini Editore, Pisa.
- ✚ Qosja Rexhep, *Fjalor demokratik*, Toena, Tiranë, 1997
- ✚ Richard A.Hudson, *Sociolinguistika* (Përkthyer nga M.Ymeri), “Dituria”, 2002.
- ✚ Ristani Viktor, *Kritika përkthimore dhe pastërtia e gjuhës*, në “Akte të Konferencës Shkencore me temë “Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar”, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë, 2004, f.162.
- ✚ Ristani Viktor, *Kritika përkthimore dhe pastërtia e gjuhës*, në “Akte të Konferencës Shkencore, 16 dhjetor 2004, Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, Tiranë, 2004, f.162-170.
- ✚ Rosenfeld, Lawrence B. “Human Communication”, New York, 1993
- ✚ Rushitaj Ramadan, *Shkolla shqipe në Suedi*, 2001
- ✚ Salvi, S. *Le lingue tagliate*, Milano, 1975, pp. 97.
- ✚ Samara, M., *Rreth huazimeve nga turqishtja në gjuhën shqipe. – Gjurmime albanologjike Seria e shkencave filologjike* (Prishtinë), 25/1995, 63–71.
- ✚ Samara, M., *Tahir N. Dizdari: Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*. Tiranë 2005, XVII + 1202 f. – në: *Studime filologjike*, 2005, nr. 3–4, f. 183–188 (recension).
- ✚ Samara, M., *Zhvillime leksiko-semantike të turqizimeve në gjuhën shqipe. – SFil 49/1995, 1-4, 61–68.*
- ✚ Samara, Miço: *Vështrim për fjalorin e pabotuar “Orientalizmat në gjuhën shqipe” të Tahir Dizdarit. – në: “Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët”. Simpozium ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë më 15, 16, 17 tetor 1992*.Prishtinë, 1995, f. 323–329.
- ✚ Schader Basil, *Shqyrtime rreth kontaktit mes shqipes dhe gjermanishtes*, Shtëpia Botuese Kristalina K-H,Tiranë, 2005.

- ✚ Sgroi.C. (1971) *Diglossia, Prestigio, Italiano Regionale*, in "L'insegnamento dell' italiano in Italia e all' estero", Roma.
- ✚ Shehu Hajri, *Mjetet e informimit masiv mund të ruajnë veten, por mund të ruajnë edhe të tjerët*, 23 Shkurt 2007.
- ✚ Shiroka Etleva, *Kuadri i përbashkët evropian për gjuhët*, në “Studime albanologjike”, II, Tiranë, 2011, f.365-369.
- ✚ Shkodra, Zija, *Kontribut për njohjen e diasporës shqiptare*, në "St. hist.", 3, 1971, f. 93-109.
- ✚ Shkurtaç Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës*, Tiranë, 2003.
- ✚ Shkurtaç Gj., *Kultura e gjuhës*, Tiranë, 2006.
- ✚ Shkurtaç Gj., *Kundërime gjuhësore*, Tiranë, 2006.
- ✚ Shkurtaç Gj., *Ligjërimit arbëreshe*, Tiranë, 2006.
- ✚ Shkurtaç Gj., *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë, 2008, 2013.
- ✚ Shkurtaç Gj., *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2009.
- ✚ Shkurtaç Gj., *Disa shënime për të folmen arbëreshe të Marceduzës*, në “Studime për nder të A. Xhuvanit”, Tiranë, 1986.
- ✚ Shkurtaç Gj., *Normëshkelësit duhet të përgjigjen për dëmin që i shkaktojnë gjuhë s shqipe*, në “Akte të Konferencës Shkenore me temë “Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar”, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë, 2004, f.9-25..Shkurtaç Gj., *Ligjërimit arbëreshe*, Tiranë, 2006.
- ✚ Siciliano, P. *Fjalorth i së folmes së Cercetos*, në "Dialektologjia shqiptare", VI, Tiranë, 1990, f. 453-510.
- ✚ Sorbrero A. (1973) *L'integrazione linguistica in giovani immigrati a Torino*, in "Parole e metodi", 6, pp.165-212.
- ✚ Sornicola R. (1977) *La competenza multipla. Un' analisi microlinguistica*, Liguori Editore.
- ✚ Spencer- Oatey. *Culturally Speaking*, 2008, f. 52.
- ✚ Stassi, L. *La cultura siciliana nella parlata di piana degli Albanesi*, në "Etnia Albanese e Minoranze Etniche e Linguistiche in Italia", Atti del IX Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo, 1981, pp. 97.
- ✚ Sula Artur, *Mbi disaprobleme të përkthimit në gjuhën shqipe*, në revista “Malësia”, 5, Podgoricë, 2010, f.105-112.
- ✚ Tabaku E.-Delia Sh., *Roli i shkollës në edukimin gjuhësor*, në “Akte të Konferencës Shkenore me temë “Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e

- shkruar”, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë, 2004, f.9-25..Shkurtaj Gj., *Ligjërimit arbëreshe*, Tiranë, 2006, f.65-73.
- ✚ Tabaku Elida, *Mësuesi si udhëheqës dhe model për një gjuhë të pastër amtare*, “Malësia”, 5, Podgoricë, 2010, f.113-118.
  - ✚ Tarifa Fatos, *Imagjinata sociologjike dhe bota jonë sociale*, Onufri, Tiranë, 2014.
  - ✚ Tarifa Fatos, *Pamundësia e projektit evropian*, Minerva, Tiranë, 2013.
  - ✚ Thomai Jani, *Leksikologjia*. Tiranë, 2003.
  - ✚ Thomai Jani, *Leksikologjia*. Tiranë, 2006.
  - ✚ Topalli Kolec, *Dialektet...*
  - ✚ Tradgil, Piter, *Kontakti gjuhësor në Greqi, Reduktimi dhe thjeshtimi në të folmet e shqipes në Atkë dhe në Beoti*, në librin e Vesel Nuhiut, *Ndikimet ndërgjuhësore*, Prishtinë, 1990, f. 275.
  - ✚ Varfi Nonda, *Shqipja e shkruar në rrugë*, në “Akte të Konferencës Shkencore, 16 dhjetor 2004, Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, Tiranë, 2004, f. 89-93.
  - ✚ Watts, R, J.. *Politeness*. Cambridge University Press, 2003.
  - ✚ Weinreich U. (1968) *Languages in contact*, The Hague.
  - ✚ Weinreich U. (1974) *Lingue in contatto (con saggi di Francescato, Grassi, Heilman)*, Torino, Boringheri.
  - ✚ Xhanari Lindita, *Veçori të përbashkëta të turqizmeve në gjuhët e Ballkanit*, Referim shkencor, Tiranë, 3.04.2014.
  - ✚ Xhuvani, A. *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1956.
  - ✚ Xhuvani, A., *Mbi thjeshtësinë e gjuhës*, në “Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës”, Tiranë, 1973, f.44.
  - ✚ Zeqiri Agron, *Anglicizmat në mediat shqiptare në Maqedoni*, në “Akte të Konferencës Shkencore, 16 dhjetor 2004, Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, Tiranë, 2004, f. 137-142.

